This provision is similar to the judgment in absentia as foreseen by the Albanian criminal procedural legislation. However, it is worth mentioning that this system has undergone continuous changes as a result of repeated findings of the ECtHR, which were mentioned above.

As a result of recent reform of the Italian legislation (Law no.60/2005), a number amendments were made to the trial in absentia regarding the notifications and the resetting of time limit allowed to appeal. With regard to notifications, it was provided the possibility of notifying the lawyer assigned for the unimprisoned defendant who has assigned a lawyer, regardless of whether the defendant has chosen a location where to receive notifications or not. It is the obligation of the defendant to be in contact with his lawyer in order to be informed on the developments about the process.

The question arises whether the notification of the assigned lawyer is equivalent (in terms of knowledge on the act) to the notification made to the defendant personally? There is an implied "weakness" in the presumption of acknowledging in cases of informing the officially assigned lawyer for the defendant in absentia. This notification is not sufficient to prove that the defendant was informed on the prosecution against him, with the exception of *aliunde* acknowledgment, i.e. as in the case when it is proven that the officially assigned lawyer has managed to create an effective professional relationship with the defendant.<sup>39</sup>

In conclusion, the trial in absentia should be held only in cases when there is sufficient evidence that the defendant is evading justice. In other cases, holding a trial in absentia is senseless not only because it does not guarantee the defendant's procedural rights, but also in the context of judicial economy, since after the defendant will receive notice of the punishment decision rendered against him, it will follow another process for resetting the time limit allowed to appeal.

---

<sup>39</sup> Even the jurisprudence of the High Court of Italy has been expressed about this case (Penal Cassation, Section I, decision 6.4.2006).

## CONSLUSIONS

In criminal proceedings the defendant has the right to be present at the court trial held against him, and he should be notified about the court trial held against him. There should exist preventive or repairing remedies in order to avoid the conducting of court trials in absentia of the accused or without them being notified, or to ensure the opening of a new court trials by introducing new evidence.

The court is obliged to take all the necessary measures to notify a person about the criminal charges raised and the criminal proceedings against him. The fact that this person could not be found or does not have a correct address should not be presumed as an expression of his will not to take part in the court proceedings or to file an appeal. The court should not proceed with the court trial in absentia of the accused unless it is unequivocally proved his notification about the court trial. Even though it might be considered as coming against the principle of reasonable time in the length of proceedings, because only in the case of a due process of law, in conformity with the constitutional model, it could be assessed the length of proceedings.

ECTHR has considered that it belongs to the Member States to find the adequate legal remedies in order to adopt the structure of criminal proceedings to the principles of due process of law and, in this context, an approach would be the closing (ending) of the criminal process at the first instance court. Given that after a long time it is very difficult to administer the evidence, to summon the witness etc., it is necessary that the process at the first instance court be held in absentia of the accused. If referring to the constitutional case law, according to which it could not be accepted an appeal submitted by the defense lawyer officially assigned or assigned by the defendant's families unless it is not proved that they express the defendant's will, then it is also reached the conclusion that in these cases the legal process should be closed at the first instance court. The criminal process could continue at the higher instance courts only when the accused notified, detained or extradited takes full knowledge about the process and expresses his will to exercise the right to appeal.

## BIBLIOGRAPHY

### Legislation

1. Criminal Procedure Code of the Republic of Albania, adopted by law no.7905, dated 21.03.1995, amended. Publication of Official Publication Centre.
2. Italian Code of Criminal Procedure, downloaded by Altalex – [www.altalex.com](http://www.altalex.com)
3. European Convention on Human Rights, ratified by the law no.8137, dated 31.07.1996.
4. Constitution of the Republic of Albania

### Literature

1. A. Vorpsi, Procesi i rregull ligjor në praktikën e Gjykatës Kushtetese të Republikës të Shqipërisë, Maluka 2011
2. Antonio Quatrone, Il processo penale – Contumacia: Evoluzione normativa e orientamenti della giurisprudenza nazionale ed internazionale, 2006
3. G. Conso, V. Grevi, Commentario breve al Codice di Procedura Penale, CEDAM, 2011
4. H. Islami, A. Hoxha, I. Panda, Komentari i Kodit të Procedurës Penale, 2003
5. Margherita Cassano, Erlisia Calvanese, Giudizio in contumacia e restituzione nel termine, Giuffrè Editore, 2008
6. M. Rrapi, Komentari i Kodit të Procedurës Penale, 2000
7. Protecting the right to a fair trial under the European Convention on Human Rights Council of Europe human rights handbooks Council of Europe, Strasbourg, 2012
8. Relazione n.50/2006, Corte Suprema di Cassazione, Servizio penale, Il giudizio in contumacia e la restituzione nel termine dopo la legge n.60 del 2005
9. Rezoluta (75) 11 “Për kriteret e gjykimit në mungesë të të akuzuarit”, e miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës
10. Right to a Fair Trial under the European Convention on Human Rights (Article 6), Interights Manual for Lawyers, 2009
11. S. Sadushi, Drejtësia kushtetuese në zhvillim, Toena 2012

**LIRIDON ZENKU**

**UNIVERSITETI NDËRKOMBËTAR I STRUGËS**

Kandidat për Master të Shkencave Juridike

Adresa: Mehmed Mehmedi Nr. 31 Kërçovë R. Maqedonisë

e-mail: zenku78@hotmail.com

## **E DREJTA DHE MËNYRA E DISPONIMIT ME TOKË NDËRTIMORE**

### **ABSTRAKT**

Me ligj rregullohen të drejtat dhe detyrat lidhur me tokën ndërtimore, kushtet dhe mënyrën e disponimit me tokën ndërtimore, si dhe çështjet tjera nga sfera e tokës ndërtimore.

Këtu është me rëndësi të përmenden zbatimi i dispozitave të ligjit, pastaj fitimi i të drejtës për disponim me tokën ndërtimore, dhënja me qira, dhe marja e të drejtës me disponimin e tokës ndërtimore.

Po ashtu duhet përmendur edhe mbikëqyrja, e drejta e shfrytzimit të tokës ndërtimore për koncesion ose partneritet publiko-privat, e drejta e shfrytzimit të përheshëm, hipoteka, tjetërsimi dhe dhënia me qira e tokës ndërtimore pronë e Shtetit nëpërmjet ankandit publik dhe me marrveshje të drejtpërdrejtë, pastaj mënyra dhe procedura e dhënies me qira afatshurtër dhe afatgjatë të tokës ndërtimore, pronë, rregullimi i tokës ndërtimore, raste të posaçme të marrjes së të drejtës së pronësisë së tokës ndërtimore.

E drejta për tokë ndërtimore ka dhe do të ketë për qëllim realizimin e plotë të detyrave për disponim me tokë ndërtimore dhe përsosja e detyrave për disponim me tokë ndërtimore që të realizojë qëllimet e veta në kushte të ndërlikuara në shoqërinë ku miratohet si e drejtë për tokë ndërtimore. Vizioni për të ardhmen është që kjo e drejtë të respektohet dhe zbatohet në

përpikshmëri si dhe të sofistikohet edhe më tej, gjithmon me qëllim drejt një ligji më efikas dhe më të sukseshëm ku personat fizik dhe juridik nuk do të kenë probleme në realizimin e të drejtës për shfrytëzimin e tokës ndërtimore.

## **Fjalët çelës: tokë ndërtimore, njohja, aplikimi, dispozitat**

### **HYRJJE**

Ashtu si që u theksua edhe në pjesën e përmbledhjes në këtë punim është bërë një vështrim i të drejtës dhe mënyrës së disponimit me tokë ndërtimore dhe nevoja e zbatimit të së drejtës. Këtu janë përdorur edhe shprehjet e veçanta dhe kuptimi i tyre. Në këtë kërkim do ti analizojmë dhe sqarojmë disa të drejta për shfrytëzimin e tokës ndërtimore si që janë: e drejta e shfrytëzimit të tokës ndërtimore për koncesion ose partneritet publik privat, e drejta për qira afatgjate, e drejta e qirasë afatshkurtër, e drejta e shfrytëzimit të përhershëm, hipoteka, tjetërsimi dhe dhënia me qira e tokës ndërtimore pronë e shtetit të Republikës së Maqedonisë nëpërmjet ankandit publik etj. Toka ndërtimore e rregulluar është tokë në të cilën janë të ndërtuara objekte të infrastrukturës komunale, për sigurimin e qasjes pa pengesë të parcela ndërtimore në rrugë publike, objekte të ujësjellësit, kanalizimit atmosferik dhe të fekaleve dhe instalimit tjetër, me lidhje deri te parcela ndërtimore. Toka ndërtimore sipas ligjit për tokë ndërtimore është tokë e ndërtuar dhe e pandërtuar, e planifikuar me plan urbanistik ose dokumentacion të planit urbanistik në pajtim me Ligjin për planifikim hapësinor dhe urbanistik.

Me ligj rregullohen të drejtat dhe detyrat lidhur me tokën ndërtimore, rregullimin e tokës ndërtimore, kushtet dhe mënyrën e disponimit me tokë ndërtimore, si dhe çështje tjera nga sfera e tokës ndërtimore.

Toka ndërtimore është e mirë me interes të përgjithshëm për shtetin dhe gëzon mbrojtje të posaçme në mënyrën dhe kushtet e përcaktuara me ligj. Rregullimi i tokës ndërtimore është veprimtari me interes publik.

Toka ndërtimore sipas ligjit për tokë ndërtimore është tokë e ndërtuar dhe e pandërtuar, e planifikuar me plan urbanistik ose dokumentacion të planit urbanistik në pajtim me Ligjin për planifikim hapësinor dhe urbanistik.

Në të drejtat e pronësisë së tokës ndërtimore dhe të drejta tjera reale zbatohen rregullat për pronësi dhe të drejta tjera reale, për peng kontraktues, për marrëdhëniet obliguese, për regjistrimin e të drejtave të patundshmërive dhe rregulla tjera.

Toka ndërtimore mund të jetë në pronësi të shtetit (Republikës së Maqedonisë), në pronësi të komunave dhe në pronësi të personave fizikë dhe juridikë vendës dhe të huaj, me kushtet e përcaktuara me ligj.

Pronësia e tokës ndërtimore e përfshin sipërfaqen e saj dhe gjithçka që është me të është e lidhur përherë, e gjendet në sipërfaqen ose nën të, nëse me ligjin për tokë ndërtimore ose ligj tjetër nuk është përcaktuar ndryshe. Kur toka ndërtimore në pronë të personave fizikë dhe juridikë me plan urbanistik ose dokumentacionit të planit urbanistik është planifikuar për ndërtimin e objekteve me interes publik për Republikën të përcaktuar me ligj, të drejtën parësore të blerjes e ka shteti Republika e Maqedonisë, në mënyrën e përcaktuar me ligj.

Objektet e ndërtuara në sipërfaqen e tokës ndërtimore, mbi ose nën sipërfaqe, me qëllim që të mbeten përherë, janë pjesë e asaj toke ndërtimore derisa nga ajo nuk ndahen, përveç nëse juridikisht i ndan nga ajo tokë e drejta reale ose ndonjë e drejtë tjetër, që bartësi i asaj të drejte e autorizon në tokë të huaj të ketë objekt në pronësi të vet ose nëse në bazë të koncesionit ose partneritetit publiko privat bartësi i asaj të drejte e autorizon në të, të ketë objekt në pronësi të vet. Objekti i përkohshëm nuk është pjesë e tokës ndërtimore dhe në bazë të objektit të përkohshëm nuk arrihen e drejta e pronësisë dhe të drejtat reale tjera në tokën ndërtimore.

## **TË DREJTA TË TOKËS NDËRTIMORE**

Pronësia e tokës ndërtimore e personave fizikë dhe juridikë e përfshin edhe të drejtën e ndërtimit në tokë, shfrytëzimin e tokës, si dhe të drejtën e bartjes së të drejtës së ndërtimit personave tjerë, në pajtim me ligjin për tokë ndërtimore dhe ligj tjetër. Personat fizikë dhe juridikë pronarë të pjesëve të veçanta të objektit ose objektit të ndërtuar në tokën ndërtimore në pronësi të tyre, vendosin të drejta dhe obligime të pronësisë së përbashkët të tokës ndërtimore. Pronësia e përbashkët e tokës ndërtimore e më shumë personave e përfshin të drejtën e shfrytëzimit të përbashkët me dedikim të tokës që nuk mund të ndahet në kuadër të parcelës ndërtimore, e bartet me të drejtën e pronësisë së pjesës së veçantë të objektit. Komunat mund ta fitojnë të drejtën e pronësisë së tokës ndërtimore nga personat fizikë dhe juridikë, me vendim të miratuar paraprakisht nga ana e këshillit. Pronësia e tokës ndërtimore e komunave e përfshin të drejtën e ndërtimit të tokës, shfrytëzimin e tokës, të drejtën e bartjes së të drejtës së ndërtimit të persona të tjerë, si dhe të drejtën e tjetërsimit të tokës ndërtimore, në pajtim me ligjin për tokë ndërtimore dhe ligj tjetër. Të gjithë personat fizikë dhe juridik dhe komunat mund ta shfrytëzojnë tokën ndërtimore në pronësi të Republikës së Maqedonisë, e dedikuar për përdorim të përgjithshëm.

E drejta e shfrytëzimit të tokës ndërtimore për përdorim të përgjithshëm dhe për lokalitete me interes publik të përcaktuara me ligj, Qeveria e Republikës së Maqedonisë mund t'ia bartë komunave, ndërmarrjeve publike dhe subjekteve tjera të themeluara nga Qeveria ose Kuvendi i Republikës së Maqedonisë.

Me tokën ndërtimore, pronë e Republikës së Maqedonisë, në emër të Republikës së Maqedonisë menaxhon Qeveria e Republikës së Maqedonisë. Toka ndërtimore në pronësi të Republikës së Maqedonisë mund të tjetërsohet, të jepet në shfrytëzim për shkak të dhënies me koncesion ose partneritetit publik privat, të jepet me qira afatgjate, me qira afatshkurtër, të shkëmbehet dhe në të të vendosen të drejta tjera reale, në mënyrë dhe me kushte të përcaktuara me ligjin për tokë ndërtimore dhe ligj tjetër. Toka ndërtimore, pronë e Republikës së Maqedonisë mund të tjetërsohet dhe jepet me qira afatgjate dhe afatshkurtër, me ankand publik dhe marrëveshje të drejtpërdrejtë dhe nëse me planin urbanistik ose dokumentacionin e planit urbanistik të parcelës ndërtimore parashihet ndërtimi i ndërtesave me interes publik të përcaktuara me ligj, me vendim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë. Me

ankand publik toka ndërtimore pronë e Republikës së Maqedonisë tjetërsohet dhe jepet me qira afatgjate kur:

- toka ndërtimore në kuadër të parcelës ndërtimore është tërësisht pronë e Republikës së Maqedonisë pa kufizime dhe më shumë se 70 % nga sipërfaqja e përgjithshme e parcelës ndërtimore është pronë e Republikës së Maqedonisë pa barra dhe kufizime.

Me marrëveshje të drejtpërdrejtë toka ndërtimore pronë e Republikës së Maqedonisë tjetërsohet në këto raste:

- për nevojat e bashkësive fetare për ndërtimin e objekteve fetare të parapara me planin urbanistik ose dokumentacionin e planit urbanistik, me pajtim të marrë paraprakisht nga ana e Komisionit për marrëdhënie me bashkësitë fetare dhe grupet religjioze, për nevojat e përfaqësive diplomatike konsullore për ndërtimin e objekteve diplomatike konsullore, për formimin e parcelës ndërtimore të paraparë me plan urbanistik ose dokumentacionin e planit urbanistik nëse personi ka në pronësi më shumë se 30 % të parcelës ndërtimore, pronarët e objektit ose pjesëve të posaçme të objekteve të ndërtuara me dokumentacion ndërtimor teknik dhe të evidentuar në librin publik të patundshmërive që nuk posedojnë akt për ndarjen e të drejtës së shfrytëzimit të tokës ndërtimore, dhe pronarët e objekteve ose pjesëve të posaçme të ndërtuara me dokumentacion ndërtimor teknik të tokës ndërtimore në të cilën e kanë themeluar të drejtën e qirasë afatgjate, nëse objektet janë ndërtuar në pajtim me planin urbanistik ose dokumentacionin e planit urbanistik dhe nëse e kanë paguar qiranë për vitin vijues dhe detyrimet tjera që dalin nga marrëveshja për qira afatgjate.

Me marrëveshje të drejtpërdrejtë, toka ndërtimore, pronë e Republikës së Maqedonisë mund të jepet me qira afatgjate për ndërtimin e objekteve me interes publik të përcaktuar me ligj, me pajtim paraprak nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe vendim të Këshillit të njësisë së vetadministrimit lokal. Lartësinë e çmimit të tokës ndërtimore, pronë e Republikës së Maqedonisë dhe lartësia e shpenzimeve të posaçme për zbatimin e procedurave për tjetërsim dhe dhënie me qira, i përcakton Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Toka ndërtimore në pronësi të Republikës së Maqedonisë, mund të shkëmbehet me tokë ndërtimore në pronësi të personave fizikë dhe juridikë, në të cilën është paraparë ndërtimi i objekteve me interes publik të përcaktuar me ligj. Për shkëmbim, Qeveria e Republikës së Maqedonisë miraton vendim me mendimin e marrë pozitiv paraprakisht nga Avokatia Shtetërore e Republikës së Maqedonisë. Shkëmbimi bëhet në bazë të marrëveshjes për shkëmbim që e nënshkruan ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve që i përkasin menaxhimit me tokë ndërtimore në pronësi të Republikës së Maqedonisë.

Toka ndërtimore në pronësi të Republikës së Maqedonisë, mund të shkëmbehet me tokë ndërtimore në pronësi të personave fizikë dhe juridikë, në të cilën është paraparë ndërtimi i objekteve me interes publik me rëndësi lokale të përcaktuar me ligj. Shkëmbimi kryhet në bazë të marrëveshjes për shkëmbim, që në emër të Republikës së Maqedonisë e lidh kryetari i komunës. Toka ndërtimore pronë e Republikës së Maqedonisë për ndërtimin e objekteve të infrastrukturës, jepet me qira afatgjate përkatësisht ndahet për shfrytëzim të përhershëm në pajtim me ligjin, në bazë të projektit për infrastrukturë. Çmimi i tokës ndërtimore, pronë e Republikës së Maqedonisë gjatë tjetërsimit dhe qirasë paguhet në denarë. Në marrëveshjet për tjetërsim dhe dhënie me qira afatgjate të tokës ndërtimore, pronë e Republikës së Maqedonisë, përcaktohet edhe afati për ndërtimin e ndërtesave, të përcaktuar me Ligjin për ndërtim, në varësi prej kategorisë së ndërtimit.

### **E drejta e shfrytëzimit të tokës ndërtimore për koncesion ose partneritet publik privat**

Për dhënie të koncesionit ose partneritet public privat në pajtim me ligjin për ndërtimin e objekteve ose kryerjen e veprimtarive përkatësisht dhënies së shërbimeve, toka ndërtimore, pronë e Republikës së Maqedonisë jepet në shfrytëzim për periudhën për të cilën ndahet koncesioni ose partneriteti publik privat. Qeveria e Republikës së Maqedonisë me kërkesë të komunave për realizimin e koncesionit ose partneritetit publik privat, si dhe me kërkesë të subjekteve tjera të cilat në pajtim me ligjin kanë të drejtë të zbatojnë procedura për partneritet publik privat, mund t'u japë në shfrytëzim tokë ndërtimore pronë e Republikës së Maqedonisë.

## **E drejta për qira afatgjate**

Në tokën ndërtimore mund të themelohet e drejta për qira afatgjate në dobi të personave fizikë dhe juridikë vendas dhe të huaj. Bartësi i së drejtës së qirasë afatgjatë të tokës ndërtimore është personi në dobi të cilit është themeluar ose ka kaluar në të e drejta, në bazë të veprës juridike ose vendimit gjyqësor. Bartësi i së drejtës për qira afatgjate është i obliguar që pronarit të tokës ndërtimore t'i paguajë qira. E drejta e qirasë afatgjate të tokës ndërtimore është e drejtë në tokë të huaj ndërtimore që e autorizon bartësin e tij që në sipërfaqe të asaj toke ose nën të, të ndërtohet objekt personal, e pronari i tokës është i obliguar që këtë ta durojë. E drejta për qira afatgjate në truallin ndërtimor nuk mund të ndahet nga trualli ndërtimor që e ngarkon dhe çdo person që në cilëndo të drejtë juridike do ta fitojë të drejtën e pronësisë të tokës së ngarkuar, ka fituar tokë të ngarkuar me qira afatgjate, nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe. E drejta në qira afatgjate të tokës ndërtimore mund të tjetërsohet dhe të trashëgohet, me ligji ose marrëveshjen për qira afatgjate, nëse me ligj ose marrëveshje nuk është përcaktuar ndryshe.

Objekti i ndërtuar në bazë të së drejtës për qira afatgjate të tokës ndërtimore, bartet, trashëgohet dhe ngarkohet së bashku me të drejtën e qirasë afatgjate.

E drejta e qirasë afatgjate të tokës ndërtimore në të cilën është ndërtuar objekti që pastaj është shkatërruar deri në atë masë që nuk mund të përdoret për qëllimin që është dedikuar, është bazë për shkëputjen e marrëveshjes, nëse në afat prej tre vitesh nga shkatërrimi, nuk ndërtohet sërish bile në masë sa është e domosdoshme të mund të përdoret për qëllimin për që është dedikuar.

Të drejtat tjera reale në dobi dhe në ngarkesë të së drejtës të qirasë afatgjate të tokës ndërtimore së bashku me objektin, mbeten si të drejta reale të themeluara në dobi, respektivisht në ngarkesë të tokës ndërtimore së bashku me objektin, me rendin e deriatëhershëm të përparësisë .

## **E drejta e qirasë afatshkurtër**

Në tokën ndërtimore, pronësi e Republikës së Maqedonisë, mund të themelohet e drejta e qirasë afatshkurtër në dobi të personave juridikë dhe fizikë vendas dhe të huaj, në pajtim me dispozitat e ligjit për tokë ndërtimore, që mund të zgjasë më së shumti deri në pesë vjet. Në tokën ndërtimore të pandërtuar mund të vendosen objekte të përkohshme në kushte dhe mënyrë të përcaktuar me Ligjin për ndërtim dhe Ligjin për vetadministrim lokal.

### **E drejta e shfrytëzimit të përhershëm**

Toka ndërtimore, pronë e Republikës së Maqedonisë e dedikuar për ndërtimin e objekteve për nevojat e organeve shtetërore, ndërmarrjeve publike dhe subjekteve të tjera, të themeluara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë ose Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, u jepet e drejta e shfrytëzimit të përhershëm të të njëjtave.

### **Hipoteka**

Në tokë ndërtimore në pronësinë e personave juridikë dhe fizikë dhe në pronësi të komunave, komunës të qytetit të Shkupit, mund të themelohet hipotekë gjyqësore, ligjore dhe kontraktuese, në pajtim me Ligjin për pronësi dhe të drejtat tjera reale dhe Ligji për peng kontraktues.

## **TJETËRSIMI DHE DHËNJIA ME QIRA E TOKËS NDËRTIMORE, PRONË E REPUBLIKËS TË MAQEDONISË NËPËRMJET ANKANDIT PUBLIK**

Procedurat për tjetërsimin dhe dhënien në qira afatgjate dhe afatshkurtër të tokës ndërtimore, pronësi e Republikës së Maqedonisë, në emër

të Republikës së Maqedonisë i udhëheqin komunat, komunat në qytetit të Shkupit dhe qyteti i Shkupit, secili në rajonin e vetë përcaktuar me ligj, përveç procedurës për tjetërsim të tokës ndërtimore pronë e Republikës së Maqedonisë, për nevojat e përfaqësive konsullore diplomatike për ndërtimin e objekteve konsullore diplomatike.

Procedura për tjetërsim dhe dhënien me qira afatgjate të tokës ndërtimore, pronë e Republikës së Maqedonisë nëpërmjet ankandit publik, zbatohet në pajtim me dispozitat e ligjit për tokë ndërtimore, me ankand elektronik me shpallje të dhënë paraprakisht nga Komisioni për zbatimin e procedurave për ankand publik në:

1. Dy gazeta ditore të cilat publikohen në gjuhën maqedonase, e dalin së paku tre muaj para ditës së publikimit të shpalljes,

2. Një gazetë ditore që botohet në gjuhën që e flasin së paku 20% nga qytetarë që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase në komunat, komunat e qytetit të Shkupit dhe qytetin e Shkupit në rajonin e të cilave gjendet toka ndërtimore lëndë e shpalljes, e del së paku tre muaj para ditës së publikimit të shpalljes dhe në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Nëse Republika e Maqedonisë është pronar i më shumë se 70% të sipërfaqes së parcelës ndërtimore, trualli, pronë e Republikës së Maqedonisë mund të jetë lëndë e tjetërsimit ose dhënies me qira afatgjate me ankand publik me ç'rast shpallja përmban obligim që blerësi i ardhshëm, respektivisht qiramarrësi, zgjedhjen e marrëdhënieve pronësore juridike për sipërfaqen tjetër të parcelës ndërtimore pronë e personave tjerë, ta kryejë me pronarët tjerë të tokës në pajtim me ligjin.

Nëse shpallja për tjetërsim ose dhënie me qira afatgjate apo afatshkurtër të tokës ndërtimore pronë e Republikës së Maqedonisë, përmban kushte të veçanta plotësuese, komunat, komunat e qytetit të Shkupit dhe qyteti i Shkupit janë të obliguara që para shpalljes të sigurojnë pëlqim për shpalljen e të njëjtës nga organi i administrates shtetërore, kompetent për kryerjen e punëve të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin me tokë ndërtimore në pronë të Republikës së Maqedonisë, që në afat prej pesë ditësh nga pranimi i kërkesës

## The Heritage

do të prononcohet për të njëjtën. Nëse nuk prononcohet në afat prej pesë ditësh, përgjigjja do të konsiderohet si pozitive.

Kushtet të veçanta plotësuese që mund të parashihen me shpallje janë:

- lartësia e qarkullimit të kapitalit të personit juridik që do të paraqitet për pjesëmarrje në ankandin publik;

- numri i objekteve të ndërtuara ose objekteve në pronë të personit juridik që do të paraqitet për pjesëmarrje në ankandin publik varësisht nga dedikimi i tokës lëndë e shpalljes publike;

- numri i personave të punësuar te personi juridik që do të marrë pjesë në ankand publik;

- numri i personave të cilët pas ndërtimit të objektit afariste do të punësohen;

- personi juridik të kuotojë në njërën prej bursave të njohura botërore ose të jetë person juridik që është i kontrolluar nga trupi rregullator dhe

- personi juridik të posedojë licencë adekuate ose të jetë i specializuar për ndërtimin e objekteve, lëndë e shpalljes publike.

Pjesëmarrjen në ankandin publik personat e interesuar juridikë dhe fizikë e vërtetojnë me parashtrimin e fletëparaqitjes me shkrim për pjesëmarrje në ankandin publik, në të cilën janë shënuar të dhënat për cilën parcelë ndërtimore ka të bëjë fletëparaqitja, për parashtruesin e fletëparaqitjes, si dhe për llogarinë e transaksionit ose llogarinë rrjedhëse në të cilën do të kthehet depozita për pjesëmarrje në ankandin publik.

Ankandi publik konsiderohet i përfunduar në momentin e kalimit të kohës së caktuar në shpallje, me ç'rast nëse gjatë kalimit të dy minutave të fundit nga ana e pjesëmarrësve jepet ofertë, afati i fundit për mbarimin e ankandit publik vazhdon edhe dy minuta. Vazhdimi i afatit të fundit lejohet më së shumti tre herë, gjatë ankandit publik.

## **TJETËRSIMI DHE DHËNJA ME QIRA AFATGJATE E TOKËS NDËRTIMORE NË PRONËSI TË REPUBLIKËS TË MAQEDONISË ME MARRËVESHJE TË DREJTJPËRDREJTË**

Tjetërsimi dhe dhënia me qira afatgjate e tokës ndërtimore, pronësi e Republikës së Maqedonisë me marrëveshje të drejtpërdrejtë, bëhet me parashtrimin e kërkesës nga personi fizik ose juridik. Kundër aktvendimeve dhe konkluzioneve të miratuara në udhëheqjen e procedurave për tjetërsim dhe dhënien me qira afatgjate të tokës ndërtimore pronësi e Republikës së Maqedonisë me marrëveshje të drejtpërdrejtë, mund të parashtrohet ankesë te ministri. Kur toka ndërtimore tjetërsohet me marrëveshje të drejtpërdrejtë, pronarëve tjerë të objekteve ose pjesëve të caktuara të objekteve të ndërtuara me dokumentacion ndërtimor teknik dhe të evidentuar në librin publik të patundshmërive që nuk posedojnë akt për ndarjen e të drejtës së shfrytëzimit të tokës ndërtimore, me kërkesë parashtrohen dëshmitë në vijim:

- certifikatë e planit urbanistik ose dokumentacionit të planit urbanistik me parcelë të definuar ndërtimore;

- elaborat gjeodezik për të dhëna numerike me listën e të dhënave për formimin e parcelës ndërtimore;

- aktzotërim që deri në ditën e parashtrimit nuk është më i vjetër se 30 ditë, me regjistrimin e të drejtës së pronësisë të parashtruesit të kërkesës, aktzotërim për tokën ndërtimore pronësi e Republikës së Maqedonisë, që deri në ditën e parashtrimit nuk është më i vjetër se 30 ditë;

- certifikatë për pasqyrën historike për regjistrimet e kryera në Agjencinë për Kadastër të patundshmërive për tokën ndërtimore të lëndës, pronësi e Republikës së Maqedonisë për periudhën prej kur është themeluar kadastra e tokës në komunën kadastrale, me identifikimin e parcelës kadastrale dhe komunës kadastrale dhe

- dëshmi për regjistrim nëse parashtruesi i kërkesës është person juridik respektivisht fotokopje të letërnjoftimit ose dokumentit të udhëtimit nëse parashtruesi i kërkesës është person fizik.

Pronarët e objekteve ose pjesëve të veçanta të objektit të ndërtuara me dokumentacion ndërtimor teknik të tokës ndërtimore ku kanë themeluar të drejtë për qira afatgjate, nëse objektet janë ndërtuar në pajtim me planin urbanistik ose dokumentacionin e planit urbanistik dhe nëse e kanë paguar qiranë për vitin rrjedhës dhe detyrimet tjera që dalin nga marrëveshja për qira afatgjate, mund të parashtrojnë kërkesë që t'u tjetërsohet toka ndërtimore me marrëveshje të drejtpërdrejtë. Qiratë që janë paguar deri në ditën e parashtrimit të kërkesës, nuk llogariten në çmimin për tjetërsimin e tokës.

### **Mënyra dhe procedura e dhënies me qira afatshkurtër të tokës, pronë e Republikës së Maqedonisë**

Procedurën për dhënien e tokës me qira afatshkurtër e udhëheqin komunat, komunat e qytetit të Shkupit dhe qyteti i Shkupit, varësisht nga rajoni i tyre i përcaktuar me ligj. Kryetari i komunave, komunave të Qytetit të Shkupit dhe qytetit të Shkupit, në emër të Republikës së Maqedonisë lidhin marrëveshje për qira afatshkurtër që ka fuqi të dokumentit zbatues. Toka ndërtimore, pronë e Republikës së Maqedonisë jepet me qira afatshkurtër nëpërmjet ankandit publik. Procedura për dhënien me qira afatshkurtër të tokës ndërtimore pronësi e Republikës së Maqedonisë nëpërmjet ankandit publik, zbatohet në pajtim me dispozitat e ligjit për tokë ndërtimore që kanë të bëjnë me procedurën për tjetërsim dhe dhënie me qira afatshkurtër të tokës ndërtimore, pronësi e Republikës së Maqedonisë nëpërmjet ankandit publik. Toka ndërtimore, pronësi e Republikës së Maqedonisë mund të jepet me qira afatshkurtër me marrëveshje të drejtpërdrejtë, me parashtrimin e kërkesës te komuna kompetente dhe të pronarëve të objektit hotelierik para të cilëve është paraparë plazhi, dhe personave juridikë dhe fizikë për nevojat e formimit të kantierit.

Marrëveshja për dhënien e tokës ndërtimore pronësi e Republikës së Maqedonisë me qira afatshkurtër, veçanërisht i përmban:

- lëndën e marrëveshjes,
- të dhënat për tokën ndërtimore,

## The Heritage

- dedikimin dhe të dhëna për objektin e përcaktuar me program,
- afatin dhe mënyrën e pagimit të qiramarrjes,
- lartësinë e qiramarrjes,
- detyrimin e blerësit për pagesën shpenzimeve të noterit dhe
- kushtet për ndërprerjen e marrëveshjes.

### **RREGULLIMI I TOKËS NDËRTIMORE**

Rregullimi i tokës ndërtimore sipas ligjit për tokë ndërtimore është ndërtimi i objekteve me infrastrukturë komunale, për sigurimin e qasjes së papenguar te parcela ndërtimore me rrugë publike, vendosjen e ujësjellësit, kanalizimit të fekaleve dhe atmosferik dhe instalimit tjetër me lidhje në parcelën ndërtimore. Shkallën e rregullimit të tokës ndërtimore me objekte të infrastrukturës komunale dhe mënyrën e përcaktimit të lartësisë së shpenzimeve për rregullim varësisht nga shkalla e rregullimit, e përcakton ministri. Programi për rregullimin e tokës ndërtimore veçanërisht i përmban të dhëna për:

- hapësirën që është lëndë e rregullimit,
- vëllimin e punëve për përgatitjen dhe pastrimin e tokës ndërtimore,
- vëllimin dhe shkallën e pajisjes së tokës ndërtimore me objekte të infrastrukturës themelore dhe sekondare,
- burimet për financimin e programit,
- llogaritjen e shpenzimeve për rregullimin e tokës ndërtimore,
- lartësinë e kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore dhe klasifikimin e saj,

## The Heritage

- mënyrën e klasifikimit të mjeteve për financimin e ndërtimit dhe mbajtjen e infrastrukturës,

- dinamikën e realizimit të programit dhe

- objektet e infrastrukturës me interes publik për Republikën e Maqedonisë dhe vlerësimin për ndikimin e saj në mjedisin jetësor dhe natyrën në pajtim me ligjin, që i financon Republika e Maqedonisë, respektivisht investuesi të cilit ia tjetëron tokën Republika e Maqedonisë. Kur rregullimi i tokës kryhet nëpërmjet pjesëmarrjes së partnerit privat, i njëjti ka të drejtë për kthimin e investimit në mënyrën që do ta kontraktojë me komunat, komunat e qytetit të Shkupit dhe qytetin e Shkupit, e veçanërisht nëpërmjet pagesave të shfrytëzuesve të rinj të objekteve të vendosura. Për tokën ndërtimore të rregulluar investuesi paguan kompensim. Për kompensimin e rregullimit të tokës ndërtimore si dhe për mënyrën e pagimit të kompensimit, investuesi me kryetarin e komunave, komunave të qytetit të Shkupit dhe qytetit të Shkupit lidh marrëveshje, në të cilën rregullohen të drejtat dhe detyrat e palëve kontraktuese me afate të përcaktuara për realizimin e të njëjtave. Në rast kur toka ndërtimore nuk është rregulluar me objekte të infrastrukturës komunale, investuesi nuk paguan kompensim për rregullim dhe mundet vet ta rregullojë tokën ndërtimore në shpenzim të vet. Mirëmbajtjen e objekteve të infrastrukturës në tokën e rregulluar ndërtimore, e kryejnë subjektet që ekonomizojnë me objektet e infrastrukturës në pajtim me ligjin.

### **Raste të posaçme të marrjes së të drejtës së pronësisë së tokës ndërtimore**

Personi që e shfrytëzon tokën e pandërtuar dhe të ndërtuar ndërtimore të bartur nga pronari i mëhershëm privat, mund ta marrë të drejtën e pronësisë së asaj toke nëse të njëjtën e shfrytëzon në bazë të marrëveshjes së lidhur me pronarin e mëhershëm më tepër se 20 vjet nga dita e lidhjes së marrëveshjes dhe kur do të paguajë tatimin mbi qarkullim të tokës. Procedurën për marrjen e të drejtës së pronësisë nga ky ligj e mban komuna, komuna në qytetin e Shkupit në rajonin e së cilës shtrihet toka ndërtimore dhe ngritët në bazë të kërkesës.

## KONKLUZION

Si që u tha edhe më lart, sjellim përfundim se e drejta për tokë ndërtimore ka pasur dhe ka për qëllim zbatimin, rregullimin, kushtet dhe mënyrën e disponimit me tokën ndërtimore, dhënja me qira afatshkurte dhe afatgjate, shfrytëzimi i tokës ndërtimore për koncesion ose partneritet publiko privat e drejta e shfrytëzuesit të përhershëm etj.

Vizioni për të ardhmen është që kjo e drejtë të respektohet dhe zbatohet në përpikshmëri si dhe të sofistikohet edhe më tej, gjithmon me qëllim drejt një ligji më efikas dhe më i sukseshëm ku personat fizik dhe juridik nuk do të kenë probleme në realizimin e të drejtës për shfrytëzimin e tokës ndërtimore.

## Referenca:

- Ligji për tokë ndërtimore G.Z.e R.M. nr. 82/08, 56/10, 53/01 dhe 53/11;
- Ligji për Eksproprijim G.Z. e R. M. nr.95/12, 24/13;
- Ligji për Vlersim Tome Velkoski 2012 ;
- Ligji për ndërtimtari 2005;
- Ligji për Revizion shtetërorë 2010

## The Heritage

-Zakoni od oblasti na dokumentiranje i upravuvanje so gradezno zemjishite 2012;

-Burime të tjera nga Fakulteti i Gjeodezisë në Shkup;

-Burime të ndryshme nga Interneti.

**Doc.Dr. Agim Nuhiu**

Universiteti Shtetëror i Tetovës

agimnuhiu@hotmail.com

**MSc.Senada Laçka**

International University of Struga

Asistent of Law Sciences

s.laçka@eust.edu.mk

## **HECURIA E PROCESIT INTEGRUES TË R.MAQEDONISË NË BASHKIMIN EVROPIAN, PËRPJEKJET DHE PENGESAT**

### **ABSTRAKT**

Nisur nga realiteti i një bashkëpunimi shumë të suksesshëm evropian, politik dhe rajonal, për më shumë se pesëdhjetë vjet, Bashkimi Evropian është shumë aktiv në ndihmën që i ofron vendeve të Ballkanit Perëndimor për forcimin e demokracisë dhe bashkëpunimit më të ngushtë, ndërkohë që nxit një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik në këtë rajon. Shqipëria, Bosnia dhe Hercegovina, Kroacia Maqedonia, Sërbia dhe Mali i Zi janë angazhuar ndaj konceptit të një stabiliteti të qëndrueshëm ekonomik, social dhe politik, që garantohet përmes lidhjesh dhe marrëdhëniesh më të ngushta me Evropën.

Nevoja për ndryshme në Ballkan dhe integrimi i saj në politikat e përditshme evropine është me se e domosdoshme për qytetarët sepse periudha e tranzicionit ka harxhuar vullnetin politik të politikbërësve dhe një inkuadrim i drejtpërdrejtë në një rreth të ri politik dhe ekonomik është rruga e vetme e ndryshimit.

Hecuria e procesit integrues të R.Maqedonisë në bashkimin evropian, përpjekjet dhe pengesat

## **Fjalët çelës: Bashkim Evropian, bashkepunim, integrim, politik**

### **HYRJE**

Integrimi evropian po hec përpara me hapa te shpejtë. Qytetarët e Evropës gjithnjë e më shumë po e njohin përditshmërinë e tyre përmes tregut të brendshëm dhe Euro-së si pjesë e një Bashkësie të Përbashkët Evropiane. Konfliktet mbarë botërore dhe krizat e vendeve fqinje të Bashkësisë Evropiane po kuptohen gjithnjë e më shumë si apele drejtuar përgjegjësisë që ka politika e përbashkët e jashtme e Evropës. BE-ja gjendet para sfidave integruese që i tejkalojnë shumëfish dimensionet e problemeve dhe reformave të brendshme që janë të nevojshme për të.

. Sfida kryesore e BE-se është shpërndarja e paqes dhe sigurisë përtej kufijve të Bashkimit Evropian. Për t'u ndeshur me këtë sfida, BE-ja zhvillon politikën e përbashkët të punëve të jashtme dhe sigurisë, në mënyrë që të veprojë si forcë e stabilitetit, bashkëpunimit dhe mirëkuptimit në tërë botën.

Përpjekjet e Maqedonisë për të qënë së paku në pragun e BE-së janë të hershme, që kur shteti yne fitoi pavarësinë e vet. Evropa dhe vlerat e saj, siç janë modeli i demokracisë, shteti evropian i së drejtës parlamentare, pluraliste dhe multietnike, ekonomia e tregut, diversiteti multikulturor, filozofia liberale, fryma kooperative, rajonale dhe trendi i integrimi evropiane dhe euroatlantike kanë gjeneruar fuqishëm në realitetin e perditshem saqë sot me të drejtë mund të thuhet se Maqedonia e tërë, bashkë me qytetarët e saj po bën përpjekjet e saja maksimale për tu shëndruar në një nga pjesët më të evropianizura të Ballkanit Perëndimor, edhe pse gjate rrugëtimit të saj ka hasur në shumë pengesa e ka kryer gabime, që sot po i paguan me ngecjen e integrimin të vendit.

### **PËRFITIMET E MAQEDONISË NGA ANTARËSIMI DHE PENGESAT PËR EURONTEGRIMIN E SAJ**

Hecuria e procesit integrues të R.Mmaqedonisë në bashkimin evropian,përpjekjet dhe pengesat

Sistemi institucional i BE-së vazhdimisht u është nënshtruar trajtimeve teorike- shkencore, analizave dhe qasjeve nga shumë autorë dhe shumë këndvështrime.<sup>1</sup> Shqyrtimet për këtë system fokusohen në trajtimin e lindjes dhe zhvillimit të proceseve politike dhe ekonomike si dhe në vetë sistemin e BE-së. Procesi i integritit europian ka ndikuar dhe në krijimin e një zonë lirie, sigurie dhe drejtësie, bazuar mbi parimin bazë të lëvizjes së lirë të mallërave, shërbimeve, të personave dhe kapitalit në të gjitha vendet e BE-së.<sup>2</sup> Në trajtimet teorike vëmendje të vacantë i kushtohet edhe plotësimit të kriterëve politike të Maqedonisë, si psh. konsolidimi i pushtetit, zgjedhja dhe funksionimi i qeverisë, puna e gjykatave, mediave, etj. si kushte që duhet të plotësohen në procesin e integritit në BE. Vend të meritaur zë edhe analiza e përmbajtjes dhe e synimeve të marrëveshjes për stabilizim-asociim ndërmjet Maqedonisë dhe BE-së.

Teoria e integritit trajton zhvillimin e BE-së duke filluar nga bashkimi i gjashtë vendeve të Europës perëndimore (Francë, Gjermani, Itali, Belgjikë, Holandë, Luksmeburg), të cilat më 18 prill 1951, në Paris lidhën traktatin e parë të Komunitetit Europian – traktatin për Bashkësinë Europiane “Për qymir dhe çelik”.<sup>3</sup>

Po ashtu, objekt trajtimi i teorisë së integritit është edhe traktati “Për themelimin e Komunitetit Ekonomik Europian” që u nënshkrua më 25 mars 1957 në Romë<sup>4</sup> dhe traktati “Për themelimin e Komunitetit Europian për Energji Bërthamore, Akti Unik Europian, Traktati i Mastrihtit, Traktati i

---

<sup>1</sup> Y. Doutriaux – C. Lequense, Institucionet e Baskimit Europian, Tiranë, 2007, fq. 25-29

<sup>2</sup> Marrëeshja për stabilizim-asociim mindis Maqedonisë dhe Bashkimit Europian. Luksemburg, 2001.

<sup>3</sup> Shih: R. Blanplain, J.C. Javiller, Droit du travail communautaire, Paris, 1998, fq. 7

<sup>4</sup> Azizi Abdulla, Bashkimi Europian, e drejta, institucionet dhe politikat, Tetove, 2010, fq. 16.

Amsterdami, Traktati i Nicës, Kushtetuta për Europën, Traktati i Lisbonës, etj.<sup>5</sup>

Nisur prej çfarëdo këndi për integrimin e Maqedonisë, vijmë te një e vërtetë e pamohueshme: Maqedonia është pjesë e Evropës dhe megjithatë herët ose vonë do të jetë edhe pjesë e BE-së.

Qëllimet bazë të integritit të RM-së do të mund të definoreshin në drejtim të konsolidimit të sistemit politik demokratik, përshejtimin e zhvillimit social dhe ekonomik, thellimi i bashkëpunimit me shtetet anëtare të BE-së dhe vendeve kandidate për anëtarësim, konsolidimi i pozitës maqedonase në planin ndërkombëtar dhe pranimi i identitetit ndërkombëtar maqedonas si shtet paqedashës plotësisht dhe pazezervë i orientuar drejt proceseve integrative.

Përfitimet e shtetit tonë janë të shumta:

- zhvillimi i përgjithshëm social dhe ekonomik i stimuluar me stabilitetin politik dhe rrethimi ekonomik;
- zmadhimi i sigurisë nacionale përmes mekanizmave të përbashkët dhe politikës së sigurisë;
- mundësia e participimit në vendimet e ndryshme kyçe për çështjet evropiane dhe botërore;
- e drejta e pjesëmarrjes në tregun unik evropian, njërin prej tregjeve më të mëdhenj dhe më të fuqishëm në botë;
- mundësia e shfrytëzimit të Unionit Monetar për impuls të ri të zhvillimit;
- hapja e mundësive të reja për punësim të qytetarëve të RM-së;
- jetesë më e mirë, në nivel të standardit të jetesës së shteteve të zhvilluara demokratike dhe ekonomike anëtare të BE-së etj.<sup>6</sup>

---

<sup>5</sup> Iva Zajmi, E drejta evropiane, Tiranë, 2007, fq. 13-60.

<sup>6</sup> Grup autorësh; Evrodijalog, Studentski zbor, Shkup, 2002, fq.(7-10)

Mosanëtarësimi i RM-së në BE do të thotë mosplotësimi i pikave të lartpërmendura, e nuk përjashtohet edhe keqësimi i gjendjes së saj në aspektin nacional dhe ndërkombëtar, pra në atë të brendshëm dhe të jashtëm. Mirëpo anëtarësimi nuk vjen pa plotësimin e kushteve që kërkon Bashkimi Evropian. Në këto bëjnë pjesë edhe obligimet që ka RM-së ndaj popullsisë shqiptare e parasegjithash:

-të inkuadrojë shqiptarët në institucionet e saj shtetërore dhe të bëhet përfaqësimi adekuat i tyre;

-të lejojë përdorimin e gjuhës shqipe në insitucione dhe në komunikimin brenda vendit;

- të bëjë përpjekjet për zgjidhjen finale të problemit të shkollimit të shqiptarëve në Maqedoni”<sup>7</sup>, etj.

Luftërat e Ballkanit në mënyrë drastike ua sollën edhe njëherë para syve të evropianëve çështjen e kufijve. Perceptimet e ndryshme të interesave, pozicioni i shquarjes së vendimeve në Grupin e Kontaktit dhe prezenca e fortë amerikane në NATO, e detyruan Evropën të bëhet aktor dytësor në marrëdhënjet ndërkombëtare. Përmes zgjërimit të saj BE-ja ka hyrë në një situatë edhe më ekspozuese dhe në të ardhmen do të konfrontohet me kufijtë e saj të jashtëm, me potencialin e konflikteve dhe fqinjët e rrezikshëm. Zgjërimi i BE-së ose do të kuptohet si fazë përfundimtare e një historie të suksesshme që po i afrohet fundit, ose, si hyrje në një situatë të re. Kush i ka parasysh përmasat dhe ndikimin e këtij ndryshimi radikal konceptual, duhet të paramendojë perspektiven e Evropës në një mënyrë tjetër. Edhe pse për ironi, vala e re e integritit të Evropës është duke u ndeshur me kufij dhe pengesa, sepse, nga njëra anë, është po integrimi ai që pakëson aftësinë e shteteve për të mbrojtur vetveten dhe qytetarët nga problemet dhe konfliktet e shumta të botës, është po ai integrim i cili i bashkon shtetet si Maqedonia ne nje fill të përbashkët me shtete dhe aleatë të fuqishëm për të përballuar së bashku

---

<sup>7</sup> Reka, Blerim “E drejta e Unionit Evropian”, Prishtinë, 2000, fq. 225

ndryshimet që sjell koha modern dhe rend i ri botëror në marrëdhënjet ndërkombëtare.

## MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIM

Në Evropën Juglindore, konfliktet lidhur me problemet etnike të minoriteteve, synimet për ndarje dhe integriteti territorial i kërcënuar, sistemet jostabile politike, shoqëritë e pazhvilluara civile dhe menaxhimet e gabuara të transformimit ekonomik janë virulente, që qartësojnë distancën e madhe ndaj shteteve hyrëse.

Prapë se prapë, perspektiva për antaresim, në kohët e fundit, edhe për shtetet juglindore të Evropës, përdoret për zhvillim demokratik dhe ekonomik. Dinamikës së konfliktit dhe dhunës në mes shteteve pasuese të Jugosllavisë, që shkapërdredhej prej katër shteteve që përbëheshin po nga aq popuj, BE-ja nuk kishte për një kohë të gjatë strategji për stabilizim. Me propozim të BE-së, G8, në qershor të vitit 1999, në takimin e nivelit të lartë në Keln, pranoi *“Paktin për Stabilitet të Evropës Juglindore”*. Pakti për Stabilitet është një kornizë e gjërë për koordinim, për aktivitetet e shteteve të bashkuara internacionale me qëllimin e prevencës aktive të krizave.

Integrimi i Republikës së Maqedonisë në Bashkësinë Evropiane paraqet qartë dhe padiskutueshëm interes strategjik të shprehur dhe qëllim prioritar në politikën e RM-së. Kjo dalngadalë është në një rrjedhë të mirë e të volitshme, kur kemi parasysh faktin e nënshkrimit të Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asocim në Prill të vitit 2001 në Qendrën evropiane të kongreseve në Luksemburg, ku morën pjesë 15 ministrat e Punëve të Jashtme të BE-së dhe delegacioni zyrtar i Maqedonisë i udhëhequr nga kryeministri Lubço Georgievski, ministri i Punëve të Jashtme Sërxfan Kerim, nënkryetarët e Qeverisë Bedredin Ibrahimi, Zoran Kërstevski, si dhe kryetarët e partive politike në vend, me përjashtim të PPD-së, AD-së dhe PS-së.

Komisioni Evropian shpalli në Maj 1999, procesin e Stabilizim Asocimit, i cili përcakton parimet përmes të cilave vendet dhe popujt e rajonit përparojnë drejt integritetit dhe anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Ndër Hecuria e procesit integrues të R.Mmaqedonisë në bashkimin evropian, përpjekjet dhe pengesat

prioritetet e përcaktuara tashmë përfshihen: hapja e perspektivës për integrimin e plotë në strukturat e BE-së, gjasa për status politik të një kandidati për antarësim, avancimi i demokracisë, shteti juridik, zhvillimi ekonomik, struktura të përshtatshme për bashkëpunim rajonal, legjislacion dhe çështje të brendshme, tregti preferenciale, duke përfshirë mundësinë për ndërtim të zonave për tregti të lirë, ndihmë ekonomike dhe financiare si dhe dialog politik. Qëllimi i këtij procesi, i cili i përfshin Shqipërinë, Bosnje-Hercegovinën, Maqedoninë dhe Kroacinë, është që të krijohen rrethanat për zhvillim të suksesshëm të bashkëpunimit në Ballkanin perëndimor, si mes shteteve, ashtu edhe në politikën e tyre me BE-në.

Ky proces mund të shikohet si hap i parë në rrugën për anëtarësim në BE për shtetet e Ballkanit Perëndimor dhe është shenjë e qartë për marrëdhënie më të ngushta të rajonit dhe BE-së. Ky proces i jep përkrahje reformave të sjellura dhe zhvillimit të shteteve hartuar sipas kërkesave të çdo shteti, në bazë të marrëveshjeve të posaçme.

Procesi i stabilizimit dhe asocimit jep dy instrumente komplementare: Marrëveshjen për Stabilizim dhe Asocim e vënë në mënyrë bilaterale në mes shteteve dhe BE-së, dhe Programit për ndihmë KARDS (Ndihmë e Unionit për rekonstruim, zhvillim dhe stabilitet), qëllimi i së cilës është ndihmë çdo shteti për integrimin e saj në BE.

Shteti ynë është ndër të parët në procesin e stabilizimit dhe asocimit. Bisedimet filluan në Shkup në muajin mars të vitit 2000 dhe pas tre raundeve bisedimesh Marrëveshja për Stabilizim dhe Asocim ishte nënshkruar në margjinat e Samitit të Zagrebit, në nëntor të vitit 2000, derisa formalisht ishte nënshkruar në Luksemburg, në Prill 2001. Pastaj, në të njëjtin vit, Parlamenti në Shkup e ratifikoi marrëveshjen, e Parlamenti Evropian e dha pëlqimin e tij në Maj 2001.

Shikuar rëndësinë e marrëveshjes mund të thuhet se është mjaft e madhe, nga fakti se shtetit tonë i jep statusin e kandidatit potencial, duke hapur mundësinë e mëvonshme të bashkimit të saj BE-së. Një gjë e tillë është e cekur edhe në preambulë, e që thotë:

*“Unioni Evropian është i gatshëm të kyçë Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë në rrjedhat politike dhe ekonomike të Evropës dhe e vërteton statusin e saj si kandidat potencial për anëtarësim në UE në bazë të marrëveshjes për Unionin Evropian dhe plotësimin e kriteve të definuara nga Këshilli i Evropës në takimin në Kopenhagë në qershor 1993, në qoftë se Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë në mënyrë të suksesshme e realizon marrëveshjen në bazë të bashkëpunimit rajonal.”<sup>8</sup>*

Qëllimet e stabilitetit dhe integritetit rajonal, si dhe respektimi i të drejtave të njeriut dhe të drejtat e minoriteteve, e përbëjnë drejtimin kryesor të Marrëveshjes dhe janë të inkuorporuara në preambulë dhe në principet e përgjithshme të Marrëveshjes. Edhe përkundër asaj që MSA fokusohet në bashkëpunimin rajonal, ajo është e ngjashme me marrëveshjet evropiane që ishin të nënshkruara me shtetet e tanishme kandidatë për anëtarësim në BE.

Kjo marrëveshje parasheh që kapitujt e MSA-së të lidhura me tregtinë të hyjnë në fuqi në bazë asimetrike në qershor 2001 dhe pa ratifikim formal të mëparshëm nga ana e parlamenteve nacionale të shteteve anëtare që është në rrjedhë e sipër<sup>9</sup>.

Në përbërjen e Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asocim hyjnë:

- Preambula;
- Teksti i marrëveshjes;
- Aneks-7;
- Protokole-5;
- Fjalime të përbashkëta<sup>10</sup>.

---

<sup>8</sup> Preambula, Marrëveshja për Stabilizim dhe Asocim, Luksemburg, 2001

<sup>9</sup> PJR Makedonija-Idnina so Evropa;  
[http://www.delmkd.cec.eu.int/mk/broshures\\_and\\_campaigns/](http://www.delmkd.cec.eu.int/mk/broshures_and_campaigns/)

<sup>10</sup> Grup autorësh; Evrodijalog, Studentski zbor, Shkup, 2002, fq. 18

Marrëveshja për Stabilizim dhe Asocim është e ndarë në kapituj (më saktësisht dhjetë) dhe fokusohet në disa elemente kyçe që do të paraqiten në vijim:

- Themelimin e asocionit në mes Bashkimit Evropian dhe shteteve anëtare të saj nga njëra anë, dhe të Republikës së Maqedonisë nga ana tjetër, në rrjedhën e procesit tranzitiv në periudhë prej më së shumti dhjetë vjetësh;

- Respektimin e stabilitetit dhe paqes ndërkombëtare, zhvillimi i marrëdhënieve të mira ndërfqinjësore, demokracisë dhe të drejtave të njeriut, të drejtës së minoriteteve, principet e së drejtës ndërkombëtare dhe qeverisjen e së drejtës;

- Dialogun politik me Republikën e Maqedonisë;

- Rregullativat për bashkëpunim më të mirë, përfshirë edhe mundësinë e krijimit të zonave jodoganore ndërmjet shteteve rajonale;

- Mundësia e krijimit të zonës jodoganore në mes Bashkimit Evropian dhe RM-së dhjetë vjet pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes;

- Rregullativa për lëvizjen e punëtorëve, liria e themelimit të ndërmarrjeve, dhënien e shërbimeve, pagesat rrjedhëse dhe lëvizja e kapitalit;

- Kushtëzimin e RM-së që të afrojë legjislacionin e vet me atë të UE-së, posaçërisht në lëmitë kyçe të Tregut të Përbashkët Evropian;

- Rregullativë për formimin e një Këshilli për Stabilizim dhe Asocim, i cili do të vështrojë implementimin e marrëveshjes, formimin e Komitetit për stabilizim dhe asocim dhe Komisionit Parlamentar për stabilizim dhe asocim.

Rëndësia politike e Marrëveshjes është shumë e lartë nga vete fakti se ajo i jep Maqedonisë statusin e kandidatit potencial duke hapur mundësinë e anëtarësimit në Bashkimin Evropian, normalisht me kusht të plotësohen kriteret e BE-së nga njëra anë dhe të zgjidhen disa çështje të brendshme që pengojnë momentalisht integrimin e shtetit në strukturat evropiane dhe veriatlantike.

## **NGA MARRËVESHJA PËR STABILIZIM DHE ASOCIM DERI TEK LIBERALIZIMI I VIZAVE**

Procesi i Asocimit dhe Stabilizimit u jep një mundësi shteteve kandidate që të përfshihen në integrim me stimulime më të larta se më parë, por edhe me kërkesë për plotësim të më shumë kushteve politike dhe ekonomike, duke nënvizuar veçanërisht nevojën e bashkëpunimit rajonal.

Zhvillimi i Marrëveshjes së Asocimit Stabilizimit kishte në konsideratë situatën aktuale të çdo vendi në perspektivën e anëtarësimit në BE mbi bazën e Traktatit të Amsterdams dhe plotësimit të kriterëve të pranimit të Traktatit të Kopenhagës të vitit 1993. Objektivat kryesore do të ishin në afrimin e rajonit sa me afër perspektivave për integrimin e plotë në strukturat e BE-së, të mbështesnin konsolidimin e demokracisë, të shtetit të së drejtës, zhvillimin ekonomik dhe reformat, të ndihmonin për struktura administrative të përshtatshme dhe për bashkëpunim rajonal, të krijojnë një kuadër zyrtar për dialogun politik në nivele të dyanshme dhe rajonale, të nxisin marrëdhënjet ekonomike, tregtinë, investimet, politikën e sipërmarrjes, transportit, zhvillimin dhe bashkëpunimin në zonat doganore me perspektivën e integrimit sa më të shpejtë.

Marrëveshjet e Stabilizimit Asocimit synojnë të sjellin një dimension të ri në marrëdhënjet e BE-së me rajonin, duke kapërcyer marrëdhënjet e bashkëpunimit me ato vende që nuk e kishin arritur këtë nivel dhe duke zhvilluar marrëdhënie me të avancuara me të tjerat që kishin tashmë këto marrëveshje bashkëpunimi.

Në të njëjtën kohë, kur përpunohej ky koncept, kishin lindur ide dhe po trajtoheshin projekte për hartimin e një plani strategjik për rindërtimin e Ballkanit. Madje mjaft e përhapur ka qënë ideja e një plani të dytë "Marshall", por kësaj here për Ballkanin.

Më 1 janar të vitit 2008 hyri në fuqi Marrëveshja për lehtësimin e vizave dhe marrëveshja e ripranimit ndërmjet Maqedonisë dhe Bashkimit Evropian. Marrëveshja për lehtësimin e vizave ka për qëllim përjashtimin e Hecuria e procesit integruar të R.Maqedonisë në bashkimin evropian, përpjekjet dhe pengesat

vizave për kategori të ndryshme të qytetarëve. Lehtësimi i vizave përfaqëson një fazë kalimtare drejt krijimit të një regjimi pa viza për qytetarët e Maqedonisë. Dialogu për liberalizimin e regjimit të vizave ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe KE-se u hap zyrtarisht më 20 shkurt 2008. Që atëherë, u mbajtën disa takime midis ekipeve negociuese të Maqedonisë dhe KE-se. Dialogu u realizua në bazë të Udhërrëfyesit për kërkesat teknike të nevojshme për të përmbushur heqjen e regjimit të vizave për Maqedoninë. Udhërrëfyesi përbëhej nga katër blloqe duke përfshirë:

1. Blloku i parë që ka të bëjë me dokumentet e sigurisë;
2. Blloku i dytë ka të bëjë me Kufijtë, Azilin dhe Migracionin;
3. Blloku i tretë ka të bëjë me Rendin Publik dhe të Sigurisë dhe
4. Blloku i katërt me Marrëdhënjet e jashtme dhe të drejtat themelore.

Udhërrëfyesi u miratua nga Komisioni Evropian dhe iu dorëzua Ministrit të Punëve të Jashtme, z. Antonio Milloshoski në një ceremoni të mbajtur më 8 maj 2008 në Bruksel.

Më 28 nëntor 2008, Komuniteti Evropian publikoi një raport fillestar për vlerësim lidhur me përmbushjen e kërkesave nga udhërrëfyesi, në të cilin theksohej se Maqedonia ka bërë përparim të rëndësishëm në të gjitha 4 blloqet dhe është më e përparuar nga të gjitha vendet tjera të përfshira në të njëjtin proces. Për verifikimin e të arriturave të Maqedonisë në fushat relevante për liberalizimin e vizave, Komisioni Evropian ka kryer misione vlerësuese në Maqedoni, me pjesëmarrjen e ekspertëve nga vendet anëtare. Misioni për Bllokun një dhe tre nga Udhëzuesi është zbatuar në periudhën 19-23 janar 2009, kurse për Bllokun dy në periudhën nga 16 deri më 20 shkurt 2009.

Në 28-29 Janar 2009 u realizua një takim rajonal lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale në kuadër të dialogut për liberalizimin e vizave me pjesëmarrjen e përfaqësuesve dhe ekspertëve nga KE-ja, Shtetet Anëtare të BE-së dhe të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor.

## The Heritage

Më 9 mars 2009, në Bruksel, u zhvillua një takim dypalësh (Maqedoni-BE) në nivel ekspertësh lidhur me katërt misionet verifikuese të ekspertëve lidhur me Blloqet e Udhërrëfyesit dhe kanë konfirmuar parashikimet fillestare të KE-së ku nuk ishte identifikuar ndonje problem i veçantë ose mangësi në plotësimin e kriterëve të udhërrëfyesit.

Më 18 maj, 2009, KE paraqiti raportin mbi zbatimin e planit për liberalizimin e vizave të Republikës të Maqedonisë përpara shteteve anëtare. Raporti theksoi se Maqedonia ishte në rrugën e drejtë për sa i përket përmbushjes të kriterëve të dala nga udhërrëfyesi.

Më 11 qershor 2009, në Bruksel, në kuadrin e dialogut për liberalizimin e vizave, u mbajt një takim i nivelit të lartë midis KE-së dhe RM-së, e cila arriti në përfundimin se R.Maqedonisë kishte përmbushur kërkesat e BE-së të parapara në udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave me sukses të plotë.

Këshilli i BE më 15 qershor 2009 u dha mbështetje politike institucioneve përkatëse maqedonase për të filluar procedurën ligjore për heqjen e regjimit të vizave.

Më 15 korrik, 2009, Komisioni European miratoi një propozim për heqjen e vizave për qytetarët e Maqedonisë, Serbisë dhe Malit të Zi nga data 1 janar 2010. Miratimin e propozimit e bëri në një konferencë për shtyp në Bruksel, Zv. Presidenti i Komisionit European dhe Komisioneri për Drejtësinë, Lirinë dhe Sigurinë Zhak Barrot dhe Komisioneri për Zgjerim Olli Rehn. Barrot tha se vendimi për të rekomanduar liberalizimin e vizave për Maqedonisë ishte plotësimi i kushteve për tu futur në zonën Shengen dhe tejkalimi i pengesave të paraqitura në gjysmën e parë të vitit 2008 duke kërkuar realizimin e pasaportave biometrike, kontrollin kufitar, rezultatet e dukshme në luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe trafikimit të qenieve njerëzore dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Ai, ndër të tjerash, theksoi se Maqedonia, sipas vlerësimeve nga ekspertët e Komisionit Evropian ka arritur rezultatet më të mira në përmbushjen e kriterëve.

Brenda procedurës ligjore, më 12 nëntor 2009, Parlamenti Evropian miratoi një rezolutë për heqjen e vizave për qytetarët e Maqedonisë, Malit të Hecuria e procesit integruar të R.Maqedonisë në bashkimin evropian, përpjekjet dhe pengesat

Zi dhe Serbisë. Sipas rezolutës, PE sygjeroi se liberalizimi i vizave duhet të hyj në fuqi më herët se sa ishte planifikuar, pra 19 dhjetor 2009. Më 30 nëntor 2009, gjatë presidencës suedeze të Këshillit të Ministrave të BE-se për Drejtësinë dhe Punët e Brendshme ka marrë vendim për të liberalizuar vizat për qytetarët e Maqedonisë, përmes ndryshimit të Rregullores 539/2001.

Më 19 dhjetor 2009, udhëtimi pa viza nëpër Evropë u bë një realitet për qytetarët e Maqedonisë. Sipas vendimit, qytetarët e Maqedonisë që posedojnë pasaporta biometrike mund të udhëtojnë pa vizë për qëndrim të shkurtër në vendet e zonës Shengen. Nën qëndrim të shkurtër nënkuptohet që qytetarët e RM-së kanë të drejtë të qëndrojnë në zonën e Shengenit duke mos i kaluar 90 ditë brenda 180 ditëve nga data e hyrjes së parë. Për të qëndruar më gjatë se 90 ditë në zonën Shengen për arsye studimi, punësimi apo nevojave të tjera private, qytetarët e Maqedonisë duhet të aplikojnë për një vizë afatgjate ose vizë qëndrimi në ambasadën ose zyrën më të afërt konsullore të vendit të udhëtimit.

Shtetasit e Republikës së Maqedonisë pa vizë për qëndrime të shkurtra do të jetë në gjendje të udhëtojnë në 25 vende të Bashkimit Evropian: Austria, Belgjika, Bullgaria, Gjermania, Greqia, Danimarka, Estonia, Italia, Qipro, Lituania, Letonia, Luksemburgu, Malta, Polonia, Portugalia, Rumania, Sllovenia, Sllovakia, Hungaria, Finlanda, Franca, Holanda, Republika Çeke, Suedia dhe Spanja dhe në tre vende jo-anëtare, që janë pjesë e zonës Shengen: Islanda, Norvegjia dhe Zvicra.

Përsa i përket Greqisë, në pikat kufitare të saj do të zbatohet një procedurë e veçantë. Zyrtarët grekë nuk do të vënë pulla në hyrje dhe dalje në pasaportat e udhëtarëve nga Republika e Maqedonisë, por këtë do ta bëjnë në një fletë të veçantë që do të lëshohet për pasagjerët në vendkalimet kufitare. Fletë të veçanta mund të ngrihen edhe te Zyra Ndërlidhëse e Greqisë në Shkup dhe në konsullatën greke në Manastir. Pasagjerët janë të inkurajuar për të marrë këtë dokument paraprakisht për të kursyer kohë në vendkalimet kufitare. Mbajtësit e këtij dokumenti janë të detyruar të posedojnë këtë dokument jo vetëm kur udhëtojnë në Greqi, por edhe kur udhëtojnë brenda zonës së Shengenit, dhe gjithashtu kanë një detyrim për të mbajtur një vit pas përdorimit të tij të fundit. Rregulla të reja për udhëtimin pa viza do të zbatohet për Mbretërinë e Bashkuar dhe Irlandën, Shtete anëtare të Bashkimit Evropian,

por jo pjesë e zonës Shengen. Informacion mbi kërkesat e hyrjes në këto dy vende, qytetarët e Maqedonisë mund të marrin në zyrat konsullore të Britanisë së Madhe dhe Irlandës.

Sipas të dhënave të Ministrisë së Punëve të Brendshme, nga data 19 dhjetor 2009 der në 15 janar 2010, rreth 200,000 shtetas të Maqedonisë kanë kaluar kufijtë e shtetit të tyre për të hyrë në BE, prej të cilëve vetëm 77 qytetarë nuk kanë qënë të lejuar të hyjnë në BE, nga të cilat 50% janë kthyer për shkak se nuk kishte një sigurim udhëtimi dhe pjesa e mbetur 50% kishin qënë më parë të ndaluar të hyjnë në BE.

Përveç pasaportave biometrike, ka kërkesa të tjera të hyrjes që të zbatohen për të gjithë shtetasit e vendeve të treta të cilët udhëtojnë në zonën Shengen. Ata janë të lidhur me posedimin e fondeve të mjaftueshme për kohëzgjatjen e qëndrimit dhe të kthimit në Maqedoni, dëshmi për zotërim të kushteve të mjaftueshme për qëndrim, përcaktimin që pasagjerët nuk do të kalojnë maksimumin e miratuar të kohëzgjatjes së qëndrimit, udhëtarët nuk konsiderohen si një kërcënim për rendin publik, shëndetin publik apo sigurinë e brendshme.

Shtetasit e Republikës së Maqedonisë, kur kalojnë kufijtë e jashtëm të zonës së Shengenit mund të kërkojnë nga ato të posedojnë disa nga dokumentet e mëposhtme:

(A) Për udhëtime afariste ose ngjarje të lidhura me punën: një ftesë nga një kompani ose autoritet për pjesëmarrjen në takime, konferenca apo ngjarjeve që lidhen me tregtinë, industrinë, dokumente të tjera që vërtetojnë ekzistencën e lidhjeve tregtare, bileta për panairë dhe kongrese, në qoftë se ju i vizitoni.

(B) Për udhëtim me qëllim të të mësuarit ose llojet e tjera të trajnimit: një konfirmim të regjistrimit në institucionet arsimore për monitorimin e kurseve profesionale apo teorike, trajnim në bazë profesionale, karta studentore e tjera.

(C) Udhëtim turistik apo për qëllime private: dëshmi / certifikatë e strehimit (një ftesë apo certifikatë nga një organizatë që ofron strehim apo Hecuria e procesit integruar të R.Maqedonisë në bashkimin evropian, përpjekjet dhe pengesat

ndonjë dokument tjetër të përshtatshëm ku deklarohet strehim) dëshmi të biletës të udhëtimit (vërtetimin e rezervimit një udhëtimi të organizuar ose dokument tjetër të përshtatshëm që përshkruan planet për udhëtim), dëshmi e kthimit (biletë vajtje-ardhje).

(D) Për udhëtime me karakter politik, shkencor, sportiv, kulturor, ose ngjarje fetare ose shkaqe të tjera: ftesa, bileta, raporte ose programe , nëse është e mundur emrin e organizatës që prët dhe kohëzgjatjes së qëndrimit, ose një tjetër vërtetim që tregon qëllimin e vizitës.

(E) Dëshmi se e ka mjete të mjaftueshme financiare: nëpërmjet parave të gatshme, kartat e kreditit ose deklaratat e sponsorizimit.

F) Konfirmimin e sigurimit shëndetësor të udhëtimit për kohëzgjatjen e udhëtimit. Shtetasit e Republikës së Maqedonisë mund të refuzohen për të hyrë në zonën Shengen nëse ata nuk përmbushin kushtet e hyrjes, dhe autoritetet evropinane kanë të drejtë të marrin vendim të arsyetuar me shkrim, i lëshuar nga autoriteti sipas legjislacionit kombëtar për refuzimin e hyrjes. Cdo qytetar i shqetësuar i Republikës së Maqedonisë që është refuzuar për të hyrë në BE ka të drejtë të ankesës në lidhje me këtë vendim, i cili nuk pezullon ekzekutimin e tij<sup>11</sup>.

### KONKLuzion

Me gjithë ndryshimet që kanë filluar të zbatohen që nga mbarimi i krizës së vitit 2001, përsëri jemi dëshmitarë se punët nuk shkojnë edhe aq mirë. Këtë mund ta vërtetojmë nëse vetëm vështrojmë disa aspekte. Sipas hulumtimeve statistikore, është konstatuar se në 2 milion banorë të RM-së, ekzistojnë katërqind mijë prej tyre, që janë të papunë e të cilët i takojnë forcës punëtore. Ndoshta procesi i tranzicionit është duke lënë gjurmët e mjegullta të vetat, kriza botërore poashtu, mirëpo kjo nuk ndodhi në shumë vende që veç më kanë kaluar këtë fazë.

---

<sup>11</sup>

PJR

Makedonija-Idnina

so

Evropa;

[http://www.delmkd.cec.eu.int/mk/broshures\\_and\\_campaigns/](http://www.delmkd.cec.eu.int/mk/broshures_and_campaigns/)

Procesi i (mos)implementimit të Marrëveshjes së Ohrit është çështje në vete, për të cilën nuk duhet të flitet shumë sepse realiteti nuk korespondon aspak me atë çka parashihet në teori.

Integrimi në BE padyshim se si për vendet e tjera ashtu edhe për Maqedoninë kërkon mund dhe reforma. Në rradhë të parë Maqedonia duhet të respektojë vlerat e demokracisë, shtetit ligjor, të sigurojë respektimin e të drejtave të njeriut dhe minoriteteve, solidaritetit dhe ekonomisë së tregut, duke qënë në dijeni të plotë se ato përbëjnë themelet e Bashkimit Evropian. Respektimi i të drejtës ndërkombëtare, paprekshmëria e kufijve ndërkombëtarë, zgjidhja paqësore e konflikteve dhe bashkëpunimi rajonal janë parime të rëndësishme më të lartë, të cilave ajo duhet përkushtuar. Këtyre ajo duhet bashkangjitur edhe fuqimisht luftën ndaj ekstremizmit, terrorizmit dhe dhunës, qofshin ato të motivuara etnikisht, politikisht apo kriminalisht.

Në pikëpamjen e sfidave të ndryshme, Evropa, fillimisht duhet t'i zbulojë rishtas kufijtë e saj politik dhe ekonomik, shpirtëror dhe kulturor. Nga ana tjetër, projekti ambicioz për Bashkim Evropian sot gjendet para sfidës më të madhe të deritanishme. Në vitet e ardhshme, Evropa ka gjasa të humb karakterin e trungut. Por, gjithmonë kur hyhet në substancë, thyhen skemat e qëndrimit kombëtar dhe linjat tradicionale historike. Nga kjo, del pyetja, a ka Evropa kohë të presë Maqedoninë të ndryshojë qëndrimet e veta apo më mirë të themi, kur do jetë Maqedonia gati, Evropa a do mund të pranojë edhe një shtet tjetër problematik brenda saj?

Për ardhmërinë e Maqedonisë duhet punuar natë e ditë sepse përveç vullnetit të mirë të shteteve të fuqishme si SHBA-ja dhe Bashkimi Evropian, përparimi i saj në sferën ndërkombëtare ballafaqohet me një bllokim nga vetë fqinjët e saj kurse bashkëpunimi dhe bashkëjetesa në mes komuniteteve dita ditës po bëhet më e vështirë, më e ftohtë dhe më e frikshme, duke na rikujtuar situatën e para vitit 2001, ku askush, as maqedonasit e as shqiptarët nuk kanë dëshirë ta përfytyrojnë përsëri. Ndonjëherë po duket se politika aktuale po mundohet të bind qytetarët e vet dhe botën e tërë sikur shteti ynë është kaq i fuqishëm dhe i sigurtë në kapacitetet e tij saqë nuk ka nevojë të jetë pjesë e asnjë komuniteti evropian, asnjë alenace ushtarake dhe as pjesë e ndryshimeve me të cilat po përplasat për çdo ditë politika botërore. Por, për fatin e keq, ne

Hecuria e procesit integruar të R.Maqedonisë në bashkimin evropian, përpjekjet dhe pengesat

nuk jemi shteti më i madh e as më i fuqishëm në botë, nuk kemi marrëdhënje brilante me fqinjët tanë, nuk kemi kapacitet ekonomik për tu patur zili e as nuk kemi ndonjë shtet ligjor, demokraci dhe kulturë politike që do na nxirrte nga këto kriza pafund.

Qytetarët e Maqedonisë aspirojnë për një ardhmëri të përbashkët, sepse kjo është formula e vetme për të mbajtur këtë shtet në këmbë. Struktura politike duhet hequr dorë nga krijimi i tensioneve të vazhdueshme mes etniteteve vetëm e vetëm për të mbuluar dështimet e tyre në aspektin e moszgjidhjes të problemeve të panumërta që po lodhin qytetarët e rëndomtë dhe po mbarojnë durimin e tyre.

Vetëm me vlera pozitive Maqedonia mund të hec përpara, si dhe qytetarët e saj duke i harruar të gjitha ato që kanë ndodhur mes tyre e të mundohen të orientohen pra, drejt një Evrope të Bashkuar. Trashëgimia negative e elitave politike në Ballkan për të zgjidhur një problem duke krijuar një tjetër më të madh dhe duke kujtuar se populli do i harroje aq shpejt, nuk ka qënë dhe nuk është e rastësishme dhe nuk ka kaluar pa lënë gjurmë në fatet e Ballkanit.

Integrimi nderkombetar mundeson krijimin e një mozaiku strukturash që i lidh shtetet së bashku. Këto struktura të ndryshme të sistemit politik evropian, të përqëndruara në BE, janë organizatat ndërqeveritare të përbëra prej shteteve anëtare. Ndjenja e dallueshmërisë, e cila zhvillohet me kalimin e kohës së bashku me forcimin e lidhjeve vepruese, i lidhin edhe me forte njerezit pavaresisht prej kufijve. Pjesë e kësaj dallueshmërie duhet të jenë edhe qytetarët e Ballkanit, historikisht një rajon i pandashëm i Evropës.

### **Bibliografia**

1. Bashkurti, Lisen, “Krizat Ndërkombëtare”, “MirgeerAlb”, Tiranë, 2008.
2. Boriçi, Gjon, “Lufta për Paqen në ish-Jugosllavi” 1987-1999, ”Geer”, Tiranë, 2008.
3. Habermas, Jurgen, “Perëndimi i përçarë”, “Asdren”, Shkup, 2006.
4. Puto, Arben, “E drejta ndërkombëtare publike”, ”Dudaj “, Tiranë, 2008.

5. Gruda, Zejnullah, "E drejta ndërkombëtare publike", "Furkan ISM", Shkup, 2007.
6. Gleny, Misha, "Historia e Ballkanit 1804 – 1999", TOENA, Tiranë, 2007.
7. Kissinger, Henri, "Diplomacia", "B.K", Tiranë, 1999.
8. Ruzie, David, "E drejta ndërkombëtare Publike", "Data Pons", Shkup, 2006.
9. Laker, Wolter, "Europe in our time: A history (1945-1992) ", Tiranë, 2003.
10. Boriçi, Gjon, "Studime, artikuj, ese", "GEER", Tiranë, 2006.
11. Grup autorësh; Evrodiyallog, Studentski zbor, Shkup, 2002.
12. Reka, Blerim; E drejta e Unionit Evropian, Prishtinë, 2000.

### **Dokumente dhe Raporte Ndërkombëtare**

13. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, 10 dhjetor 1948.
14. Konventa e Evropës për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, 4 nëntor 1950.
15. Pakti ndërkombëtar lidhur me të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore, 16 dhjetor 1966.
16. Pakti ndërkombëtar për të drejtat qytetare dhe politike, 16 dhjetor 1966.
17. Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit, Raporti për programet 2010.
18. Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asocim, Qendra evropiane të kongreseve, Luksemburg, Prill 2001.

### **Materiale nga Interneti**

19. PJR Makedonija-Idnina so Evropa;  
[http://www.delmkd.cec.eu.int/mk/broshures\\_and\\_campaigns/](http://www.delmkd.cec.eu.int/mk/broshures_and_campaigns/)

**PhD Candidate Shemsije Demiri**

International University of Struga

Faculty of Law Sciences

[sh.demiri@eust.edu.mk](mailto:sh.demiri@eust.edu.mk)

## **SHKURORËZIMI SI MËNYRË E ZGJIDHJES SË MARTESËS GJATË VITEVE 1998-2012**

### **ABSTRACT**

Divorce is an institution of family law which allows the final solution of marriage. The causes are more diverse, ranging from divorces made with agreement between the spouses, fictitious divorce, and divorce as the only alternative healing disrupted marital relations.

However, divorce proceedings materially burden the parties, and as a result of this, some spouses are prevented from finding a solution for their marriage, especially in situations where separation is necessary.

Therefore, in this paper it is being presented:

Resolution of a valid marriage which deeply differs from marriage annulment, because marriage annulment is the solution of an invalid marriage, while divorce is the solution of a valid marriage, divorce is only done as a result of causes foreseen by law and judicial proceedings.

Among the reasons which cause serious marital disorders are: jealousy , character mismatch, constant rows, etc. , as well as: an unbearable life of spouses , b ) infidelity , c ) offenses against spouse's life , d ) serious abuse , d ) bad intentional and unreasonable abandonment, f ) incurable mental illness

and inability to act , the ) unreasonable interruption of actual life for more than a year and f ) divorce by agreement .

**Keywords : dissolution of marriage by divorce , reasons for divorce , ways of divorce, divorce with agreement, lawsuit divorce and statistical data of divorces.**

## **HYRJE**

Martesa është institucion i rëndësishëm i së drejtës familjare, dhe paraqet marrëdhënie të jetës së përbashkët e të vazhdueshme midis një burri dhe një gruaje, ndërkaq në disa shtete edhe marrëdhënie midis dy personave me gjini të njëjtë (në shtete të cilët kanë të legalizuar martesën midis personave me gjini të njëjtë). Të gjitha legjislacionet nacionale japin definicionin e institucionit të martesës se *“Martesa është bashkësi jetësore e burrit dhe gruas e rregulluar me ligj në të cilën realizohen interesat e bashkëshortëve, familjes dhe shoqërisë”*.

Marrëdhëniet në mes bashkëshortëve themelohen ne vendim të lirë të burrit dhe gruas për të lidhur martesë, në barazinë ndërmjet tyre, respektim të ndërsjellët dhe ndihmës reciproke (neni 6 i Ligjit mbi familjen të RM-së Gazeta Zyrtare e RM-së nr.157/2008, në tekstin e mëposhtëm LF).<sup>1</sup>

Barazia e bashkëshortëve si në rastin e lidhjes së martesës, gjatë martesës si dhe në rast shkurorëzimi garantohej edhe me dokumentin më të rëndësishëm ndërkombëtarë- Deklaratën Universale të të drejtave të njeriut (neni 16.al.1). Siç e cekim edhe më lart, martesa është marrëdhënie e vazhdueshme por jo e përhershme sepse e njëjta mund edhe të zgjidhet me vdekjen e njërit nga bashkëshortët, me shpalljen e njërit nga bashkëshortët e zhdukur për të vdekur, me anulimin e martesës dhe me shkurorëzimin e saj.

---

<sup>1</sup> Ligji mbi familjen (teksti i spastruar), Gazeta zyrtare e RM-së nr.157 /2008

## I. Zgjidhja e martesës me shkurorëzim

Tërë historiku i shkurorëzimit pothuajse ka qenë i drejtuar kundër gruas dhe ka pasur për qëllim nënshtrimin e saj, do të thotë që pushteti i ka takuar burrit sepse kanë egzistuar dy shkaqe kryesore të shkurorëzimit: mospasja e fëmijëve dhe shkelja e besnikërisë bashkëshortore. Nëse bashkëshortët nuk kishin fëmijë, posaçërisht djem, supozohej se gruaja ishte fajtoreshë për këtë gjë.

Shkurorëzimi është institucion i lashtë ,dukuri përbërëse dhe e pandashme e martesës këtu do të përmendi një thënie të VOLTERIT ku thotë se „*shkurorëzimi lindi disa javë pas martesës*“ do të thotë atëher kur lindi martesë lindi edhe shkurorëzimi.<sup>2</sup> Të tjerët e quajnë si një opsion nuklear në marrëdhëniet martesore.<sup>3</sup>

Në antikë në rastet e këtilla burrit i caktohej për detyrë të shkurorëzohej nga ajo grua edhe kundër vullnetit të tij dhe të lidhte martesë të re, në të cilën do të kishte fëmijë që do të trashëgojnë, më vonë ky qënim zbutet, sepse burrit i'u la mundësia që të vendos se a do të shkurorëzohej apo të kishte edhe ndonjë grua jashtëmartesore. Si shkak i dytë ka qenë shkelja e besnikërisë bashkëshortore, kështu që nëse gruaja shkelte besnikërinë bashkëshortore, dënohej rreptë për shembull edhe me dënim me vdekje, por nëse burri shkelte besnikërin ndaj gruas nuk i takonte ky dënim por atij i lejohet kjo shkelje<sup>4</sup> .Nga gruaja kërkohej një besnikëri absolute, sepse në sistemet patriarkale ishte me rëndësi të veçantë që fëmijët e lindur të kenë atësi të dyshimtë dhe të kontestueshme. Këto dy shkaqe kanë qenë të ndërlydhura ngushtë ndërmjet

---

<sup>2</sup> Oruci, Gani, “E drejta familjare”, Prishtinë, 1994, fq.89

<sup>3</sup>A Few Words About Divorce, gjendet në :  
<http://diggerjones.wordpress.com/2006/12/06/a-few-words-aboutdivorce>.

<sup>4</sup> Oruci, Gani, “E drejta familjare” ,Prishtinë, 1994, fq.91

tyre, sepse, si në rastin kur gruaja nuk ishte e aftë të lindte fëmijë sidomos djem, ashtu edhe në rastin e dytë kur ajo shkelte besnikërinë, egzistonte rreziku që në familje të hynte një familje a ndonjë person i huaj dhe në atë mënyrë të ndërpritej kontinuiteti midis të palindurve dhe të paslindurve, pra me një fjalë, rrezikohej vazhdimësia e familjes dhe trashëgimtarët të jenë të padyshimtë ,pra të kenë atësi të pakontestueshme. Kurse sot shkurorëzimi ka marrë përmasa të mëdha si në botë ashtu edhe tek ne, keshtu që numri I shkurorëzimeve sa vjen e shtohet .

## II. Shkaqet e shkurorëzimit

Shkaqet e shkurorëzimit janë të ndryshme dhe një numër i madh i tyre ndërlidhen me aspektet sociologjike, juridike, historike, ekonomike, psikologjike e nga më të ndryshmet. Tek ne familja është një proces tranzicioni, shëndrimi nga një familje patriarkale në një familje demokratike. Por ky proces, për shkak të krizës së thellë, shoqërohet me probleme të mëdha, ndaj të cilave nuk është immune as familja jonë. Nga ana tjetër, faktorët që ndikojnë në transformimin e familjes ndikojnë njëkohësisht edhe në shtimin e numrit të shkurorëzimeve, fjala vjen, emancipimi i gruas shkakton shtimin e numrit të shkurorëzimeve, sepse, sa më tepër që thellohet ky proces, ajo bëhet më e barabartë dhe e pamvarur nga burri. Shkollimi, ngritja profesionale dhe pavarësia ekonomike janë faktorë të rëndësishëm në këtë mes. Gruaja e emancipuar dhe e siguruar ekonomikisht vendos më lehtë për shkurorëzim se sa gruaja, që është ekonomikisht e varur nga burri. Ajo nuk i duron dot marrdhëniet konservatore në familje e në martesë, sepse ato janë të drejtuara kundër saj, nga kjo mundë të konkludojmë se martesë tek ne ndodhet në krizë. Dobësimi i gjithanshëm i bazës materiale e thellon krizën e familjes dhe ajo gjen shprehjen edhe në numrin e shkurorëzimeve.

Shkurorëzimi mund të bëhet për shkaqe të parapara me ligj. Legjislacioni ynë, përkatësisht LFM, e ka përvetësuar sistemin e përzier në të

cilin parashihen shkaqet e përgjithshme dhe shkaqet e veçanta për të kërkuar shkurorëzim.<sup>5</sup>

### III.1. Shkaqet e përgjithshme të shkurorëzimit

Çdo rast i shkurorëzimit është i ndryshëm nga tjetri, duke u bazuar në problemet dhe karakterin e ndryshëm të personave, si dhe qasjen dhe mënyrën e të jetuarit në një bashkësi martesore. Mirëpo, të gjitha shkaqet që merren si arsye për ndarjen e një martese sjellin jetën e padurueshme të përbashkët. Këtë shkak e parasheh edhe Ligji mbi familjen i RM-së (neni 40 LF). Ndërkaq, jetën të padurueshme e bëjnë problemet e ndryshme që sjellin veprimet e njërit ose të dy bashkëshortëve, siç janë: xhelozia e pakontrolluar, kontradiktat dhe konfliktet gjatë çdo veprimi të njëri-tjetrit, keqpërdorimet dhe keqtrajtimet, dhuna fizike dhe psikike, shkelja e besnikërisë bashkëshortore, shpenzimet tepër të mëdha që dëmtojnë pasurinë familjare, etj. Pra, Ligji mbi familjen i RM-së, shkaqe për të shkurorëzuar një martesë i kategorizon në tre grupe: pëlqimi i përbashkët i bashkëshortëve për ndarjen e tyre (neni 39.al.1 LF), nëse marrëdhëniet bashkëshortore janë përkeqësuar deri në atë masë sa që jeta e përbashkët është bërë e padurueshme (neni 40 LF), dhe nëse marrëdhëniet martesore në mënyrë faktike kanë pushuar të funksionojnë më gjatë se një vit (neni 41 LF).

Në LFK, në nenin 69, parag 1, thuhet: *bashkëshortët mund të kërkojnë shkurorëzim kur marrëdhëniet martesore janë çrregulluar seriozisht dhe në mënyrë të vazhdueshme*. Në këtë rast ligjvënësi nuk i ka përcaktuar shkaqet konkrete, por për shkaqe objektive kur marrëdhëniet bashkëshortore janë tronditur mund të kërkohej shkurorëzimi. Si shkaqe që sjellin çrregullimin serioz të marrëdhënieve bashkëshortore mund të jenë: xhelozia, mospërputhja e karaktereve, grindjet e vazhdueshme, etj.

### III.2. Shkaqet e veçanta të shkurorëzimit

---

<sup>5</sup> Ligji mbi familjen (teksti i spastruar), Gazeta zyrtare e RM-së nr.157 /2008

Ndryshe nga shkaqet e përgjithshme shkaqet e veçanta janë caktuar në legjislacion. Sipas LFK në nenin 69, parag. 2, si shkaqe të shkurorëzimit në mes tjerash janë: a) jeta e padurueshme e bashkëshortëve, b) shkelja e besnikërisë bashkëshortore, c) veprat penale kundër jetës së bashkëshortit, ç) keqtrajtimi serioz, d) lënia qëllim keqe dhe e paarsyeshme, dh) sëmundjet psikike të pashërueshme dhe paaftësia për të vepruar, e) ndërprerja e paarsyeshme e jetës faktike për më shumë se një vit dhe f) shkurorëzimi me marrëveshje.

## **IV MËNYRAT E SHKURORZIMIT**

### **IV.1. Shkurorëzimi me marrëveshje**

Procedura e shkurorëzimit inicohet me padi ose me propozimin e përbashkët të bashkëshortëve për shkurorëzim me marrëveshje. Ligjvënësi e ka paraparë mundësinë që shkurorëzimi të bëhet me marrëveshjen e bashkëshortëve. Megjithatë, shkurorëzimi me marrëveshje çdo herë bëhet para gjykatës kompetente. Kështu shkurorëzimi bëhet me vendim të gjykatës në bazë të marrëveshjes së bashkëshortëve. Në rastet e marrëveshjes së përbashkët të bashkëshortëve gjykata e cila zhvillon procedurën e shkurorëzimit e ka shumë më lehtë të sjell vendimin për ndarjen e tyre. Mjet juridik për iniciimin e procedurës së shkurorëzimit përveç marrëveshjes (propozimit) së përbashkët të bashkëshortëve<sup>6</sup> është edhe kërkesa e njërit bashkëshort, pra me anë të padisë së ngritur nga ana e njërit bashkëshort. Në pajtueshmëri me nenin 237 të LF- pas pranimit të padisë për shkurorëzim ose propozimit për shkurorëzim me marrëveshje, para dorëzimit të padisë të paditurit mbahet seancë për pajtim të bashkëshortëve.

---

<sup>6</sup> Martesa mund të shkurorëzohet me pëlqimin reciprok të bashkëshortëve. Nëse bashkëshortët kanë fëmijë të mitur të përbashkët, apo fëmijë madhor të cilëve u është vazhduar e drejta prindërore, është e nevojshme që të dorëzojnë marrëveshje për mënyrën e ushtrimit të drejtave dhe detyrimeve prindërore dhe për ushqimin dhe edukimin e fëmijëve. Gjykata do të sjell vendim për shkurorëzim pas pëlqimit reciprok të bashkëshortëve nëse vërtetohet se pëlqimi i tyre është i lirë, serioz dhe i vendosur (neni 39 i LF).

Bashkëshortët mundet që me marrëveshje të përbashkët të zgjidhin çështjen e ndarjes së fëmijëve. Nëse nuk ekziston marrëveshja midis tyre lidhur me përkujdesjen e fëmijëve atëherë, gjykata *ex officio* sjell vendimin për ruajtjen, edukimin dhe ushqimin e fëmijëve.

Andaj fëmijët mund të vazhdojnë jetën e mëtutjeshme me njërin prind, ose nëse janë dy ose më tepër fëmijë – disa me njërin e disa me tjetrin prind, ndërkaq nëse ruajtja dhe edukimi i fëmijëve nga prindërit e tyre është në kundërshtim me interesin e tyre, atëherë fëmijët ngelin nën përkujdesjen e organit të kujdestarisë

#### IV.2 Shkurorëzimi me padi

Shkurorëzimi me padi, gjithherë ekziston kur njëri bashkëshortë e ka paraqitur padinë kundër dëshirës së bashkëshortit tjetër. Padia paraqitet në rastet kur nuk ekziston pajtimi i bashkëshortëve për shkurorëzim. Padia për shkurorëzim i paraqitet gjykatës kompetente ( LFK, neni 68). Sikur të shkurorëzimi me marrëveshje edhe të shkurorëzimi me padi, shkurorëzimi bëhet vetëm me vendim të gjykatës.<sup>7</sup> Padinë për shkurorëzim kanë të drejtë ta paraqesin vetëm bashkëshortët. Trashëgimtarët nuk mundë të paraqesin padi për shkurorëzim, ata vetëm mund të vazhdojnë procedurën për shkurorëzim .

Bashkëshortët mund të paraqesin padin edhe nëpërmjet përfaqësuesit me prokurë, ajo duhet të jetë e vërtetuar dhe duhet të theksohet baza për paraqitjen e padisë.

Paditësi mundë ta tërheq padinë deri në mbylljen e seancës kryesore pa pëlqimin e bashkëshortit të paditur, kurse pas mbylljes së seancës kryesore e deri në përfundim të procedurës në formë të prerë, këtë mund ta bëj vetëm me pëlqimin e bashkëshortit të paditur.

Procedura e shkurorëzimit përbëhet nga këto faza: tentimi për pajtimin e bashkëshortëve, caktimi i masave të përkohëshme për vendosjen dhe

---

<sup>7</sup> Aliu, Abdullah; Gashi, Haxhi; “E drejta familjare”, Prishtinë, 2007, fq.164-165

ushqimin e bashkëshortit të pasiguruar, seanca kryesore (sigurimi i provave)dhe marja e vendimit.

Në rastet kur procedura e shkurorëzimit ka filluar me propozimin e bashkëshortëve për shkurorëzim me marëveshtje,si rregull nuk zhvillohet procedura e provave .

Në Republikën e Maqedonisë sipas të dhënave statistikore nga Enti shtetëror për statistikë,numri i shkurorëzimeve 15 viteve të fundit vazhdimisht është në rritje.

Në vitin 1998 janë regjistruar 13.993 kurorëzime dhe 1.027 shkurorëzime, në vitin 1999 ka pasur 14.172 kurorëzime dhe 1.045 shkurorëzime, në vitin 2000 janë regjistruar 14.255 kurorëzime dhe 1.325 shkurorëzime, ndërsa në vitin 2001 janë regjistruar 13.267 kurorëzime dhe 1.448 shkurorëzime kurse në vitin 2002 janë regjistruar 14.522 kurorëzime dhe 1.310 shkurorëzime , në vitin në vitin 2003 janë regjistruar kurorëzimi i 14.402 kurorëzime dhe ka pasur 1.405 shkurorëzime; në vitin 2004 – 14.073 kurorëzime dhe 1.645 shkurorëzime; në vitin 2005 janë regjistruar 14.500 kurorëzime dhe 1.552 shkurorëzime; në vitin 2006 ka pasur 14.908 kurorëzime dhe 1.475 shkurorëzime; në vitin 2007 janë të regjistruara 15. 490 kurorëzime dhe 1.417 shkurorëzime.

Ndërkaq, sipas të dhënave statistikore (16.06.2009) gjatë vitit 2008, kemi zvogëlimin e numrit të kurorëzimeve dhe numrit të shkurorëzimeve. Në krahasim me vitin 2007, lidhja e martesave në vitin 2008 është zvogëluar për 5.1 % d.m.th janë lidhur 14.695 martesa.

Gjatë vitit 2008 më tepër martesa janë lidhur në muajin gusht (13.1%), ndërkaq më pak martesa në muajin prill (4.8%). Mosha mesatare gjatë lidhjes së martesës së parë është 24.7 vjet për femrën dhe 27.7 për mashkullin. Statistikat japin rezultatin se numri i shkurorëzimeve në vitin 2008 (1.209) është 14.7 % me i ulët se në vitin 2007. Sa i përket muajve, më tepër shkurorëzime janë regjistruar në muajin dhjetor (11.4%) , më pak në muajin gusht (2.5%).

Në vitin 2009 janë regjistruar 14.923 kurorëzime dhe 1287 shkurorëzime, për dallim prej vitit të kaluar numri i kurorëzimeve është ritur për 1.6%, poashtu edhe numri i shkurorëzimeve është ritur për 6.5%.

Në vitin 2010, numri i të kurorëzuarve është zvogluar për 5.1% dhe janë regjistruar 14. 155 kurorëzime , ku poashtu edhe numri i shkurorëzimeve është ritur për 33.6%, janë regjistruar 1720 shkurorëzime.

Në vitin 2011 janë regjistruar 14.736 kurorëzime, për dallim nga viti i kaluar numri i kurorëzimeve është ritur për 4.1%, kurse janë regjistruar 1753 shkurorëzime dhe për dallim nga viti i kaluar numri është ritur për 1.9% të shkurorëzimeve.

Në vitin 2012 janë regjistruar 13991 kurorëzime për dallim nga viti i kaluar numri është ulur për 5.1%, kurse janë regjistruar 1926 shkurorëzime për dallim nga viti i kaluar numri i të shkurorëzuarve është ritur për 9.9% .<sup>8</sup>

Të dhënat e shumta japin rezultatin se në shtetin tonë në një përqindje të konsiderueshme ndahen martesat e reja (nga 1-3 vjet bashkëjetesë). Të rinjtë të cilët lidhin martesë në kohën e sotme për dallim nga më herët, më tepër i japin rëndësi të jetuarit në mënyrë bashkëkohore, barazisë midis partnerëve në martesë, nuk respektojnë kultin e autoritetit ndaj më të vjetërve, duke marrë qëndrime të ndryshme nga prindërit e tyre.<sup>9</sup>


Paraqitja në mënyrë grafike:

---

<sup>8</sup> [www.stat.gov.mk/pdf/2007/2.1.7.19.pdf](http://www.stat.gov.mk/pdf/2007/2.1.7.19.pdf)

<sup>9</sup> Bakievska,Mimoza “*Prestanok na brakot so razvod vo Bitola*”, Manastir, 2007, fq. 9.

## Numri i kurorëzimeve dhe shkurorëzimeve për 15 vitet e fundit



### KONKLUZION

Për ta përfunduar këtë punim, duhet mbajtur mend disa aspekte thelbësore të këtij problemi.

**E para,** shkurorëzimi në të drejtën kuptohet si zgjidhje e martesës së vlefshme si e plotëfuqishme gjatë jetës së bashkëshorteve deri sa bashkëshortët të jenë gjallë.

Familja patriarkale shëndrohet në familje demokratike dhe ajo është në një proces tranzicioni, por ky proces për shkak të krizës së thell, shoqërohet me probleme të mëdha, ndaj të cilave nuk është immune as familja jonë. Nga ana tjetër faktorët që ndikojnë në transformimin e familjes, ndikon njëkohësisht edhe në shtimin e numrit të shkurorëzimeve të cilat i shqyrtoam gjatë kërkimeve dhe se rezultatet janë të shumta, këto e tregojnë edhe të dhënat statistikoke nga enti shtetëror që ne i cekëm paraprakisht.

**E dyta,** Në bazë të analizimit të të dhënave të mbledhura rezultatet tregojnë se ekzistojnë mekanizma dhe baza të ndryshme për shpëputjen e Shkurorëzimi si mënyrë e zgjidhjes së martesës gjatë viteve 1998-2012 72

martësës, mirëpo, ekzistojnë po ashtu edhe alternativa të ndryshme për ta penguar atë. Në R.M të dhënat rreth procedurës së shkurorëzimit mund të merret vetëm nga organet shtetërore, nga avokati dhe mediatorët. Fatkeqësisht mungojnë burime tjera të informimit. Në vendet evropiane e sidomos në SHBA ekzistojnë burime të ndryshme të cilët ua lehtësojnë qytetarëve qasjen deri tek informacionet e nevojshme për shkurorëzimin e martësës, duke filluar nga burimet elektronike (gjetja e avokatëve që realizojnë shkurorëzimin, mediatorëve, informata rreth alimentacionit, legjislacionin ku përfshihen të drejtat dhe obligimet për bashkëshortët që shkurorëzohen si dhe rrjedhja e procedurës, forma dhe përmbajtja e kontratës apo marrëveshjes për shkurorëzim, të dhënat për përgatitjen dhe paraqitjen në gjykatë, organizimi i forumeve ku mund të parashtrihen pyetje përgjigjet e të cilëve i japin profesionistët në fushën e shkurorëzimeve, të drejtat e fëmijëve prindërit e të cilëve shkurorëzohen, informata për gjyshërit lidhur me të drejtat e tyre ndaj nipërve, dhe shumë të dhëna të detajuara të nevojshme për bashkëshortët). Vendorsja e këtyre kontakteve u mundëson palëve një përkrahje juridike dhe psiko-sociale.

Çdo rast i shkurorëzimit është i ndryshëm nga tjetri, duke u bazuar në problemet dhe karakterin e ndryshëm të personave, si dhe qasjen dhe mënyrën e të jetuarit në një bashkësi martesore. Jetën të padurueshme e bëjnë problemet e ndryshme që sjellin veprimet e njërit ose të dy bashkëshortëve, xhelozia e pakontrolluar, kontradiktat dhe konfliktet gjatë çdo veprimit të njëri-tjetrit, keqpërdorimet dhe keqtrajtimet, dhuna fizike dhe psikike, shkelja e besnikërisë bashkëshortore, Edhe pse nuk jamë e mendimit që një martesë e krijuar të priset , mirëpo nëse egzistojn shkaqet e lartëpërmendura të cilat do të ndikojnë negativisht në krijimin e një familje të shëndosh, do të ishte e arsyeshme që martesë të ndërpritet.

### **Bibliografia**

1. Aliu, A M Gashi , H, E drejta familjare, Prishtinë, 2007
2. Bakievska, M. Prestanok na brakot so razvod vo Bitola, Manastir, 2007
3. Bakievska, M. Brakot kako institucija vo Republika Makedonija, Manastir 2007
4. Mandro-Bilalli, A.; Meçaj, V.; Zaka, T.; Fullani, A., E drejta familjare, Tiranë, 2006

## The Heritage

5. Oruçi, G. E drejta familjare. Prishtinë, 1994
6. Spiroviq, L, Semejno Pravo, Shkup, 2004
7. Kodeksi për etikën profesionale të avokatëve, bashkëpunëtorëve profesional të avokatëve dhe praktikantëve të Dhomës së avokatëve të Republikës së Maqedonisë
8. Ligji mbi familjen (teksti i spastruar), Gazeta zyrtare e RM-së nr.157 /2008
9. Ligjit mbi procedurën kontestimore, Gazeta zyrtare e RM-së nr.79/2005
10. Tarifa për shpërblimin dhe kompensimin e shpenzimeve për punën e avokatit, Gazeta zyrtare RM-së, nr.153/2008
11. The European Convention on Human Rights and fundamental freedoms, 1950
12. Universal Declaration of Human Rights, 1948
13. A Few Words About Divorce, gjendet në:  
<http://diggerjones.wordpress.com/2006/12/06/afew-words-about-divorce>
14. Divorci dhe pasojat e tij, artikulli gjendet në:
15. <http://www.cdodite.com/20080425132058/Divorci-dhe-pasojat-e-tij.html>
16. Indeksi mbi reformën e profesioni ligjor, gjendet në:
17. [www.albanet.org/rol/publications/kosovo\\_lpri\\_04\\_2007\\_alb.pdf](http://www.albanet.org/rol/publications/kosovo_lpri_04_2007_alb.pdf)
18. [www.stat.gov.mk/pdf/2007/2.1.7.19.pdf](http://www.stat.gov.mk/pdf/2007/2.1.7.19.pdf)

**PhD Candidate Xhevdet F. Bushi**

**BSc. Besa Zeqiri – Bushi**

# **MARKETINGU MIKS SI KONCEPT ME RËNDËSI I MARKETINGUT DHE ELABORIMI I PRODUKTIT SI FAZË E RËNDËSISHME E MARKETINGUT MIKS**

## **ABSTRAKT**

Qëllimi i këtij punimi është se si ta kuptojmë marketingun si shkencë dhe rolin e produktit në marketing, pasi që në kohë të fundit ka filluar të vetëdisohet vetëdija apo bindja e njerëzve për marketingun dhe kuptimin e tij, pasi që deri në kohën e fundit është keqpërdorur dhe keqkuptuar termi “marketing”.

Marketingun miks mund ta quajmë si ABC e (marketingut dhe shitjes) çdo produkti që do të del në treg, pa praktikimin e marketingut miks, mund të themi se çdo produkt do të ketë jetëgjatësinë më të shkurtër.

Produkti si fazë e 4 është faza kryesore pa të cilën nuk mund të krijohet shitja apo prodhimi i tij dhe mund të themi plotësisht se pa produkt nuk ka marketing, pasi që marketingu si shkencë ndërthur në vete lëmi të ndryshme si psh. Marketingu i shërbimeve, marketingu industrial, marketingu operacional etj.

Për të filluar me studimin e marketingut mund të themi se është shkenca më interesante dhe frytëdhënëse për të prodhuar, shitur apo kategorizuar produktin.

Për produktin si fazë e marketingut themi se çdo gjë nis dhe mbaron me treg ai është produkti.

Pa produkt ska treg dhe pa treg ska produkt është esenca e rëndësisë së marketingut dhe produktit. Në këtë punim janë shkoqitur dy koncepte me rëndësi që janë: koncepti i shitjes dhe marketingut që janë koncepte shumë me rëndësi për të bërë hulumtimin e një tregu.

**Fjalët çelës: marketing, produkt, koncepti i shitjes.**

## **HYRJE**

Gjurmët e marketingut zënë fill qysh në format më të hershme të shkëmbimit, por zhvillimi i sistemit monetar, afirmimi i pikave të shitjes, i tregtarëve lëvizës, i qendrave urbane në përgjithësi, qoi në përsosjen dhe lehtësimin e vazhdueshëm të procesit të shkëmbimit.

Me rrjedhën e kohës ai ka pasur një zhvillim gjithnjë e në rritje<sup>1</sup>.

Planifikimi<sup>2</sup> si funksion primar, përkatësisht funksion fillestar të marketingut mund ta definojmë si "...proces kreativ, me të cilin paraprakisht përcaktohet kahja e aksionit të subjektit ekonomik". Planifikimi i marketingut dallon tri horizonte kohore:

- a) Afatgjatë, që kanë të bëjnë me periudha më të gjata se tri vjet,
- b) Afatmesme, që kanë të bëjnë me periudha deri në me periudha një deri në tri vjet, dhe
- c) Afatshkurtëra, që kanë të bëjnë me periudha deri në një vit, kështu që në vete duhet të përfshinë planet vjetore (që janë plane për një vit, zakonisht për vitin afarist), planet operative (të cilat kanë të bëjnë me plane ditore, javore, të dekadave, mujore dhe tremujore)<sup>3</sup>.

## **1. Ç'KUPTOJMË ME MARKETING?**

---

<sup>1</sup> Kotler, Philip, "Principles of marketing", Milano, Italy, 1999, fq.9.

<sup>2</sup> Meler, Marcel, "Bazat e Marketingut", e perkthyer nga Universiteti Victory, fq.95

<sup>3</sup> Meler, Marcel , po aty, fq.95

Në qoftë se në një mjedis çfarëdo ndonjëri do të pyetej çka kupton ai me marketing?, përgjithësisht mund të merrej përgjigjja se me marketing kuptohet shitja apo publiciteti. Përgjigjja përmban elemente të së vërtetës, por është e pamjaftueshme, pasi në realitet marketingu është shumë më tepër se sa shitja dhe publiciteti. Pjesa dërmuese në shtetin tonë nuk kanë ide fare tjetër se çka është marketingu vetëm se përgjigjen reklama, edhe mediat e keqkuptojnë termin e marketingut pasi që thuhet koha për marketing apo faqja e marketingut, vetëm se aty kuptohet se është fjala për reklamën (në kuadër të promocionit) e cila është fazë e Marketingut.

Mirëpo me kalimin e kohës do ta kuptojnë siç duhet fjalën apo termin marketing<sup>4</sup>. Fjala Marketing në anglisht do të thotë treg, ndërsa me marketing në kuptim të ngushtë do të kuptojmë të tregtuarit, më parë thamë se marketingu nuk mund të identifikohet me shitjet. Marketingu nënkuptohet si rrugë që përmes tij rrjedhin produktet prej prodhuesit drejt konsumatorëve.

Një definicion tjetër është se Marketingu është tërësi e aktiviteteve me të cilat prodhimi optimalizohet për përmbushjen e nevojave dhe të kërkesave të konsumatorëve, ngase tregu me mekanizmin e tij sugjeron për mënyrën e prodhimit, asortimentin, shpërndarjen, çmimin, porosit, dhe sjelljen e konsumatorëve (të individëve, të organizatave dhe të shoqërisë).

Janë shumë me rëndësi dy koncepte të cilat shfrytëzohen në shkencën e marketingut:

1. Koncepti i Marketingut që ka për qëllim, plotësimin e kërkesave dhe nevojave të konsumatorit, dhe
2. Koncepti i shitjes që ka për qëllim plotësimin e kërkesave të shitësit.



Qëllimet e të dy koncepteve i kam paraqitur përmes të dy skemave në vijim.

---

<sup>4</sup> Po aty, fq.9-15

<sup>5</sup> Po aty, fq. 19

## The Heritage



### *Dallimi midis konceptit të shitjes dhe marketingut<sup>6</sup>*

Dallimi midis orientimit shitës dhe konceptit të marketingut qëndron në faktin se shitja (orientimi afarist shitës) në shënjestër të qëllimeve afariste vë nevojat për shitje më të suksesshme, kurse marketingu në shënjestër të qëllimeve afariste vë nevojat e blerësëve (konsumatorëve). Shitja është e preokupuar me nevojën e shitësit që t'i realizojë produktet e tija dhe t'i shndërrojë ato në para, kurse marketingu preokupohet me idenë për kënaqjen sa më të mirë të konsumatorëve me produkte, aktivitetet dhe mjetet të tij që janë të lidhura me zhvillimin dhe distribuimin e produktit deri te konsumatorit final.

<sup>6</sup> Rexha, Nexhmi, "Bazat e Marketingut" fq.16.

Kompleksiteti dhe shumëllojshmëria e shijeve, e parapëlqimeve që klientët shfaqin në treg, nuk mund të mos merren parasysh nga prodhuesit dhe tregtarët. Kështu që prodhuesit në rastin tonë çimentoja (produkt ndërtimor), tashmë do të ishte i nevojshëm dhe do të merren parasysh këto aspekte të cilat janë:

- Çfarë produkti duhet prodhuar që të përmbushin kërkesat e klientëve me materialin dhe cilësinë?
- Cilat do të jenë format më të efektshme të promocionit që do të mundësonin informimin e klientëve dhe nxitjen e kërkesës së tyre për produktet e ndërmarrjes?
- Cili mund të jetë çmimi më optimal tërheqës për klientin e që njëkohësisht mundëson dhe realizimin e fitimit për ndërmarrjen?
- Kur, ku dhe në ç'mënyrë do të kontaktoni me klientelën?

Këto dhe e probleme tjera që deri tani nuk i kemi përmendur, nuk janë thjeshtë aspekte të procesit të *prodhimit*, poashtu as thjeshtë aspekte të *tregtimit*. Ato janë aspekte të një procesi më të përgjithshëm që ndërthur këto veprimtari janë aspekte të *marketingut*. Në këtë mënyrë ky i fundit përmes informacionit të duhur dhe të përgjithshëm, e drejton procesin e prodhimit me qëllim që produkti që do të hidhet në treg të përmbush kërkesat e klientëve.

Mund të shtrohet pyetja tjetër: në ç'raport qëndronte marketingu kundrejt veprimtarisë prodhuese? Prodhimi padyshim përbën një veprimtari ekonomike, por kjo nuk do të thotë se ai duhet të mbivlerësohet në raport me marketingun. Prodhimi i çimentos në vetvete nuk do të mjaftonte për të qenë të suksesshëm në shitjen e tyre në treg.

Në realitet prodhimi dhe marketingu janë dy anë thelbësore të sistemit të përgjithshëm të ekonomisë së tregut, qëllimi i të cilit është t'i jap konsumatorit të mirat dhe shërbimet që kënaqin nevojat e tij. Të mirat ekonomike<sup>8</sup> janë produkte dhe shërbime, të mirat janë produkte fizike materiale siç janë: librat, ushqimi, kurse shërbimet janë produkte jofizike, siç janë: pastrimi i rrobave, mësimet në

---

<sup>7</sup> Ceku, Bardhyl, "Marketingu Bazat". Tiranë, 2010, fq. 15.

<sup>8</sup> Livoreka, Ramiz, "Mikroekonomia", Prishtinë, 2012, fq.7

universitet. Prodhimi dhe marketingu synojnë të prodhojnë një vlerë që siguron plotësimin e nevojave njerëzore që quhet **dobi ekonomike**, e cila paraqitet në disa lloje:




Fig.1. Llojet e dobive dhe të marketingut<sup>3</sup>

- a) Si dobi e formës, b) Si dobi e kohës, c) Si dobi e vendit dhe d) Si dobi e zotimit.
- **Dobia e formës** sigurohet kur një fabrikues prodhon diçka duke u nisur nga materiali tjetër,
- **Dobia e kohës** nënkupton që produkti duhet të jetë i pranishëm në momentin kur klienti e dëshiron atë,
- **Dobia e vendit** do të thotë që produkti duhet të jetë i pranishëm në momentin ku klienti e kërkon atë,
- **Dobia e zotimit** nënkupton realizimin e një transaksioni dhe marrjen në zotrim të një produkti në përputhje me rregullat e caktuara.

Marketingu nënkupton një bashkësi veprimtarish në dy nivele. Kështu që përkufizimi mban parasysh mikromarketingun dhe makromarketingun. Përkufizimi i parë përqëndrohet mbi klientin dhe organizatën; i dyti mbi sistemin e përgjithshëm të prodhimit e të shpërndarjes.

**Mikromarketingu**<sup>9</sup> do të përkufizohet si vënia në jetë e veprimtarive që synojnë arritjen e objektivave që ka caktuar një organizatë, mbi bazën e parashikimit të nevojave të klientëve, duke drejtuar një fluks të

---

<sup>9</sup> Ceku, Bardhyl, "Marketingu Bazat", Tiranë, 2010, fq.17.

mirash e shërbimesh nga prodhuesi drejt konsumatorit e që kënaqin nevojat e këtij të fundit. **Makromarketingu**<sup>10</sup> paraqitet si process social ekonomik që drejton fluksin e të mirave e shërbimeve nga prodhuesi tek konsumatori me qëllim harmonizimin e ofertës me kërkesën dhe realizimin e objektivave të shoqërisë. Sikurse mikromarketingu edhe makromarketingu interesohet për fluksin e të mirave dhe shërbimeve që qarkullojnë ndërmjet prodhuesit e konsumatorit.

## 1.2. EVOLUIMI I KONCEPTIT TË MARKETINGUT

Fundi i shek.XIX me afirmimin e revolucionit industrial, shënoi edhe fillimin e sistemit modern të marketingut. Deri atëherë nuk ishte tipik prodhimi “tepricë” dhe marëdhëniet e shkëmbimit ishin të kufizuara. Prodhimi “masiv”, përsosja e teknologjisë, transportimi efikas, ulja e çmimeve, lënia pas e praktikës së “vetëfurnizimit”, prirja drejt blerjes, popullimi i qytetarëve, specializimi i punës etj, nxitën procesin e shkëmbimit. Në teoirnë e marketingut i dallojmë katër periudha të evoluimit të marketingut të cilat janë:

- Periudha e parë (*orientimi drejt prodhimit*),
- Periudha e dytë (*orientimi drejt shitjes*),
- Periudha e tretë (*koha e departamentit të marketingut*),
- Periudha e katërt (*departamenti i marketingut gjen vendin e tij në strukturën e ndërmarrjes, madje kemi një mbivlerësim të tij*).
- Periudha e parë (*ka të bëjë orientimi drejt konsumatorit*). Prodhuesi ishte mbret dhe drejtonte tregun. Oferta krijonte vetvetiu kërkesën e saj. Objektivi kryesor i prodhuesve ne kete shtuate ishte zgjerimi i kapacitetit prodhues. Kërkesa e lartë nuk perballej nga prodhimi i vogël qe ofrohej në treg, ndërkohë që edhe konkurrenca ishte e kufizuar. Roli kryesor konsistonte në shpërndarjen fizike të mallrave. Mbizotronte rregulli që “malli i mirë ë shet veten” apo që “përpara që të vesh tiganin për të skuqur peshkun, duhet ta kesh zënë atë”.
- Periudha e dytë (*orientimi drejt shitjes*).korrespondon me rrethanat e një rritjeje të vazhdueshme të prodhimit e përpjekjeve për

---

<sup>10</sup> Po aty, fq.17.

zgjerimin e pikave te shitjes, shtimit të personelit shitës, cilesinë e një shitjeje më të mirë apo të një shërbimi më të personalizuar etj. Ende vazhdohej të prodhohej pavarësisht nga kërkesa dhe funksioni i publicitetit, puna e personelit të shitjes synonte përputhjen, drejtimin e kërkesës përballë produkteve të prodhuara *a priori*. Konkurrenca po bëhej gjithnjë e më e dukshme, në sitaten kur prodhimi përkonte me kërkesën nga pikpamja sasiore.

- *Periudha e tretë (koha e departamentit të marketingut)*. Oferta kalon kërkesen. Nuk mund të ecej me pa siguruar një shtytje nga marketingu, dhe përkishte për atë krijohet Departamenti i Marketingut në kuadrin e strukturave organizative të ndërmarrjeve. Filluan kërkimet e tregut, si aspekt normal i punës së Departamentit të marketingut. Departamenti i marketingut tashmë rekomandonte drejtimin se si të përpunonte miksin e ofertës së tij. konkurrenca paraqitej gjithnjë dhe më e fortë.




Fig.2 Evoluimi i marketingut<sup>11</sup>

Duhet të shkruhet për secilin veç e veç dhe të bëhet një analizë për 4 P të Marketingut.

<sup>11</sup> Ceku, Bardhyl, "Marketingu Bazat", Tiranë, 2010, fq. 19.

*Periudha e katërt (Departamenti i marketingut gjen vendin e tij në strukturën e ndërmarrjes, mandej kemi një mbivlerësim të tij).* Kjo periudhë përkon në 30 vitet e fundit, tashmë pozicioni i marketingut është njësoj dhe më i privilegjuar në raport me departamentet e tjera brenda për brenda ndërmarrjes. Ku konkurrenca paraqitet gjithmonë më intensive dhe e sofistikuar, faktorët e tillë si roli i markës apo besnikëria bëhen gjithmonë më të rëndësishëm. Veprimtaria e ndërmarrjes tashmë përshkohet nga filozofia e konceptit të marketingut.

Zhvillimi i marketingut mund të shihet edhe sipas llojit të ekonomisë në të cilën ballafaqohen oferta me kërkesën. Sipas këtij këndëshikimi mund të dallojmë katër llojet e mëposhtme të ekonomisë:

- Ekonomia e Prodhimit- *oferta është më e ulët se kërkesa*  $O < K$ ,
- Ekonomia e shpërndarjes – *oferta është e barabartë me kërkesën*  $O = K$
- Ekonomia e tregut – *oferta është më e lartë se sa kërkesa*  $O > K$
- Ekonomia e mjedisit – *oferta është shumë më e lartë se sa kërkesa*  $O \gg K$

### **1.3 KUPTIMI I MARKETING MIKSIT DHE ELEMENTEVE TË TIJ**

#### **1.3.1. Ç'KUPTOJMË ME MARKETING MIKS ?**

## The Heritage

Marketingu miks përmban kombinimin e produkteve, çmimeve, distribuimit dhe të promocionit, me qëllim final të plotësimit të nevojave dhe të kërkesave të grupeve të caktuara të konsumatorëve. Duke patur parasysh se konsumatorët dallojnë në treg sipas nevojave të shfaqura dhe atyre potenciale, marketingu miks ka për detyrë zgjidhje të ndryshme, të cilat ju përshtaten atyre. Elementet kritike të marketingut miks siç i përmendëm edhe më lartë janë :

1. Produkti – malli ose shërbimi që i ofrohet tregut
2. Çmimi - është vlera e produktit apo shërbimit në treg shprehur në para,
3. Distribuimi - rrugët nëpër të cila kalon produkti nga prodhuesi deri te konsumatori, dhe
4. Promocioni - është metoda e shitjes së produktit dhe shërbimit në treg.

Ndonëse këto instrumente duhet të jenë në harmoni me atributet e produktit, viteve të fundit vërehen disa tendenca të unifikimit të cilësisë së produkteve pa marrë parasysh origjinën e tyre. Shkak i këtyre lëvizjeve janë: procesi i zgjerimit dhe qasjes në informata shkencore dhe tregtare, transferi teknologjik dhe qasja në sisteme të avancuara të prodhimit. Në këto kushte të tregut fitorja është e ndërmarrjes, e cila ka program të qartë dhe atraktiv të prodhimit dhe të marketingut.

Pra marketing miksi, gjegjësisht 4 P e marketingut i përbëjnë: Produkti (Product), Çmimi (Price), Promocioni(Promotion), dhe Distribucioni (Place).

### 1.3.2. KUPTIMI I PRODUKTIT DHE NIVELET E TIJ

Në konceptin tradicional të industrialistëve, ndërmarrja konceptohej vetëm si një organizatë që prodhonte produkte. Ajo “JETONTE” nga produkti

Marketingu miks si koncept me rëndësi i marketingut dhe elaborimi i produktit si fazë e rëndësishme e marketingut miks

dhe për produktin. Sipas “Drucker” ajo çfarë mendojnë të prodhojnë drejtuesit e ndërmarrjes nuk ka më rëndësinë kryesore, ajo që ka rëndësi është se çfarë dëshiron të blej konsumatori dhe cili është konceptimi i tij për vlerën që e jep produkti”.

Produkti ka qenë dhe është i pranishëm gjithnjë në fushëveprimin e njeriut. Pa marr parasysh se në ç’formë krijohet, shfaqet, funksionon, gjendet në rrafsh të drejtë në mes të ofertës dhe kërkesës. Produkti është elementi kryesor i marketingut mik, me të cilin janë në interaksion çmimi, distribucioni dhe promocioni. Me këtë mund të themi se Produkti është tërësi e vetive fizike, shërbyese dhe funksionale që është në gjendje t’i kënaq nevojat e caktuara të blerësit.

Pra, produkti është gjithçka që i ofrohet tregut dhe që gjen vend te konsumatori për kryerjen e një funksioni, kënaqsie apo shërbimi prej të cilës mund të themi se edhe njeriu ekziston.

Pa produkt nuk do të kishte jetë njeriu, sepse e tërë filozofia e produktit varet nga tregu dhe konsumatori. Pra janë dy figura të rëndësishme pasi që nuk mund të lëvizin njëra pa tjetrën. Philip Kotler ka dhënë një definicion për produktin ku thotë se: “Produkt është çdo gjë e mirë që mund t’i ofrohet tregut e që provokon vëmendjen, furnizimin, përdorimin ose konsumimin dhe të ketë mundësi të përmush ndonjë dëshirë apo nevojë. Nënkuptohen objektet fizike, shërbimet, personat, distribuimet, organizimet dhe idetë”<sup>12</sup>.

Sipas Johan Gunther. Termi “produkt” jo vetëm e cakton një objekt. Një produkt është një “objekt” që paraqet nevojat dhe dëshirat në treg. Këto mund të jenë: objekte si një makinë apo libër; organizata që përfaqësojnë ide ose parti politike; vende dhe vendndodhje, hotel, qender e mjekesise familjare etj ; persona që drejtojnë dhe përfaqësojnë një sipërmarrje, ose politikanë që përfaqësojnë të votohen <sup>13</sup>. Nga ky definicion del se çdo e mirë që

---

<sup>12</sup> Kotler, Philip, “Principles of marketing”, 1999, fq.661

<sup>13</sup> Gunther,Johann, ”Marketingu” Prishtinë, 2010, fq. 89

ka dalje në treg dhe në të cilën konsumatori gjenë dobinë apo interesin e vet për kënaqjen e nevojave të caktuara.

Me produkt konsumatori i kënaq nevojat materiale (ushqimin, veshjen, strehimin etj.), nevojat që kanë lidhmëri me shërbimet (udhëtimi me tren, shërbimi me telefon, shërbimi në restorant etj.), nevojat që manifestohen në cilësi të simboleve, përkatësisht të diferencimeve të statuseve, kur konsumatori dëshiron dhe ka mundësi të blejë produktin më të mirë – shembull. Veturë që mund të jetë ndër veturat më të mira, dhe ka mundësi të blejë mobiljet më të shtrenjtat që dallohen ndër të tjerat që ekzistojnë në treg ose të planifikon ndërtimin e shtëpisë me planin detal të brendshëm dhe të jashtëm, që në kohët e fundit zihet në gojë që këtë objekt nuk e ka askush në këtë rrethinë etj). Krijuesi i markës REVLON thotë për produktin “ Në fabrikën tonë ne prodhojmë artikuj kozmetikë, në parfumeri ne shesim ëndrrën...”. Fabula e këtyre thënieve është se filozofia e ndërmarrjes qëndron në konceptimin e produktit për klientin.

Dimensioni i Produktit – Produkti përmban dobishmëri dhe vlerë për konsumatorin. Vlera e tij caktohet nga blerësi i cili e vlerëson aftësinë e produktit që t’i ndihmojë në përmbushjen e nevojave. Produkti mund të vështrohet në nivele të ndryshme të cilat paraqesin nivelet e tij.

Në praktikë dallojmë 5 nivele të produktit dhe janë<sup>14</sup>: Bërthama, Produkti Gjenerik, Produkti i Pritur, Produkti Global, si dhe Produkti Potencial.

Në nivelin bazë qëndron **bërthama e produktit**, përgjigjja e pyetjes “çfarë blen klienti?” Pra, kemi të bëjmë me epërsitë kryesore të ofruar për blerësin: Qëllimi që një femër të blejë të kuq buzësh është jo që t’i baj buzët e kuqe por që të doket bukur” ose idea e blerjes së një kamere SONY është filmimi ose kopja e momenteve më të rëndësishme të jetës.

---

<sup>14</sup> Ceku, Bardhyl, ”Marketingu Bazat”, 2010, fq. 44

**Produkti gjenerik** është bërthama e veshur me të gjitha karakteristikat e produktit. Kemi të bëjmë me atë që e njohim menjëherë si gjendje të ofertës: një blerje në tregtoje, një seminar apo një kandidatë politik. Duke u nisur nga shembulli i mëparshëm, për kamerën do të kishim stilimin, madhësinë, kujtesën etj.

**Produkti i pritur** - korrespondon me teresine e attributeve që bleresi pret te gjej tek produkti: një orë dore duhet të tregojë kohën, një hotel duhet të jetë i pastër dhe të ketë një personel që pret, kamera duhet të realizojë regjistrimin.

**Produkti global** – që nganjëherë quhet metaprodukt, plotëson nevojat e klientëve tej parashikimeve, paraqet tërësinë e atyre vetive që ofron një prodhues rreth një produkti gjenerik me qëllim që të diferencohet. Kështu një prodhues paisjesh kompjuteri si BULL ka përshtatur nocionin e “ofertës globale” për të përshkruar se çfarë i ofrohet klientit: kompjuteri me programet bazë, programet e aplikimit, shërbimet e mirëmbajtjes (përgatitje, asistencë, këshilla etj). Kemi të bëjmë me një zgjedhje dhe jo me një produkt të izolua dhe njihet si shitje sistemesh, që kuptojmë mënyrën se si blerësi i një produkti përmbush të gjitha detyrat që lidhen me mendimin që mendohet të realizojë. Prodhimi duhet të realizojë gjithmonë ndryshime në produkt që të bëhet më tërheqës me attribute më të mira se produkti aktual. Kurse produktet potenciale i përfshijnë të gjithë përmirësimet dhe transformimet, të cilat për produktet bazë do të ishin të shumta.

### 1.3.3. KLASIFIKIMI I PRODUKTEVE

Me qëllim të përshtatjes adekuate të produkteve konsumatorëve, në marketing zbatohet metodologjia e klasifikimit. Me klasifikimin e produkteve nënkuptojmë ndarjen në lloje sipas gjenezës, mënyrës së konsumit e të tjerë. Nga aspekti i marketingut, klasifikimi i produkteve bëhet kryesisht sipas destinimit në konsum. Kështu klasifikimi i produkteve ndahet në dy grupe të mëdha që janë:<sup>15</sup>

1. *Produktet e destinuara të konsumit të gjërë, dhe*
2. *Produktet e destinuara të konsumit prodhues – shërbyes (industrial).*

**Produktet e konsumit të gjërë** – iu dedikohen përmbyshjes së nevojave të individëve, familjeve që kanë tretmanin e konsumatorit të panjohur. Produktet e tilla prodhohen në mënyrë masive për treg të gjërë, përkatësisht për mesazhet e caktuara të cilat hulumtohen me të gjitha parametrat që i kanë. Me aktivitetet e marketingut kërkohen nevojat dhe kërkesat e blerësve, mundësisht sa më homogjene dhe produktet e ndërmarrjeve të karakterit të konsumit industrial ose të gjërë që orientohen në tregun përkatës.

Mallrat e konsumit të gjërë janë produkte finale që në to ka përfunduar procesi i prodhimit, prandaj shërben për përmbyshjen e nevojave të ndryshme të blerësve dhe i reagimit të tyre ndaj produkteve, klasifikimi bëhet në katër grupime<sup>16</sup>;

Produktet e rëndomta (konvencionale), Produktet e veçanta (shopping), Produktet speciale, dhe Produktet e preferuara.

**a. Produktet e rëndomta** - blehen pa hezitime, pa humbur kohë dhe pa bërë krahasime për çmime, cilësi etj. Konsumatori blen çdo ditë (p.sh. bukë, duhan, gazeta etj), prandaj i ka të njohura çmimet, cilësinë e produkteve dhe

---

<sup>15</sup> Kotler, Philip, “Principles of marketing” 1999, fq.562-565.

<sup>16</sup> Jakupi, Ali, “Bazat e marketingut”, Prishtinë, 2000, fq.205.

punktet ku shiten ato. Në këtë drejtim blerësi pa mundim furnizohet me produkte dhe i përmbush nevojat e veta.

Produktet e rëndomta ndahen në:

1. **Produktet kryesore** (ato që blehen rregullishtë në mënyrë rutinare, sidomos produktet ushqimore, të higjienës, të ndriqimit etj),
2. **Impulsive** (produkte që blehen pa ndonjë planifikim apo aktivitet kërkimor, por që janë të dispersuar gjerë e gjatë nëpër punktet e shitjes)
3. **Krahasuese** (kur blerja bëhet me urgjencë, për shkak të nevojës së shfaqur të natyrës së tillë)

b. **Produktet e veçanta** – imponojnë angazhim më të madhë të blerësve, për të krahasuar çmimet, stilin, cilësinë, modën etj. Më krahasim me produktet e rëndomta, për të cilat informacionet janë të përditshme dhe të bollshme, për produktet e veçanta informacionet janë më të pakompletuara, më të mangëta. Blerësi në mënyrë intenzive në etapën e blerjes e kërkon çmimin, cilësinë, stilin dhe kushtet e shitjes. Kur është fjala për produktet e tilla, konsumatorët me të ardhura më të vogla detyrohen të hulumtojnë çmimet dhe faktorët tjerë, në mënyrë që të vendosin për blerje (veshmbathje, këpucë e të ngjashme).

Produktet e veçanta klasifikohen në:

1. **Produktet homogjene** (bëjnë pjesë produktet e njejta por se blerësi i dëshiron ato me çmime më të ulëta) dhe
2. **Produktet heterogjene** (ku nga produktet e ndryshme tentohet të zgjidhet cilësia, çmimi e kushtet tjera më të volitshme).

c. **Produktet Speciale** – në këto produkte bëjnë pjesë mobiljet, disa mjete të amvisërisë të konsumit të zgjatur, veturat, veprat artistike etj. Lidhur me këto konsumatori bënë përpjekje më të shumta për të grumbulluar sa më shumë informacione dhe të fituar dije reale, rreth produkteve për të cilat merr vendim t'i blejë. Vendimin për produktet e kësaj kategorie jo vetëm që e merr me vështërsi, por në rast nevojë është në gjendje të pres derisa të blejë produktin që dëshiron.

**d. Produktet e preferuara** – dallohen nga produktet e rëndomta . Radhiten në shkallë paksa më të lartë me këta të dytat , dallimi shfaqet nëpërmjet preferimit për produktet e caktuara. Për produktet e preferuara angazhimi është pak më i theksuar, me qëllim të zvoglimit të rrezikut me rastin e blerjes.

Produktet e konsumit të gjërë në bazë të kohëzgjatjes dhe të mënyrës së konsumit, kalsifikohen në dy tërësi; në produktet e konsumit të menjëhershëm dhe në produktet e konsumit të zgjatur. Në konsumin e menjëhershëm bëjnë pjesë produktet ushqimore të cilat i përmbushin nevojat elementare biofizilogjike, ndërsa në konsumin e zgjatur e përbëjnë produktet që përdoren kohë më të gjatë, p.sh. televizioni, mjetet teknike të amvisërisë etj. Nga aspekti i elasticitetit të konsumit, produktet e konsumit të gjërë ndahen në këto kategori:

**Produktet e nevojave parësore** (ushqimi, ndonjë pjesë e veshmbathjes, higjienës), **Produktet e nevojave dytësore** (mobiljet, llojet e caktuara të produkteve të veshmbathjes, të higjienës), dhe

**Produktet e nevojave tretësore** (përfshinë produktet më të rralla të shtrenjta e që i përkasin kategorisë luksoze).

**Produktet e konsumit të gjërë mund të klasifikohen** edhe sipas strukturës së konsumit. Nga ky aspekt ndahen në: produktet ushqimore, të pijeve, të veshmbathjeve, produkte të mobiljeve, të veprave artistike e të stolive, të lodrave të fëmijve e të ngjashme.

**Produktet e konsumit të gjërë** ndahen edhe në: **produkte defanzive** dhe në **produkte kreative**. Defanzime janë në fuksion të zbritjes së ndonjë shqetësimi, dhembje, ndërsa Produkte kreative e kanë rolin e knaqjes së nevojave.

**Produktet e konsumit industrial (prodhues – shërbyes)** - karakterizohen me veti tjera kundrejt produkteve të konsumit individual (të gjërë). Ato nuk janë në nivelin final por nevoiten të hyjnë në procese tjera të prodhimit. Këto produkte kanë përmbajtje dhe cilësi të llojllojshme. Disa hargjohen në një proces të prodhimit (materialet e ndryshme, energjetika) dhe Marketingu miks si koncept me rëndësi i marketingut dhe elaborimi i produktit si fazë e rëndësishme e marketingut miks

prej tyre fitohen produktet e konsumit të gjërë. Produktet e tjera kanë aso përmbajtje dhe janë të angazhuara në shumë procese të prodhimit, me vite të tëra (paisjet, impiantet, objektet ndërtimore).

Produktet e kësaj grupe klasifikohen në: **produktet e konsumit prodhues** dhe në **produktet e konsumit shërbyes**. Në këto grupime kryhen aktivitete për prodhimin, formsimin dhe adaptimin e produkteve finale, që e kanë rolin e plasimit dhe përmbushjes së nevojave të konsumatorëve të panjohur.

Nga aspekti i marketingut, varësishtë nga specifikat që i kanë produktet ndahen në : lëndë të para, materiale riprodhuese, pjesë të ndërrimit, paisje bazike, objekte ndërtimore, mjete të punës, paisje ndihmëse, material ndihmës dhe në hedhurina. Shërbimet ndahen në dy grupe: në shërbime fizike dhe në shërbimet intelektuale.

Produktet e konsumit industrial(prodhues e shërbyes) në bazë të shkallës së finalizimit mund të klasifikohen në: lëndë të para, material riprodhues, gjysmëprodukte dhe produkte finale. Ndërkaq, nga numri(masiviteti) i bartësve të nevojave, produktet ndahen në: produkte që kanë përdorim masiv do të thotë ato që destinohen për konsum të gjërë, për konsumatorë të panjohur, si dhe në produkte për përdorim individual (produkte kryesisht sipas porosisë, ku më parë dihet kush është blerësi).

Klasifikimi i produkteve të marketingut bëhet me qëllim që ndërmarrja të ketë të qartë definimin e programit të marketingut. Programi i marketingut për produktet e konsumit të gjërë është më i ndërlikuari, pastaj radhitet ai i paisjeve, kurse te lëndët e para është më i thjeshtë.

#### **1.3.4. ATRIBUTET (TIPARET) E PRODUKTIT**

Produkti i ka variablat e caktuara, të cilat e diferencojnë dhe i japin vlerë në pikëpamje të ndryshme. Variablat e kanë domethënien e attributeve të karakteristikave, apo të veçorive me çka produktet dallohen nga njëri-tjetri. Variablat e karakterizojnë produktin për të mirë a për të keq, ndikojnë në preferencat e blerësve dhe për ndërmarrjen janë parametra të rëndësishëm. Variablat e produktit, realisht mund të sistematizohen në tri grupe, siç janë<sup>17</sup>: cilësia e brendshme, ekonomia dhe cilësia e jashtme(estetika).

**Cilësia e brendshme** – me cilësi nënkuptohet grumbull i vetive fizike-kimike, biologjike, teknologjike dhe simbolike, të cilat e avancojnë ose e degradojnë, e formësojnë ose e dështojnë produktin si element parësor të ofertës. Cilësia mund të vështrohet në kënde të ndryshme. Në të përfshihet funksionaliteti, siguria, kohëzgjatja e përdorimit, efikasiteti dhe qëndrueshmëria. Ndonëse këto attribute duken edhe nga jashtë, tërësia e tyre organike është e brendshme dhe përmbajnë esencën e produktit.

**Funksionaliteti** – produkti duhet të jetë funksional, t'i përmbush nevojat e konsumit prodhues-shërbyes ose të konsumit të gjërë. Mjetet e punës çmohen si cilësore kur posedojnë karakteristika të nevojshme për kryerjen e operacioneve në procesin e prodhimit, të trafikut etj. Me këtë nënkuptohet veprimi i tyre i pandërprerë, me prishje dhe havari sa më të vogla, me aktivizim të lehtë në punë dhe me ndërprerje nga procesi i punës pa probleme teknike dhe të sigurisë.

**Siguria** – produktet blehen për përdorim të menjëhershëm apo më të gjatë. Me qenëse produktet kanë përbërje të ndryshme cilësia e sigurisë është komponentë shumë e rëndësishme. Mjetet në amvisëri që shërbejnë si media edhe për propagandë ekonomike(tek aparatet), duhet të kenë siguri për shëndetin e njeriut sa i përket rrezeve radioaktive, nëpër objektet nukleare siguria përfshihet në kufizimin e rrezeve të uranimit, në përdorimin e pesticideve doza e helmeve nuk guxon të rrezikojë cilësinë e produkteve në natyrë, e kështu të dëmtojë shëndetin e konsumatorit.

---

<sup>17</sup>Jakupi, Ali, “Bazat e marketingut”, Prishtinë, 2000, fq. 207.

**Kohëzgjatja e përdorimit** - Është faktorë me rëndësi i cilësisë së mjeteve të punës, të paisjeve dhe të produkteve tjera, të cilat janë të natyrës së përdorimit të gjatë. Përkufizimi i cilësisë në fjalë megjithatë është çështje relative. Në ekonomitë e zhvilluara, mjetet e punës dhe të prodhimit vjetërsohen edhe moralisht nga konkurrenca, zbulimet e reja, inovacionet, disenji me çka tejkalon të arriturat tekniko-teknologjike brenda intervaleve të shkurtëra kohore.

**Efikasiteti** - shprehet nëse materiali që e përbënë produktin është cilësor, teknologjia dhe normat tjera tekniko-procesore, si dhe veprimet tjera të dsitribuimit etj. Vlera e produktit dhe interesi i konsumatorit për të shtohet krahas efikasitetit të produktit. Efikasiteti në shfrytëzimin dhe konsumin e produktit është parakusht për dhënien e efekteve si në sferën e prodhimit ashtu edhe në atë të konsumit. Efikasiteti matet nëpërmjet shfrytëzimit të faktorit të kohës, përdorimit pa probleme, ngase produkti duhet të ketë madhës, formë, disenjë sa të jep efekte në kohën e shfrytëzuar, në komoditet dhe rrjedhimisht në rendiment, ekonomitë dhe rentabilitet më të lartë.

**Qëndrueshmëria** – në kuadrin e cilësisë së produktit, qëndrueshmëria zë vend të rëndësishëm. Qëndrueshmëria është tipar i sferës teknike të mjeteve të prodhimit, një gjë e tillë arrihet nga përbërja me material cilësor dhe me metoda të zgjedhura e të përsosura. Qëndrueshmëria më tepër ka të bëjë me cilësinë e substancës së produktit, e cila kushtëzon kohëzgjatjen e përdorimit.

**Ekonomia e Produktit**- çdo ndërmarrje biznesin e vet e zhvillon me sukses, nëse brendapër brenda saj realizon parimet themelore: rendimentin, ekonomitetin dhe rentabilitetin. Me trende pozitive të këtyre parimeve realizohen të ardhura më të mëdha, ngase me shpenzime më të vogla shënon indikator të suksesshëm material dhe financiar. Tërë ky aktivitet është në interaksion me programet, konceptin, vendimet dhe strategjitë e marketingut, sepse konsumatori me disa përjashtime është i interesuar që kënaqjen e nevojave të përmbush me produkte dhe shërbime që kanë çmime më të volitshme.

Vërtetë ekonomia e produktit përmban diapazon të gjërë, duke filluar nga kostoja më e lirë e cila mundëson çmimin më të ulët (lirë) e të

pranueshëm, promocioni, distribuimi deri te mirëmbajtja, racionaliteti në përdorim dhe eksplotim, përkatësisht konsum.

Ekonomia e produktit nga ana e konsumatorit vështrohet në tri aspekte:

a. Vlera e blerjes, b. Shpenzimet e mirëmbajtjes, dhe c. Racionalizimi i kohës dhe rigjenerimi i energjisë nëpërmjet komoditetit dhe ruajtjes së vitalitetit me ndihmën e komoditetit të krijuar. **Shembull;** nëse blejmë një makinë që kushton 5,000.00 € dhe që harxhon shumë dhe shpenzimet e mirëmbajtjes janë aq të mëdha dhe pjesët e shtrenjta sa që nuk ja vlen të investohet në atë makinë, nëse makina kushton 5,000.00 € dhe çmimi i një servisi është 350 € dhe një amortizer i kushton 120 €, çka kuptojmë me këtë?

Me këtë kuptojmë Jo-ekonomitet – makinë jo ekonomike, ngase shpenzimet tjera pos çmimit blerës janë më të shtrenjta, dhe anasjelltas, nëse makina kushton më shtrenjtë dhe harxhimet (shpenzimet) ditore i ka të vogla, servisimet e lira, për atë makinë apo veturë themi se është ekonomike. Estetika – është një prej variableve të produkteve.

**Estetika** - paraqet pamjen e jashtme zbukurimet të cilat joshin blerësin të vendos më shpejtë për blerjen e produktit që posedon këtë veti. Natyrisht njeriu, qenia më e përsosur në rolin e konsumatorit i ka paradispozitat edhe të natyrës psikologjike. Estetika e shfaqur nëpërmjet formës, ngjyrës, nuancave të ndryshme të ndonjë elementi, konsumatorin e ngacmon më bindshëm që të blejë produktin.

Në shtetet e zhvilluara, veçanërisht në ekonominë e SHBA-ve është shfaqur një rrymë e veçantë e quajtur **styling (stajlling)**, sipas së cilës pretendohet që produktet nëpërmjet përsosjes së estetikës të shiten me sukses më të theksuar. Për këtë qëllim punojnë ekspert të ndryshëm të cilët marrin për bazë stilin e jetesës, reagimet e konsumatorëve ndaj modave, hireve që paraqiten në formë të çuditshme, çaste dhe në forma të caktuara.

Estetika që nuk është në harmoni me përmbajtjen e tërësishme të produktit, me çka nënkuptohet funksionaliteti, përdorshmëria e Marketingu miks si koncept me rëndësi i marketingut dhe elaborimi i produktit si fazë e rëndësishme e marketingut miks

qëndrueshmëria, ekonomia me tipare të veta nuk i sjell dobi konsumatorit. Estetika duhet gjithnjë të avancohet, por që të mbetet në suaza të realitetit, por aq sa e zbukuron dhe i jep shije në shqisat vizuele. Konsumatorët kanë reagime të ndryshme në këtë drejtim, nëpër qendrat e zhvilluara dhe qendrat më të mëdha urbane sjelljet e konsumatorëve ndryshojnë kundrejt vendbanimeve tjera qoftë rurale apo edhe atyre me rregullime më të vogla urbanistike.

### 1.3.5. DIZAJNI I PRODUKTIT<sup>18</sup>

Është aktivitet kompleks dhe kreativ, që ka të bëjë me esencën dhe cilësitë e tjera të përmbajtjes, strukturës së brendshme dhe të jashtme. Çdo produkt dhe shërbim e ka disenjin e vet, në asnjë çast diseni nuk duhet të vështrohet një anshëm: vetëm nga forma, funksionaliteti, ngjyra, e tjerë. Kompleksin e tij e përbën: përmbajtja, substanca, forma e jashtme, funksionaliteti, përdorshëria dhe raportet që i ka me mjedisin. Me fjalë të tjera diseni i produktit përfshinë në mënyrë të komponuar, harmonike dhe efikase variablet tjera të produktit siç janë funksionaliteti, qëndrueshmëria, përdorshëmëria, estetika, ekonomiteti dhe çdo gjë tjetër që e bëjnë më të rëndësishëm produktin për konsumatorin, më të përshtatshëm për ambientin dhe mjedisin, më të qëndrueshëm dhe parësor për fushën e konkurrencës. Diseni duhet të mbështetet në: parimin tekniko-teknologjik, ekonomik, ergonomik dhe estetik.

**Parimi tekniko-teknologjik** – fillimisht ka të bëjë me zgjedhjen dhe përpunimin e materialit sa më cilësor nga i cili mundësohet formësimi i produktit me karakteristika cilësore, siç janë tiparet e përdorimit, të manipulimit, të shërbimit, siguria dhe lëndimet e mundshme, lehtësia dhe rreziku më i vogël për përdorim.

**Parimi ekonomik** – diseni ia imponon sjelljet në masat e mundësive në efikasitet dhe efektivitet. Diseni është tejet konkurrent po që se nuk i merr për bazë rentabilitetin e produktit të ndërmarrjes, as konsumatorit nuk i sjell dobi. Ndërmarrja nuk ka mundësi të prodhojë produkte me çmime

---

<sup>18</sup> <http://marketingu 2010.wordpress.com/about/politika-e-dizajnit-te-produktit/>

që nuk i pranon tregu, ndërsa blerësi mund ta lakmojë produktin me disenj të ofruar, mirëpo i mungon fuqia blerëse (paraja) ose nuk e pranon çmimin enorm.

**Parimi ergonomik** – përmban elemente harmonike të volitshme të disenjit të produktit, që e lidhin njeriun - makinën dhe ambientin ku punohet dhe jetohet. Ergonomia është shkencë e re, e cila merret me çështjet e përshtatshmërisë së mjeteve të metodave dhe njerëzve në mjedisin e punës dhe të jetesës. Me këtë nënkuptohet ngritja dhe ruajtja e shëndetit, e disponimit dhe e rendimentit të punës.

**Parimi estetik** – është mjaftë i qëndrueshëm në ekonomin bashkëkohore. Konsumatori çdo ditë shprehë nevoja të reja për disenjë me cilësi të jashtme, me vija estetike, ngjyrë, formë e cila është joshëse dhe tërheqëse.

**Dizajni në procesin e zhvillimit të produktit** – sikurse jeta e njeriut edhe jeta e produktit nuk lind dhe as nuk zhduket përnjëherë, derisa në krijimin e tij kalohet nëpër faza të caktuara, siç do të kalojë nëpër fazat e tjera të ekzistimit në treg.

Disenji si veprimtari kreative është i nevojshëm për produktin e ri dhe për modifikimin dhe renovimin e produkteve për t'ia zgjatur sadopak jetën në treg.

Disenji duhet të jetë gjithnjë aktual, bashkëkohor që ecën në hap ose para preferencave të blerësve. Kjo mund të arrihet në mbështetje me të mbërrimet dhe forcën e inovacioneve. Me inovacione nënkuptohen çpikje të reja në funksion të produkteve, përkatësisht të kërkesave të konsumatorëve.

**Inovacionet** – paraqiten në dy tërësi: në inovacionet e procesit teknologjik dhe në inovacionet e produktit. Veprimtaria inventive është e lidhur me diturinë, shkencën. Sipas dr.G.Devetak: “Shkenca zbulon, teknologjia zbaton, ndërsa tregu verifikon” që do të thotë që tërë atë që e krijojnë inovacionet duhet të jetë i pranuar nga tregu.

Marketingu miks si koncept me rëndësi i marketingut dhe elaborimi i produktit si fazë e rëndësishme e marketingut miks

Ndërmarrjet janë të obliguara të organizojnë inovacionet në mënyra të volitshme. Kryesisht funksionojnë tri forma të organizimit: 1. Ad-hoc; 2. Komisionet profesionale-shkencore; dhe 3. Shtabet për hulumtime në afat më të gjatë.

***Dizajni industrial*** – është i pranishëm në industri, në urbanizëm, ndërtimtari, në veprimtaritë shërbyese, në tregëti, turizëm etj. Për disenjin industrial janë dhënë definicione të ndryshme. Sipas teoricientit amerikan të disenjit , Edgar Kanfmann: “Disenji industrial është shkathtësi e shfrytëzimeve të burimeve teknologjike për kreimin dhe përpunimin e produkteve dhe të sistemeve që u shërbejnë njerëzve”. Disenji industrial nënkupton diapazonin në kuptim më të ngushtë të definimit kundrejtë disenjit të produktit, përkatësishtë aq sa ka shtrirje në aktivitetet industriale. Pra, përfshinë tërë përmbajtjen, strukturën dhe formën e produkteve të cilat prodhohen në industri dhe si produkte finale përmbushin ndonjë nevojë të konsumatorëve. Elementet pjesëmarrëse në produkt janë rezultat e parimeve tekniko-teknologjike, ekonomike, ergonomike dhe estetike.

### 1.3.6. SPECIFIKAT PËRCJELLËSE TË PRODUKTIT

Specifikat përcjellëse të produktit janë: marka, ambalazhi dhe shërbimet e shitjes<sup>19</sup>.

**Marka e Produktit** – është fjalë, shenjë, simbol, termin, shprehje, emër apo kombinim i ndonjërës prej tyre me çka emërtohet, identifikohet dhe mbrohet produkti. Marketingu është çështje e hershme është përdorur qysh në Greqinë antike dhe në Egjiptin e Lashtë, për t’i mbrojtur blerësit nga blerjet jo cilësore.

**Përparësitë tek konsumatori janë:** lehtësimi i blerjes, sigurimi i satisfaksionit të rregullt, sigurimi i bindjeve për cilësi, racionalizimi në kohë dhe shpenzimet tjera materiale, arritja dhe mbajtja e nivelit të statusit.

---

<sup>19</sup> Kotler, Philip, “ Principles of marketing” . Milano ,1999, fq. 595-605.

**Ambalazhimi i Produktit** – është pjesë përbërëse e marketingut miks. Ambalazhimi është aktivitet i veçantë i harmonizuar me karakteristikat dhe disenjin e produktit dhe shërben për ruajtjen, promocionin dhe individualizimin e produktit.

Nga aspekti i marketingut ambalazhi duhet t'i përmbajë disa kërkesa: ekonomitetin, komunikimin, funksionalitetin, madhësinë, llojin adekuat të materialit për paketim, formën, disenjin sipërfaqësor, teknikën e manipulimit dhe të përdorimit. Ambalazhi ndahet në: primar, sekundar, display dhe të transportit.

### **Shërbimet e shitjes**

Shitja nuk është vetëm akt për të kryer shërbimin e produkteve dhe të shërbimeve nga prodhuesi tek konsumatori, por përmbajnë një proces më të gjërë në ndikimin e nxitjes dhe të avancimit të saj të vazhdueshëm. Shërbimet e shitjes janë: Garancioni, Kredia dhe Servisimi<sup>20</sup>.

**Garancioni** – është mjet që prodhuesi apo tregëtia ia jep blerësit të produkteve. Jepet për produktet e konsumit të gjërë, sidomos të konsumit të zgjatur, si dhe të llojeve të produkteve të konsumit industrial. Garancioni është shërbim gjatë dhe pas shitjes. Fletëgarancioni përmban shënimet për llogotipin, emrin e produktit, datën e prodhimit, afatin e garancionit etj.

**Kredia** – krediti është instrument që e rregullon sadopak ofertën me kërkesën, ngase kërkesat e tregut bëhen më masive. Përparësia e kreditit është se produktin që nuk ka mundësi ta blejë konsumatori e merr (pranon) tash por e paguan më vonë(përmes ratave).dmth, ekziston parimi ekonomik i kreditit “Merr tani, paguaj më vonë”.

Nëpërmjet akordimit të kredive fuqia blerëse përmirësohet, shtohet, kështu që bëhet e aftë për blerje, numër më i madhë i konsumatorëve, ndërsa

---

<sup>20</sup> Kotler, Philip, “Product management”. Zagreb, 1989, fq.38.

ndërmarrja prodhuese apo tregtare e nxit shitjen, zvoglon stoqet, mund të planifikojë veprimtarinë stabile dhe afatgjate.

**Servisimi** – është aktiviteti i shitjes pas aktit të shitblerjes. Në formë të veçanta garancioni dhe kredia janë shërbime që iu ofrohen blerësve si pjesë përbërëse e ofertës. Servisimi përmban aktivitete të llojeve përkatëse rreth mirëmbajtjes së produkteve, rregullimit, evitimit të defekteve, shpjegimit të funksioneve, përdorimit, sigurimin e pjesëve të ndërrimit. Servisimi është dy lloje: I Obligueshëm dhe I pa obligueshëm.

**Obligimi për servisim** apo Servisim i obligueshëm rezulton nga fletëgarancioni që i përcakton obligimet e shitësit. Kurse Servisimi i paobligueshëm është servisim i cili i bëhet çoftë teknologjisë apo paisjeve tjera por nuk ndihet i obliguar për evitimin e defektit, mirëpo për çdo shërbim apo servisim kërkon shumë e caktuar për kryerjen e atij shërbimi.

### **1.3.7 ASORTIMENTI (GAMA) E PRODHIMIT DHE VEÇORITË E TIJ**

Ndërmarrja themelohet për të ushtruar veprimtari të caktuar, prodhuese, shërbyese, qarkulluese etj. Qysh në fazën e themelimit precizohet se çfarë produktesh duhet të prodhohen, siç ndodh edhe me ndërmarrjet shërbyese, të cilat i përcaktojnë në start shërbimet që do të ofrojnë. Kurreshtarët interesohen se çfarë prodhon ajo ndërmarrje që po themelohet, kurse përgjigja mund të jepet duke ia shpjeguar llojet e produkteve që do të prodhohen. Thënë më ndryshe nga veprimtaria apo ushtrimi i funksionit të asaj ndërmarrje materializohet me një apo më shumë produkte të cilat përbëjnë asortimentin ose gamën e produkteve. Asortimenti ose gama e produkteve është tërësia e llojeve të produkteve apo shërbimeve që prodhohen në atë ndërmarrje.

Në kuptim të gjerë përfshihen llojet e produkteve e të shërbimeve në një degë, përmbajnë asortimentin, madhësinë me të gjitha karakteristikat që prodhohen në degën përkatëse. Babai i marketingut Philip Kotler, asortimentin e prodhimit e vështron në tri shkallë apo aspekte: E para, produkti (kushtimisht një produkt); E dyta, Linja e produktit (që përmban grupe të llojeve të produkteve), dhe E treta, miks produktet (programi i prodhimit i cili

përfshinë të gjitha llojet, sasinë dhe strukturën e produkteve që i prodhon ndërmarrja).

### **Dimensionet e asortimentit të prodhimit<sup>21</sup>**

Asortimenti është çështje komplekse për ndërmarrjen. Kryesishtë karakterizohet me shkallë të theksuar të heterogjenitetit, dmth.rrallë mund të ndodhë që ndërmarrja prodhon vetëm një lloj produkti apo produkte homogjene. Poashtu, asortimenti veçohet në dimensionet që i ka. Dimensionet e asortimentit janë: gjerësia, thellësia dhe qëndrueshmëria

Në linjën e parë prodhohen tri lloj produktesh (1A,1B dhe 1 C)

Në të dytën vetëm një lloj produkti (2 A)


Në të tretën katër lloje produktesh (3A,3B,3C,3D), kurse

në linjën e katërt prodhohen tri lloj produktesh (4A,4B,4C)

---

<sup>21</sup> Kotler,Philip, “Marketing management”, Zagreb, 1989, fq.230.

## The Heritage



Numri i produkteve: 12

Numri i linjave: 4

Thellessia mesatare: 3

### 1.3.8. ZHVILLIMI I PRODUKTIT TË RI DHE CIKLI JETËSOR I

#### TIJ

Definimi i produktit të ri – është kompleks i pa definuar sa duhet. Vështirë mund të jetë produkti aq origjinal sa të ketë domethënie plotësisht të re. Para se të merret vendimi për zhvillimin e produkteve të reja, ndërmarrja duhet të ndërtojë një sistem të organizuar për mbledhjen e ideve për investime, dhe të bëjë përpunimin preliminar të tyre.

Përpunimi i tyre përfshinë: vlerësimin e tregut, vlerësimin e kornizës ligjore në theks zhvillimin e produkteve të reja, verifikimin paraprak teknologjik të produktit dhe propozimit investiv, përpunimin e propozimit financiar dhe organizativ, vlerësimin e strukturës së të punësuarëve dhe aftësive të ndërmarrjes për pranimin e përpunimin e propozimit investiv. Produkti i ri kalon nëpër disa faza të cilat përbëjnë proces të caktuar, i cili përmbledhet në dy tërësi: faza e parë, kërkimet për marrjen e vendimit për produktin e ri, dhe faza e dytë përfshinë procesin e zhvillimit të produktit. Mund të japim një definicion të produktit, ku me Produkt kuptojmë rezultatin final të veprimtarisë prodhuese, i cili për dallim nga shërbimet, ekziston si i tillë edhe pas procesit të prodhimit dhe me karakteristikat dhe dukjet e tij i

përbush (plotëson) kërkesat e tregut. Pra, me produkt të ri kuptojmë çdo gjë që futet në treg dhe është e re si për konsumatorin edhe për ndërmarrjen, dhe tregu sot është i stërbushur me produkte të reja. Pra produktet e reja konsiderohen edhe ato produkte që lansohen për herë të parë si në një treg të ri ose të vjetër si dhe për produktet e vjetra në një treg të ri.

Philip Kotler zhvillimin e produktit e ndan në 6 faza:

- Evolucioni i idesë së produktit
- Seleksionimi dhe zgjidhja e ideve më të mira
- Analiza Ekonomike
- Konkretizimi i idesë së produktit
- Testimi i tregut dhe i strategjisë së marketingut
- Lansimi dhe komercializimi i produktit.

Hedhja e produktit të ri<sup>22</sup> në treg nuk bëhet aty për aty, por brenda një periudhe të gjatë. Por idea për të hedhur një produkt në treg kalon përmes disa fazave: grumbullimi i informacioneve nga tregu, anketimi i konsumatorëve, analizat e SËOT-it, konkurrenca, analiza financiare, plani i marketingut, këta janë shumë faktorë me rëndësi që të hudhim në treg një produkt.


Nevojat për lansimin e produktit të ri janë dykahëshe: të ndërmarrjes dhe të tregut. Ndërmarrja vendos për lansimin dhe zhvillimin e produktit të ri, nëse ekzistojnë mundësitë organizative dhe të resurseve brenda në te, si dhe nëse ekziston tregu aktual dhe potencial. Faktikisht ndërmarrja kalkulimet i bënë me veten. Po që se konstatohet se shkohet në produkt të ri, vihen në spikamë faktorët që ndikojnë dhe e formojnë këtë vendim. Në zhvillimin dhe komercializimin e produktit të ri, ndërmarrjen e nxisin nevojat vetiake.

---

<sup>22</sup>Beqaj, Besim, “Zhvillimi I produkteve te reja”, Prishtinë, 2003, fq.73

Ndërmarrja ka nevojë për hedhjen e produktit nëpër tregje të reja, pozicionimin e mirëfilltë të produkteve në tregjet aktuale dhe ato potenciale. Produkti i ri përkatësisht shumica e produkteve të reja në programin e prodhimit është faktor që ndërmarrjes i sjell dobi për sigurimin e ekzistencës dhe të perspektivës.

Cikli jetësor i produktit të ri në treg<sup>23</sup> – produkti në treg kalon përmes pesë fazave, sikurse kalon jeta e njeriut. Ato faza janë: faza e hedhjes (lansimit), faza e rritjes, faza e pjekurisë, faza e ngopjes dhe faza e degjenerimit.shitja



<sup>23</sup> Po aty, fq. 93.

Pra siç thamë edhe më lartë cikli jetësor i produkteve është i njëjtë me ciklin jetësor të gjallesave. Dihet qartë faza e parë dhe e fundit, kur lancohet produkti dhe kur braktiset produkti nga tregu.

### KONKLuzion

Në këtë punim kemi paraqitur marketingun miks që ndahet në katër kategori: produktin, çmimin, promocionin dhe distribuimin. Ne gjatë këtij punimi kemi paraqitur veçanërisht produktin dhe rolin e tij në shoqëri. Produkti si fazë e marketingut miks është themeli i çdo gjëje që do të kishte në dispozicion tregu. Produkti është jeta e tregut dhe pa produktin tregu s'do të kishte jetë.

Punimi ka një rëndësi të vëçantë sepse nuk është e lehtë të definosh produktin dhe fazat e saj.

Në kuadër të këtij punimi kemi elaboruar edhe për artibutet (tiparet) e produktit të cilat janë kategorizuar në tri grupe (cilësia e brendshme, ekonomia dhe cilësia e jashtme). Disenji i produktit si element me rëndësi i produktit është fazë që produkti duhet të bazohet në disa parime të pamjes apo dukjes së produktit për treg dhe jo vetëm dukja është me rëndësi te disenji, por në kuadër të disenjit është veçuar parimi tekniko-teknologjik, ekonomik, ergonomik dhe estetik.

Në kohë të fundit, në kuadër të konkurrencës lojale përdoren edhe llojet e specifikave përcjellëse të produktit siç janë: garancioni, kredia dhe servisimi. Garancioni përdoret shumë në kohë të fundit për joshje të klientëve, ku edhe Kredia është lehtësim i blerjes. Servisimi është element shumë me rëndësi pas shitjes së produktit apo shërbimit. Në kuadër të produktit është edhe dimensionimi i asortimentit të prodhimit që dallohet sipas tri shkallëve: thellësia, gjerësia dhe qëndrueshmëria. Çdo produkt sikurse jeta e njeriut dhe lindja e tij edhe produkti e ka jetën e njëjtë duke filluar nga lindja (lansimi), rritja, pjekuria, ngopja dhe degjenerimi i tij.

Çdo produkt i ofrohet tregut për të mbuluar ndonjë vakum që nuk e ka tregu dhe që është i nevojshëm për jetën e njeriut.

Marketingu si shkencë është shumë i praktikuar në kohën e sotme për arsye se konkurrenca është e madhe dhe tregun e kanë mbuluar lloje të ndryshme të produkteve, dhe për këtë arsye ne kemi shkoqitur produktin dhe fazat e tij.

Marketingu miks si koncept me rëndësi i marketingut dhe elaborimi i produktit si fazë e rëndësishme e marketingut miks

**LITERATURA E SHFRYTËZUAR:**

1. Philip Kotler Principles of marketing. , Emerald Group, Milano, Italy 1999
2. Philip Kotler, Marketing management, Prentice Hall,, . Zagreb 1989
3. Ceku Bardhyl..Drejtimit marketing....Progres Tiranë 2010,
4. Ali Jakupi, Bazat e marketingut., Interpress R.Company,,, Prishtinë 1999,
5. Besim Beqaj – Zhvillimi i produkteve te reja. Prishtine 2003,
6. Marcel Meler – Bazat e Marketingut, Universiteti Victory 2008
7. Ramiz Livoreka – Parimet e Mikroekonomisë...KOHA, Prishtinë 2012
8. Rexha Nexhmi, Reshidi Nail...Bazat e Marketingut Prograf Prishtinë 2000.
9. Interneti – [www.ëordpress.com/about/politika-e-dizajnit-te-produktit](http://www.ëordpress.com/about/politika-e-dizajnit-te-produktit).

**Biljana Ciglovska, PhD**

International University of Struga

b.ciglovska@eust.edu.mk

## **INSTRUMENTS AND POLICIES FOR REGULATING TRADE IN AGRICULTURAL PRODUCTS**

### **ABSTRACT**

The Foreign-trade policy of each country should create conditions for improving the competitive power of domestic producers which will enable their dynamic and equal inclusion in the international exchange and cooperation. It will also enable, establishing favorable production structure in the national economy, in which the emphases will be placed on certain sectors of the economy, depending on their importance for the country's development and promotion.

But, it should also be considered the fact that, each country is a member of some international organization, and it has no complete autonomy in creating its national foreign-trade policy. Therefore, the national foreign-trade policies should be created on the base on and in accordance with the international trade policy defined by the World Trade Organization (WTO).

This paper will analyze the foreign-trade policies and instruments of developed and developing countries which they establish in accordance with the WTO regulations and how they use them in regulating the trade with agricultural products.

***Key words: Foreign-trade policy, instruments, agricultural trade, WTO.***

## 1. Instruments for regulating the trade with agricultural products

Under the General Agreement on Tariffs and Trade (GATT) are provided range of instruments that regulates the international trade in agricultural products and they are often used for restriction of international agricultural trade. The instruments can be divided into two groups such as<sup>1</sup>:

- **direct interventions**, which includes: tariffs, import and export quotas, export subsidies, sanitary and phytosanitary restrictions and
- **indirect interventions**, which includes: exchange rate control, production programs, marketing support, subsidies for raw materials, tax release and aid for long term investments.

The direct protection instruments that are most used is the tariffs, the import and export quotas and subsidies. Tariff is a duty that is charged on imported goods. It is calculated by the value as a percentage of the good's value and there are also specific tariffs calculated by the unit of goods.

Poashtu duke e ditur përkufizimin e natyrës së punimit kam paraqitur fazat e vendosjes në përgjithësi dhe sektorin e prodhimit të Ndërmarrjes “Sharrcem” në veçanti, pastaj llojet e vendimeve, ku poashtu nëpërmes ndërmarrjes “Sharrcem” në Han të Elezit kam apostrofuat vendimet strategjike , taktike dhe operative deri te teknikat e vendosjes nga autorë të ndryshëm, ku ndryshe nga vendosja individuale, vendosja grupore për të arritur synimet e vendosjes duhet të orientohet dhe organizohet nëpërmjet teknikave të veçanta e që janë të shumta , por që në këtë punim kam veçuar disa si më të rëndësishme në aspektin e vendimarrjes.

**Fjalët çelës :menaxhment, vendimarrje**

## **HYRJE**

Duke e ditur se vendosja është e vjetër sa edhe vetë njerëzimi, marrja e vendimeve gjithnjë e më shumë sot po trajtohet dhe po i jepet një vend të veçantë në lëmitë shkencore e cila dita–ditës po bëhet shumë e rëndësishme për t’u studiuar.

Vendosja si term ka një përdorim të gjerë në fusha të ndryshme; ajo është sinonim i jetës dhe i punës, ngase nuk ka pore të jetës ku njeriu nuk mund të ballafaqohet me marrjen e vendimeve, përkatësisht vendosjen, prandaj kësaj qasje që është me rëndësi jetike në jetën e njeriut në fillim nuk iu ka dhënë trajtim i merituar, por me kohë ajo po përsoset.

Para viteve 30-ta të shekullit të kaluar studimi i procesit të vendimarrjes ka pasur kryesisht karakter akademik, që si pasojë ka pasur ekzistimin e dallimeve të mëdha ndërmjet nevojave praktike të marrësit të vendimeve dhe teorisë, e cila deri atëherë është zhvilluar<sup>1</sup>

Në kushtet bashkëkohore të jetës dhe të punës duke e pasur parasysh dinamizimin e jetës, vendosja sot është shumë intensive dhe në lidhshmëri teorike me çështjet praktike.

Çdo aktivitet njerëzor është pasojë e ndonjë vendimi të marrë, prandaj aftësia e marrjes së vendimeve është shkathtësi, e cila përsoset me kohë gjatë prvojës.

Vendosja është e pranishme në të gjitha profesionet dhe në të gjitha vendet e punës, por dallimi qëndron në faktin se sa vendime merren në atë vend pune dhe çfarë është rëndësia e atyre vendimeve.

Siç shprehem më lartë vendimet mund të merren në fusha të ndryshme, pra edhe në jetën private, edhe në ate afariste, vendimet që merren në jetën private shpesh merren edhe në bazë të intuitës, por vendimet që merren në

---

<sup>1</sup> Kuka, Ibrahim, “Vendosja Afariste - teori dhe metoda të vendosjes”, Prishtinë, 1997, faqe 18.

jetën afariste nuk mund të bazohen vetëm në intuitë, sepse ato prekin interesat e një numri më të madh njerëzish.

Nëse nisemi nga ajo se çfarë është dallimi ndërmjet vendosjes në sferën private dhe asaj afariste, marrja e vendimeve nga aspekti i menyrës, fazave, faktorëve e rrethanave në të cilat vendoset nuk ka dallim të madh, por dallimi qëndron në atë se kush është subjekt që sjell vendime, a është njeriu si person juridik, përkatësisht numrin e personave që prek vendimi, ngase në jetën private vendimi e prek drejtpërsëdrejti marrësin e vendimit, ose familjen e tij, ndërsa te vendimet afariste, vendosja prek një numër të madh të të punësuarëve, përkatësisht njerëzish.

Prandaj të gjitha vendimet nuk e kanë rëndësinë e njëjtë, por edhe pasojat nga realizimi i marrjes së vendimeve nuk e kanë rëndësinë e njëjtë. Kështu vendimet që merren për një periudhë të gjatë kohore, domosdoshmërisht kërkojnë edhe analiza më të mëdha për të marrë vendime; ngase gabimet eventuale në marrjen e vendimeve të mëdha kanë një kosto shumë të madhe dhe me pasojat të mëdha.

Edhe në nivelin intuitiv kur merren vendimet nuk do të thotë se nuk kemi të bëjmë me integrimin e vlerave, ose marrja parasysh e gjithë faktorëve pozitiv dhe negativ të çdo opcioni për t'u krijuar realizimi i vendimit, ngase nga hulumtimet e bëra nga shkencëtarët lidhur me intuitën në marrjen e vendimeve të duhura del se njerëzit kanë afësi të jashtëzakonshme për t'i vlerësuar intuitivisht opsionet, çka qon deri te përfundimi që truri ka sistemin i cili specializohet për vlerësimin e vlerës shprehet profesori Marius Usher nga Universiteti në Tel Aviv, por pavarësisht kësaj vendimet, sidomos ato afariste duan analiza komplekse, e jo mbështetje vetëm në intuitë.

Në kushtet ideale menaxheri duhet t'i ketë të gjitha informatat e duhura për vendosje, por në realitet disa punë janë të pasigurta për vendosje ashtu që vendimet ballafaqohen me rrezik dhe pasiguri, kështu menaxherët

përpiqen të sigurojnë informata për vendime alternative që të zvogëlojnë pasigurinë në vendosje<sup>2</sup>.

Ndaj duke e ditur se vendosja është zgjidhja ndërmjet shumë alternativave është e rëndësishme të identifikohet alternativa më e besueshme, përkatësisht zgjedhja e alternativës më të mirë.

Procesi i vendosjes është pjesë përbërse e jetës së njerëzve. Ajo mund të jetë nën ndikim të emocioneve apo të arsyes, përkatësisht të dyjave së bashku<sup>3</sup>.

Procesi i marrjes së vendimeve sipas autorëve të ndryshëm kalon nëpër faza të ndryshme, por fazat kryesore të vendosjes janë :

- Definimi i problemit;
- Përkufizimi i problemit;
- Kërkimi i zhdhjedhjeve alternative;
- Realizimi i qëllimit dhe
- Përcjellja dhe kontrollimi i implementimit.

Duke i definuar fazat e ndryshme të vendosjes, në praktikë arrihet në mënyra të ndryshme deri te vendimi .Të gjitha vendimet nuk merren në mënyrë të njëjtë dhe ndryshimi paraqitet në shkallën e përpunimit të fazave dhe proceseve të veçanta të marrjes së vendimit.

---

<sup>2</sup> Шуклев, Бобек, “Менаџмент”, Скопје, 1998, faqe 334.

<sup>3</sup> Prof.Dr.Berim Ramosaj: Bazat e Menaxhimit, Prishtinë, 2000, faqe 71.

## The Heritage

Për të ardhur deri te mënyra më e përshtatshme e marrjes së vendimit në Ndërmarrjen “Sharrcem” në sektorin e prodhimit, procesi i vendimarrjes shqyrtohej sipas kësaj strukture:

- Vënia e qëllimeve, që duhet të arrij vendimi;
- Përcaktimi i rezultateve që duhet të realizohen;
- Mbledhja e të dhënave dhe informacioneve të nevojshme për vendosje;
- Analiza e të dhënave;
- Parashikimi;
- Konkluzionet;
- Formimi i vendimit;

### Llojët e vendimeve

Vendimet mund të jenë të llojeve të ndryshme, ato mund të jenë:

- Vendime të Programuara
- Vendime të Paprogramuara

**-Vendimet e Programuara-** janë vendime që bazohen në kritere të caktuara të vendosjes, këto vendime janë kur menaxheri e di se çfarë do të ndodhë dhe i ka të gjitha informatat e duhura për vendosje.

**-Vendimet e paprogramuara** –përdoren për zgjidhjen e problemeve të reja, kur menaxheri nuk ka informacione ose njohuri që mund t'i shfrytëzoj si bazë për vendosje.

Vendimet përveç kësaj ndarje, ato mund të jenë :

- Vendime Strategjike

-Vendime Taktike

-Vendime Operative

**-Vendimet Strategjike**-janë vendime afatgjate dhe më të rëndësishmet, sepse me anë të këtyre qëllimeve përcaktohet ardhmëria e ndërmarrjes, prandaj këto vendime i sjell organi më i lartë i ndërmarrjes.

Menaxhimi strategjik nuk përqëndrohet vetëm me problemet kryesore me të cilat ndeshet organizata. Ai angazhohet gjithashtu edhe me zbatimin efektiv të strategjisë<sup>4</sup>.

LLoji i vendimeve ndikon shumë në zbatimin e kërkimeve. Pra natyra e kërkimeve është e lidhur shumë ngushtë me shpenzimet e kërkimeve dhe efektin<sup>5</sup>.

Ndaj në këtë kontekst vendimet e nivelit të lartë, përkatësisht vendimet strategjike kudo dhe kurdo merren nga organet më të larta udhëheqëse dhe kanë për qëllim të përcaktojnë ardhmërinë e ndërmarrjes, prandaj në këtë aspekt do të apostrofoj në mënyrë konkrete këto vendime të marra nga një organizatë serioze dhe profitabile e cila dita-ditës me privatizimin e saj po zë një vend të merituar në tregun jo vetëm kombëtar, por edhe më gjërë.

Kështu vendimet që merren nga organet më të larta të ndërmarrjes “Sharrcem” në Han të Elezit, pra nga Bordi më i lartë janë :

-bën elaborimin e strategjisë së kompanisë;

---

<sup>4</sup>. Kume,Vasilika, “ Menaxhimi Strategjik”, Tiranë, 2000, faqe 26.

<sup>5</sup>. Livoreka, Ramiz, “Kërkim Marketingu”, Prishtinë, 2011, faqe 14.

## The Heritage

-vendos për marrjen e huave, bisedimet për kreditë dhe transaksionet e ngjashme për kompaninë;

-vendosë për punësimin dhe largimin nga puna të punësuarit e kompanisë;

-bën planin e biznesit dhe master planin (planin kryesor);

-lidh çfërdo kontrate, veçanërisht për punësim, shitjen e prodhimeve apo pasuritë, blerjet, garancionet, shërbimet apo ndonjë formë tjetër të obligimeve;

-bën përcaktimin e politikës së shitjes, veçanërisht çmimeve të shitjes, apo ndonjë formë tjetër të zbritjes dhe afatet e pagesave;

-vendos për dhënien e kredive dhe paradhënien e obligimeve krediteve prej kompanisë;

-vendos për plotësimin e kërkesave të sigurimeve, garancive apo obligimet paralele apo hyrja e mundshme e borxheve për kompaninë.

Të gjitha këto që u thanë më lartë ishin vendime të nivelit të lartë menaxherik, që merreshin nga Trupat e Përbashkëta të Kompanisë “Sharrcem” ku siç dihet në kuadër të këtyre vendimeve caktohet strategjia e ndërmarrjes dhe njëherit korniza brenda të cilave duhet të lëvizin vendimet taktike të Kompanisë.

**-Vendimet Taktike-** Këto vendime kryesisht i sjell niveli i mesëm menaxherial, ku nëpërmes këtyre vendimeve përcaktohet efikasiteti dhe funksionalizimi i ndërmarrjes dhe realizohen vendimet strategjike.

Këto vendime kryesisht merren nga niveli i mesëm në hierarkinë e ndërmarrjes dhe shfrytëzohen për zgjidhjen e problemeve rutinore.

Këto vendime do t'i apostrofoja me konkretisht po sipas Kompanisë së lartëpërmendur “Sharrcem” për të parë se çfarë kompetencash ka niveli i mesëm menaxherial në hierarkinë e kësaj ndërmarrje duke shkëputur detyrat dhe kompetencat e Shefit të Prodhimit :

## The Heritage

-në konsultim me menaxherin kryesor bën planin e prodhimit për vitin paraprak;

-vendos për llojin e bluarjes së çimentos bashkë me udhëheqësin e bluarjes së çimentos;

-merr vendim për furnizim me repromateriale të nevojshme në procesin e prodhimit;

-vendosë dhe jep urdhëra për punën me ndërrime, nëpërmes coordinatorëve të ndërrimeve;

-përcjellë, përpunon dhe analizon efikasitetin e prodhimit.

**Vendimet Operative**-siç na është e njohur këto vendime kryesisht janë karakteristike për nivelet e ulëta të Menaxhmentit dhe shfrytëzohen për zgjidhjen e problemeve rutinore, që do të thotë se në shumicën e rasteve janë të programuara.

Edhe në këtë nivel merren vendime varësisht prej natyrës së veprimtarisë së punës që kryhet, pasi në këto nivele merren vendime të përditshme, do të thotë këto nivele janë të lidhura drejtpërdrejt me kryerjen e punës.

Në këtë kontekst do të parqitja rastin e ndërmarrjes se lartëcekur ku kryerësi i punës që është i lidhur drejtpërdrejt në prodhim, në rast të paraqitjes së ndonjë avarie, ai më parë duhet ta lajmëroj nivelin më të lartë udhëheqës, përkatësisht të mesëm, por në rast të pamundësisë, ai merr vetë vendim për ta ndalur repartin.

Po kësisoji merren vendime të këtij niveli edhe në reparte tjera, pasi këto janë vendime që merren për zgjedhjen e problemeve të natyrës së përditshme.

## Procesi dhe fazat e vendosjes

Perkufizimi i vendosjes, marrja e vendimeve të përgjithëshme, me vështirim të veçantë në ndërmarrjen “sharrcem” të hanit të elezit

Duke paraqitur procesin e marrjes së vendimeve ne duhet te paraqesim edhe njohjen e natyrës së procesit të vendimeve dhe në këtë kontekst dallimin e sjelljes së vendimeve, ngase sjellja e vendimeve rutinore nuk kërkon kohë të njëjtë me vendimet strategjike pasi këto të fundit kërkojnë edhe alternativa të shqyrtimit, por edhe dije, përkatësisht njohje mbi problemin në të cilin merret vendimi.

Prandaj gjatë vendosjes afariste hasim në dy mënyra të sjelljes së menaxherëve në procesin e vendimmarrjes: ata të cilët i marrin vendimet në mënyrë shumë të lehtë, pa i analizuar pasojat e marrjes së vendimit të gabuar, që do të thotë se i marrin vendimet ad hoc dhe grupi i dytë: ata të cilët i marrin vendimet ngadalë dhe me kujdes, duke i hulumtuar të gjitha alternativat e mundshme, por duhet të cekim se edhe ky grup shpeshherë duke i analizuar të gjitha alternativat dhe duke dashur që gjithmonë të shkon në rrugën më të sigurtë, ndodhë ndonjëherë edhe të vonohen në marrjen e vendimeve gjë që do të ishte vendim i vonuar dhe i ngadalshëm, por edhe i paarsyeshëm në angazhimin e njerëzve dhe mjeteve për atë vendim.

Kështu që tipi më i nevojshëm dhe më i dëshiruar i menaxherëve për ndërmarrjen do të ishte ai i cili do të lëvizte ndërmjet dy skajshmërive, pra ai i cili e di se kur nuk kërkohet kohë e gjatë në vendimmarrje merr vendimin e duhur dhe e kundërta kur do analiza për ndonje vendim di të shqyrtoj alternativat e marrjes së vendimit me kujdes etj.

Dhe në këtë kontekst do të cekja ndërmarrjen e sipërërmendur “Sharrcem” pasi ajo veq disponon me një përvojë dhe me kuadro, ku ditaditës po i kushton rendësi marrjes së vendimeve „njeriu i duhur në vendin e duhur” pra menaxherët ku secili di të kuptoj rëndësinë e vendit të punës dhe natyrën e marrjes së vendimit.

Vendosja ka fazat e procesit, pastaj faktorët e vendosjes, mënyrat, rrethinën e vendosjes, teknologjinë dhe metodat e vendosjes etj. gjë që e bën këtë temë të rëndësishme dhe serioze për studim të mëtejshëm.

### **Teknikat e Vendosjes**

Ndryshe nga vendosja individuale, ku nuk ka nevojë për ndonjë teknikë të vendosjes, te vendosja grupore është e nevojshme që grupi të orientohej dhe të organizohet, prandaj janë të nevojshme teknikat e veçanta të vendosjes si:

-Teknika „**Braistorming**” –është kjo metodë e vendosjes që karakterizohet në diskutime në mes anëtarëve të grupit ku secili anëtar ofron zgjidhje alternative të problemit. Esenca e kësaj teknike qëndron në atë se kjo e drejtë e vendosjes nuk duhet të jetë e rezervuar vetëm për menaxherët e nivelit të lartë, por edhe për anëtarët tjerë të ndërmarrjes, përkatësisht grupit.

**Teknika Delfi**-është teknikë mjaft e rëndësishme për vendosje. Kjo është punë e sinkronizuar e ekspertëve të profileve të ndryshme e cila shpie deri në vendimin përfundimtar, përmes vlerësimeve të shumta, metoda delfi është bërë dhe gjithnjë është metoda e shfrytëzuar më së shumti në botë<sup>6</sup>.

**Teknika nominale grupore**- Te kjo teknikë anëtarët e grupit veprojnë në mënyrë të pavarur, gjë që në disa raste anëtarët nuk ka nevojë as të jenë në vend të njëjtë. Vendosja përmes teknikës nominale grupore zhvillohet nëpër disa faza derisa të merret vendimi përfundimtar.

## KONKLUZION

Duke njohur kushtet e vendimarrjes, në një rrethinë gjithnjë e më të paqartë, vendosja bashkëkohore është e pamundur të realizohet pa informacione të mjaftueshme. Prandaj menaxherët sot, gjatë zgjidhjes së problemeve, përveç dijes dhe aftësive duhet të kenë informata dhe të dhëna të mjaftueshme për të marrë një vendim të nevojshëm.

Kështu duke pasur parasysh se element me rëndësi për marrjen e një vendimi është sfida që kemi përpara dhe zgjidhja që mund të bëjmë, duhet të cekim se vendosja dallon varësisht se çfarë vendimesh merren. Nëse merren

---

<sup>6</sup> Stojanović, Radmila, “Planifikimi në shoqërinë vetëqeverisëse”, Prishtinë , 1978, faqe 118.

vendime të nivelit të lartë duhet të kihet parasysh se edhe shkalla e rrezikshmërisë është më e madhe dhe meqë janë vendime të paprogramuara edhe mundësia e gabimit është më e madhe , pastaj kostoja e korigjimit më e lartë, gjë që nuk është e njëjtë me vendimet e nivelit të ulët.

Prandaj në kushtet bashkëkohore, vendosja afariste siç u cek më lartë është e pamundur të realizohet pa mbështetje të fortë informative, mirëpo në rrethana të rrezikut dhe paqartësisë, kur menaxherët nuk disponojnë informacione të duhura marrja e vendimeve varet nga aftësia, dija, dhe përvoja e tyre ose bashkëpunimi me ekspert të asaj fushe duke marrë këshilla profesionale për të marrë një vendim të duhur.

### ***Literatura***

- Vasilika Kume: Menaxhimi Strategjik, Tiranë, 2000.
- Prof.Dr.Ibrahim Kuka: Vendosja Afariste, Prishtine, 1997.
- Бобек Шуклев: Менаџмент, Скопје, 1998.
- Prof.Dr.Ramiz Livoreka: Kerkim Marketingu, Prishtinë, 2011.
- Prof.Dr.Berim Ramosaj: Bazat e Menaxhimit, Prishtinë, 2000.
- Dr.Ali Jakupi: Ekonomia dhe Organizimi i ndërmarrjes, Prishtinë, 1997.
- Dr.Radmila Stojanoviq: Planifikimi në shoqërinë vetëqverisëse, Prishtinë, 1983.
- Nexhmi Rexha , Nail Reshidi: Bazat e Marketingut, Prishtinë, 1998.
- Heinz Weihrich, Harold Koontz: Menadžment,deseto izdanje, Zagreb, 1994.

**Prof .Dr. Lekë Sokoli**

**Faculty of Political Sciences**

**International University of Struga**

## **INTEGRIMI EVROPIAN I SHQIPERISË, AKTUALITET DHE PERSPEKTIVË.**

### **ABSTRAKT**

BE përfaqëson sot modelin më të suksesshëm të bashkimit pa luftë, nëpërmjet elementit ekonomik e më pas atij politik të shteteve europiane që më parë kishin mangësi të mëdha në trajtimin e konsensusit si kartën kryesore në kuadrin e një bisedimi ndërshtetëror.

Ndryshimi i një regjimi politik me një tjetër imponon një periudhë tranzicioni, periudhë ku shteti duhet të përshtatë strukturat e tij institucionale dhe jo vetëm, me qëllim përafrimin me modelin që aspiron. Orientimi i Shqipërisë, pas rënies të komunizmit ishte i njëjtë me atë të ish –shteteve socialiste, integrimi në strukturat euroatlantike.

**Fjalët çelës: Bashkimi Evropian, integrimi, strukturat veriatlantike, tranzicion**

## HYRJE

*“Unë personalisht besoj se populli shqiptar dhe institucionet e tij do të ndeshen me kujdes me këtë sfidë dhe do të mbartin standardet europiane në vendin e tyre. Angazhimi, vendosmëria, durimi dhe realizmi janë bazat e strategjisë.*

*Dhe Europa do të jetë në anën tuaj, me ndihmë, mbështetje, këshilla dhe inkurajim”.*

*Romano Prodi<sup>1</sup>*

Integrimi nuk duhet keqkuptuar si eliminim i thjeshtë kufijsh, i cili do të bëjë të mundur lëvizjen e lirë drejt vendeve më të pasura të Europës. Ai nënkupton, përshtatjen e modelit qeverisës me vlerat europiane të demokracisë, respektimit të të drejtave të njeriut, të minoriteteve, funksionimi i shtetit të së drejtës dhe imponimi i ligjit, sikurse dhe një sërë elementesh ekonomike, që të bëjnë funksionale ekonominë e tregut.

Ndërkohë që anëtarësimi në strukturën ushtarake të Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO) u konkretizua në prill 2008, me ftesën e bërë në Summitt-in e Bukureshtit, për tu bërë anëtare me të drejta të plota vetëm një vit më vonë, procesi i anëtarësimit në Bashkimin European dhe më tej integrimi, duket se është një proces edhe më kompleks.

Vitet 1990-1993 mbetën në historinë e diplomacisë europiane si vitet e negociimit të kushteve dhe mjeteve të asocimit të shteteve të Europës qendrore dhe lindore në BE. Rezultati i negociatave diplomatike u konkretizua në marrëveshjet e asocimit, të nënshkruara midis një shteti të asociuar dhe KE, dhe SHA nga ana tjetër.

Analistët e fenomenit european të dekadës së fundit të shek. XIX vërejnë se “vendimi i zgjerimit të BE-së drejt qendrës dhe lindjes së kontinentit

---

<sup>1</sup> Instituti i Studimeve Ndërkombëtare “Shqipëria dhe Bashkimi European”, (<http://www.aiis-albania.org/BE.pdf>)

ka shkaqe politike (për ti hequr nga influenca e socializimit sovjetik) si dhe motive ekonomike (konsolidimi i tregut evropian përëndimor nëpërmjet zgjerimit drejt një zone të paaksesueshme deri në vitin 1989 ose pothuajse të paaksesueshme)<sup>2</sup>.

Individi i thjeshtë është i preokupuar të dijë se çfarë përfiton nga anëtarësimi, fazat të cilat duhen kapërcyer deri në integrimin e plotë, sot kur Shqipëria është kandidate potenciale për anëtarësim në BE, si dhe koston që duhet paguar.

Sondazhet e kryera tregojnë një nivel të ulët njohurish rreth Bashkimit European, procesit të integritimit si dhe strukturave komunitare europiane<sup>3</sup>.

Le për të dëshiruar fakti se integrimi i Shqipërisë perceptohet si një proces i jashtëm në raport me aktivitetin e të intervistuarve, i reflektuar dhe në faktin se njohuritë e tyre mbi institucionet e Bashkimit European janë të kufizuara (psh. në bazë të një sondazhi në administratën lokale vetëm 20% e të intervistuarve e dinin që Komisioni European ishte një institucion i BE, ndërsa tek të intervistuarit e institucioneve të pavarura dhe gjyqësorit kjo përqindje shkonte tek 30%).

Televizioni dhe mediat duket se janë burimi kryesor i informacionit në lidhje me procesin e integritimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Pas tyre, interneti rradhitet si burim i tretë më i rëndësishëm i informacionit.

Edhe pse sondazhi është realizuar në vitin 2006, rezultatet e tij janë ende aktuale, pasi roli i institucioneve të implikuara në proces nuk është ende i dukshëm në realitet, në kuptimin e një roli informues, agresiv i cili të shterojë

---

<sup>2</sup> Mazilu, Dumitru, “*Integrarea europiana, Drept comunitar si institutiue europiane*”, Lumina Lex, 2008 fq. 30

<sup>3</sup> Sondazh i bërë me 1077 të intervistuar në katër grupe (administrata qendrore, administrata lokale, institucionet e pavarura dhe gjyqësori), në periudhën nëntor – dhjetor 2006, ku theksi vihej mbi aspekte si njohuritë rreth MSA-së dhe informacion mbi procesin e integritimit të Shqipërisë në BE. (Për më tepër shih: “*Shqipëria dhe BE, MSA dhe më pas*”. MIE, Tiranë 2007)

pyetjet mbi integrimin nga ana e individëve të interesuar rreth fenomenit dhe jo vetëm kaq, qytetarëve të thjeshtë duhet tu bëhet transparent procesi, avantazhet dhe disavantazhet e tij, duke çrrënjësuar idenë se procesi kryhet në Bruksel!

## NDIKIMI INSTITUCIONAL NË PROCESIN INTEGRUES

Integrimi evropian koordinohet nga struktura institucionale të veçanta, në kuadër kombëtar dhe në kuadrin dypalësh të bashkëpunimit, ku rol kryesor ka Komiteti ndërministror për Integrimin Evropian si struktura më e lartë institucionale, që drejton dhe monitoron gjithë procesin e integritit në Shqipëri.

Kjo strukturë drejtohet nga Kryeministri dhe përbëhet nga ministra dhe zyrtarë të lartë të institucioneve të tjera qëndrore.

Përveç tij, *Ministria e Integritit* është struktura speciale e Këshillit të ministrave e cila koordinon dhe monitoron të gjithë procesin e Stabilizim-Asocimit, si dhe përkujdeset për vënien në jetë të prioriteteve qeveritare të integritit evropian.

*Drejtoria e Përgjithshme për bashkëpunimin Euro-Atlantik*, në *Ministrinë e Jashtme* është strukturë tjetër institucionale, përgjegjëse për promovimin, njohjen, dhe përkrahjen e procesit të Stabilizim Asocimit në nivelet më të larta politike të Bashkimit Evropian.

Dialogu me Bashkimin Evropian zhvillohet nëpërmjet Trojkës Ministrore, takimeve të Komitetit të përbashkët dhe Task Forcës konsultative në nivel ministror dhe takimet e grupit të punës në nivel zv/ministrash.

Duke u ndalur në aspekte mbi koston që duhet të paguajë Shqipëria për të qënë anëtare e BE-së besojmë se bilanci është pozitiv nëse reformat e duhura politike dhe ekonomike dhe ato sociale realizohen siç duhet.

Aspekte stabilizuese si forcimi i institucioneve, konsolidimi i shtetit të së drejtës, përafrimi i legjislacionit të cilat krijojnë kuadrin e duhur për zhvillimin e tregëtisë të lirë, lëvizjen e lirë të mallrave, kapitalit, shërbimeve,

punonjësve brenda strukturës europiane, konsolidimi i ekonomisë të tregut janë argumente pro integritet, të mbështetura nga aspekte sociale, kulturore, ekonomike të tjera si mundësitë për punësim në kuadrin institucional komunitar, fonde europiane, që mund të merren më lehtë dhe të investohen për interesa vetjake, Shqipëria si treg evropian ku produktet kompetitive do çojnë automatikisht në uljen e çmimeve, rritja e pagave, fakti që bëhemi pjesë e strukturës të përbahkët europiane të cilës i përkasim gjeografikisht, dhe kultura jonë bëhet pjesë përbërëse e kulturës europiane.

Ne kemi çfarë ti eksportojmë Evropës - frymën e tolerancës fetare, vlera monumentale dhe figura të tilla si Nënë Tereza, Ismail Kadare, pa u trembur se do humbim identitetin kombëtar.

Nënvizimi i argumentave të mësipërm, i kufizuar vetëm në argumentat pro imponohet përveçse nga karakteri i disiplinës ku u trajtuan këto elemente, nga fakti që euroskepticizmi në vendin tonë pothuajse nuk ekziston si dhe nga karakteri i pakthyeshëm i procesit të integritet në Bashkimin Evropian.

Pa mohuar një nuancë politike në vendimarrjen e BE-së përse i përket pranimit të një shteti të ri në strukturat europiane duhet thënë se kjo nuancë politike zbehet në momentin që shteti plotëson detyrimet e tij dhe procesi i anëtarësimit vjen si pasojë e natyrshme e reformave dhe progresit të arritur dhe jo si një *dhuratë* e faktorit ndërkombëtar, edhe pse për shumë shtete është proceduar në pranimin e tyre edhe pse të papërgatitura plotësisht, për të vijuar plotësimin e detyrimeve brenda strukturës komunitare europiane.

Pa dashur të parashikojmë afate për anëtarësimin e Shqipërisë, pranojmë faktin se procesi mund të ndodhë pas 4 – 21 vjetësh, në periudhën nga viti 2010 deri në vitin 2027<sup>4</sup>, për sa kohë që dhe propozimi i fundit i Greqisë për anëtarësimin e plotë të Ballkanit Perëndimor, brenda vitit 2014 rezultoi një nismë e cila nuk gjeti përkrahjen e duhur për konkretizim.

## KONKLuzion

---

<sup>4</sup> MIE, “15 pyetje për Bashkimin Evropian”, Tiranë 2007, fq. 38.

Ideja e një Europe të bashkuar u përkrah dhe nga perandorë dhe intelektualë, por vetëm pas Luftës së Dytë Botërore shtetet europiane e institucionalizuan këtë bashkëpunim ndërkombëtar me kompetenca në fusha specifike si NATO, Bashkimi i Europës Perëndimore. Këto organizata vunë bazat e një solidariteti më të ngushtë ndërmjet shteteve anëtare, por ende shfaqen karakteristikat klasike të një bashkimi midis shteteve dhe të bashkëpunimit ndërqeveritar.

Plani Schuman parashikonte transferimin e sovranitetit drejt një organizate me fuqi shtërnguese mbi anëtarët e tij. Iniciativa çoi në integrimin e prodhimit të qymyrit dhe çelikut të Francës dhe Gjermanisë në kuadër të një organizate të hapur për pjesëmarrjen e shteteve të tjera europiane.

Integrimi european duhet të niste nga një integrim sektorial, e më pas të kalonte në një integrim të përgjithshëm, i cili nis me eliminimin e rivalitetit që ekzistonte midis Francës dhe Gjermanisë për zonat strategjike Ruhr dhe Saar.

Iniciativa europiane rifillon me forcë në vitin 1955, në kuadër të Konferencës së Messinës ku ministrat e jashtëm të KEQÇ ranë dakord për krijimin e një bashkimi ekonomik, bazuar në tregun e përbashkët dhe mbi krijimin e një organizate për energjinë bërthamore.

Një komision ekspertësh i udhëhequr nga P. H. Spaak çoi në hartimin e dy projekteve që paraprinë Traktatin e Romës.

Objektivi i menjëhershëm i Traktatit të Romës, i nënshkruar më 25 mars 1957, dhe i cili hyn në fuqi më 1 janar 1958, u përfaqësua nga krijimi i një tregu të përbashkët dhe trajtimi progresiv i politikave ekonomike të shteteve anëtare si mjete për realizimin e një zgjerimi të vazhdueshëm dhe të ekuilibruar të një rritjeje të standarteve të jetesës dhe të një marrëdhënieje më të ngushtë midis shteteve anëtare.

Duke nisur nga viti 1950, niveli i integritit european u rrit në mënyrë progresive si nga pikëpamja gjeografike, ashtu dhe nga ajo e zhvillimit të politikave dhe strukturave institucionale të përbashkëta. Kështu, duke u nisur nga një Komunitet Ekonomik prej 6 anëtarësh, në momentin e sotshëm u arrit

në një bashkim politik prej 27 shtetesh (në negociim për aderimin e vendeve të tjera).

BE mbetet në teresi një komunitet drejtësie, që do të thotë se legjitimiteti dhe funksionimi i tij garantohen nga respekti që cdo vend anëtar i jep së drejtës dhe demokracisë përfaqësuese.

I konceptuar si mjet për të bërë të pamundur që të përdoret lufta ose forca për zgjidhjen e konflikteve mes tyre, BE nuk mund të hapet tjetër përveçse drejt vendeve që kanë struktura kushtetuese ose praktika qeveritare në pajtim me modelin demokratik përfundimor.

Po i njëjti konsensus ligjor shpjegon faktin që institucionet europiane mund të ushtrojnë pushtet shtërngues pa pasur mjete policore, dhe kjo sepse shtetet anëtare vënë në dispozicion të së drejtës europiane aparatet e tyre juridike dhe administrative. Shtetet i konformohen logjikës së sovranitetit të deleguar.

Nëse një shtet i caktuar do të refuzonte një normë europiane të adoptuar tashmë ose do e shkelte në mënyrë të shprehur një vendim të drejtësisë të marrë në zbatim të së drejtës europiane, ky shtet do vendosej “de facto” jashtë Bashkimit Europian.

Integrimi evropian ndërthuri që në fillim proceset ekonomike me ato politike. Lufta e ftohtë mes botës përfundimore dhe asaj lindore, kërcënimi i komunizmit dhe objektivi i ruajtjes së paqes në kontinent si dhe dëshira për pavarësi nga SHBA nuk kanë qënë elementë të huaj në fillimet e integrimit ekonomik evropian. Kështu që dhe tentativat para Traktatit të Romës (1957) patën arsye politike: krijimi në 1951 i KEQC pati objektiv kryesor shmangien e një lufte të re mes Francës dhe Gjermanisë, dmth. sigurinë e kontinentit evropian.

Bashkimi Evropian përfaqëson, nëpërmjet organizimit dhe objektivave strukturën më komplekse politike dhe ekonomiko-monetare, që ekziston në kontinentin evropian. Nga gjithë strukturat europiane (BE, NATO, Këshilli i Europës, OSBE) BE përfaqëson organizatën kyc.

BE e nisi aktivitetin e saj nën këtë emërtim në 1 nëntor 1993 pas Traktatit të Maastrichtit.

Bashkimi European përfshin aktualisht 20 republika dhe 7 monarki kushtetuese (Belgjike, Danimarka, Luksemburgu, Hollanda, Anglia, Spanja, Suedia) – te gjitha demokraci.

Sot, një pjesë e opinionit publik european akuzon BE për mungesë të liderëve vizionarë-sic ishin Charles de Gaulle, Francois Mitterand, Konrad Adenauer dhe Helmut Kohl – që të mund të përballojnë sfidat e mëdha ku gjendet sot BE në kushtet e globalizmit. Shtetasit europianë pyesin veten “Quo vadis Europa”? dhe presin nga liderët e BE përgjigje bindëse dhe të përgjegjshme. Këto përgjigje duhet të reflektojnë një konvergjencë mes opinionëve të strategëve të BE-së dhe shtetasve dhe ti referohen si përmirësimit të funksionimit të institucioneve dhe mekanizmave europiane si dhe masa të duhura me qëllim krijimin e një Europe më të fuqishme dhe dekmokratike, më afër qytetarëve të saj dhe problemeve të tyre.

Si perfundim, duhet thene se BE sot përbën rezultatin e zhvillimit të një projekti rreth 5-6 dekadash. Kjo periudhë nuk u anashkalua nga sfidat apo momentet e krizës. Cfarë është e rëndësishme është se cdo herë u gjetën personalitete - shpeshherë nga vende të vegjël si Pierre Werner, ish kryeministër i Luksemburgut – që i kapërcyen këto momente krize me sukses. Për më tepër, motori i kësaj organizate ishte aleanca franko-gjermane që funksionoi shkëlqyeshëm gjatë periudhës së presidentit francez Mitterand dhe kancelarit gjerman Kohl.

## LITERATURA

1. Ervin Pupe, “*Institucionet dhe e drejta e Bashkimit European*”, (cikël leksionesh), 2009.
2. Instituti i Studimeve Ndërkombëtare “*Shqipëria dhe Bashkimi European*”, (<http://www.aiis-albania.org/BE.pdf>)
3. Iva Zajmi, “*E drejta europiane*”, Extra, Tiranë, 2007.
4. Komisioni i Komuniteteve Evropiane “*Raporti i progresit 2009 për Shqipërinë*”, Bruksel, 14.10.2009.
5. Dumitru Mazilu, “*Integrarea europiana, Drept comunitar si instituti europiane*”, Lumina Lex, 2008.
6. Ligoraq Toshi, “*Shtetësia europiane dhe impakti i saj mbi defiçitin demokratik në Bashkimin European. Risetë e Traktatit të Lisbonës*”, material nga Konferenca shkencore “*Sistemi kushtetues dhe sfidat e tij*”, ([http://www.soros.al/konference\\_sistemit\\_kushtetues.htm](http://www.soros.al/konference_sistemit_kushtetues.htm)).
7. Ministria e Integrimit, “*Glosari për integrimin european, institucionet dhe politikat e Bashkimit European*”.
8. Ministria e Integrimit, “*15 pyetje për Bashkimin Evropian*”, Tiranë 2007.
9. Ministria e Integrimit “*Shqipëria dhe BE, MSA dhe më pas*”, Tiranë 2007.
10. Revista “*European*”, revistë periodike e Ministrisë së Integrimit, nr.1,- janar 2004; nr. 2 – mars 2004.

**Doc. Dr. Bledar Ilija**

Albanian National Chamber of Advocate, Title Lawyer

bledar\_ilia@hotmail.com

## **DALLIMI I PËRGJEGJËSISË NË SHKAKTIMIN E DËMIT JO PASUROR DHE VERIFIKIMI I DËMIT**

### **ABSTRAKT**

Ndërmarrja ime për të trajtuar “Dëmin jo pasuror” në termat e një punimi shkencor më përfshiu në kërkime që i përkasin një fushë shumë delikate, të pashkelur tërësisht dhe, për këtë shkak po aq interesante, të së drejtës civile. Tërheqja ndaj këtij objekti ishte rrjedhojë e mishërimit në të, thuajse të të gjithë parimeve të së drejtës civile. Pretendimet e mia në formimin teorik, gjejnë në këtë fushë, lëndë për të eksploruar, për të kundërshtuar, për të krijuar, së fundi, për të shfaqur opinione vlerësuese.

Ndryshimi i sistemit politik solli frymë dhe botëkuptim të ri në legjislacionin e vendeve të Evropës lindore, për rrjedhojë edhe në Shqipëri. Instituti i shkaktimit të dëmit, me përkufizime të politizuara dhe të përcipta filloi të ndryshojë, duke u përshtatur me të drejtën dhe trashëgiminë doktrinare të vendeve evropiane kontinentale ose, në një vlerësim më kombëtar, u rikthye në përkufizimet e të drejtës civile të rregulluara në Kodin Civil të vitit 1929.

Me shpërblimin e dëmit ndaj të dëmtuarit, gjen zgjidhje shkaktimi i një dëmi të paligjshëm. Por që të arrihet deri këtu duhet që paraprakisht të plotësohen kushtet për lindjen e detyrimit dhe të konsumohen procedurat civile.

**Fjalët çelës: Dëm, e drejta civile, Kodi Civil, procedurë civile.**

## **HYRJE**

Dëmi jo pasuror është i njohur qartësisht dhe nga doktrina bashkëkohore. Dallimi i përgjegjësisë në shkaktimin e dëmit jo pasuror dhe Verifikimi i dëmit është hapi i parë që duhet të realizohet në situatat gjyqësore.

Rrugët normale dhe me të përdorshme të verifikimit të dëmit kundër shëndetit janë:

- Bisedimi midis palëve. (Përpyqjet për të zgjidhur konfliktin me pajtim),
- Procesi administrativ,
- Procesi penal,
- Procesi Civil (Me përjashtim të objektit të shkaktimit të dëmit të pretenduar).

Në të gjitha këto mundësi dallohet dhe kërkohet prania e kornizës procedurale. Konstatimi i dëmit kundër shëndetit, përgjatë të katër mundësive të përmendura, konsiderohet i vlefshëm dhe shërben gjithmonë si shkak i objektit të padisë.

Menjëherë pasi është verifikuar dëmi kundër shëndetit: Humbja e jetës, dëmtimi i shëndetit nga kushtet e paraburgimit etj., krijohet shkaku për të kërkuar shpërblimin e tij dhe, subjektit të dëmtuar apo përfaqësuesit të tij ligjor, nuk u ngelet gjë tjetër veçse të paraqesin padinë.

Përpara gjykatës lind një problematikë e tërë që mund të reduktohet në këto çështje:

- Përshtatja e bazës ligjore (Neni 16 i Kodit të Procedurës Civile),
- Vërtetimi i kundërligjshmërisë në rastet kur faji është element i përgjegjësisë në shkaktimin e dëmit apo, i mungesës së forcës madhore në rastet e përgjegjësisë pa faj.
- Gjetja e lidhjes shkakësore midis veprimit apo mosveprimit të kundërligjshëm dhe pasojës, vlerësimi i dëmit të shkaktuar dhe masës së shpërblimit.

Dallimi i përgjegjësisë në shkaktimin e dëmit jo pasuror dhe verifikimi i dëmit

Në lidhje me çështjen e parë, që ishte përcaktimi i bazës ligjore. Praktika gjyqësore na ka treguar që veprohet pak a shumë kështu:

Në rrethana të zakonshme procedurale gjyqtari udhëhiqet nga neni 16 i Kodit të Procedurës Civile: "...Gjykata bën cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarëveshjen pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët", duke vijuar me përcaktimin e bazës ligjore të padisë, nenin 641 të Kodit Civil.

Shembujt që do të vijojnë tregojnë që kjo punë nuk është kaq e thjeshtë sa po tregohet apo sa, duket, përkundërti kërkon njohje të thellë të ligjit dhe të gjitha cilësitë e një gjyqtari të aftë profesionalisht për të kryer detyrën.

Neni 640 i Kodit Civil parashikon: "Dëmi pasuror që shpërblehet përbëhet nga humbja e pësuar dhe fitimi i munguar..." Ndërsa neni 641 i Kodit Civil, duket sikur merret me shpërblimin e dëmit jo pasuror, duke barazuar humbjen me pakësimin e aftësisë për punë si dhe me shpenzimet për mjekim etj:

"Personi që i ka shkaktuar tjetrit një dëm në shëndetin e tij detyrohet ta shpërblejë dëmin, duke pasur parasysh humbjen ose pakësimin e aftësisë për punë, shpenzimet që janë bërë për mjekimin e tij, si dhe shpenzime të tjera që kanë lidhje me dëmin e shkaktuar" Disa nene me sipër, pikërisht në nenin 625 të Kodit Civil, përmendim edhe njëherë përmbajtjen e ij, përcaktohet:

"Personi që pëson një dëm, të ndryshëm nga ai pasuror, ka të drejtë të kërkojë të shpërblehet kur:

a) ka pësuar një dëmtim të shëndetit ose është cenuar në nderin e personalitetit të tij:

b) është fyer ujtimi i një të vdekuri...."

Paqartësia dhe inkoherenca në dispozitat e fundit, na detyrojnë të rikthehemi një çast në vlerësimin e konceptit dëm kundër shëndetit, duke u përpjekur të dallojmë në se ka apo jo elementë të dëmit pasuror.

Situata të tilla kur, janë të siguruara pjesë të ndryshme të trupit apo shëndeti (duart në rastin e një pianisti, këmbët në rastin e një atleti etj.) ka dëmtime të shëndetit, jo për faj të të dëmtuarve apo të forcave madhore, krijojnë vështirësi në përjasjen e doktrinë dhe ligjit, me cilësimin juridik të faktit.

Çfarë dëmi është shkaktuar: Pasuror apo jo pasuror? Dëm material kundër një të drejtë subjektive, asaj të "pronësisë" mbi sigurimin e veçantë të këmbëve apo duarve, apo dëm jo pasuror, drejtuar kundër shëndetit apo, së fundi, dëm moral për shkak të frustracionit që u krijua nga dështimi i shfaqjeve apo i garës.

Unë do të parashtojë këto pikëpyetje mbi këtë lloj dëmi:

Në rast se kemi dëm pasuror kush është fitimi i munguar ose, në rast se kemi dëmtim të shëndetit

cilat janë shpenzimet për rikthimin e aftësisë për punë. Si do të shpërblehej dëmi moral ?

Unë nuk jam plotësisht dakord me përgjigjen e dhënë nga jurisprudenca jonë në lidhje me pyetjen e parë, që fitimi i munguar përfaqësohet nga përqindja e depozitës së kursimeve, ndërsa pyetja e dytë realisht është e diskutueshme të këtë një përgjigje përfundimtare, kategorike. Pyetjes në lidhje me shpërblimin e dëmit moral do ti japim përgjigje përfundimtare të bazuar në ligjin vendas dhe jurisprudencën evropiane.

## **Kundërligjshmëria e dëmit**

Neni 608 i Kodit Civil, i cili jep kuptimin e përgjegjësisë civile nga shkaktimi i dëmit, kërkon patjetër ekzistencën e një dëmi të paligjshëm.

Pjesëmarrja në jetën sociale, përbën gjithashtu dhe një burim incidentesh të papëlqyeshme e me pasoja të padëshirueshme.

Atëherë nëse kushtet e tjera të përgjegjësisë civile janë të plotësuara, mund të themi se në të gjitha këto raste bëhet fjalë për dëm të shpërblyeshëm në kuptim të nenit 608 të Kodit Civil. Vetë dispozita e mësipërme në fakt, në paragrafin e dytë të saj, përkufizon kuptimin e dëmit të paligjshëm si vijon:

"...Dëmi quhet i paligjshëm kur është njëdhim i shkeljes ose i cenimit të interesave dhe i të drejtave të tjetrit, që mbrohen nga rendi juridik ose nga zakonet e mira."

Dallohet qëndrimi novator në krahasim me legjislacionin e mëparshëm, që parashikonte se dëmi duhej të shkaktohej në mënyrë të paligjshme, por pa e pasqyruar në fakt në ligj.

Në këtë mënyrë i ngelej jurisprudencës dhe doktrinës të sqaronin dhe interpretonin ligjin në këtë drejtim. Nga dispozita e cituar kuptohet se një dëm do të konsiderohet i paligjshëm, nëse ka ardhur si pasojë e veprimit ose mosveprimit, i cili ka shkelur apo cenuar të drejtat dhe interesat e një të treti, kur këto të fundit mbrohen nga rendi juridik, ose nga zakonet e mira.

**Shkelja ose cenimi i të drejtave a interesave që mbrohen nga rendi juridik.** Në këtë rast është e thjeshtë të kuptohet karakteri i paligjshëm i një dëmi. Kështu në lidhje me këtë, doktrina ka pranuar se kundërligjshmëria në këtë rast konsiston në faktin se veprimi (mosveprimi) vjen në kundërshtim me të drejtën objektive.

Gjithashtu dëmi, duke cenuar një marrëdhënie juridike konkrete, çon në shkeljen e të drejtës subjektive të personit të dëmtuar, e drejtë kjo që i është

garantuar nga ligji (nga normat juridike objektive).<sup>1</sup>

**Shkelja ose cenimi i të drejtave dhe interesave që mbrohen nga zakonet e mira.** Në rastin kur ardhja e një dëmi do të ishte pasojë e një veprimi (mosveprimi) që vjen në kundërshtim me ligjin atëherë gjithçka do të ishte e thjeshtë. I dëmtuari do t'i drejtohej gjykatës me një kërkesë ku do të tregonte veç të tjerash të drejtën dhe interesin sipas tij të shkelur apo cenuar dhe normën juridike që i garantonte këtë të drejtë. Me plotësimin edhe të kushteve të tjera, ky person do të legjitimohej të kërkonte shpërblimin e dëmit të shkaktuar.

Sidoqoftë, neni 608/2 i Kodit Civil ngarkon me përgjegjësi civile edhe personin që ka shkaktuar një dëm, duke shkelur apo cenuar të drejtat dhe interesat e një të treti të mbrojtura këto nga zakonet e mira.

Zakoni përbën një mënyrë të vepruari në një shoqëri të caktuar. Siç dihet e drejta fillimisht është bazuar mbi zakonet (e drejta zakonore), duke iu referuar jo thjesht praktikës së përditshme, por njëfarë tradite që përgjithësisht ka sjellë paqen dhe ka ruajtur mirëkuptimin midis individëve të shoqërisë.

Zakonet shoqërore në këtë mënyrë përbëjnë formën e parë të së drejtës të bazuar mbi traditën apo të drejtën zakonore që sot do t'i referoheshim ndoshta si "moral i përbashkët" i materializuar në zakonet dhe paragjykimet e një shoqërie. Atëherë nëse është ky moral i përbashkët për të cilin bën fjalë neni 608 i Kodit Civil, kur i referohet "zakoneve të mira", do të lindte pyetja se në cilat raste dhe mbi ç'kriterë do të konsideronim se një veprim (mosveprim) i caktuar cenon një të drejtë, interes të mbrojtur nga këto zakone të mira, pra nga morali.

Përgjigja është e vështirë, duke pasur parasysh se jo rrallë ka divergjenca mes të drejtës dhe moralit. Sigurisht mendoj se rregullat e sistemit ligjor do të prevalojnë në rast kolizioni të së drejtës dhe moralit. Ajo çka mund

---

<sup>1</sup> Sallabanda, Andon, "E drejta e detyrimeve", pjesa e përgjithshme, Tiranë, 1962 .

të them me siguri është që interesi që pretendohet të jetë shkelur, gjithsesi nuk duhet të ketë një karakter imoral, që të konsiderohet se është shkelur një e drejtë që mbrohet nga zakonet e mira.

Është detyrë e jurisprudencës që të "listojë" në të ardhmen interesat që mbrohen nga zakonet e mira, sidomos Gjykata e Lartë që do të bëjë unifikimin e praktikave të ndryshme.

### **Veprimi ose mosveprimi që ka shkaktuar dëmin.**

Siç u tha edhe më sipër paligjshmëria konsiston në papajtueshmërinë e veprimit ose mosveprimit me rendin juridik a zakonet e mira. Në këtë mënyrë ajo nuk ka të bëjë me anën subjektive, pra me fajësinë e autorit të dëmit. Si rrjedhim nuk ka rëndësi fakti nëse ky i fundit e dinte apo jo se me veprimin apo mosveprimin e tij po cenonte një dispozitë të caktuar ligjore.

Ky qëndrim është pranuar nga doktrina<sup>2</sup> me argumentimin se një person i zakonshëm nuk mund të ketë informacion për gjithë legjislacionin dhe mjafton të dijë që veprimi i tij të konsiderohet i qortueshëm nga shoqëria. Pra, në këtë mënyrë prezumohet dijenia e ligjit.

Si kategori objektive dëmi mund të shkaktohet si rezultat i një veprimi ose mosveprimi të paligjshëm. Shkaktimi i dëmit nga një veprim i paligjshëm ndodh atëherë kur veprimi i autorit të dëmit vjen në kundërshtim me ligjin a zakonet e mira.

Gjithashtu dëmi mund të shkaktohet edhe nga një mosveprim i paligjshëm (neni 609/2). I tillë do të jetë rasti kur personi përgjegjës ka pasur detyrimin objektiv për të vepruar dhe në fakt nuk ka

---

<sup>2</sup> Semini, Marjana, "E drejta e detyrimeve dhe e kontratave", pjesa e përgjithshme, Tiranë 1998.

## **Fakte justifikuese dhe përjashtimi nga përgjegjësia civile.**

Ka raste kur megjithëse një personi i është shkaktuar një dëm, autori i tij nuk do të detyrohet të shpërblejë atë, për faktin se ky dëm nuk konsiderohet i paligjshëm për shkak të disa rrethanave të cilat suprimojnë karakterin e paligjshëm të tij. Vetë ligji e lejon autorin e dëmit të veprojë në një mënyrë të caktuar dhe nëse gjatë veprimeve të tij vjen një dëm, ky nuk passjell lindjen e përgjegjësisë civile që rrjedh nga shkaktimi i dëmit. Kategori të tilla që justifikojnë ardhjen e një dëmi janë:

### **Mbrojtja e nevojshme.**

Shkaktimi i një dëmi në kushtet e mbrojtjes së nevojshme, nuk passjell përgjegjësi civile për autorin e tij, ky dëm nuk është i paligjshëm. Një zgjidhje e tillë është pranuar edhe në të drejtën penale. Kodi Civil e parashikon këtë në nenin 611 të tij sipas të cilit: *"Nuk është përgjegjës ai që i shkakton dëm tjetrit për mbrojtjen e nevojshme të tij ose të një personi tjetër"*. Kjo dispozitë nuk e përkuqizon kuptimin e mbrojtjes së nevojshme. Për këtë doktrina dhe jurisprudenca i janë referuar ligjit penal. Natyrisht këtu është fjala vetëm për dëmin pasuror.

Është e drejta e çdo personi që të mbrojë jetën, shëndetin, të drejtat dhe interesat e tij apo të një tjetri nga cenimi i padrejtë i tyre.

Në mungesë të forcës publike çdokush mund të mbrohet me mjetet të cilat disponon nga një dëm i tillë i paligjshëm ndaj vetës apo një të treti.

Që të konsiderohet "e nevojshme", mbrojtja duhet të plotësojë disa kushte ashtu si edhe sulmi. Kështu ky i fundit duhet të jetë i padrejtë, i vërtetë dhe i çastit. Një sulm do konsiderohet i padrejtë, kur ai synon të cenojë të drejtat dhe interesat e ligjshme të një personi dhe vetë sulmi vjen në kundërshtim me ligjin. Gjithashtu sulmi duhet të jetë i vërtetë, pra duhet të ekzistojë objektivisht dhe jo të jetë fryt i imagjinatës së mbrojtësit.

Kusht i tretë për ekzistencën e një sulmi është se ai duhet të jetë i çastit. I tillë do të jetë sulmi që është në realizim e sipër apo, duket qartë se ai po Dallimi i përgjegjësisë në shkaktimin e dëmit jo pasuror dhe verifikimi i dëmit

fillon. Pra, nuk jemi para një sulmi të tillë as kur ai ka përfunduar tashmë, as kur flitet për një sulm të ardhshëm për të cilin mund të merren masa parandaluese.

Për sa i përket mbrojtjes, duhet që kjo të drejtohet vetëm ndaj autorit të sulmit të padrejtë, për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e ligjshme të tij apo të një të treti si dhe çka është më e rëndësishme duhet të jetë në proporcion me sulmin. Si do të zgjidhet atëherë çështja në rastin e kapërcimit të kufijve të mbrojtjes së nevojshme? Mendoj së përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga mbrojtësi duhet të ndahet mes këtij dhe sulmuesit për aq sa është kapërcyer kufiri i mbrojtjes së nevojshme.

### **Ushtrimi i një të drejtë. Përmbushja e një detyrimi ligjor apo urdhri të një autoriteti kompetent.**

Këto janë dy rrethana të tjera në të cilat shkaktimi i një dëmi përjashton përgjegjësinë civile të autorit. Gjithashtu Kodi Penal, neni 21 parashikon se nuk përgjigjet penalisht ai që ka vepruar në këto kushte.

### **Ushtrimi i një të drejtë.**

Për sa i përket kësaj çështjeje mund të thuhet se ai që shkakton një dëm gjatë ushtrimit të një të drejtë subjektive të tij, nuk përgjigjet për dëmin e ardhur. Kështu për shembull, dikush ndërton, brenda të gjitha normave të urbanistikës, një pallat dhe në këtë mënyrë i zë pamjen ndërtimit fqinj, duke ia ulur kështu vlerën këtij të fundit. Në këtë rast nuk mund të flitet për shkaktim të një dëmi të paligjshëm sepse është e drejta e çdo pronari të ndërtojë mbi truallin e tij. Po kështu, pronari i cili pret rrënjët e pemëve që hyjnë në token e tij vepron në bazë të së drejtës së tij të ligjshme (neni 155 i Kodit Civil).

Ushtrimi i të drejtave duhet bërë brenda kufijve që cakton ligji, e kundërta do të çonte në ngarkimin me përgjegjësi për shpërblimin e dëmit. Në praktikë kjo nuk mund të jetë kaq e thjeshtë sepse po të shihet mirë shpesh mund të rezultojë së problemi i përgjegjësisë civile nga shkaktimi i dëmit përbën një problem konflikti të drejtash. Nga njëra anë qëndron e drejta për të vepruar e dhënë nga vetë ligji, nga ana tjetër e drejta e secilit për garanci ndaj çdo abuzimi të mundshëm. Gjithë problemi qëndron se si duhen peshuar këto

dy të drejta antagoniste në rast kolizioni të tyre.

Disa të drejta lejojnë në vetvete "dëmtimin" e të tjerëve. Kështu e drejta për të ushtruar një aktivitet tregtar në një sistem të nismës së lirë, lejon konkurrencën ndaj një tregtari tjetër, që në njëfarë mënyre e dëmton këtë të fundit. Në këtë rast nuk mund të ndëshkohet tregtari i cili mund të ketë shkaktuar falimentimin e konkurrentit të tij. Nëse kjo do të lejohej nga ligji, do të ndalohej vetë konkurrenca. Po kështu e drejta e kritikës letrare apo artistike lejon të shkruash atë çka mendon për një libër, apo vepër tjetër, të tregosh se cilët janë filmat që duhen apo nuk duhen parë. Kjo mund të dëmtojë rëndë autorët, por nëse do të ndëshkoheshin kritikët vetëm mbi këtë bazë, do të suprimohej e drejta e kritikës.

Gjithashtu ndodhemi para mungesës së përgjegjësisë civile për dëmin e ardhur, si pasojë e përmbytjes së një detyrimi ligjor apo zbatimit të urdhrit të një autoriteti kompetent. Lidhur me këtë edhe në Kodin Penal, neni 21/1, parashikohet se: *"Nuk ka përgjegjësi penale personi që vepron ...për të përmbytshur detyra të caktuara nga ligji ose nga një urdhër i dhënë prej një personi kompetent, veç rastit kur urdhri është haptazi i paligjshëm."*

Gjykata e Rrethit Tiranë, me vendimin nr. 2236 date 12.7.1999 ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë si të pabazuar në prova dhe në ligj. Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 87 date 3.2.2000 ka vendosur, ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Tiranë dhe detyrimin e Ministrisë së Financave t'i paguaj shumën 500.000 leke paditësit. Gjykata e lartë, duke krijuar jurisprudence të qarte në këtë drejtim ka konstatuar:

"Gjykata e apelit, duke ndryshuar vendimin e gjykatës së rrethit, gjykon çështjen në fakt dhe i pranon kërkesën paditësit, duke arsyetuar së paditësi ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit, dhe shuma e kërkuar nga paditësi është e arsyeshme, pasi vërtet nuk ka ndonjë masë për të caktuar shpërblimin e dëmit, por çmon gjykata e apelit, shuma e kërkuar çmohet e drejte. Ky konkluzioni i gjykatës së apelit është i pambështetur në ligj dhe si i tillë duhet të priset.

Paditësi, ashtu siç del nga shqyrtimi i çështjes ka pësuar një dëm jo pasuror, i cili në përgënjeshttrimin që i është bërë nga ana e paditur, duke u Dallimi i përgjegjësisë në shkaktimin e dëmit jo pasuror dhe verifikimi i dëmit

botuar në gazeta qendrore dhe lokale është rivendosur dinjiteti i paditësit. Në këtë aspekt vendimi i gjykatës së shkallës së parë është në përputhje me nenin 625 të Kodit Civil"<sup>3</sup>.

**Nevoja ekstreme.** Nëse do të shkaktohej një dëm në kushtet e nevojës ekstreme, a do të përbënte

kjo një rrethanë që do të përjashtonte autorin e dëmit nga detyrimi për dëmshpërblim?

Për këtë Kodi Civil ka parashikuar se: *"Personi që ka shkaktuar dëmin, duke qenë i shtrënguar nga nevoja për të shpëtuar vetën ose të tjerët nga rreziku i atëçastëm i një dëmi të rëndë, rrezik i cili nuk ka qenë shkaktuar dhe as nuk mund të mënjanohej prej tij, detyrohet të shpërblejë dëmin. Gjykata, duke marrë parasysh rrethanat e posaçme të çështjes, mund ta shkarkojë plotësisht ose pjesërisht këtë person nga detyrimi i shpërblimit të dëmit."* Në këtë mënyrë dispozita nuk jep një përgjigje të prerë. Ajo vendos rregullin se një dëm i shkaktuar në kushtet e nevojës ekstreme do të shpërblehet nga ai që e ka shkaktuar. Ky rregull ka edhe përjashtimin e vet sipas të cilit ekziston mundësia e shkarkimit apo kufizimit të përgjegjësisë dhe kjo është lënë në çmimin e gjykatës, pasi kjo të ketë vlerësuar rrethanat e posaçme të çështjes.

Në mënyrë që të kuptojmë zgjidhjen që ka pranuar legjislacioni ynë, fillimisht le të shohim se çfarë nënkupton nocioni i nevojës ekstreme dhe i dëmit të shkaktuar në këtë rast.

Në dallim nga mbrojtja e nevojshme, kuptimin e së cilës e gjejmë në të drejtën penale, Kodi Civil parashikon se kur kemi të bëjmë me një dëm të shkaktuar në gjendje të nevojës ekstreme. Sipas nenit 612 të Kodit Civil personi që ka shkaktuar dëmin duhet të ketë vepruar me qëllim shmangien e një rreziku të çastit që mund të sjellë një dëm të rëndë për vetën ose të tjerët, por me kusht që ky rrezik të mos jetë shkaktuar nga vetë ai dhe që nuk mund të mënjanohej dot me mënyra të tjera. Është e kuptueshme se që të ndodhemi

---

<sup>3</sup> Vendim Nr. 521, datë 29.5.2001 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë

para nevojës ekstreme, dëmi i shkaktuar duhet të jetë më i vogël se sa dëmi i cili rrezikonte të vinte.

Përse legjislatori nuk e ka përjashtuar nga përgjegjësia autorin e dëmit në një rast të tillë kur çdo njeri i arsyeshëm do të kishte vepruar në këtë mënyrë? Ndryshe nga rasti i mbrojtjes së nevojshme, dëmi në kushtet e nevojës ekstreme i shkaktohet një të treti, që nuk ka marrë pjesë në krijimin e rrezikut.

Përjashtimi nga përgjegjësia civile do të cenonte interesat e të dëmtuarit pa të drejtë, pasi ai nuk ka asnjë lidhje me faktin që ka sjellë dëmin. Kur personi ka shkaktuar një dëm, duke vepruar në mbrojtje të vetës apo të të drejtave të tij, kjo zgjidhje (përgjegjësia e tij) është më se e kuptueshme. Kjo sepse ai ka shmangur një dëm më të madh që i kanosej dhe shpërblimi i dëmit të shkaktuar i kushton më pak se sa dëmi që mund t'i vinte.

Nga ana tjetër nuk do të ishte e drejtë nëse dikush do të vepronte për të mbrojtur një person tjetër nga një rrezik i çastit dhe të detyrohej më pas të dëmshpërblente ndonjë dëm të mundshëm, që mund t'i ishte shkaktuar një të treti. Kodi Civil i vitit 1981 parashikonte se gjykata mund t'ia ngarkonte përgjegjësinë për shpërblimin e dëmit personit të tretë në favor të të cilit kishte vepruar autori i dëmit. Sipas Kodit aktual gjykata nuk mund ta bëjë një gjë të tillë. Megjithatë kjo përbën një rrethanë për ta shkarkuar shkaktuesin e dëmit nga përgjegjësia civile.

Këto ishin rastet kur megjithëse është shkaktuar një dëm, ligji e përjashton autorin nga përgjegjësia për shpërblimin e tij. Kjo sepse nuk plotësohet njëri nga kushtet për lindjen e kësaj përgjegjësie që ishte kundërligjshmëria e dëmit. Le të shohim më poshtë kushtin e tretë të përgjegjësisë në rastin e shkaktimit të dëmit që është faji.

### **Faji si baza e përgjegjësisë civile.**

Dallimi i përgjegjësisë në shkaktimin e dëmit jo pasuror dhe verifikimi i dëmit

E drejta jonë civile dhe doktrina juridike kanë pranuar si bazë të përgjegjësisë civile fajin e personit përgjegjës për dëmin e shkaktuar. Në këtë mënyrë në rastin e shkaktimit të dëmit, nuk mjafton konstatimi i tre kushteve për të cilat u fol më sipër (dëmi, kundërligjshmëria e tij, lidhja shkakësore).

Për të lindur përgjegjësia civile e autorit të dëmit, duhet që ky të ketë vepruar me faj. Një kusht i tillë i përgjegjësisë parashikohet në Kodin Civil, neni 608/1 si vijon: "*Personi që, në mënyrë të paligjshme dhe me faj, i shkakton tjetrit një dëm në personin ose në pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar.*".

Kodi Civil jo vetëm pranon fajësinë si kusht për përgjegjësinë civile që rrjedh nga shkaktimi i dëmit, por gjithashtu ka vendosur parimin e prezumimit të fajësisë së autorit të dëmit. Sa më sipër del nga neni 608/2: "*Personi që ka shkaktuar dëmin nuk përgjigjet kur provon se nuk ka faj...*".

Duke pranuar këtë parim, i dëmtuari mjafton të provojë dëmin e shkaktuar si rezultat i veprimit të paligjshëm të personit përgjegjës. I mbetet këtij të fundit barra e provës për të vërtetuar së dëmi ka ardhur nga rrethana të cilat ai nuk mund t'i ndalonte, pra që ai nuk ka faj në shkaktimin e dëmit. Si rrjedhim çdokush që ka shkaktuar një dëm do të prezumohet fajtor, përderisa ai nuk provon të kundërtën domethënë që nuk ka faj. Vetëm në këtë rast ai do të përjashtohet nga përgjegjësia për shpërblimin e dëmit.

Në një gjykim civil për shpërblim dëmi, i padituri i ngarkuar me detyrimin për dëmshpërblim, ka apeluar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke paraqitur si një nga shkaqet e ankimit faktin se në gjykimin e shkallës së parë nuk ishte vërtetuar fajësia e tij. Ky pretendim është i gabuar, sepse fajësia e të paditurit prezumohet nga ligji. Barra e provës për të vërtetuar se nuk ka pasur faj, në gjykime të tilla është mbi paditësin.

"Demi biologjik, duke qenë cenim në integritetin fizik dhe/ose psikik të njeriut, është objektivisht i vërtetueshëm. Prandaj, në zbatim të rregullave parimore të neneve 2, 6, 29 e vijues të Kodit të Procedurës Civile (*da mihi factum, dabo tibi ius*), i dëmtuari që kërkon dëmshpërblimin ka barrën e provës të vërtetojë së dëmi ka ndodhur, si dhe lidhjen shkakësore të tij me faktin e paligjshëm.

Përveç kësaj, gjykata kërkon mendimin e specializuar të eksperteve mjeko-ligjore në shërbim të arritjes së përfundimeve përkatëse sipas bindjes se saj të brendshme për vërtetimin ose jo të shkaktimit të dëmit biologjik, lidhjes shkakësore juridike të tij me faktin e paligjshëm, si dhe për përcaktimin e llojit dhe shkallës përkatëse të dëmtimit, në përqindje për dëmtimet e përhershme dhe në dite për ato të përkohshme..."<sup>4</sup>.

### **Kuptimi dhe llojet e fajit në fushën e të drejtës civile.**

Kodi Civil parashikon përgjegjësinë e personit që ka shkaktuar dëmin me faj, por nuk e përkufizon kuptimin e fajit si element i anës subjektive të përgjegjësisë. Për këtë, doktrina i është referuar kuptimit që i është dhënë fajit në të drejtën penale.

Faji përfaqëson qëndrimin psikik të autorit të dëmit ndaj veprimit të tij dhe pasojës së ardhur. Ky qëndrim shfaqet në dy aspekte të tij: momentin intelektual dhe momentin volitiv<sup>5</sup>. Momenti intelektual ka të bëjë me mundësinë subjektive për të parashikuar ose jo pasojat që mund të vijnë nga një veprim i caktuar. Kurse momenti volitiv lidhet me dashjen ose mosdashjen e këtyre pasojave të parashikuara. Në funksion të këtyre dy momenteve janë përcaktuar edhe format e fajit që janë: 1) dashja dhe 2) pakujdesia.

**Dashja.** Vetë dashja si formë e fajit, ndahet në dashje direkte dhe dashje indirekte (eventuale). Kështu themi se një person ka vepruar me dashje direkte kur ai parashikon mundësinë e ardhjes së pasojës së dëmshme, e dëshiron ardhjen e saj dhe vepron me qëllim që kjo pasojë të vijë. Faji në formën e dashjes direkte përbën shkallën më të lartë të fajësisë. Për sa i përket dashjes

---

<sup>4</sup> Vendim Unifikues Nr.12, datë 14.09.2007 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

<sup>5</sup> Semini, Marjana, "E drejta e detyrimeve dhe e kontratave" Tiranë 1998.

indirekte, autori i dëmit parashikon ardhjen e pasojës nga veprimi i tij, nuk e dëshiron këtë pasojë, por me vetëdije lejon ardhjen e saj.

**Pakujdesia.** Pakujdesia si formë e fajit dallon nga dashja dhe shfaqet në dy forma: 1) pakujdesia në formën e vetëbesimit të tepruar dhe 2) pakujdesia në formën e neglizhencës. Kur personi përgjegjës ka parashikuar pasojat që mund të vijnë nga veprimi i tij, nuk i dëshiron ato, madje, duke pasur një besim të tepërt në aftësitë e tij, të mjeteve të cilat përdor apo të të tretët, mendon se mund t'i mënjanojë ato; në këtë rast kemi të bëjmë me pakujdesi në formën e vetëbesimit të tepruar. Ndërsa kur personi nuk i parashikon pasojat që mund të vijnë dhe as nuk i dëshiron ato, por kishte detyrimin objektiv dhe mundësinë subjektive për t'i parashikuar, jemi para pakujdesisë në formën e neglizhencës. Kur personi nuk kishte as detyrimin objektiv dhe as mundësi subjektive të parashikonte pasojat, ai ka vepruar pa faj dhe bëhet fjalë për “dëmin e rastit”, rrethanë kjo që e përjashton personin nga detyrimi për shpërblimin e dëmit, pra nga përgjegjësia civile.

Në rastin e pakujdesisë në formën e neglizhencës, ka lindur problemi lidhur me çështjen e vlerësimit të kujdesit të treguar nga personi përgjegjës, për të parashikuar mundësinë e ardhjes së pasojave të dëmshme.

Doktrina jonë juridike ka pranuar vlerësimin in abstrakto, duke e krahasuar sjelljen e autorit të dëmit me atë të një njeriu normal. Ky qëndrim, duket i drejtë nëse do të pranojmë dhe filozofinë se njeriu është arbitër i vetvetes, dhe si i tillë është i lirë të zgjedhë dhe të veprojë midis së mirës dhe së keqes.

### **Përgjegjësia pa faj.**

Kodi Civil ka vendosur ndër kushtet për lindjen e përgjegjësive civile që rrjedh nga shkaktimi i një dëmi të paligjshëm fajin e autorit të dëmit. Ky përbën aktualisht dhe bazën e kësaj përgjegjësie.

Parimi i fajësisë qëndron në themel të teorisë tradicionale të shkaktimit të dëmit. Në fillimet e saj shpërblimi justifikohet vetëm me qëllimin për ndëshkim të autorit të dëmit, në formën e një dënimi civil. Kështu nëse dikush kishte shkaktuar një dëm me faj të tij, do të përgjigjej për shpërblimin e tij sepse ky konsiderohej si ndëshkim dhe frenim për të mos përsëritur në të ardhmen veprime të tilla. Në këtë mënyrë shpërblimi i të dëmtuarit nuk përbënte asnjë motiv për ekzistencën e tij. Më pas krahas shpërblimit si sanksion civil filloi t'i kushtohej rëndësi edhe shpërblimit të të dëmtuarit,

derisa ky arriti të jetë edhe qëllimi i vetëm i ekzistencës së vetë institutit të shkaktimit të dëmit.

Këto ide për bazën e përgjegjësisë civile të lidhur pandashmërisht me fajin e autorit të dëmit, i përkasin shek. XVIII-XIX. Kjo periudhë i takon një shoqërie paraindustriale, në të cilën mjetet e prodhimit kufizoheshin në forcën e krahëve të njeriut, të kafshëve apo të energjisë natyrore si era, uji etj. Në këto kushte gjendja ishte lehtësisht e kontrollueshme nga ana e njeriut. Si rrjedhim edhe përgjegjësia me faj ishte e kuptueshme.

Revolucioni industrial, mundësoi vënien në shërbim të njeriut të energjive me potencial tepër të madh si, energjia termike, kimike, elektrike e atomike. Këto dhe shpejtësitë e mëdha të përfutuara prej tyre krijojnë situata të rrezikshme të cilat shumë lehtë mund t'i shpëtojnë kontrollit të njeriut dhe të shkaktojnë dëme të pallogaritshme. Në këtë mënyrë këto aktivitete mbartin gjithmonë rrezikun e ndonjë avarie të mundshme. Sigurisht që teknika ofron bashkë me këto aktivitete edhe shumë masa sigurie, por të cilat shpesh nuk mund të eliminojnë të gjitha rreziqet.

Megjithatë shoqëria nuk mund të heqë dorë nga këto arritje me gjithë ndonjë rrezik të mundshëm që mund të paraqesin ato. Kështu ushtrimi i aktiviteteve të tilla nuk përbën një veprim të paligjshëm. Në këto kushte të flasësh akoma për një përgjegjësi me faj, kjo do të thotë që i dëmtuari të mos shpërblehet dot. Për këtë arsye doktrina ka pranuar gjithnjë e më shumë përgjegjësinë pa faj, ose e thënë ndryshe përgjegjësinë objektive të personit përgjegjës. Në këtë rast mjafton vetëm vërtetimi i lidhjes shkakësore për të lindur përgjegjësia për dëmin e shkaktuar<sup>6</sup>.

Duke qenë se në rrethana të tilla të përmendura më sipër, aktiviteti e përmban rrezikun në vetvete dhe personi që ushtron një aktivitet të tillë nuk mund të përjashtohet nga përgjegjësia as, duke provuar se nuk ka pasur faj në ardhjen e dëmit, ai është i rrezikuar që në çdo moment të mund të lindë për të përgjegjësia për shpërblimin e ndonjë dëmi të ardhur si pasojë e ushtrimit të aktivitetit.

---

<sup>6</sup> Galgano, Francesco, "E drejta private", Tiranë, 2008

Për këto arsye në fushat ku ekziston më tepër mundësia e një dëmi, ligji ka parashikuar detyrimin e personave që kanë si detyrim të përgjigjen për dëmet e shkaktuara, të bëjnë sigurimin e detyrueshëm të përgjegjësisë së tyre. Përmendim këtu qarkullimin e automjeteve. Të gjithë e dimë se në kohët që jetojmë, me rritjen masive të trafikut nga momenti në moment mund t'i shkaktosh dikujt një dëm edhe sikur të zbatosh të gjitha rregullat e qarkullimit rrugor. Kjo përgjegjësi konsiderohet e tillë, që drejtuesi mjetit do të përgjigjet për dëmet e shkaktuara, pavarësisht nga fajësia e tij. Për këtë arsye është parashikuar sigurimi i detyrueshëm i drejtuesve të mjeteve për përgjegjësinë civile për dëmet e shkaktuara të tretëve. Po kështu, në çdo biletë udhëtimi përfshihet edhe siguracioni i udhëtarëve për dëmet që mund t'u vijnë atyre gjatë udhëtimit.

Për sa i përket rasteve konkrete të përgjegjësisë pa faj, sistemi ynë ligjor ka pranuar që me LVJD-në, përgjegjësinë objektive të personit që ushtron një veprimtari e cila përbënte një rrezik për të tjerët. Për sa u përket sistemeve të huaja, ato kanë operuar më së shumti nëpërmjet jurisprudencës dhe interpretimeve prej saj të dispozitave ekzistuese.

Kështu mund të përmendet përgjegjësia për dëmet e shkaktuara nga kafshët apo nga ndërtesat, të cilat megjithëse janë dispozita tepër të hershme, janë interpretuar si raste të përgjegjësisë objektive (në Francë dhe në Itali).

Në rregullimet ligjore aktuale, vazhdon ende të mbizotërojë parimi tradicional i përgjegjësisë me faj. Gjatë hartimit të Kodit Civil janë futur rishtazi disa dispozita, si edhe janë shtuar raste të reja të përgjegjësisë civile. Nëse kemi të bëjmë me raste të përgjegjësisë me faj apo të përgjegjësisë objektive, mendoj ta trajtoj konkretisht në çdo rast konkret në kapitullin përkatës.

### **Lidhja shkakësore.**

**Nevoja e konstatimit të lidhjes shkakësore.** Për të lindur përgjegjësia civile, nuk mjafton konstatimi i një dëmi dhe kundërligjshmëria e tij. Duhet vendosur gjithashtu ndërmjet tyre një raport shkak-pasojë. Pra, duhet provuar që ky dëm e ka burimin në këtë fakt, domethënë në veprimin e autorit të dëmit. Ky kusht i përgjegjësisë civile është së pari një kërkesë e arsyeshme dhe së dyti është e imponuar nga ligji.

Neni 608 i Kodit Civil detyron çdo person që në mënyrë të paligjshme dhe me faj *shkakton* një dëm, me shpërblimin e tij.

Gjithashtu edhe nene të tjerë 621, 622, 623, 628, 636 përdorin të gjithë foljen *shkakton*. Jo vetëm kaq, por legjislatori, në ndryshim nga rregullimet e mëparshme ligjore, në nenin 609/I të Kodit Civil, ka përcaktuar shprehimisht nevojën e konstatimit të lidhjes shkakësore kur thuhet se: “Dëmi duhet të jetë rrjedhim i drejtpërdrejtë dhe i menjëhershëm i veprimit ose mosveprimit të personit.”

Evidentimi i lidhjes shkakësore do të ishte relativisht i thjeshtë Nëse dëmi do të kishte lidhje me një shkak të vetëm, lehtësisht të identifikueshëm. Por në shumicën e rasteve një dëm është rezultat i shumë faktorëve, lidhja mes të cilëve është e domosdoshme për ardhjen e pasojës së dëmshme. Të gjithë këta faktorë shkojnë drejt dëmit final si një zinxhir, një hallkë e të cilit të mungojë, pasoja nuk do të vinte. Atëherë lind pyetja nëse e drejta duhet t’i ketë parasysh të gjithë këta faktorë në përcaktimin e lidhjes shkakësore dhe raportit shkak-pasojë ? Ndoshta përgjigja do të ishte pozitive nëse do të kishte barazi ndërmjet shkaqeve fizike dhe juridike.

Por e drejta nuk mund të marrë në konsideratë çdo shkak që mund të përcaktohet nga një konstatim i thjeshtë, por do të veçojë vetëm ato shkaqe që përbëjnë *shkakun juridik* të dëmit.

Përcaktimi i raportit shkakësor paraqet vështirësi në praktikë, duke përbërë një problem, që teorikisht nuk mund të thuhet se është zgjidhur. Ende ekzistojnë mendime të ndryshme lidhur me këtë çështje. Në fakt është e vërtetë, së për lidhjen shkakësore nuk është dhënë një përkufizim i saktë shkencor, duke ia lënë në këtë mënyrë vlerësimin e saj arsyes, përvojës praktike dhe çmimit të gjykatës.

Dallimi i përgjegjësisë në shkaktimin e dëmit jo pasuror dhe verifikimi i dëmit

## KONKLUZION

Çështja e parë që shtrohet për zgjidhje në rastin e shkaktimit të një dëmi, ishte nëse jemi para një përgjegjësie civile kontraktore apo jo kontraktore (në rastin tonë u fol vetëm për dëmin që shkaktohet nga veprimet e paligjshme). Për fat të keq praktika gjyqësore evidenton një numër jo të vogël rastesh, kur këto dy përgjegjësi nuk dallohen nga njëra tjetra. Dëmi i shkaktuar do të jetë kontraktor, kur i dëmtuari dhe autori i dëmit janë të lidhur në një marrëdhënie kontraktore. Dëmi i shkaktuar do të rezultojë nga mospërbushja e detyrimeve që rrjedhin për palët nga klauzolat e kontratës. Si i tillë dëmi në këto raste do të shpërblehet sipas përgjegjësisë kontraktore dhe jo sipas dispozitave që rregullojnë shkaktimin e një dëmi të paligjshëm, siç vërehet jo rrallë në praktikë.

Për sa i përket dëmit jo kontraktor, do të konsiderohet i tillë rasti kur midis të dëmtuarit dhe autorit të dëmit nuk ekziston asnjë lidhje e mëparshme kontraktore. Janë këto raste që do të sjellin përgjegjësinë civile jashtëkontraktore dhe do të rregullohen nga dispozitat e shkaktimit të dëmit.

## Bibliografi

1. Gaqo Floqi, Mbi Përgjegjësinë e shpërblimit të dëmit nga një veprim i paligjshëm në të drejtën civile, Drejtësia Popullore, viti 1951, nr. 5.
2. Prof. Dr. Mehdi J. Hetemi, Detyrimet dhe kontratat, Tiranë 1998.
3. Manuel DROIT CIVIL, personnes – famille – incapacite – biens – obligation – suretes, Pierre Voirin; Tomë i 26 EDITION par Gilles Goubeaux.
4. W. Brondolo, A. Marigliano: “E drejta dhe dëmi psikik”, 1996,
5. Rustem Gjata, Revista Drejtësia, viti 1972, nr. 1.
6. Francesco Galgano, E drejta private
7. Thimio Kondi, Disa probleme të detyrimeve që lindin nga shkaktimi i dëmeve jashtëkontraktore, Drejtësia Popullore, viti 1989, nr. 3.
8. Dr. Marjana Semini, E drejta e detyrimeve dhe e kontratave, pjesa e përgjithshme, Tiranë 1998.
9. Andon Sallabanda, E Drejta E Detyrimeve, pjesa e përgjithshme, Tiranë 1962.
10. Droit Civil, La responsabilite civil et obligations, faqe 340 (biblioteka e Sh.M.)
11. P. Szollosy "Vlerësimi i dëmit rrjedhojë e moskuptimeve në vende të ndryshme evropiane", Zurich, 2007.
12. Giovanni Battista Petti: “ Shpërblimi i dëmit biologjik, e drejta aktuale”, UTET.
13. G. Giannini e M. Pogliani, Giuffrè: “ Dëmi dhe paligjshmëria civile”, 1997.
14. Ugo dal Lago, Edvige Bressan dhe Alessandra Casarotto: “ Shpërblimi i dëmit në rastet e shpifjeve” 2008

**Phd Flora Sela Kastrati**

Universiteti Shtetëror i Tetovës

## **BASHKIMI EVROPIAN DHE KOSOVA**

### **ABSTRAKT**

Ndërkombëtarizimi i çështjes së Kosovës, që kishte elementet e një “konflikti të ngrirë” gjatë gjithë periudhës së Luftës së Ftohtë dhe sigurimi i mbështetjes së qendrave ndërkombëtare të vendosjes, kishte filluar hap pas hapi që nga demonstratat e vitit 1981, kur shqiptarët kërkuan që edhe Kosovës t’i njihej statusi i republikës.

Kosova në analet e historisë nuk është e njohur vetëm me problemet, që kishte, në dekadën e fundit të shekullit XX. Ajo kishte qenë, shume me heret, arenë, ku serbët, në mënyrë shumë të rafinuar, kishin kryer gjenocid dhe shkatërrim të paparë.

**Fjalët çelës: Ndërkombëtarizimi, Lufta e Ftohtë, gjenocid.**

## **HYRJE**

Kosova e filloi mesin e shekullit të XIX me programin e “Naçertanies” të Ilija Garashaninit. Gjatë Krizës Lindore dhe Luftërave Ballkanike, Kosova u pushtua nga Monarkia Serbe. Konferenca e Londrës e vitit 1913 e njohu këtë pushtim territorial të Kosovës, duke e lënë kështu Kosovën jashtë kufijve politik të shqiptarëve <sup>1</sup>. Gjatë këtij pushtimi Kosova u nda në pesë qendra administrative: Distrikti i Prishtinës, i Prizrenit, i Novi Pazarit, i Kumanovës dhe i Shkupit. Në 1913-ën u organizua edhe Distrikti i Zveçanit me qendër Mitrovicën. Ndërsa nën administrim të Malit të Zi ngelën këto qytete shqiptare: Deçani, Peja, Istogu dhe një pjesë e Drenicës.

Gjithashtu edhe pas Luftës së Parë Botërore u vazhdua me të njëjtin avaz. Me mbështetje të ligjit - Dekreti mbi Reformën Agrare dhe Kolonizimin, u pushtuan, kolonizuan si dhe u ndërruan edhe emrat e vendeve në Kosovë, të gjitha këto duke u sllavizuar. Me këtë rast serbët vazhduan largimin me forcë nga vendet e tyre shqiptarët nga Kosova duke i depërtuar përmes Greqisë për në Turqi. Një pjesë e konsiderueshme nga këta refugjatë u vendosën edhe në Shqipëri.

Pas Luftës së Dytë Botërore, Tito dhe Partia Komuniste i detyruan popujt e Jugosllavisë, edhe pse me mendime të ndryshme, që të punojnë për qëllime të përbashkëta, të paktën në mënyrë sipërfaqësore. Kjo ishte më lehtë për shkak të kërcënimit nga Bashkimi Sovjetik, të cilin e ndjenin bashkarisht të gjithë. Thuhej se Jugosllavia ishte një vend me gjashtë republika, pesë kombësi, me katër gjuhë, me tri fe, me dy alfabetë dhe me një Tito. Vdekja e Titos, ndarja e Bashkimit Sovjetik dhe falimentimi i sistemit socialist i vunë pikë shtrirjes së fundit se Jugosllavia do të qëndronte unike.

Edhe gjatë kësaj periudhe u vazhdua me represion ndaj shqiptarëve të cilët mbetën brenda Federatës Jugosllave, si pjesë e Serbisë. Gjatë periudhës komuniste politikat e ndjekura ndaj Kosovës si nga Federata Jugosllave ashtu edhe nga Republika e Serbisë u dallua për nga represioni etnik i vazhdueshëm.

---

<sup>1</sup>Bashkurti, Lisen, “Krizatndërkombëtare”, Tiranë, 2008, faqe. 130

<sup>38</sup> Ahtisaari, Martti, “Detyra në Beograd”. Prishtinë, 2008, faqe 19

Kosova kurrë nuk pushoi, ajo si e tillë çdo dekadë shpërthente në lëvizje për mbrojtjen e të drejtave kombëtare e njerëzore nga represioni serb.

Kriza e Jugosllavisë kishte filluar menjëherë pas vdekjes së Titos. Serbët pretendonin se ata ishin kombi i cili duhet të menaxhonte me Jugosllavinë. Gjithsesi federalistët ishin ata që e shtynë deri në fundin e viteve 80' të shek. XX. Proceset në Evropën Lindore mbas rënies së Murit të Berlinit dhe shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik, e përshpejtuan krizën jugosllave dhe e futën në një rrugë pa krye.

Duke pasur parasysh pozicionin e veçantë dhe të privilegjuar të Jugosllavisë në kontekstin e sistemit ndërkombëtar të bipolaritetit, depërtimi i Kosovës në qendrat ndërkombëtare të vendosjes nuk ishte i lehtë, për më tepër që Perëndimi nuk ishte i gatshëm të njihte të drejtën për vetëvendosje, pasi në këtë mënyrë do të pranohej edhe ndërkombëtarisht se kemi të bëjmë me një popull të ndarë e që në rrethana politike ndërkombëtare, pas rënies së Murit të Berlinit dhe pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, do të ndiqte rrugën e kombit gjerman.

Interesimi i qarqeve politike evropiane për problemin e Kosovës do të nisë të shtohet gradualisht pas suprimimit të dhunshëm të autonomisë politiko-territoriale, përkatësisht pas ndryshimit të dhunshëm të Kushtetutës së vitit 1974<sup>2</sup>.

Në mars të vitit 1989 Parlamenti i Serbisë shfuqizoi statusin autonom të Kosovës. Ishte ky fillim i politikës brutale të shtypjes së popullatës me shumicë shqiptare nga ana e Serbisë. Që nga ai moment në shkollë dhe universitet nuk mund të ligjërohej dhe të mësohej më në gjuhën shqipe. Policia dhe sistemi i shëndetësisë u pastruan nga shqiptarët, ndërsa në fillim të vitit 1989 u vendos gjendja e jashtëzakonshme. Ky hap i qeverisë së Beogradit u pasqyrua me dhunë pa kontroll të aparatit serb të sigurisë, të ushtruar kundër popullatës me shumicë shqiptare.

Shqiptarët e Kosovës kundër masave shtypëse të Serbisë reagues me rezistencë paqësore, me një bojkot të institucioneve publike dhe kulturore dhe me krijimin e strukturave paralele. Kërkesat e shqiptarëve të Kosovës filluan

---

<sup>2</sup> Ukshini, Sylë, "Kosova në politikën e jashtme të BE-së -1991-2007", Shkup, 2001 Logos-A, faqe 113

të radikalizohen në vitet e 90' të shekullit XX. Për shkak të politikës së shtypjes nga Serbia dhe duke pasur parasysh fillimin e shpërbërjes së Jugosllavisë, lufta e shqiptarëve të Kosovës për rivendosjen e autonomisë, u shndërrua në një luftë për shkëputje, për pavarësi nga Serbia <sup>3</sup>.

Rasti Jugosllavisë ka demonstruar vështirësitë e llojit të vet të përgjakshëm. Më 1981, demonstratat e shqiptarëve në Kosovë dhe pas dhjetë vjetësh, shpallja e pavarësisë së Sllovenisë, vërtetuan se problemet nacionale të këtij shteti ishin larg zgjidhjes dhe se nacionalizmi do të ishte një forcë e rëndësishme edhe për disa vite që do të pasonin. Ajo që shihet qartë ishte se federata jugosllave, si bashkësi e kombeve nuk funksiononte. Në një masë të konsiderueshme kriza jugosllave injorohej nga Perëndimi, i cili gjatë kësaj kohe ishte i zënë duke u marrë me pasojat e kolapsit sovjetik, kurse problemet e ish-Jugosllavisë, nga pikëpamja ekonomike dhe politike, i konsideronte të parëndësishme <sup>4</sup>.

Historia e Ballkanit në vitet 90' pasqyron dobësitë e këndvështrimit evropian për veprimet ndërkombëtare. Të gjitha vendet e Bashkimit Evropian ishin dakord që Serbia nën drejtimin e Millosheviçit ishte një burim abuzimesh të rënda të të drejtave të njeriut si në Bosnjë ashtu edhe në Kosovë. Ato ishin gjithashtu dakord që konflikti ishte shumë destabilizues për Evropën dhe se duhej të ishte në një masë të mirë përgjegjësi e Evropës për të sjellë rendin dhe drejtësinë në rajon. Evropianët në fakt ndërhyjnë duke vendosur një embargo ndaj rajonit (nga i cili më shumë përfituan serbët se sa boshnjakët), dhe duke dërguar trupa paqeruajtës atje. Megjithatë ajo që ata dështuan të bënin është të merrnin një vendim kolektiv për të dislokuar një forcë ushtarake, për të hequr nga pushteti Millosheviçin dhe për të demokratizuar Serbinë, duke shkuar kështu në zemër të problemit. Në fakt, trupat paqeruajtëse evropiane kontribuan tek problemi me refuzimin e tyre për të luftuar madje në disa vende, ato u mbajtën peng dhe u nevojiti të shpëtoheshin. Ishte vetëm në saj të veprimit të shteteve që kishin vullnetin për të përdorur në mënyrë deçizive format tradicionale të pushtetit ushtarak - kroatët në rastin e Bosnjës dhe

---

<sup>3</sup>Fischer, Joschka, "Vitetkuq-gjelbër", Prishtinë, 2008, Koha, fq.99

<sup>4</sup>Dauti, Daut, "Unioni evropian nga ideja në realitet", Prishtinë, Phenix, 2001, faqe 106

amerikanët në rastin e Kosovës - që dominimi serb përfundoi dhe Ballkani më në fund gjeti paqen<sup>5</sup>.

Gjatë vitit 1998 dhe në fillim të vitit 1999, Bashkësia Ndërkombëtare u ballafaqua me dilemën morale dhe juridike: nevoja për ta mbrojtur popullatën e viktimizuar nga shkeljet më mizore të të drejtave të njeriut si dhe shkeljet më të rënda të së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare dhe nga ana tjetër, përgjegjësi për ta shmangur përdorimin e forcës nëse kjo ishte e mundur.

Qëndrimet dhe veprimet e RFJ-së ishin shkaktari kryesor i dhunës dhe i trazirave në Kosovë gjatë dhjetëvjeçarit të viteve 90' të shekullit XX, dhe në veçanti në periudhën ndërmjet viteve 1997 dhe 1999. Regjimi i Millosheviçit me politikën e tij të dhunës dhe me qeverisjen e keqe të Kosovës, e ka marrë mbi vete përgjegjësinë kryesore për nxitjen e krizës së vendosjes në radhët e qeverive të brengosura si dhe tek institucionet ndërkombëtare, dhe në veçanti në Kombet e Bashkuara dhe në NATO. Ai është po ashtu përgjegjës për sjelljet kriminale të zyrtarëve serbë në Kosovë. Qasja e RFJ-së ndaj Kosovës ka qenë e mbizotëruar nga lojërat e forcave të brendshme politike. Natyrisht që me shfrytëzimin e kartës nacionaliste dhe etnike si pjesë e strategjisë së tij për ta grabitur pushtetin, Millosheviçi erdhi e u shndërrua në peng të forcave të brendshme ideologjike të cilat nuk ishin të gatshme për kompromise rreth Kosovës. Në rrethana të brendshme të tilla, ai mund të ketë patur fare pak mundësi për ta pranuar ndonjë kompromis pragmatik, pavarësisht nga ajo se çfarë strategjie diplomatike do të përdorte Bashkësia Ndërkombëtare. Udhëheqja kosovare, po ashtu, nuk e ofronte hapësirën e nevojshme për zgjidhje. Kërkesa e pa kompromis për pavarësi si e LDK-së ashtu edhe e UÇK-së, e më vonë edhe veprimet provokuese dhe të qëllimshme kryengritëse të UÇK-së, Beogradin e vunë para një sfide të përshkallëzimit, kërkesat e të cilës shkonin edhe më larg sesa ato qëndrime që përkraheshin nga opozita demokratike e cila e kundërshtonte Millosheviçin. Bashkësia Ndërkombëtare, në fakt, ishte unanime në qëndrimin e saj kundër idesë së Kosovës si shtet i pavarur. Sidoqoftë, ishte strategjia “ndërkombëtarizuese” e UÇK-së ajo e cila e nxititi ndërhyrjen ushtarake të udhëhequr nga NATO-ja, dhe jo kompromisi

---

<sup>5</sup> Fukuyama, Francis, “Ndërtimi i Shtetit”, Tiranë, AIIS, 2008, faqe. 171 - 172

diplomatik, dhe kjo strategji çonte në mundësi më të madha drejt pavarësisë e jo drejt ndonjë autonomie e tipit të para vitit 1989 <sup>6</sup>.

Ndërhyrja në Kosovë kishte karakter më tepër humanitar se sa të themi interes i pastër politik i ndonjë force ndërkombëtare . Madje kjo ndërhyrje nga administrata e Xh.W.Bush në fillim u quajt edhe politikë shumë pak e mbështetur në interesa e më tepër në interesa humanitare. E këtij mendimi ishte këshilltarja e Sigurisë Kombëtare Kondoliza Rajs. Ajo në numrin janar-shkurt 1000 të revistës “Foreign Affairs” organ joformal qendror i politikës së jashtme dhe sigurisë të SHBA-së shkruan se synimet humanitare janë për t’u lavdëruar, por si të tilla janë të pamjaftueshme, për ta arsyetuar angazhimin e ushtarëve amerikan. Vetëm arsyetimi kombëtar justifikon angazhimin e tyre, por jo qëllimet kryesisht humanitare <sup>7</sup>.

### **Marrëdhëniet e BE-së me Kosovën gjatë dekadës së fundit të shek.**

#### **XX**

Shpërbërja shtetërore e ish-Jugosllavisë ishte një proces i pandalshëm historiko-politik, si pasojë e kundërthënieve dhe armiqësive të akumuluar brenda etnive të ndryshme, të dominuar institucionalisht nga hegjemonizmi serb, në krijesën artificiale shtetërore të krijuar në Versajë shtatë dekada më parë. Shpërbërja e ish-Jugosllavisë dhe pushimi i ekzistimit të saj si shtet si subjekt juridiko-ndërkombëtar e konstatuan “mendimet këshillëdhënëse” të Komisionit të Arbitrazhit të BE-së (Komisioni i Badinterit), të cilat pastaj u morën për bazë nga Bashkimi Evropian me rastin e njohjes ndërkombëtare të shteteve të reja nga kjo hapësirë dhe përfundimisht nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së. Mendimi i Komisionit të Arbitrazhit (Hagë, 09.01.1991) e posaçërisht Raporti i Badinterit (11.01.1991), çështjen e Kosovës nuk e

---

<sup>6</sup> Shih [www.kipred.net](http://www.kipred.net)

<sup>7</sup> Shih [www.foreignaffairs.org](http://www.foreignaffairs.org)

<sup>8</sup> Reka, Blerim, “E drejta e vetëvendosjes: dimensioni ndërkombëtar i problemit të Kosovës”, Shkup, Interdiskont, 2008, faqe 86

trajtnan mbi parimet e njëjta mbi të cilat u njoh subjektiviteti i pavarur shtetëror i katër ish-republikave jugosllave: Slloveninë, Kroacinë, Bosnjë-Hercegovinën dhe Maqedoninë. Megjithatë Komisioni i Badinterit mori për bazë Kushtetutën e RSFJ-së të vitit 1974, nuk ia njohu Kosovës statusin e konstituentit të njëres prej tetë njësive federale, duke shpërfillur edhe Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Kosovës të 11.09.1991, sikur edhe rezultatet e referendumit të Kosovës si shtet sovran dhe i pavarur, siç u bë me njohjen ndërkombëtare të vullnetit politik të katër republikave tjera të Jugosllavisë.

Qeveria e vetëshpallur e Kosovës në ekzil ia kishte dorëzuar kërkesën Konferencës Evropiane për Paqe në Jugosllavi për njohje ndërkombëtare të Kosovës shtet i pavarur (dhjetor 1991). Kosova gjithnjë ka pasur, ashtu siç e ka edhe tani, bazën dhe popullatën e vet, aplikimi për njohje ndërkombëtare të pavarësisë së plotë të Kosovës nuk mori përgjigje pozitive nga bashkësia ndërkombëtare. kjo ndodhi për shkak se organet dhe institucionet paralele, Qeveria e vetëshpallur e Kosovës si dhe Presidenti i vetëshpallur i Kosovës, nuk ishin të aftë të kontrollonin në mënyrë efektive territorin dhe popullatën që jetonte brenda kufijve të Kosovës.

Mendimi i Badinterit sanksionoi ndërkombëtarisht shpërbërjen e ish-Jugosllavisë, dhe me të edhe shuarjen e subjektivitetit juridiko-ndërkombëtar, dhe në bazë të këtij parimi që kufijtë deri atëherë administrativë të brendshëm të Jugosllavisë u njohën si kufij ndërkombëtar, kjo nuk u bë edhe me rastin e Kosovës. Kushtetuta jugosllave e vitit 1974, Kosovës i garantonte paprekshmëri dhe mos ndryshim të kufijve të saj pa pëlqimin e Kuvendit të Kosovës. Konferenca Ndërkombëtare Paqësore për ish-Jugosllavinë e mbajtur në Londër në gusht 1991 nuk ofroi shumë më tepër për zgjidhjen e drejtë statutore të Kosovës. Në këtë Konferencë si pjesëmarrës të drejtpërdrejtë të punimeve të saj ishin ftuar vetëm përfaqësuesit e gjashtë republikave sllave, përfaqësuesit e BEE-së, anëtarët e përhershëm të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, Japonia dhe Kanada, përfaqësues të shteteve të botës islame si dhe përfaqësues të shteteve fqinje të ish-Jugosllavisë. Ndërsa në kategorinë e veçantë të ashtuquajtur “palë të interesuar” u ftuan shqiptarët e Kosovës, serbët e Bosnjës dhe Kroacisë, kroatët e Bosnjës, myslimanët e Sanxhakut dhe hungarezët e Vojvodinës.

Në Konferencën e Londrës (1991) çështja e Kosovës përmendet vetëm në “Programin Aksional” dhe në “Deklaratën mbi Serbinë”. Në programin

Aksional thuhet se ai grup i punës duhet të propozojë iniciativa të reja rreth çështjes së pakicave, e në veçanti rreth çështjes së Kosovës, të Vojvodinës, të Sanxhakut, si dhe të pozitës së shqiptarëve në Maqedoni. Kurse në Deklaratën mbi Serbinë kërkohet që të rivendosen të gjitha të drejtat qytetare të popullsisë së Kosovës dhe të Vojvodinës dhe të garantohen të drejtat e bashkësive nacionale dhe etnike dhe të pakicave kombëtare në pajtim me dispozitat e Kartës së OKB-së, KSBE-së dhe me dispozitat e projektrezolutës së Konferencës së BEE-së për ish-Jugosllavinë.

Problemi i Kosovës i cili konsiderohet si konflikt etno-territorial, ku shqiptarët si popull shumicë angazhoheshin për recesion, ndërsa qeveria e Beogradit e luftonte këtë synim me qëllim të kontrollimit të territorit të pretenduar, paraqet një rast me peshë edhe për Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë, njëkohësisht paraqet edhe sfidën më të madhe politike deri në ditën e sotme për Bashkimin Evropian. Kosova ishte një problem i trashëguar në rrethanat e shpërbërjes së Perandorisë Osmane, kur pas Luftës së Parë Ballkanike, Konferenca e Londrës më 1913, vendosi kundër shumicës shqiptare për mbetjen e Vilajetit të Kosovës në Serbi. Në sfond të kësaj barre historike dhe të konfrontimeve gati njëshekullore shqiptaro-serbe politika evropiane në vitet e para të viteve 90' u karakterizua nga një përmbajtje e madhe. Që nga fillimi evropianët nuk ishin të përgatitur as ushtarakisht dhe as politikisht për një problem të tillë si ai i Kosovës. Nismat diplomatike për Kosovën pothuajse nuk ndodhnin dhe çështja e ndërhyrjes ushtarake ishte e papërfytyrueshme<sup>8</sup>.

Pra shpërbërja e Jugosllavisë në fillim të viteve 90' krijoi shpresën te shqiptarët e Kosovës se do të ndodhte rishikimi i kufijve, të cilëve u ishte nënshtruar populli shqiptar për më shumë se 80-të vite. Në vend të kësaj, politika evropiane në konferencat ndërkombëtare për Jugosllavinë dhe për Kosovën u mbështet në parimin se e drejta e vetëvendosjes u takon vetëm atyre popujve që kishin statusin e republikës. Për njohje evropiane të shteteve të reja vendimtar ishte statusi i republikës, si dhe kombinimi i parimeve të konceptit “evropian” dhe të atij “klasik”. Në anën tjetër, Kosova edhe pse i plotësonte

---

<sup>8</sup> Ukshini, Sylë, “Lufta për Kosovën”, Prishtinë, Rozafa, 2008, faqe 23

kushtet e konceptit “evropian”, nuk ishte republikë dhe për këtë arsye, ajo nuk u njoh si shtet<sup>9</sup>.

Si në Evropë ashtu edhe në SHBA, politika e njohjes determinohet dhe koordinohet nga udhëheqja e lartë politike. Vendimet e Komisionit të Badinterit është naive të shikohen vetëm në një anë, vetëm në anën konstitucionale të interpretimit të Kushtetutës së vitit 1974, por duhen shikuar edhe anën politike, shpesh drejtësia ndërkombëtare nuk bëhet për hir të drejtësisë, por për hir të politikave, dhe politika e atëhershme franceze ishte pro politikës serbe. Kjo kishte një vendim politik sepse drejtësia ndërkombëtare bie ndesh me interesat kombëtare. Veprimet e pavarura dhe divergjente të shteteve anëtare të BE-së kanë çuar në dobësimin edhe në mosefikasitetin e politikës së jashtme, gjë e cila ka bërë të pamundur zhvillimin e identitetit të politikës së jashtme dhe të sigurisë, për dallim nga politika monetare nuk ka arritur të gjejë një aplikim në rrafshin mbikombëtar. Sot e kësaj dite akoma nuk janë tejkaluar plotësisht këto mosmarrëveshje mbi politikën e jashtme dhe të sigurisë. BE-ja pati probleme me ratifikimin e Traktatit Kushtetues për Evropën, si dhe gjatë ratifikimit të Traktatit të Lisbonës. Politika e Jashtme dhe e Sigurisë akoma ngelet e influencuar nga politikat nacionale të shteteve të mëdha anëtare të Bashkimit Evropian dhe kjo bën të kuptohet se ende është shumë larg të bëhen krahasime të pozicionit ndërkombëtar të Përfaqësuesit të lartë të BE-së për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë me sekretarin e Jashtëm të SHBA. Ndoshta, pikërisht kjo mungesë ekuilibri ka forcuar zërat kritikë që mohojnë ekzistimin e një politike të përbashkët evropiane të jashtme dhe të mbrojtjes, madje vlerësohet jorealiste pritja për një të ardhme të afërt.

Pra ky ishte një kompromis jo i favorshëm për Kosovën, kuptohet pa vullnetin e përfaqësuesve të Kosovës, dhe konferenca e Londrës mbeti me një zgjidhje tepër konfuze dukshëm të reduktuar statutore.

Duket se përjashtimi i Kosovës nga analogjia e Badinterit për t’ua njohur konstituentëve federal, të drejtën e vetëvendosjes, ishte një aplikim selektiv i kësaj të drejte vetëm ndaj ish republikave e jo edhe ndaj ish KSA-

---

<sup>9</sup> Ukshini, Sylë, “Lufta për Kosovën”, Prishtinë, Rozafa, 2008, faqe 96

ve, ndonëse sipas kushtetutës së ish RSFJ-së që të teta ta konstituonin ish federatën e fundit jugosllave <sup>10</sup>.

Bashkimi Evropian në rastin e mosnjohjes edhe të Kosovës në pakon e njohjes së shteteve të reja të pavarura dhe sovrane pas shpërbërjes së ish Jugosllavisë, bëri gabimin e parë strategjik politik, duke mos dashur të hapë një luftë të re në Kosovë por edhe pa këtë njohje të Kosovës lufta do të fillojë në vitin 1998.

Gabimi i dytë i Bashkimit Evropian gjatë kësaj periudhe vlerësohet të jetë njohja e përsheptuar e të vetëshpallurës "RFJ" më 1996 pa asnjë kushtëzim. Madje edhe në kundërshtim të vet parimeve të BE-së për njohjen e shteteve të reja nga ish BRSS-ja dhe ish RSFJ, të përcaktuara në vendimin e saj (16 dhjetor 1991), por edhe në kundërshtim me rezolutat dhe rekomandimet e mëvonshme të BE-së, se RFJ-ja nuk do të njihet pa zgjidhjen demokratike të Republikës së Kosovës. Pavarësisht gjithë kësaj vazhdoi politika represive e regjimit serb, e cila dy vjet më vonë nga kjo njohje do të shkaktojë luftë të re në Ballkan.

Ky dinamizëm i qëndrimit politik të BE-së ndaj problemit të Kosovës ishte vërejtur me aktivizimin e Grupit të Kontaktit (SHBA, Britani e Madhe, Gjermani, Itali, Francë dhe Rusi) si dhe inkuadrimit më aktiv të BE-së brenda tij, gjatë viteve 1998-1999. Konstatimi i shumë studiuesve është se, BE-ja në rastin e Kosovës ishte më unike se sa gjatë luftës së Kroacisë apo të Bosnjës

Me shumë rëndësi është të përmendet se Kosova deri në përfundim të kësaj periudhe, të para vitit 1999, nuk kishte shfrytëzuar asnjë mbështetje financiare të BE-së nga programet e saja për vendet e tranzicionit, siç ishte programi FHARE. Këtë e vërtetojnë shumë fakte. Në atë periudhë ministri i Punëve të Jashtme të Gjermanisë do të shkruante "Këshilli i Ministrave ... miratoi unanimitisht rezolutën, me të cilën iu shpreh përkrahje e pa rezervë NATO-s. Kjo rezolutë ishte shumë e rëndësishme për ne dhe ishte më shumë se vetëm letër e shtypur, pasi ua bënte të qartë Beogradit dhe Moskës se edhe shtetet neutrale në BE e mbështesin aksionin ushtarak kundër Serbisë dhe se ndërmjet NATO-s dhe BE-së, kur bëhet fjalë për çështjen e Kosovës, nuk ka dallime"

---

<sup>10</sup> Reka, Blerim, "E drejta e Unionit Evropian". Prishtinë, KIEAI, 2000. Fq. 228

<sup>11</sup>. Një fakt tjetër për opinionin publik është se pesë ministrat perëndimor të jashtëm, i ashtuquajtur “Quint”, e jo Këshilli i NATO-s, ishte organi politik drejtues gjatë luftës në Kosovë, në kuadër të të cilit çështjet politike, diskutoheshin dhe detajoheshin, dhe njëkohësisht përgatiteshin dhe merreshin edhe vendime joformale .

## KONKLUZION

Për Bashkimin Evropian u deshën të ndodhin masakra në Kosovë që të ndërrojë qëndrimin politik ndaj Kosovës. Pas shpërthimit të luftës në Kosovë vërehet ndryshimi i qëndrimit politik i BE-së, me rikualifikimin e problemit nga një problem ekskluzivisht i “shkeljes së të drejtave të njeriut” në kualifikimet e reja “kërcënim për stabilitetin rajonal”, “nevojën e përcaktimit të statusit të ardhshëm politik të Kosovës, me ndërmjetësim ndërkombëtar”, “përgjegjësi për krimet e luftës dhe për pastrim etnik në Kosovë” etj.

---

<sup>11</sup> Fischer, Joschka, “Vitet kuq-gjelbër”, Prishtinë, Koha, 2008.fq.161

<sup>13</sup> Fischer, Joschka, “Vitet kuq-gjelbër”, Prishtinë, Koha, 2008.fq.165.

## Bibliografia

1. Fischer, Joschka, "Vitet kuq-gjelbër", Prishtinë, Koha, 2008.
2. Reka, Blerim, "E drejta e Unionit Evropian". Prishtinë, KIEAI, 2000.
3. Ukshini, Sylë, "Lufta për Kosovën", Prishtinë, Rozafa, 2008
4. Reka, Blerim, "E drejta e vetëvendosjes: dimensiononi ndërkombëtar i problemit të Kosovës", Shkup, Interdiskont, 2008.
5. Fukuyama, Francis, "Ndërtimi i Shtetit", Tiranë, AIIS, 2008
6. Dauti, Daut, "Unioni evropian nga ideja në realitet", Prishtinë, Phenix, 2001
7. Bashkurti, Lisen, "Krizat ndërkombëtare", Tiranë, 2008
8. Ahtisaari, Martti, "Detyra në Beograd". Prishtinë, 2008
9. [www.foreignaffairs.org](http://www.foreignaffairs.org)

**Doc. Dr. Bekim Kadriu**

Universiteti Shtetëror i Tetovës

## **KONVENTA PËR TË DREJTAT E FËMIJËS**

### **ABSTRAKT**

Të drejtat e shënuara në Konventën për të drejtat e fëmijëve i definojnë parimet universale dhe normat për statusin e fëmijëve. Sot, sa më shumë bëhet e qartë se qeveritë vetë nuk kanë mundësi që vetë dhe në mënyrë të plotë ti sigurojnë të drejtat e fëmijëve pa pjesëmarrjen e shoqërisë në përgjithësi dhe në këtë drejtim Organizatat Joqeveritare luajnë një rol fundamental në implementimin e kësaj konvente. Ajo është njëra nga shkaqet plus të cilët mundësuan që nga kjo konventë sot të bëhet instrumenti më i respektuar gjerësisht me parimet e së cilit u pajtuan pothuajse të gjitha vendet e botës.

**Fjalët çelës: Konventa për të drejtat e fëmijës, organizatat joqeveritare, implementim.**

## HYRJE

Konventa për të drejtat e fëmijëve sendërgjon një standard universal për ndërtimin e një bote më të mirë – një botë në të cilën interesi më i lartë i fëmijës do të jetë shqetësimi parësor i të gjithëve. Sfida e 10 viteve që vijnë është të çojmë përpara sukseset e arritura duke punuar së bashku për t'u dhënë dorën atyre fëmijëve që ende u mohohet e drejta për mbijetesë, zhvillim, mbrojtje dhe pjesëmarrje.<sup>1</sup>

Duke pasur parasysh cënimin masiv të së drejtës për të jetuar dhe shkeljen e të drejtave të fëmijëve Organizata e Kombeve të Bashkuara ka filluar prej kohësh të merret me këtë problem. Një vit pas themelimit të OKB-së Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara themeloi më 11 dhjetor 1946, fondin për fëmijët, të njohur si UNICEF.

Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara shpalli më 10 nëntor 1959 "Deklaratën për të Drejtat e Fëmijëve". Në hyrje të deklaratës në fjalë thuhet: *"Njerëzimi, u ka borxh fëmijëve gjërat më të mira që mund t'u ofrojë"*.

10 vjet më vonë, në vitin 1979 kjo deklaratë, e cila deri atëherë kishte pasur vetëm karakter rekomandues, u zgjerua duke marrë karakter detyrues në aspektin e së drejtës ndërkombëtare.

Dhjetë vjet më vonë, pra në 10 nëntor 1989 dhe pas një sërë bisedimesh të vështira Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara shpalli Konventën për të Drejtat e Fëmijëve e cila hyri në fuqi më 1 shtator 1990. Kjo konventë përmban 54 nene dhe 14 vjet pas miratimit është ratifikuar nga 191 vende duke përfshirë të gjithë anëtarët e KB-së, përveç dy shteteve (Somalisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës).

Të drejtat e njeriut në përgjithësi dhe ato të fëmijës në veçanti kanë pësuar përmirësime të ndjeshme, si rezultat i reformave të gjithanshme ligjore

---

<sup>1</sup> Ann M. Veneman, Drejtore Ekzekutive, UNICEF, me rastin e 10 vjetorit të KDF-së

dhe institucionale, që kanë synuar përafrimin e tyre me standardet evropiane. Kështu më 19 prill të vitit 1991 u themelua Ambasada e Parë e Fëmijëve në Botë në Shkup, si asociacion botëror dhe organizatë e parë e regjistruar ndërkombëtare, jofitimprurëse, jopartiake dhe joqeveritare në Republikën e Maqedonisë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

**Ambasada Megjashi** - si asociacion botëror dhe organizatë e parë e regjistruar ndërkombëtare, jofitimprurëse, jopartiake dhe joqeveritare në Republikën e Maqedonisë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, angazhohet për respektimin e personalitetit të fëmijëve nëpërmjet mbrojtjes së të drejtave të tyre, përfaqësimit të interesave të fëmijëve dhe nëpërmjet pasurimit të jetës së tyre me përmbajtje, të cilat fëmijërinë e bëjnë të sigurt dhe kreative. E përforcon lëvizjen e OJQ-ve për të drejtat e fëmijëve duke zhvilluar qasje vullnetare në punë dhe përkujdeset për realizimin e Konventës së të drejtave të fëmijëve.

Ambasada me aktivitetet e veta kontribuoi në zhvillimin dhe përforcimin e vetëdijes qytetare për të drejtat e fëmijëve. Ajo theu heshtjen për vuajtjet fëmijërore, sidomos për keqpërdorimin fizik, seksual dhe ekonomik të fëmijëve, duke zbuluar në opinionin publik më shumë raste të keqpërdorimit dhe drejtpërdrejt duke u angazhuar për implementimin e mekanizmave më efikas për mbrojtjen e fëmijëve.

Republika e Maqedonisë iu bashkangjiti KDF në nëntor të vitit 1993.<sup>2</sup>

E nënshkruar nga të gjitha vendet e botës dhe kohët e fundit e kthyer në ligj nga të gjithë, Konventa dhe parimet e saj kanë bërë vend në legjislacionet kombëtare dhe lokale, duke i nxitur qeveritë në të gjithë botën që t'i vendosin të drejtat e fëmijëve dhe zhvillimin e tyre në krye të programeve të mandateve të tyre qeverisëse. Që nga viti 1990, më shumë se

---

<sup>2</sup> Ambasada e parë e Fëmijëve në botë – Megjashi, Raport alternativ i organizatave joqeveritare ndaj raporteve shtetërore për gjendjen e të drejtave të fëmijëve në Republikën e Maqedonisë, Shkup 1009.

70 vende, në përpjekje për të reformuar sistemet e tyre ligjore, i kanë bërë kodet e fëmijëve pjesë të legjislacioneve të brendshme.

Kjo konventë përmban një sërë të drejtash. Së pari që të gjithë fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejta të barabarta. Asnjë fëmijë apo i ri, nuk duhet të përbuzet, përjashtohet, diskriminohet apo shpërdoret për shkak të gjinisë, ngjyrës, gjuhës apo besimit.

Fëmijët dhe të rinjtë nuk duhet të shfrytëzohen për punë. Ata kanë të drejtë për arsim fillestar falas. Përveç kësaj, atyre duhet t'u mundësohet edhe arsimimi i mëtejshëm. Po ashtu fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtë për pushim, kohë të lirë, lojë dhe pjesëmarrje në aktivitete kulturore dhe artistike. OKB-ja kërkon që fëmijët dhe të rinjtë të gëzojnë shëndet të plotë dhe të kenë mundësi për përkujdesje shëndetësore dhe mjekësore.

Fëmijët dhe të rinjtë duhet të gëzojnë të drejtën e informimit, të shprehjes së mendimit të tyre dhe të drejtën për t'u dëgjuar. Prindërit, edukatorët apo mësuesit nuk duhet të përdorin dhunë ndaj fëmijëve, t'i keqtrajtojnë apo shpërdorin.

Një aspekt i rëndësishëm është mbrojtja dhe ndihmë të veçantë për fëmijët dhe e të rinjtë në raste lufte dhe nëse janë refugjatë. Kësaj i shtohet kërkesa që fëmijët dhe të rinjtë të kenë të drejtë të jetojnë me prindërit e tyre dhe të mbajnë kontaktin me të dy prindërit, nëse ata jetojnë të ndarë.

Në lidhje me fëmijët dhe të rinjtë me të meta Konventa për të Drejtat e Fëmijëve thotë se ata kanë të drejtën e ndihmës dhe të përkrahjes së veçantë si dhe të pjesëmarrjes aktive në jetën shoqërore.<sup>3</sup>

Të gjitha këto të drejta dhe liri të fëmijëve të përmbledhura shkurtimisht sipas neneve të kësaj Konvente flasin edhe njëherë për vëmendjen dhe rëndësinë që duhet tu kushtohet të njëjtave si dhe për thirrjen

---

<sup>3</sup> [http://www.yradio.org/index.php?option=com\\_content&view=article&id=133](http://www.yradio.org/index.php?option=com_content&view=article&id=133)

për mbrojtje dhe respektim të plotë të tyre si nga ana e individëve të tjerë ashtu dhe nga ana e shtetit dhe institucioneve shtetërore.

Me qëllim që të përparohet implementimi i KDF-së, u krijuan Protokolle të veçanta me të cilat shtetet që i kanë ratifikuar duhet gjithashtu të raportojnë se si shkon implementimi i tyre. Protokolli Fakultativ ndaj Konventës për të drejtat e fëmijëve për tregti më fëmijë, prostitucionin fëmijëror dhe pornografinë fëmijërore u soll në Nju Jork me 15 Maj të vitit 1000, ndërsa i ratifikuar nga ana e Republikës së Maqedonisë me 17 tetor të vitit 1003. Protokolli fakultativ ndaj Konventës për të drejtat e fëmijëve për involvim të fëmijëve në konflikte të armatosura u soll në Nju Jork me 15 Maj të vitit 1000, ndërsa u ratifikua nga Republika e Maqedonisë më 11 Janar të vitit 1004.

Këto marrëveshje ndërkombëtare që janë ratifikuar në pajtim me Kushtetutën janë pjesë e sistemit të brendshëm juridik dhe nuk mund të ndryshohen me Ligj.<sup>4</sup>

### **Konceptet parësore të Konventës për të drejtat e fëmijëve**

Njëqind fëmijë, njëqind individë, ne jemi njerëz – jo njerëz që duhet të bëhemi, jo njerëz të së nesërme, por njerëz tani menjëherë – sot.<sup>5</sup>

Duke u bazuar në respektin për dinjitet të të gjitha qenieve njerëzore, KDF e njeh çdo fëmijë si bartës të të drejtave të tij njerëzore: këto të drejta nuk rrjedhin apo ndërvaren nga të drejtat e njeriut apo ndonjë të rrituri tjetër. Kjo është mbështetja për konceptin e autorizimit të fëmijës, duke i mundësuar fëmijës si një subjekt i respektuar dhe qytetar i shoqërisë, që të sfidojë dhe të ndërrojë kufizimet e perceptimeve diskriminuese dhe pritjet nga të rinjtë.

Faktikisht, fëmijët mbeten të varur nga të rriturit (falë zhvillimi të tyre fizik dhe psikik, mungesa e të mirave materiale/të ardhurave dhe ndryshimeve

---

<sup>4</sup>Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare 51/1991, neni 118

<sup>5</sup> Korczak, Januzs, “ Si të duhet fëmija”, 1919

në situatat ekonomike dhe sociale të prindërve si papunësia, shkurorëzimi i prindërve etj.), që kanë ndikim të mënjëhershëm në standardin e jetesës së fëmijës.<sup>6</sup>

Si koncept i rëndësishëm i Konventës paraqitet edhe nevoja për krijimin e ombudsmanit për fëmijë. Asambleja e përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në sesionin special mbi fëmijët të vitit 1001 ka miratuar planin për veprim të titulluar “Një botë e përshtatshme për fëmijët”, dokument i cili përmban angazhimin nga shtetet që ta themelojnë dhe forcojnë mbështetjen dhe monitorimin kombëtar të fokusuar në fëmijë, siç është, avokati popullor për fëmijë dhe që i njëjti të jetë një institucion i veçantë dhe i ndarë nga institucionet tjera i cili tërësisht do u përkushtohet mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.

Gjithashtu ato mund të ofrojnë mekanizma të ankesave dhe korrigjimeve, këshillime për fëmijët dhe prindërit, informim dhe lobim si dhe funksione mbikëqyrëse – në përgjithësi duke vepruar si një lobi i institucionalizuar dhe i pavarur. Në parim, mbrojtja e të drejtave të fëmijëve është ende një fushatë e uhdëhequr nga të moshuarit, por duhet të gjenden forma të reja për përkrahje të fëmijës dhe të hulumtohen iniciativa të rinjve. Për më tepër, në shumë shtete ka filluar lobimi për përfshirjen e parimeve të KDF në kushtetutat shtetërore, në mënyrë që të ofrojë një kornizë më të fuqishme ligjore për të drejtat e fëmijëve. Në këto shtete, si Franca dhe Belgjika, ligjet e KDF-së janë zbatuar direkt në rastet gjyqësore.

---

<sup>6</sup> Kuptimi i të drejtave të njeriut, Doracak mbi arsimimin për të drejtat e njeriut, Vjenë, Austri, 2003, fq. 5

## **Sfidat dhe programi veprues i Konventës për të drejtat e fëmijëve**

Sipas analizave dhe vizitave që u bëhen fëmijëve nga ana e ekipeve të UNICEF, Afrika dhe Azia paraqesin sfidat më të mëdha të përbotshme në fushën e të drejtave të fëmijëve për mbijetesë, zhvillim dhe mbrojtje.<sup>7</sup> Progresi i këtyre fëmijëve në kujdesin shëndetësor parësor, arsim dhe mbrojtje do të jenë kyçi i përshpejtimit të përmirësimeve në fushën e të drejtave të fëmijëve për të arritur objektivat e pranuar ndërkombëtarisht për zhvillimin e tyre.

Gjithashtu nuk duhet të nënvlerësohet edhe rreziku që u kanoset të drejtave të fëmijëve nga kriza aktuale ekonomike dhe nga sfida të tjera të jashtme. Ekziston një rrezik real që pasojat e këtyre goditjeve do të jenë prezente gjatë gjithë jetës për disa gjenerata, duke minuar kështu përpjekjet për të avancuar të drejtat e fëmijëve në dekadat që vijnë. Në të njëjtën kohë, historia kë treguar se kriza të tilla mund të bartin mundësi për ndryshim. Qeveritë dhe faktorët e tjerë mund t'i përdorin sfidat si një rast për të rikonfirmuar angazhimin e tyre ndaj parimeve dhe neneve të Konventës dhe të punojnë së bashku për të konsoliduar arritjet në fushën e të drejtave të fëmijëve.<sup>8</sup>

Një sfidë tjetër mbetet forcimi dhe zbatimi i ligjeve në favor të të drejtave të fëmijëve. Kjo mund të kërkojë krijimin brenda qeverive të strukturave permanente që kanë përgjegjësinë kryesore për promovimin e të drejtave të fëmijëve dhe koordinimin e veprimeve midis sektorëve. Forcimi i strukturave të pavarura për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si ombudsmeni i fëmijëve, mund të jetë një mekanizëm për monitorimin e të drejtave të fëmijëve në nivel komuniteti dhe vendi. Për të vlerësuar zbatimin efektiv të konventës, është e nevojshme të kuptohet më mirë situata e fëmijëve bazuar në prova dhe në fakte, në punë studimore dhe në kryerjen e vlerësimeve përkatëse.

---

<sup>7</sup> Situata e fëmijëve në botë, botim special, United for Children, UNICEF, fq. 8

<sup>8</sup> Po aty, fq. 10

Sfida e sotme është pakësimi i rreziqeve dhe krijimi i një mjedisi mbrojtës për fëmijët, trajtimin e të gjitha rreziqeve që kërcënojnë të drejtat e tyre, përfshirë edhe ato rreziqe që bazohen në tradita të dëmshme si dhe shfrytëzimi i mundësive që ofrojnë progresi social, ekonomik dhe teknologjik. Nxitja e diskutimit të hapur për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve, përmirësimi i mbikqyrjes përmes përmirësimit të sistemeve të mbledhjes së të dhënave, analizës dhe përdorimit të tyre, krahas ndërtimit të kapaciteteve të familjeve dhe komuniteteve për të kuptuar dhe realizuar të drejtat e fëmijëve, janë hapa jetësorë për eliminimin e të gjitha formave të dhunës, shfrytëzimit dhe abuzimit kundër fëmijëve.<sup>9</sup>

Përsa i përket programit veprues me qëllim që të përparohet implementimi i Konventës për të drejtat e fëmijëve, u krijuan protokolle të veçanta me të cilat shtetet që i kanë ratifikuar duhet gjithashtu të raportojnë se si shkon implementimi i tyre.

Raportin e parë për gjendjen me të drejtat e fëmijëve, shteti nënshkruar patjetër duhet që ta dërgojë 1 vitë pas ratifikimit të Konventës e më tej raporte kërkojnë çdo 5 vite. Në vitin 1007, Republika e Maqedonisë e dorëzoi raportin e dytë periodik për KDF, ndërsa në vitin 1008 raportet Inicuese për protokolet fakultative. Të gjitha raportet i shqyrton Komiteti për të drejtat e fëmijëve pranë OKB-së, i cili mblidhet disa herë në vit në Gjenevë. Kur do ti fitojë Komiteti raportet shtetërore, më tej kërkon informata të shkruara nga organizatat joqeveritare ose ndërqeveritare. Për këtë qëllim OJQ-të nëpër gjithë botën mblidhen në koalicione nacionale për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve (koalicioni i Maqedonisë u formua me 13 nëntor të vitit 1997 me zyrën e saj - sekretariatit në ambasadën Fëmijërore - Megjashi) që të mundën më së miri të përgjigjen në kërkesat e Komitetit.<sup>10</sup>

---

<sup>9</sup> Po aty, fq. 10

<sup>10</sup> Raport alternativ i organizatave joqeveritare ndaj raporteve shtetërore për gjendjen e të drejtave të fëmijut në Republikën e Maqedonisë, Ambasada e parë e fëmijëve në botë – Megjashi, fq.4

Gjatë kohës së takimeve preliminare, anëtarët e Komitetit përgatisin një listë të pyetjeve të cilat dërgohen deri te qeveritë. Nga qeveritë kërkohet që të përgjigjen në ata pyetje me shkrim. Rolin që e kanë OJQ-të shihet edhe në këtë që vijon: në rast se situata në vend është serioze, me rrezik që të vazhdojë të keqësohet, organizata joqeveritare mund që të kërkojë procedurë urgjente nga Komiteti, por ende nevojitet një bashkëpunim më i madh midis aktorëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë, komuniteteve, qeverive vendore dhe qytetarëve. Qeveritë duhet të punojnë me donatorët, organizatat joqeveritare, udhëheqësit fetarë, mësuesit, punonjësit e shëndetësisë, punonjësit socialë dhe anëtarët e parlamentit me qëllim përballimin e sfidave të shumëfishta me të cilat përballen përpjekjet për zbatimin universal dhe tërësor të të drejtave të fëmijëve.

### **Ecuria dhe arritjet e Konventës për të drejtat e fëmijëve**

Konventa ka pasur një ndikim të thellë dhe të shtrirë gjerësisht në institucionet publike. Kjo vihet re në faktin që objektivat, politikat, programet dhe fushatat avokuese për të drejtat e njeriut dhe progresin social, në plan kombëtar dhe ndërkombëtar, u referohen gjithnjë e më shpesh dhe vendosin gjithnjë e më shumë në fokus të drejtave të fëmijëve.

Gjithashtu, Konventa ka ndihmuar në rritjen e ndërgjegjësimit të bizneseve, shkollave, familjeve dhe komuniteteve në lidhje me të drejtat e fëmijëve. Impakti i saj në media është i qartë dhe shfaqet në kodet e etikës për raportimin e çështjeve të fëmijëve, zgjerimin e hapësirës që zënë problematikat e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, si dhe në tërheqjen e mendimit të fëmijëve për çështje që prekin dhe shqetësojnë ata. Edhe udhëheqësit e komuniteteve fetare punojnë në mënyrë aktive për të drejtat e fëmijëve, duke trajtuar çështje të ndjeshme, si stigma dhe diskriminimi të cilat shoqërojnë probleme të tilla si HIV, AIDS dhe arsimimin e vajzave. Konventa shërben si burim frymëzimi për një brez të ri fëmijësh, të cilët janë kthyer në partnerë të rëndësishëm në shoqëri.

Kjo konventë ka ndikuar në transformimin e qëndrimit ndaj fëmijëve duke përcaktuar standardet minimum për trajtimin, përkujdesjen, zhvillimin, mbrojtjen dhe pjesëmarrjen që i takon të ketë çdo individ nën moshën 18 vjeç. Nenet e këtij traktati përforcojnë bindjen e përbashkët që kanë shoqëritë e

ndryshme, se për të përmbushur të drejtave të fëmijëve, është e domosdoshme të mbrohet fëmijëria, të përcaktohet një kohë gjatë së cilës fëmija mund të rritet, të mësojë, të luajë dhe të zhvillohet.

Epoka e Konventës ka njohur përparime të mëdha në mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijëve dhe ka kontribuar në konsolidimin dhe zgjerimin e përpjekjeve për mbrojtjen e tyre. Gjatë kësaj kohe janë bërë hapa të mëdhenj në drejtim të pranimit të rëndësisë që ka fuqizimi i fëmijëve për të marrë pjesë në zhvillimin dhe mbrojtjen e tyre. Ja disa nga arritjet e kësaj Konvente:

- Vdekshmëria vjetore tek fëmijët nën 5 vjeç ka rënë nga 13 milionë në 1990 në rreth 9 milionë në vitin 1008.
- Imunizimi rutinë me anë të tre dozave të vaksinës DPT3 është rritur nga 75% në vitin 1990 në 81% në 1007.
- Vaksinat kanë ndihmuar në uljen e vdekshmërisë globale nga fruthi në një masë 74% që nga viti 1000
- Parandalimi i malaries - Përdorimi i rrjetave me insekticide kundër mushkonjave për të mbrojtur fëmijët nën 5 vjeç ka pësuar rritje të dukshme në Afrikën Sub-Sahariane që nga viti 1000.
- Më shumë se 1.6 milionë njerëz janë furnizuar me ujë të pijshëm nga burime të përmirësuara në periudhën midis 1990 dhe 1006.
- Regjistrimi në shkollën fillore - Numri i fëmijëve të paregjistruar ka rënë nga 115 milionë në vitin 1001 në 101 milionë në vitin 1007.
- Barazia gjinore në arsimin fillor ka pësuar përmirësime dhe indeksi i barazisë gjinore është 96% e sipër në shumicën e vendeve në zhvillim.<sup>11</sup>

Por është e rëndësishme të theksohet se realizimi i premtimeve të Konventës ka nevojë për kontributin e çdo personi dhe çdo institucioni. Të gjithë duhet të zhvillojnë aftësinë për të kuptuar, për të reaguar dhe për të promovuar të drejtat e fëmijëve. Duhet bërë përpjekje të bashkërenduara për të zgjeruar këto kapacitete në të gjitha nivelet e qeverisjes, veçanërisht në nivel

---

<sup>11</sup> Statistikat e botimit special “Situata e fëmijëve në botë”, United for Children, Unicef, fq. 6

lokal ku shpesh mungojnë. Duhet të mbështeten përpjekjet e familjeve për të siguruar ndihmën dhe mbrojtjen e nevojshme për të drejtat e fëmijëve. Në shumë raste, kjo ka të bëjë me dhënien e mundësisë për të pasur akses në shërbimet bazë cilësore dhe për të zgjeruar njohuritë e tyre në fushën e shëndetit dhe higjienës, duke forcuar në të njëjtën kohë pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrjen që prek jetën e tyre.

Si bartës të të drejtave, është e domosdoshme që fëmijët të njohin dhe të kuptojnë të drejtat e tyre si dhe të fuqizohen për t'i kërkuar ato. Konventa duhet të mësohet nëpër shkolla, me qëllim që fëmijët të bëhen avokatë të vetes. Nga ana tjetër, fëmijët kanë detyrimet e tyre ndaj fëmijëve të tjerë në kuadër të konventës: ndërgjegjësimi për të drejtat e tyre sjell detyrimin e njohjes dhe respektimit të të drejtave të të tjerëve!

### **Vizioni drejt të ardhmes së fëmijës sipas Konventës për të drejtat e fëmijëve**

*>>Zbatimi i Konventës nuk është çështje e zgjedhjes, mirëqenies apo bamirësisë, por e përmbushjes së detyrimeve juridike<< <sup>12</sup>*

Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve si struktura e ngarkuar për monitorimin e zbatimit të Konventës dhe Protokollove të saj Opsionale vazhdon të nxjerrë udhëzime të qarta për zbatimin e të drejtave të fëmijëve në të gjitha shtetet që janë palë me këtë Konventë përmes raportimeve, komenteve të përgjithshme dhe ditëve të debatit. Qeveritë e vendeve të ndryshme gjithnjë e më shumë po i zbatojnë këto rekomandime duke sjellë përfitime të rëndësishme në fushën e të drejtave të fëmijëve.

Qasja që bazohet tek të drejtat e njeriut përfaqëson një kuadër të qëndrueshëm për trajtimin e pa barazive dhe kërkon që të gjitha veprimet e qeverive të kenë në themel parimet e të drejtave të njeriut. Veprimet humanitare tani mbajnë parasysh të gjitha nevojat e fëmijës duke venë në rend prioritar arsimin dhe mbrojtjen përkrah angazhimeve historikisht tradicionale

---

<sup>12</sup> Komiteti drejtues i të drejtave të fëmijëve (Platforma Ndërkombëtare e OJQ-ve për monitorimin si vazhdim i sesionit special mbi fëmijët), 1001

të kësaj ndihme, që është sigurimi i mjeteve dhe shërbimeve bazë për të përmbushur nevojat fizike kryesore të fëmijëve. Rritja e shpejtë e aksesit në informacion dhe në teknologjitë e komunikimit në vendet në zhvillim po bëhet një mjet i rëndësishëm për të përçar dije dhe njohuri deri te komunitetet më të marginalizuara.

## KONKLUZION

Konventa për të drejtat e fëmijëve është një arritje për të cilën është luftuar shumë dhe e cila është fituar me shumë mund. Ajo është një dokument i çmuar që na tregon rrugën drejt një bote ku të drejtat e fëmijëve të respektohen dhe, si rezultat i kësaj të përmirësohen, në mënyrë të ndjeshme të gjitha aspektet e jetës njerëzore. Ndërsa dekada e parë e shekullit 11 i afrohet fundit, ne duhet të përfitojmë nga mundësitë për të vënë në jetë parimet dhe dispozitat e Konventës. Sfida madhore e 10 viteve të ardhshme do të jetë njësimi i detyrimit të qeverive me përgjegjësinë sociale dhe atë individuale. Sfida e sotme është konsolidimi i arritjeve të 10 viteve të fundit, pakësimi i rreziqeve dhe shfrytëzimi i mundësive që ofrojnë progresi social, ekonomik dhe teknologjik.<sup>13</sup>

Ndërtimi i partneriteteve të gjëra është faktor jetësor për pranimin dhe zbatimin e parimeve të Konventës dhe të drejtave që ajo sanksionon. Bashkëpunimi në fushën e shëndetit, arsimit, mbrojtjes dhe pjesëmarrjes së fëmijëve është zgjeruar dukshëm vitet e fundit dhe premtan për një progres të shpejtë në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe në arritjen e objektivave të zhvillimit të pranuar në nivel ndërkombëtar. Rritja e shpejtë e aksesit në informacion dhe në teknologjitë e komunikimit në vendet në zhvillim po bëhet një mjet i rëndësishëm për të përçar dije dhe njohuri deri te komunitetet më të marginalizuara.

---

<sup>13</sup> Situata e fëmijëve në botë, botim special, United for Children, UNICEF, fq. 11

## **BIBLIOGRAFIA**

- 1.George Herbert Mead, “Mendja Qenia dhe Shoqëria”, Prishtinë, 1001
- 1.Hannan Arendt, “Gjendja Njerëzore”, Ipls&Dita, 1000
- 3.Samuel Pufendorf, “Deyra e Njeriut dhe e Qytetarit sipas Ligjit Natyror”, Isp & Dita, 1000
- 4.Përmbledhje nga Raija Hanski dhe Martin Scheinin, Rastet kryesore të Komitetit për të Drejtat e Njeriut, Instituti për të Drejtat e Njeriut, Universiteti Abo Akademi Turku/Abo, 1003
- 5.Ismet Salihu, “E Drejta Penale Ndërkombëtare”, Prishtinë, 1005
- 6.Kurtesh Saliu, “E Drejta Kushtetuese”, Prishtinë, 1004
- 7.Hamdi Podvorica, “E drejta Familjare”, Universiteti Ilirija Prishtinë, 1000
- 8.Lisen Bashkurti, “Mbi të Drejtën Ndërkombëtare dhe Organizatat Ndërkombëtare”, Tiranë, 1006
- 9.Agim Gjoleka Esmeralda Gjoleka, “Avokati në Procesin Gjyqësor Civil”, Tiranë, 1008
- 10.Pričajnik za Sproveduvanje Analiza na Buxhetot od Perspektiva na Covekovite Prava, Shkup, 1011
- 11.Zejnullah Gruda, “E Drejta Ndërkombëtare Publike”, Prishtinë, 1001
- 11.Karta e Kombeve të Bashkuara, 1945
- 13.Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, SHBA, 1948

**Doc.dr.Ebrar Ibraimi**

International University of Struga

Faculty of Law Sciences

ebrari2002@yahoo.com

## **KUSHTETUTAT DHE RISHIKIMI I TYRE – “PUSHTETI KUSHTETUES” VERSUS “PUSHTETIT PËR TË RISHIKUAR KUSHTETUTËN”**

### **ABSTRAKT**

Mendimi juridik-politik për kushtetutat është zhvilluar përballë rrjedhës së kohës në raport me përmbajtjen dhe qëllimet e tyre, por edhe në raport me evolucionin e kërkesave për ndarjen e pushteteve dhe për shtetin e së drejtës.

Hartuesit e kushtetutave të para formale të periudhës së fundshekullit XVIII besonin në përjetësinë dhe qëndrueshmërinë e veprës së tyre, pasi mbizotëronin ideja e pandryshueshmërisë së sistemit shoqëror – politik, por dinamika e jetës, vecanërisht e jetës shoqërore e politike, ka ndikuar në nevojën për përshtatje të këtyre akteve themelore të cilat duhej t'i përshtateshin kërkesave të kohës.

Kjo nevojë për përshtatje përbën një ndër arsyt kryesore për të cilat në tekstet kushtetuese parashikohen procedurat për mundësinë e realizimit të ndryshimeve të mëvonshme të tekstit kushtetutes, prandaj momenti gjenetik i krijimit të kushtetutës, në të cilin ushtrohet “pushteti kushtetues”, është përcaktues për formulën e rishikimit të kushtetutës, gjatë zbatimit të së cilës nuk mund t'i bëhet me referim pushtetit origjinar kushtetues, por pushtetit për

Kushtetutat dhe rishikimi i tyre – “pushteti kushtetues” versus “pushtetit për të rishikuar kushtetutën”

të rishikuar kushtetutën, që në doktrinën kushtetuese përgjithësisht pranohet si i derivuar prej të parit.

Në kontekstin e gjithë kësaj dinamike dhe përkrah nevojës, vullnetit dhe mundësisë efektive për të rishikuar kushtetutën, paraqet rëndësi edhe analiza teorike e përmbajtjes së rishikimit të realizuar apo që kërkohet të realizohet, pasi pushteti për të rishikuar kushtetutën nuk duhet parë si i pakufizuar dhe nuk duhet të cenojë bërthamën e ngurtë të kushtetutës, përcaktimi i së cilës përbën gjithashtu objekt të trajtimit në vijim.

### **Fjalët çelës: kushtetutë, sistem politik, pushtet kushtetues**

#### **HYRJE**

Zhvillimet historike paraqesin rëndësi për teorinë kushtetuese për shkak të efektit që ato kanë në ideologjitë dhe institucionet politike, si dhe në politikat publike. Evolucioni i shtetit në aspekt historik është bashkë-shoqëruar edhe me ndryshimet përkatëse në rendin juridik kushtetues, pasi në kushtetutën e shtetit në një moment të caktuar historik pasqyrohen ideologjitë politike të një grupi dominues në castin konkret dhe të rrethanave në të cilat ky grup është krijuar, kompromiset e rastit apo marrëdhënjet mes partive politike ose institucioneve publike. Kushtetuta dhe kuptimi i saj janë vepër e demokracisë së qytet-shteteve(poliseve) greke dhe e mendimeve të Aristotelit dhe të Platonit; në aspektin historik elementet e para për kushtetutën, në kuptimin e saj formal, paraqiten në Greqinë dhe Romën e vjetër. Megjithatë ajo e ka burimin dhe bazën e vet kuptimore.

Në fjalën “*constitution*” që rrjedh nga fjala latine “*constitutio*” e përdorur në shtetin romak si akt i perandorit, me të cilin rregulloheshin vetëm disa çështje nga sfera e organizimit shtetëror dhe shoqëror.

Është kjo arsyeja për të cilën në evolucionin e të drejtës kushtetuese mendimi juridik romak ka pasur ndikim vendimtar në paraqitjen dhe përmbajtjen e termi “kushtetutë” në vendet e para ku ajo është nxjerrë si akti themelor dhe më i lartë në shtet.

Termin “*constitutio*” nuk e hasim më gjatë mesjetës. Në këtë kohë si sinonim i tij përdoret termi “*lex fundamentalis*” si emërtim i akteve ligjore me

rëndësi organizative dhe politike. Akteve të tilla u jepet karakteri kushtetues, ngaqë konsiderohen si akte juridike me fuqi më të lartë se ligje të tjera.

Kuptimi bashkekohor i kushtetutave është i mëvonshëm në kohë dhe është shfaqur nga fundi i shekullit XVIII me revolucionet e mëdha në SHBA dhe në Francë. Kushtetuta e SHBA-ve e vitit 1787 dhe Deklarata franceze e të Drejtave të Njeriut dhe të Qytetarit e vitit 1789 krijuan kuptimin modern të kushtetutave si akte themelore formale që sanksionojnë parimet kryesore të rendit shtetëror dhe të drejtat e shtetasve.

### **Kushtetutat e ngurta “të antikitetit” dhe ato bashkëkohore përballë rrjedhës së kohës. Rëndësia e krahasimit**

Nocioni i ri i kushtetutave, si një realizim praktik i tërësisë së doktrinëve që kanë në qendër të reflektimit të tyre vendosjen e pushtetit në rregullat juridike dhe që përfshihen nën emrin e konstitucionalizmit, në teorite bashkëkohore përdoret për t’iu kundërvënë atij të “kushtetutave të antikitetit”, si pasqyrim i tensioneve mes forcave të ndryshme kushtetuese konkurruese dhe që përcaktohet si një rezultat i papërcaktuar qartë në një sërë ligjesh, institucionesh, zakonesh dhe konventash që janë zhvilluar me kalimin e kohës. Në këtë këndvështrim kushtetuta në antikitet tregonte parimet themelore që mund të nxirren nga institucionet funksionuese në një vend dhe nga zhvillimi përkatës, të rrënjosura në traditën e vendit dhe që përbëjnë “trashëgiminë kombëtare” reale dhe kishin si karakteristikë sanksionimin e pavarësisë, ose, e thënë me saktë, sanksionimin e privilegjeve të kategorive të caktuara shoqërore.

Në periudhën e mesjetës është karakteristike përballja e vazhdueshme dhe reciproke për të përfituar privilegje dhe të drejta mes subjekteve të së drejtës së kohës, të tilla si: monarku, kisha, fisnikëria apo borgjezia. Marrëveshjeve të arritura mes tyre, që pasqyroheshin në dokumente të shkruara të posacme dhe që mund t’u nënshtroheshin gjithësesi bisedimeve të reja për ndryshim, mund t’u njihet karakteri kushtetues vetëm përse i përket objektit të rregullimit që kishin dhe jo sepse mund të përcaktonin një rregullim të përgjithshëm politik dhe social. Me fjalë të tjera, në kuadër të një të drejte që sanksionon pabarazi dhe privilegje, secili mendonte dhe vepronte për vete,

Kushtetutat dhe rishikimi i tyre – “pushteti kushtetues” versus “pushtetit për të rishikuar kushtetutën”

nuk kishte asnjë që mund të mendonte dhe të vepronte për të gjithë. Përmendim këtu *Magna Carta Libertatum* (Karta e Madhe e Lirive) e mbretit Joan Pa Toke e vitit 1215, që me të drejtë konsiderohet si “Marrëveshje kushtetuese” midis mbretit dhe baroneve anglezë, pasi nga ky dokument buron ideja e epërsisë të së drejtës, bazës juridike të pushtetit dhe të procedurës juridike të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut e të shtetasit. Nëpermjet *Magna Charta Libertatum* mbreti u garantonte në formë të shkruar feudalëve angleze disa të drejta të cilat ata deri atëherë i shfrytëzonin në bazë të zakoneve kushtetuese. Ndër këto të drejta përmendim: të drejtën e feudalëve në harac të arsyeshëm të caktuar nga Kuvendi i Përgjithshëm i Mbretërisë e jo nga ana e mbretit; të drejtën e mbrojtjes së pronës feudale nga ndërhyrjet e kundërligjshme të mbretit; të drejtën e zgjidhjes gjyqësore të mosmarrëveshjeve me mbretin; të drejtën e pjesëmarrjes së feudaleve në kontrollin e zbatimit të Kartës së Madhe, duke përfshirë edhe pjesëmarrjen e drejtëpërdrejtë; të drejtën e feudaleve në kryengritje kundër mbretit në rast se ai nuk u përmbahet dispozitave të Kartës, etj.

Edhe pse kjo Kartë garantonte vetëm të drejtat e feudalëve, me anë të interpretimit intensiv ajo ka pësuar evolucion, kështu që sot në fakt paraqet bazën kushtetuese lidhur me liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të shtetasit në këtë vend. Duhet vënë gjithashtu në dukje se Karta e Madhe e Lirive bën pjesë në grupin e Kartave kushtetuese që nuk vendosin theksin thjeshtë në sistemin e pushteteve publike, por rregullojnë në themel raportet ndërmjet individëve dhe autoriteteve, duke nxitur marrëveshje të shumta që kanë për qëllim ristrukturimin e shoqërisë civile: gjë që mund të cojë në shpjegimin e arsyeve për të cilat zakonisht bëhet fjalë për kushtetuta të *ngurta*, që kushtëzojnë legjislacionin e zakonshëm në kuadër të burimeve të krijimit të së drejtës.

Opinionin dominues ndërmjet konstitucionalistëve nuk pretendon, as beson, se mund të ketë ndryshuar vetë koncepti i kushtetutës gjatë rrjedhës së kohës. Përtej varianteve të ndryshme në kuadër të Kartave kushtetuese, që kanë ekzistuar apo ekzistojnë akoma, është e përhapur teza sipas të cilës duhet kërkuar një koncept “*absolut*”, i vlefshëm për cdo kohë dhe cdo vend, i përfaqësuar nga ai kompleks minimal normash themelore, në bazë të të cilit mund të thuhet që cdo shtet krijohet në mënyrë të ligjshme. “Kushtetutave të antikitetit”, përvec mospasjes së një karakteri të përgjithshëm, thuhet se u mungon karakteri parashikues ose, më mirë, janë parashikuese në një sens të

ndryshëm nga kushtetutat në shqyrtim: mund të themi që ato, duke u shfaqur si “përshkruese” të rendit politik ekzistues, parashikojnë situatën reale të raporteve mes palëve; nuk bëjnë parashikim paraprak dhe nuk janë paraprirëse ose krijuese të institucioneve qeverisëse. Ajo që përbën kushtetutën është pikërisht tërësia e zakoneve të hershme, që vijojnë të zbatohen, rregullojnë e kushtëzojnë qeverisjen dhe që shihen si hyjnore për shkak të zbatimit për një kohë të gjatë dhe të pandërprerë. Këtij koncepti për kushtetutat antike autore si Groppi, Dogliani, Rebuffa i vendosin përballë konceptin e kushtetutave bashkëkohore me karakter vullnetar dhe parashikues: ndryshe nga të parat, kushtetutat bashkëkohore paraqiten si frut i një akt vullneti, që përfshin të tërë dhe ka për qëllim të përcaktojë bazat e bashkëjetesës.

Një element i përbashkët i kushtetutave revolucionare të shekullit XVIII, që në vijim si do të përbëjë edhe një karakteristikë të të gjitha kushtetutave bashkëkohore, është qenia e tyre si dokumente të shkruara, të miratuara në formë solemne dhe që përmbajnë parime të cilat karakterizojnë formën e shtetit dhe regjimin politik.

Shkrimi përbën një kusht të domosdoshëm për zbatimin e kërkesave për stabilitet dhe siguri juridike, që qëndrojnë në themel të juridiksionit të raporteve kushtetuese në drejtim të një kufizimi të pushtetit arbitrar dhe të garancisë së një qeverisjeje të kufizuar, që shoqërojnë lindjen e konstitucionalizmit të shekullit të XVIII, kërkesa të cilat do të vazhdojnë të ekzistojnë edhe në fazat dhe epokat pasuese. Pikërisht ngaqë kushtetutat e shkruara i korrespondojnë një vullneti të racionalizuar dhe stabilizues të raporteve politike, mund të kuptohet se si ato janë, përkundrazi, produkt i periudhave historike të dominuara nga paqëndrueshmëria, irracionaliteti e pasiguria.

Dokumente të tilla janë finalizuar në krijimin e garancive për të drejtat dhe, për këtë qëllim, disiplinojnë organizimin e pushteteve: pjesa më e madhe e normave në përmbajtje të tyre janë norma për pushtetin, jo për të drejtat, por që kanë për qëllim garantimin e të drejtave.

Bërthama kryesore e kushtetutave të reja është përmbledhje dhe frymëzim i nenit 16 të Deklaratës franceze të të Drejtave të Njeriut dhe të

Kushtetutat dhe rishikimi i tyre – “pushteti kushtetues” versus “pushtetit për të rishikuar kushtetutën”

Qytetarit të datës 26 gusht 1789, sipas të cilit “*Cdo shoqëri, në të cilën nuk është e sigurtuar garancia e të drejtave dhe as është përcaktuar ndarja e pushteteve, nuk ka kushtetutë*”. Rëndësia politike e konceptit të ri për kushtetutat në këtë periudhë u theksua nga radikali Tom Paine “*Kushtetuta është dicka që i paraprin qeverisë dhe qeveria është vetëm një krijim i kushtetutës ... kushtetuta nuk është akt i një qeverie, por i një populli që krijon një qeveri dhe qeverisja pa kushtetutë është pushtet pa asnjë të drejtë*”

## RËNDËSIA TEORIKE DHE PRAKTIKE E KUSHTETUTËS

Hartimi i një kushtetute zakonisht pason disa ngjarje politike të rëndësishme si: shpallja e pavarësisë, një revolucion i suksesshëm, krijimi i një shteti të ri nga bashkimi i shteteve që formalisht ishin të pavarur nga njëri-tjetri, një rindërtim i rëndësishëm i institucioneve të një vendi etj. Duke iu referuar historisë dhe epokave të rëndësishme, Tokevili në “Demokracia në Amerikë” shkruante se “*Ka epoka në të cilat kombet tronditen nga të këqija aq të mëdha, sa në mendimet e tyre shfaqet ideja e një ndryshimi rrënjësor të kushtetutës politike. Ka të tjera në të cilat shqetësimi është akoma më i thellë... Është epoka e revolucioneve të mëdha dhe e partive të mëdha... Pastaj ka epoka në të cilat ndryshimet janë aq të pandjeshme, sa që njerëzit kujtojnë se kanë arritur në një stad final; atëherë shpirti njerëzor beson se është i mbështetur fort në baza të sigurta dhe nuk e con vështirimin përtej një horizonti të caktuar. Është koha e intrigave dhe e partive të vogla...*”. Prej teorive politiko-juridike të Tokevilit, kapërcejmë në të njëjtën vijë mendimi në teorinë e Kelzenit për të drejtën bazë; ai, duke sqaruar përmbajtjen dhe rëndësinë e normës juridike themelore në rendin juridik të një shteti të vetëm, nder të tjera shprehet se domethënia e normës themelore është vecanërisht e qartë në rastin në të cilin një rend juridik nuk ndryshohet në rrugë ligjore, por nëpërmjet një revolucioni zëvendësohet me një rend të ri juridik.

Gjatë argumentimit të tij Kelzen merr shembull një shtet monarkik, në të cilin një grup njerëzish tenton nëpërmjet një ndryshimi të papritur të vendoset në vend të qeverisë së ligjshme dhe të ndryshojë qeverisjen e deritanishme monarkike në republikane. Ai prezanton të dy variantet e mundshme të zgjidhjes:

- Nëse tentativa për ndryshimin e formës së qeverisjes realizohet me sukses, domethënë nëse pushon rendi juridik antik (forma monarkike e qeverisjes) dhe hyn në fuqi rendi i ri juridik (forma republikane e qeverisjes), në momentin në të cilin sjellja efektive e këtij grupi njerezish nuk i korrespondon me atij antik, por në përgjithësi të riut, atëherë sjellja ndaj tij është si ndaj një rendi të ri juridik dhe për pasojë aktet e zbatuara prej tij konceptohen si akte juridike të vlefshme dhe faktet që e kundërshtojnë si shkelje të së drejtës. Për rrjedhojë merret një normë e re themelore, jo më ajo që delegon si autoritet legjislativ monarkun, por ajo që përkundrazi delegon regjimin revolucionar.
- Nëse në të kundërt kjo tentativë do të dështonte, pasi rendi i ri juridik mbetet i paefektshëm dhe nuk i korrespondon sjellja efektive e atyre të cilëve norma u referohet, atëherë akti që është ndërmarrë nuk duhet konsideruar si shpallje e një kushtetute, por si vepër penale e tradhëtisë së lartë; jo si pozicionim i së drejtës, por si shkelje e saj dhe, kuptohet, e rendit të vjetër juridik, vlefshmëria e të cilit prezumon normën themelore që delegon monarkun si autoritet krijues të së drejtës.

Sipas Kelzenit, vlefshmëria e një rendi juridik, që rregullon sjelljen e një grupi njerëzish të caktuar, gjendet në një raport të sigurtë të varësisë me faktin që sjellja reale e këtyre njerëzve i korrespondon rendit juridik dhe, nëse duhet thënë, edhe efikasitetit përkatës.

Neni homolog I Kushtetutës franceze të vitit 1958, neni 54 e zgjeron rrethin e subjekteve që mund ta ushtrojnë këtë të drejtë duke ia njohur shprehimisht edhe “*Presidentit të Republikës, Kryeministrit, 60 deputeteve ose 60 Senatorëve*”. Ky ndryshim në parashikimin përkatës kushtetues ndodhi për shkak të pakënaqësisë që kishte shfaqur *gaullist*-ët për procedurën dhe mënyrën se si ishte ratifikuar Traktati i Romës në vitin 1957, të cilin ata e konsideronin si një shkelje të sovranitetit shtetëror.

Gjithashtu edhe dispozitat e Ligjit Themelor Gjerman të vitit 1949 për caktimin e Kancelarit apo vendosja e kufizimeve absolute në procesin e rishikimit të tij përbëjnë një përpjekje për të rregulluar problemet që u bënë shkak për vendosjen e sundimit nazist nëpërmjet zbatimit të disa dispozitave të Kushtetutës liberal-demokrate të Vajmarit si:

Kushtetutat dhe rishikimi i tyre – “pushteti kushtetues” versus “pushtetit për të rishikuar kushtetutën”

- neni 48, të cilit iu referua Hitleri sapo u caktua kancelar në vitin 1933 për të pezulluar garancitë kushtetuese për të drejtat themelore të parashikuara në nenet: 114 (hapeas corpus), 115 (paprekshmëria e banesës), 117 (fshehtësia e korrespondencës), 118 (liria e fjalës dhe e shtypit), 123 (e drejta e tubimit), 124 (e drejta e mbledhjes dhe organizimit) dhe 153 (garantimi i pronës private) apo

- procedura e rishikimit të kushtetutës nga zbatimi formal i të cilës u miratua një ligj kushtetues me 24 mars 1933 [*The Enabling Act*], që në nenin 2 i jepte të drejtën qeverisë federale që në rast nevojë të miratonte ligje të cilat mund të devijonin nga parashikimet kushtetuese për sa kohë që nuk ndikonin në institucionet e *Reichtag* dhe *Reichsrat* dhe nuk cenonin të drejtat e Presidentit.

Në vitin 1934, Hitleri e shkeli tre here nenin 2 dhe nuk pati asnjë padi gjyqësore, meqë edhe vetë ligji kushtetues nuk parashikonte ndonjë masë që mund të merrej nëse kancelari e shkelte nenin 2. Edhe në SHBA institucionet publike janë të shenjuara nga historia dhe eksperiencia përkatëse, e cila bën dallimin në drejtim të organizimit dhe procedurave që i krijojnë dhe rezonancës që patën në vijim të realizimit të amendamenteve kushtetuese.

Nëpermjet studimit të krahasuar mund të vendosim edhe një lidhje ndërmjet normave kushtetuese me ideologjitë politike, marrëdhëniet ndërqeveritare, si edhe me politikat publike, të cilat gjejnë pasqyrimin e tyre më të mirë dhe garantimin maksimal në parashikimin në tekstet kushtetuese:

- Nëse dispozitat e kushtetutave të “antikitetit”, për shkak të koncepteve dhe ideologjive përkatëse për shtetin e shoqërinë, bënë më shumë një rregullim të situatës së faktit, nuk kishin karakter parashikues dhe shfaqeshin si një e drejtë, privilegj që sanksiononin pabarazinë dhe jo domosdoshmërisht kishin formë të shkruar; përkundrazi, tek kushtetutat bashkëkohore, përvec formës së shkruar, vërejmë se përmbajnë dispozita me karakter parashikues dhe kanë në themel të tyre krijimin e garancive për të drejtat dhe barazinë duke rregulluar organizimin dhe ndarjen e pushteteve.
- Duke analizuar kushtet dhe rrethanat historike gjatë të cilave krijohen kushtetutat në shqyrtim, pavarësisht se disa prej tyre mund të mos

përfaqësojnë zgjidhje afatgjata për problemet e qeverisjes, por me shumë rregullime të përkohshme të konfliktit të interesave, mund të vlerësojmë se cila doktrinë apo politikë kushtetuese mund të transferohet përtej kufijve shtetërore dhe cila jo, si dhe mund të konstatojmë parimet e tyre themelore në kushte dhe rrethana të ngjashme.

### KONKLuzion

Impakti i historisë në institucionet politike është shumë i rëndësishëm në të drejtën kushtetuese, madje mund të argumentohet se si ajo influencohet vecanërisht nga kundërshtitë historike. Sa kushtetuta janë shkruar apo rishikuar për të zgjidhur problemet e ndodhura në të kaluarën? Mjafton të marrim një shembull të thjeshtë, nenin 28 të Kushtetutës franceze të vitit 1946 që parashikonte se Parlamenti mund t'i drejtohej Këshillit Kushtetues për të përcaktuar nëse një traktat është në përputhje me kushtetutën përpara se traktati të ratifikohet.

Ndryshimet në të drejtën kushtetuese janë të projektuara njësoj në “dialogun” si me të shkuarën ashtu edhe me të ardhmen, prandaj në kuadër të krahasimit paraqet rëndësi të vecantë krahasimi në rrafsh historik, ashtu si edhe shpjegimi i ndryshimeve në doktrinën kushtetuese përtej kufijve shtetërore në të njëjtin rrafsh kohor duke sqaruar ndryshimet dhe ngjashmëritë në doktrinën kushtetuese nga njëri shtet tek tjetri.

### Literatura e shfrytëzuar

1. AMATO G., BARBERA A., *Manuale di diritto pubblico I*, Bologna 1997.
2. ANDREANI A., *Sistemi costituzionali comparati (Corso di lezioni)*, Firenze, Edizioni Cusl Firenze, 2008.

Kushtetutat dhe rishikimi i tyre – “pushteti kushtetues” versus “pushteti për të rishikuar kushtetutën”

3. ANDY KNIGHT W., *A Changing United Nations: Multilateral Evolution and the Quest for Global Governance*, New York, St. Martin's Press, 2000.

4. ARDANT P., (*Manuel*) *Institutions politiques & droit constitutionnel*, 6<sup>e</sup> édition, Paris 1994.

5. BALDUZZI R., BIANCHI P., CARROZZA P., DI GIOVINE A., FERRARI G.F., FLORIDIA G.G., FRACCHIA F., GARBARINO C., PARODI G., PIZZETTI F., ROMBOLI R., RUGGERI A., SALAZAR C., SICARDI S., *La revisione costituzionale del Titolo V tra nuovo regionalismo e federalismo: problemi applicativi e linee evolutive*, a cura di FERRARI G.F. e PARODI G., Padova, CEDAM, 2003.

6. BARDUSCO F., FURLAN F., IACOMETTI M., MARTINELLI C., VIGEVANI G.E., VIVIANI SCHLEIN M.P., *Costituzioni comparate*, Torino, Giappichelli, 2

7. BARNAVE A., *Potere costituente e revisione costituzionale*, a cura di Martucci R., Roma, Piero Lacaita Editore, 1996.

8. BARTOLE S., *Riforme costituzionali nell'Europa centro-orientale: da satelliti comunisti a democrazie sovrane*, Bologna, Il Mulino, 1993.

9. BIN R., PITRUZZELLA G., *Diritto costituzionale*, Torino, Giappichelli, 2005

**PhD Sulo Haderi**

Dekan i Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Tiranës

## **ECONOMIC DEVELOPMENT AND GROWTH: THE PROPERTY RIGHTS AND REFORMS IN ALBANIA**

### **ABSTRACT**

The main purpose of this article is to shed light to several issues pertaining to acceleration of economic growth and development in Albania, which will ultimately contribute to country's integration to the EU. In analogy with Bulgaria and Romania's case, we have made assumptions that if Albania has to join the European Union by 2014, it would call for upholding a high steady annual growth rate of 7 per cent, so as to catch up with the level of Bulgaria and Romania's per capita income, when they joined the EU in January 1st, 2007.

We first provided a detailed analysis on the fundamental factors propelling the economic growth in Albania and simultaneously making comparative assessment of main growth indicators with two countries in the region (Bulgaria and Romania), which have recently joined the European Union. Albania's economic growth has been impressive during the early years of country's transition, thanks to successful macroeconomic stabilization and extensive structural reforms and increase of the total factor productivity (TFP). Due to a high average real GDP growth maintained throughout a 10 year period following 1998, Albania's per capita GDP (PPP) soared by 60 percent compared to its 1998 level. However, the growth has somewhat restrained in the past years, posing threats to Albania's goal of becoming an EU member.

According to our analysis, Albania's per capita income shows an exponential behaviour of divergence from the two other countries. Soon after

Economic development and growth: the property rights and reforms in Albania

the year 2000, the decline in the total factor productivity (TFP), which used to be the major source of economic growth in the first decade is becoming problematic, while shifting priorities to other factors conducive to economic growth.

Our analysis is followed by the identification of respective policy reform options necessary to address the challenges Albania faces towards EU integration. In pursuit of the macroeconomic stabilisation and the high growth rates, two politics are suggested as priorities: (i) increasing investments in human capital in search of improving its quality and (ii) notable improvements in state administration governance.

We are aware of the challenges poised by such complex issues as the ownership rights and associated reforms that made it difficult to come up with an acceptable model that better suits to Albania's economy, however we have made a modest effort to propose a tentative alternative.

Based on fundamental economic theories and empirical results it can be drawn that the optimal growth rate for Albania must be the one that makes our country's converge to other countries at comparable levels and economic parameters. From the perspective of Albania's potential membership to the EU and practical reasons, we would suggest to adopt as an optimal growth rate, the rate that would allow our country to become an EU member by 2015, which implies the rate that satisfies the convergence criteria to the EU.

We hope this paper will provide a base for discussion among policymakers, the private sector, the civil society and donors on this much debated issue.

## INTRODUCTION

The importance of maintaining high levels of economic growth is widely known and accepted in theory and practice, because there is no economic and social development without economic growth. Every strategy for the development of the country should be oriented over a high economic growth. High economic growth it is not a goal, but a necessity. Basic indicators of economic growth are generally considered the figures of GDP per capita and GDP growth rate. In the following analysis, we will be focused on three main topics: First, the macroeconomic performance of the country during the transition period, considers first of all economic growth and then the factors that have conditioned that. Second, factors that hinder the higher economic growth, and can it be considered as the desired growth for our country. Third, what could be considered as the optimal growth and at what level would this growth be for the midterm and in the long run.

The paper is organized as follows. Section II presents an overview of economic growth and its major factors. Section III outlines the factors that hinder the increase of economic growth. Section IV highlights the tentative definition of the optimal growth rate for Albania by providing also some indications on the levels of the optimal growth rate in the mid and long run. Section V lays down the current issues and challenges on real estate aspects in Albania including some background, respective property legislation and government initiatives, restitution of property rights, etc. Section VI provides conclusions and recommendations.

## **I. Overview of economic growth and its factors**

Statistics and evaluations of international financial institutions, for 1992 - 2007 period, reflect an impressive and one of the highest levels of economic growth. The main factors that explain this growth are:

**(i) Macroeconomic stabilization and structural reforms based on the standard stabilization package.** Irrespective of the recent economic growth, there was achieved a fiscal consolidation, contributing to a continuously decreasing budget deficit until 3.4% of GDP in 2007. Moreover, monetary policies were implemented to maintain inflation at moderated levels and national reserves according with the FMN standards (sustainability of Balance of Payments);

**(ii) Partly liberalization of trade and privatization of the economy ensure a space and a suitable climate for a higher growth;**

**iii) High level of remittances from the Albanian emigrants.** Despite difficulties associated with evaluation of remittances, they have shown a sustainable growth until 997 million \$ (2006, almost the same figure stands also for 2007), accounting for 14.8% of GDP: which is a higher level than the volume of exports and foreign investments altogether.

Although different studies have indicated the pattern of remittance usage for increased consumption, in Albania they have played a major role in the prospering of construction sector and even the services.

**(iv) Growth of used resources productivity.** Calculations of economic growth resources shows that despite the increases in production factors like capital and labor forces, that are increased in lower rates, the total factor productivity (TFP) has given the main contribution. TFP contribution comes from structural reforms that have driven to a resource allocation from the sectors with lower productivity like agriculture, to sectors with higher productivity like construction and services.

**What is called the optimal economic growth and how much it should be in the midterm and long run?**

The question posed is whether Albania should continue with this trend or is it possible for our country to grow with higher rapid levels as until now?

First we must discuss which are the criteria's that we must take into account to determine the optimal economic growth. Neoclassical growth theory suggests that countries with different levels of product per capital must converge in the context that countries with lower levels of incomes should reach the countries with higher development, during the footpath of arriving the long run equilibrium which is known as the sustainable state.

According to endogen growth theory between countries with different rates of savings and investments must have differences in growth rates. Meanwhile neoclassical theory says that this difference in savings rate has an impact in the growth rate for a long transition period. The facts favor the neoclassical view. Industrialized countries seem that converge towards the income levels of the richest country, which, using the ICP measures of incomes, is still United States.<sup>9</sup>

Robert Barro in serial papers has shown that while countries with higher investment rate tend to grow rapidly, high investment action seems to be transitory until they terminate in unchanged levels with high income per capital, but not with a higher rate. According to Barro this is called conditional convergence, it means that countries are converging in unchanged states, which are conditioned from the rate of investments to the GDP, part of government expenditures for education to GDP and rate of investments in human capital.

Barro facts suggest that conditional convergence is realized in 2% per year. For example, if the income level of India is now 5% of United States income levels, in 35 years will be approximately 10% of American level, considering that the other variables that have an impact in income level such as saving rates are equal between the two countries.

Economic development and growth: the property rights and reforms in Albania

Based on this verified view from empirical results can be suggested that optimal growth rate is the one which brings this country convergence with the other countries compared to it. This problem shows clearly our country intention of being part of European Union. So a practical criteria of the optimal growth rate that we will suggest is that rate which ensure the acceptance of our country in EU in 2015, so the rate that realizes the convergence criteria to EU.

Before answering these questions that show how can be obtained these convergence, let get a desired economic growth which ensure the accession in EU; through which it can be possible that in 2015 income per capital indicator towards the BME can be equal or higher than the one of Rumania and Bulgaria.

According to this assumption, the desired level of incomes per capital must be 7% in the optimistic case and 5% in the pessimistic one. As we are discussing for an increase in the real income per capital, we must have into account that the total economic growth will be 7% (or 5%) plus the population growth.

Assumptions: Growth rate of Albania for 2007-2015, 7% optimistic and 5%; 6% for 2015-2020. BME grow with the same rates as the average growth of the population

In the above analysis we presented the dynamic of economic growth with the intention of convergence with EU countries and the best indicator was the dynamic of GDP per capital in dollars with the 2000 year prices. Besides this indicator can be used others such as national income published in World Bank statistics also GDP per capital .

## **2. Policies that ensure the economic stabilization**

Keeping the macroeconomic stabilization is an important condition for a sustainable economic growth. So:

Maintaining macroeconomic stability qualifies as a priority in our programme. The major goals with regard to the macro-economic indicators include ensuring a per capita income growth rate at 7 per cent annually, a yearly inflation rate of 3+/-1 per cent, a budget deficit of 0–2 per cent by the end of the mandate, a public debt below 50 per cent, a one-digit unemployment rate, and a reduced deficit of the current account.

The goal in the fiscal area concerns preservation of fiscal discipline and budget deficit through expansion of the tax base, better fiscal management, and reduced evasion. The following measures will be launched:

- Establishing a lump-sum alternative tax for the very small business.
- Reducing expenditure for investments in infrastructure and other sectors, including railway transport, health and pension funds, allowing greater leeway for the private sector, which would also help enhance competition and the quality of investments in these sectors. These measures would impact on reduction in the deficit, increase in investments and economic growth.
- A better diversification of the debt portfolio will be lended in conformity with the strategy for the debt management. The debt maturity would extend to not less than 700 days by 2010, thus reducing the risk concerning short-term maturity.
- A large part of the debt is kept by the second-tier banks, thus leading also to a relatively high level of poverty in the banking system for which the public sector is to blame. Therefore, we will pursue the policy of promoting individuals' participation in public borrowing, and increasing public borrowing twice as much by 2011, basically through briefing the public on the debt instruments.

Economic development and growth: the property rights and reforms in Albania

Expanding debt sustainability analysis and increasing its frequency. This analysis impact directly on the policies and strategies to be developed for reducing and keeping the debt under control.

- Albania's trade conducted largely in Euros, and composition of foreign debt, are coherent with it. However, the exchange rate risk needs to be monitored. In this context, we will aim to increase the long-term debt versus internal debt stock, and external debt versus internal debt, which affect the debt management positively.

- Public expenditure management calls for significant improvements. To this end, measures will be undertaken to ensure: (i) use of MTEF so as to improve the strategic resource allocation and the efficiency of the use of these resources in accordance with the NSSD and fiscal decentralisation; (ii) implementation of the budget regulations so as to improve allocation effectiveness in the sectors in which important investments, including transport, are made; (iii) adoption of the rules intended to limit increase in non-priority expenditures; and, (iv) upgrading of transparency and auditing procedures, and gradual elimination of subsidies.

The goal in the monetary area concerns the keeping up with and improvement on the inflation control targets achieved so far (3+/-1 per cent), the financial system sustainability and supervision strengthening. The dynamics of the economic developments and global markets, the critical analysis of the developments in the monetary area, and the shortcomings and fragility noted, give rise to the need for significant improvements in the development and application of the monetary policy and performance of the Bank of Albania.

We consider the change in the Law —For the Bank of Albania as an imperative action we have to take. We will promote further amendments to the above mentioned Law so as to ensure real independence, and bring it into line with legal practices and regulations of the Central European Bank and the European System of Central Banks. In this context, the following measures will be undertaken:

## The Heritage

- Drafting the Law —For the Bank of Albania by 2009. The substantial amendments to the law concern the legal and real independence of the Bank of Albania, by: (i) eliminating the possibility of directly financing the budget deficit; and (ii) boosting the professional and public profile of the Supervision Council, as the body responsible for drafting the monetary policy of the Bank of Albania;

- Urging and supporting the Bank of Albania in its review of the existing monetary policy regime, and adoption of a new regime, the inflation-targeting regime, in the shortest time possible. The need for a change in the existing regime, which is practically outdated, and the apparent delays of the Bank of Albania as compared to its commitments to this change, makes the adoption of this new regime imperative.

- Further improving the financial system, because there is still room for structural reforms of the financial system, which would increase the monetary policy effectiveness.

The goal on the ***fiscal area*** concerns preservation of fiscal discipline and budget deficit through expansion of the tax base, better fiscal management, and reduced evasion.

## Bibliography

1. World Bank, —Albania Sustaining Growth beyond the Transitionl, 2006
2. Albania: Selected Issues, IMF, Country Report No. 06/285
3. Doing Business 2008, Albania – World Bank

Economic development and growth: the property rights and reforms in Albania

4. Një rishikim i shpenzimeve publike dhe i kuadrit institucional në Shqipëri (PEIR): Arsimi. Banka Botërore, 2006
5. William J. Baumol, Anne B. Blackman dhe Edward N. Wolff, —Productivity and American Leadership: The Long View, (Cambridge, Mass.: MIT Press 1989), Chap. 5.
6. —Economic Growth in a Cross Section of Countries, Quarterly Journal of Economics, May 1991.
7. Raporti vjetor i BSH, vitet 2001 - 2007
8. Law No. 8743 On State Immovable Properties
9. Law No. 8741 dated 22 February 2001 *On the Transfer of State Public Immovable Properties to Local Governments*
10. Law No. 7622 dated 13.11.1992, *On Forests and Forest Police*; Law No. 7917 dated 13.04.1995 *On Pastures and Meadows*
11. Law No. 8744 dated 22.02.2001 On State-Owned Immovable Properties, amendments included
12. Law No. 7501 of 22 July 1991 *On Land*
13. Law No. 8053 of 21 December 1995 *For Transfer of Ownership without Compensation of the Agricultural Land*
14. Law No. 8312 of 26.03.1993 *For in-transferred of Agricultural Lands*
15. Law No. 8337 of 30 April 1998 *For Transfer of ownership of Agricultural Land, Pasture Meadows*
16. Assessment of Mass Valuation Methodology for Compensation in the Land Reform Process in Albania
17. Decision of Council of Ministers No. 3015 of 24 April 2003 *On the Leasing of State Enterprises and Institutions Property*

## The Heritage

18. Law No. 9235 of 29 July 2004 *On Restitution and Compensation of Property*, amendments included
19. Law no. 7491 of 29 April 1991 *On Constitutional Principles*
20. Albanian Constitution
21. Law No. 8743 *On State Immovable Properties*

**Prof. Dr. Evis Kushi**

**Fakulteti i shkencave ekonomike**

**Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"**

## **PROBLEMATIKAT KRYESORE NË QEVERISJEN E SH.A.**

### **ABSTRAKT**

Qeverisja e sh.a tanimë po pranohet si thelbësore në krijimin e një klime tërheqëse të karakterizuar nga kompani konkurruese dhe nga tregje financiare të efektshme. Grupi i Bankës Botërore ka bashkuar përpjektet për të promovuar dialog politikash në fushën e qeverisjes së shoqërive aksionere dhe kanë organizuar Tavolinat e Rrumbullakëta mbi Qeverisjen e Shoqërive Aksionere në partneritet të ngushtë me politikë-bërësit, përfaqësuesit e institucioneve rregullatore dhe pjesëmarrësit e tregut nga secili vend.

**Fjalët çelës: qeverisje, Banka Botërore, shoqëri aksionare**

## **HYRJE**

Ministrat e disa vendeve të Europës kanë pranuar se janë të nevojshme përpjekje të qëndrueshme dhe intensive për të vënë në jetë reformat ekonomike, ligjore dhe administrative dhe sigurimin e strukturave për një qeverisje të mirë.

Është e rëndësishme që të mbahet ritmi i reformave dhe të vihen në jetë mekanizma të besueshëm për zbatim. Tregjet duhet të risigurohen që reformat e qeverisjes së shoqërive aksionere që do të çojnë në mënyrë të pakthyeshme drejt standarteve globale.

Sot ekzistojnë Tavolinat e Rrumbullakëta mbi Qeverisjen e Shoqërive aksionere në Azi, Euroazi, Amerikën Latine, Rusi dhe në Europën Juglindore(EJL). (Vendet që marrin pjesë në Tavolinën e Rrumbullakët të EJL janë: Shqipëria, Mali i Zi, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Rumania, Kroacia, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë.

Puna e tavolinave i është përshtatur çështjeve të veçanta në rajonet përkatëse. Por secila nga Tavolinat shfrytëzon Parimet e OECD mbi Qeverisjen e Shoqërive aksionere si një kuadër të përbashkët për diskutime. Kjo Tavolinë e Rrumbullakët është pjesë e Kompaktit për Reformën, Investimet, Integritetin dhe Rritjen ekonomike (Kompaktit të Investimeve) dhe është realizuar brenda kuadrit të programit të EJL të Qendrës për Bashkëpunim me vendet joanëtare. Kompakti i Investimeve synon të përmirësojë mjedisin ekonomik të biznesit dhe të rajonit. Ai përcakton angazhimin e vendeve të rajonit për të hedhur themelet institucionale për një rritje të qëndrueshme ekonomike dhe për reformën në mënyrë që të krijohet një ekonomi e fortë tregu dhe të nxiten investimet private.

Sot OECD është institucioni i vetëm ndërkombëtarisht i pranuar i parimeve të qeverisjes që trajtojnë të gjithë kuadrin e qeverisjes së shoqërive aksionere, ligjor, institucional strukturat dhe praktikatat rregullatore që krijojnë kontekstin në të cilin veprojnë firmat.

### 1.1. Ç'do të thotë “Qeverisje e shoqërive aksionere”

Qeverisja e shoqërive aksionere është sistemi me anë të cilit drejtohen dhe kontrollohen kompanitë. Qeverisja e sh.a përfshin një komplet marrëdhëniesh midis menaxhmentit të një kompanie, bordit të saj, aksionerëve dhe aktorëve të tjerë. Kjo qeverisje siguron strukturat nëpërmjet të cilave përcaktohen objektivat e kompanisë dhe mjetet për arritjen e këtyre objektivave dhe ato të monitorimit të performancës.

Një qeverisje e mirë duhet të sigurojë *iniciativat e duhura* për ndjekjen e zbatimit të objektivave që janë *në interes të kompanisë dhe të aksionerëve*, duhet të lehtësojnë monitorimin e efektshëm duke nxitur kështu firmat të përdorin ashtu siç duhet burimet e tyre.

Qeverisja e shoqërive aksionere është *një element kyç në përmirësimin e efektshmërisë* ekonomike. Tanimë ajo është pranuar si një kusht themelor për krijimin e një klime tërheqëse për investimet, e karakterizuar nga kompani kompetitive dhe nga tregje financiarë eficientë. Rëndësia e tregjeve financiarë eficientë në rritjen ekonomike sot mbështetet si në nivelin mikro ashtu edhe në atë makro-ekonomik

Evidenca e marrë nga burime të ndryshme është gjithnjë e në rritje, duke treguar se disa aspekte themelore të qeverisjes së sh.a luajnë një rol kyç në përmirësimin e performancës, nëpërmjet lehtësimit të aksesit në tregjet kapitale, duke përmirësuar besueshmërinë e investitorëve dhe duke kontribuar për konkurrueshmërinë e shoqërive aksionere.

Duke shfrytëzuar Parimet e OECD si një kuadër konceptual, Tavolinat e Rrumbullakëta kanë shqyrtuar që të pestë elementët kyç të një kuadri të qëndrueshëm të qeverisjes së shoqërive aksionere janë të përshkruar në Parimet:

- të drejtat e aksionerëve ;
- trajtimin e njëjlojtë të aksionerëve;
- rolin e aktorëve në qeverisjen e sh.a ;
- transparencën dhe zbulimin;
- përgjegjësitë e bordit.

**Praktikat negative të qeverisjes së sh.a, mungesa e ndëgjegjësimit mbi vlerat e qeverisjes së sh.a dhe ndonjëherë edhe një kuadër i dobët institucional,** kanë qenë pengesa të ndjeshme për zhvillimin e tregjeve të efektshëm të kapitalit dhe për ndërtimin e një klime të përshtatshme për investimet. Problemi më i madh aktual lidhur me drejtimin dhe administrimin në përgjithësi të shoqërive aksionere në **Shqipëri**, është mungesa e kulturës dhe e përvojës së bashkëpronësise i cili kufizon së tepërmi zgjerimin dhe rritjen e tyre.

Krijimi i sektorit privat të ekonomisë, si rrjedhojë e iniciativës së lirë private, zhvilloi njësitë e vogla, dyqanet e sektorit të shërbimit dhe të tregtisë, ambientet dhe bizneset e karakterit familjar, të vogël dhe të mesëm. Bizneset vendase ngelen në sektorin e tregtisë dhe të shërbimeve, ndërsa kompanitë e huaja shpesh janë stepur për shkak të nivelit relativisht të lartë të rrezikut ekonomik dhe politik. Në këtë linjë sot konstatohet mjaft i kufizuar numri i bizneseve në të cilat pronësia dhe menaxhimi konsiderohen dy gjëra të ndara. Në shumicën e rasteve shoqëritë publike me aksioner shtetin trajtohen akoma si ndërmarrje shtetërore. Bordet trajtohen si organe pa shumë përgjegjësi, pa iniciativë, shtojca të administratës publike apo të dikastereve, me status të kufizuar dhe që mund të ndryshohen sa here ndryshojne qeverite. Shoqëritë aksionere përbëjnë pa asnjë dyshim pjesën më dinamike të bizneseve private e publike, të cilat japin kontribut të rëndësishëm në prodhimin e përgjithshëm bruto të ekonomisë Shqiptare, në rritjen ekonomike, në investimet dhe në zgjerimin e vendeve të punës. Në botën e sotme ekonomike që karakterizohet nga një lloj pushteti absolut i financave në tërësi, nga zgjerimi i tregjeve financiare, nga zgjerimi dhe dominimi i parasë elektronike, parasë së padukshme etj., paratë dhe kapitalet “fluturojnë” lirisht midis ekonomive, vendeve dhe tregjeve. Nëse ndodh kështu, aktorët kryesorë të këtij ambienti janë shoqëritë aksionere në përgjithësi dhe në mënyrë të veçantë shoqëritë anonime. Shoqëritë aksionere luajnë rol të dorës së parë për zgjerimin, rritjen ekonomike dhe thithjen e kapitaleve të lira në ekonomi.

Duke u nisur nga fakti se shoqëritë aksionere janë një formë relativisht e lartë organizimi dhe drejtimi i bizneseve me shumë pronarë, duhet theksuar se në ekonominë tonë shoqëritë aksionere janë akoma të kufizuara në numër. Por problemet që janë trajtuar më poshtë konsiderohen si problemet më të mëdha që shqetësojnë sot Shoqëritë Aksionere në Shqipëri.

## **1.2. Problematikat lidhur me një kuadër të dobët ligjor**

1. Ligjet dhe rregullat janë ngritur tashmë në lartësinë e standarteve ndërkombëtare, sidoqoftë ka një hendek midis asaj çka shkruhet në ligj me praktikën aktuale. Edhe pse janë miratuar ligjet e falimentimit, pasojat kontradiktore dhe politike të falimentimeve kanë vonuar krijimin e procedurave të përshtatshme. Këto ligje dhe procedura mbeten tepër të njëanshme në favor të borxhlinjve.

2. Plogështia e sektorit gjyqësor dhe simptomat e një sistemi jo solid si neglizhenca profesionale apo ushtrimi i gabuar i profesionit përbëjnë një faktor shqetësues për aplimin e praktikave më të reja të qeverisjes. Ky problem shfaqet kur gjykatat kanë qenë të paafta në marrjen e vendimeve të drejta dhe në sigurimin e evidencave për përcaktimin e penalteteve përkatëse.

1. Ligjvënësit duhet të kontrollojnë konsistencën dhe vijueshmërinë midis elementëve përbërës të kuadrit ligjor që lidhet me të drejtat e aksionerëve. Veçanërisht ata duhet të sigurohen që të drejtat e aktorëve njihen ose jepen në përputhje me kodet e reja të punës që kanë hyrë në fuqi. (Duhet siguruar përputhshmëria me direktivat e BE)

4. Mosaplikimi i “Standarteteve Ndërkombëtare Financiare të Raportimit IFRS” përbën një çështje shumë të debatuar. Hyrja në BE është një forcë udhëheqëse në këtë proces por harmonizimi me direktivat e BE lidhur me praktikën financiare është akoma në fazat foshnjore. Është e rëndësishme që ky proces të përshpejtohet dhe të realizohet implementimi i plotë i IFRS, të paktën për të gjitha kompanitë e listuara publikisht.

5. Një kujdes i veçantë i duhet kushtuar konsolidimit, sepse ekziston një dëshirë e përhapur dhe e vazhdueshme për të konsoliduar kompanitë simotra, kompanitë degë të kompanive më të mëdha, në një kohë kur mundësia për konsolidimin e deklarimeve financiare është e rëndësishme për të kuptuar biznesin e kompanisë, gjendjen financiare dhe vlerën ndaj aksionerëve. Kompanitë duhet të përdorin kritere për konsolidimin, krahas zbatimit të udhëzimeve dhe procedurave të posaçme të paraqitura nga IFRS.

6. Përgjegjësia e organeve të ndryshme të kompanisë për të bërë të njohur informacionin dhe niveli i delegimit të tij nuk është e mirëpërcaktuar në aktet rregullatore përkatëse. Menaxhmenti dhe bordi i drejtorëve kanë përgjegjësinë kryesore në ndërtimin e strukturave të brendshme të kontrollit të cilat mundësojnë mbledhjen, përpunimin dhe ekspozimin e informacioneve të nevojshme për aksionerët, të interesuarit e tjerë, rregullatorët dhe tregun në përgjithësi.

Gjithashtu ata duhet të zhvillojnë procedura specifike që të sigurojnë shpërndarjen e informacionit për të gjithë aksionerët dhe publikun në përgjithësi, në mënyrë të rregullt, në kohën e duhur dhe në mënyrë të barabartë për të gjithë.

7. Ka rëndësi të madhe kompletimi i kuadrit ligjor dhe rregullator lidhur me zbulimin, sidomos lidhur me llojin e ngjarjeve për të cilat kërkohet në mënyrë të deyrueshme publikimi i informacionit. Ky kuadër duhet të përmbajë një listë ngjarjesh që duhen bërë publike në të gjitha rastet, por vetëm pasi ato të justifikojnë pëpara organeve rregullatore se publikimi i këtij informacioni nuk e dëmton interesin e përgjithshëm të kompanisë.

Moskryerja e detyrës nga anëtarët e bordeve të kompanive për të asistuar auditorët e jashtëm i nështrohet përgjegjësisë civile. Ata që paraqesin informacion fals ose të genjeshtërt duhet të konsiderohen si shkaktarë të një vepre penale dhe tju nënshtrohen sanksioneve penale.

8. Për shkak të ndryshimeve të shpeshta të kuadrit rregullator dhe institucional, zakonisht rregullimi i mbajtjes së llogarive dhe profesionit të auditimit është shumë larg të qenit efektiv. Zakonisht kjo është në përgjegjësinë e organizatave të dobëta, jo të pavarura dhe joprofesionale, të cilat shumë rrallë kanë autoritetin për të imponuar sanksione. Për më tepër edhe kur ekzistojnë dënimet, ato zakonisht janë shumë të vogla. Cilësia dhe pavarësia e auditimeve të jashtme zakonisht është shpërfillur.

9. Në praktikë bordet ende nuk luajnë një rol qendror dhe strategjik, meqenëse funksionet e tyre nuk janë ndarë qartazi nga ato të menaxhimit. Ato munden të kryejnë vetëm detyra proceduriale ose të jenë përfaqësues të thjeshtë për kontrollin e aksionerëve. Në përgjithësi bordet janë të dobët nga

pikëpamja e autoritetit, burimeve dhe përgjegjësiwe aktuale të tyre, iu mungon pavarësia në drejtim, e kjo kryesisht për mungesë të akteve ligjore që nuk specifikojnë funksionet dhe përgjegjësitë e tyre, por edhe për shkak të influencës së madhe që kanë aksionerët e mazhorancës.

**10.** Transaksionet abuzive midis palëve përbëjnë një nga abuzimet më të përhapura dhe më serioze të të drejtave të aksionerëve. Kjo vjen si pasojë e dobësive të shumta të kuadrit ligjor e rregullator si dhe nga një zbatim i dobët i përcaktimeve ligjore ekzistuese.

### **1.3. Praktikak negative të qeverisjes: (mungesa e ndërgjegjësimit mbi vlerat e qeverisjes)**

**1.** Abuzimi me të drejtat e aksionerëve në pakicë mbetet një nga dobësitë më të mprehta të politikave të qeverisjes së shoqërive aksionere. Rasti më tipik në Shqipëri është rasti i mospagimit të dividendit nga AMC aksionerëve të pakicës që ndodhi në vitin 2004. Kështu mbas 5 viteve pune AMC kishte vendosur vetëm një herë të shpërndante dividend në mars të 2004 në mbledhjen e Asamblesë së jashtëzakonshme, efektiv ky për vitin 2002. Por sipas raportimeve të dy viteve të tjera fiskale në vazhdim asnjë shpërndarje dividendi nuk u bë praktikisht, derisa pas dy vitesh çështja u bë publike. Edhe pse shpërndarja e dividendëve përflitej vit pas viti ato u paguan me vonesa të mëdha duke i siguruar kompanisë përfitime të konsiderueshme. Gjithsesi AMC u gjobit për këtë shkelje me 1% të xhiros vjetore në vitin 2004. Kjo gjobë përlllogarit me afërsisht 168 milion lekë ose 1.15 milion €. Prandaj mbrojtja e aksionerëve në minorancë kërkon zbatim të efektshëm të procedurave specifike në transaksionet kryesore mes palëve të interesuara dhe sigurisht një monitorim të vazhdueshëm të tregut nga ana e organeve kompetente.

**2.** Prezenca e shtetit si aksioner kryesor shfaq tendencat e një pozicioni dominant të tij në strukturat drejtuese, kryesisht kjo në respektimin e të drejtave të aksionerëve minoritarë. Gjithsesi kjo prezencë nga ana tjetër po sjell vonesa të konsiderueshme në praktikak e proçesit të privatizimit në të gjitha vendet e ELJ, jo vetëm në Shqipëri. Kjo i detyrohet jo vetëm rotacioneve politike në vendet e sipërpërmendura por edhe politikës makroekonomike së shteteve në fjalë.

3. Në Shqipëri njihet transferimi i lirë i aksioneve për shoqëritë aksionere, ku përfshihen edhe ato të listuara në bursë. Por de facto ekzistojnë ende përjashtime të mëdha. Kryesisht ky përjashtim bëhet nëpërmjet dokumentave të themelimit, ose në disa raste prej kontratave abuzive të menaxherëve, e kjo përbën një zonë të rëndësishme rreziku për abuzim.

4. Në shumë vende të Europës, struktura e pronësisë vjen nga procesi i privatizimit. Si e tillë aksionerët kanë marrë pjesën e tyre të aksioneve nëpërmjet privatizimit në masë, pa paguar për to. Ndaj një pjesë e tyre nuk e kanë konceptin e investitorit, në sjellje e mendësi dhe rrjedhimisht pastaj nuk trajtohen si të tillë.

5. Mjaft raste të deklarimit të falimentimit janë shembuj tipikë të shpalljes së falimentimit vetëm për të lehtësuar transferimin e kontrollit. Kjo gjë është realizuar nëpërmjet skemave të dyfishta të cilat kanë sjellë përzierjen e aksionerëve më me peshë, të menaxherëve të jashtëm e ndonjëherëtë edhe të kreditorëve.

6. Përsa kohë që transparencja nuk konsiderohet si një avantazh drejt suksesit, por si pengesë për një përdorim të informacionit sipas dëshirës, kompanitë do vazhdojnë të qëndrojnë apatike ndaj këtij mjeti të fuqishëm për zhvillim.

7. Kompanitë vazhdojnë të ruajnë konceptin e pronësisë mbi informacionin me synim fshehjen e informacionit të rëndësishëm për aksionerët dhe publikun e gjerë. Praktika europiane ndërkohë, lejon mospublikimin e informacionit vetëm nëqoftëse ai është i një rëndësie minimale, ose publikimi i tij do ta dëmtonte seriozisht kompaninë, e nga ana tjetër mospublikimi do të sillte një ndikim në drejtim të gabuar.

Për këtë mjafton të shikosh sa nga shoqëritë e mëdha janë të hapura për dhënien e informacionit, sa janë të gatshme që publiku i gjerë të interesohet mbi raportet e tyre të fitimit e të të ardhurave. Në mjaft raste kjo inefiçensë i dedikohet kryesisht mentalitetit qeverisës dhe praktikave të përdorura nga organet e drejtimit të kompanive.

**8.** Numri i pamjafteshëm i Financierëve Publikë të çertifikuar, të trajnuar e të kualifikuar siç duhet, sikurse edhe i specialistëve financiarë brenda institucioneve rregullatore, bën që kompanitë të mos jenë në gjendje të përmirësojnë cilësinë e përgjithshme të raporteve të tyre financiare dhe i lë ato akoma në fazën e tranzicionit për të arritur standartet e reja financiare.

**9.** Bordet e kompanive janë të përfshirë nga interesa të veçanta, gjë që shkakton probleme serioze lidhur me besnikërinë e tyre ndaj kompanive. Për shkak të strukturave përgjithësisht të përqëndruara dhe të lidhjeve të ngushta me pronarët kryesorë ose për shkak të copëtimit tepër të madh të numrit të aksioneve, anëtarët e bordeve përfaqësojnë aksionerë të caktuar, madje kanë ekzistuar edhe raste flagrante kur janë paguar drejtëpërsëdrejti nga aksioneri.

**10.** Problem tjetër në lidhje me bordet është se ato nuk kanë komitete të specializuara dhe kjo lidhet kryesisht me përmasat tipikisht të vogla në vetvete të bordeve. Komitete të tilla në shumicën e rasteve nuk janë të mandatuara me ligj, akte rregullatore apo kërkesa të listimit. Funksionet e zakonshme të kryera nga komitetet e specializuara janë pikërisht ato më të pazhvilluarat në praktikën e bordeve të Shqipërisë.

**11.** Shpërblimi i anëtarëve të bordit rrallë publikohet dhe procesi i vendimmarrjes nuk është transparent, megjithëse zakonisht kërkohet një miratim formal nga AGM (Mbledhjet e Përgjithshme Vjetore). Janë shumë të rralla paketat e shpërblimit që e lidhin pagesën e bordit me performancën e firmës dhe ndonjëherë ato pengohen nga kufizimet ligjore lidhur me shpërblimin në formën e aksioneve.

**12.** Në disa kompani pjesëmarrja në takimet e bordit mund të jetë formale, në vend që të jetë aktive, me frymë kritike dhe kërkesë llogarie. Anëtarët e bordit nuk i kushtojnë kohën e nevojshme përmbushjes së detyrave të tyre, pjesëmarrja e tyre të jetë e dobët dhe përgatitja për mbledhjet e bordit e kufizuar.

**13.** Një problem shumë i veçantë dhe karakteristik për vendin tonë është manipulimi me vlerat e Bilancit kontabël. Kështu shumë nga kompanitë e mëdha si ato të shërbimit celurar shfrytëzojnë vlerat e larta të pajisjeve për të llogaritur një amortizim më të lartë se ai që rezulton faktikisht, duke

zvogëluar në këtë mënyrë fitimin e periudhës ushtrimore. Këtë gjë e realizojnë duke shfrytëzuar faturat e dyfishta dhe duke rritur koston e pajisjes në faturën që paraqitet në doganë, në mënyrë të tillë që pastaj të rezultojë një shumë më e madhe amortizimi për tu zbritur për çdo vit.

**14.**Nëqoftëse përdorim të dhënat publike të AMC-së (sipas raporteve financiare të kompanisë prindërore, Cosmote,çdo vit Vodafone dhe AMC shpenzojnë rreth 1 miliardë lekë për aparatet dhe mjetet e mëtejshme të rrjeteve telefonike. Në pamje të parë, këto sasi investimesh mund të justifikojnë çmimet e larta të shërbimeve telefonike. Por, këto janë investime afatgjata: jetëgjatësia e stacioneve bazë, sasive të madhe dhe kullave telefonike shtrihet në dhjetëra vite. Kështu që periudha për të rekuperuar investimin është mëse e mjaftueshme. Kujtojmë që jetëgjatësia e amortizimit të rrjeteve të telekomunikacionit që sapo përmendëm është më shumë një mjet financiar, disi fiktiv, për llogaritjen e taksave dhe tatimeve, dhe jo një reflektim i saktë i jetës së rrjeteve funksionuese.

### **1.4. Problematikat e qeverisjes së sh.a në rrethin e Elbasanit**

Në qytetin e Elbasanit ekziston një numër jo i madh i shoqërive aksionere. Kryesisht janë me veprimtari prodhuese. Të pyetur në mënyra të ndryshme(telefon, pyetësorë, duke i takuar fizikisht) për të kuptuar rreth

problemeve që ndeshen në drejtimin e veprimtarive të tyre mbas shumë vështirësive, arritëm të kuptojmë problemet më madhore që ndeshen në qeverisjen e këtyre shoqërive në qytetin tonë.

- Problemi i bashkëpronësisë, pra mosndarja e pronës nga menaxhimi
- Mos ekzistenca shpesh e financierëve në këto shoqëri(punen e tyre e bën kontabilisti, magazinieri)
- Mos zbatimi si duhet i të drejtave të aksionerëve
- Traitim jo i njëjlojtë i tyre
- Ekzistenca e bordeve drejtuese të dobët nga pikëpamja e autoritetit, përgjegjësisë, pavarësisë në veprim për shkak të mosndarjes qartë të funksionit nga menaxhimi
- Mos ekzistenca fare e tyre
- Probleme me transparencën dhe zbulimin(manipulimi me vlerat e bilancit)

### **1.5. Roli i financiereve në vlerësimin e sh.a**

Kompanitë e mëdha të organizuara në formën e shoqërive aksionere që kanë një aktivitet të madh e të larmishëm, kane nevojë për një financier të aftë të vlerësojë me kujdes e përgjegjshmëri gjendjen financiare të saj. Pikërisht për të realizuar këtë, drejtimi ka nevojë për informacion të bollshëm, i cili mund të sigurohet nga pasqyrat financiare.

Kështu pasqyrat financiare na japin informacion për:

- Pozicionin financiar
- Performancën
- Ndryshimet në gjendjen financiare të njësisë.

Pozicioni financiar i njësisë ekonomike paraqitet në pasqyrën e Bilancit Kontabël, performanca në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, kurse ndryshimet në gjendjen financiare të njësisë shfaqen nëpërmjet pasqyrës së kapitalit dhe pasqyrës së fluksit të parave. Megjithatë çdo pasqyrë siguron informacion i cili është i ndryshëm nga të tjerët, asnjëra prej tyre e vetme nuk mund të sigurojë të gjithë informacionin të mjaftueshëm. Financierit i takon të meret me:

## The Heritage

- Politikën e dividendëve(modeli i skontimit të dividendëve, modeli i skontimit, dividendet e mbetur, faktoret që ndikojnë në politikën e dividendëve)
- Metodat e parashikimit financiar(metoda e % mbi shitjen,buxhetet, buxheti i arkës)
- Të bëjë planifikimin e fitimit për shoqërinë(analiza e pikës kritike, problemet në lidhje me të)
- Të vlerësojë me kujdes riskun dhe kthimin e aktiveve të shoqërisë
- Të bëjë buxhetimin e kapitalit(me anë të metodave të ndryshme, NPV, IRR)
- Të kuptojë mire problemet që ndesh firma, cili është shkaku i tyre, të japë konkluzionet e sygjërimit personale për politikën që do ndjekë shoqëria në të ardhmen lidhur me pozicionin në treg, politikën lidhur me konkurrentët nëse i duhet të ulë koston e prodhimit apo të investojë në përmirësimin e cilësisë së produkteve për të pasur fitime më të larta në të ardhmen.

Pra një financier merr pjesë në marrjen e vendimeve brënda një shoqërie, sigurisht kur ai është i aftë e i specializuar në profesionin e tij si ekonomist. Por ajo cka ndodh realisht në shumicën e shoqërive aksionere në qytetin e Elbasanit në lidhje me punësimin e financierëve është një realitet tjetër. Këto shoqëri kanë të punësuar një kontabilist i cili bën punën e tij si i tillë, por kryen dhe rolin e financierit, madje dhe të magazinierit kur është e nevojshme. Pra kontabilisti plotëson dhe kujdeset për bilancin e shoqërisë, duke bërë dhe analizën e një financieri në fund.

Kjo situatë që vjen për shkaqe të ndryshme(situata aktuale jo e favorshme financiare e shoqërisë, nivel i lartë kulturës informale, moszbatimi sic duhet i ligjit), bën që vendimet e marra në këto shoqëri të mos jenë plotësisht të drejta duke ndikuar rrjedhimisht në pozicionin e tyre në treg në lidhje me konkurrentët.

## KONKLUZION

Rezulton që në Shqipëri ka shoqëri aksionere që janë në pronësi të investitorëve të huaj, (të pozicionuara kryesisht në Tiranë), që karakterizohen nga strategji të qarta, role e detyra të ndara qartë midis punonjësve sipas një hierarkie të caktuar, motivim e shpërblim sipas meritokracisë. Kjo i siguron këtyre shoqërive një pozicion më të mirë e të qartë në treg, diferencim nga konkurrentët, rritje të kërkesës konsumatore për produkt duke rritur të ardhurat e duke dhënë një kontribut të rëndësishëm në prodhimin e përgjithshëm bruto e në rritjen ekonomike të shtetit Shqipëtar.

## LITERATURA

- 1.Ligji Nr:7638 për shoqërite tregtare;
  - 2.Shuli, I; Perri, R. (2008), “Analiza e pasqyrave financiare”, Tiranë ;
  - 3.Dhamo, S. (2003), “Kontabiliteti financiar”, Tiranë;
  - 4.Xhafa, H; Cicëri, B. (2008), “Drejt看im financiar 1”, Tiranë;
  - 5.Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan (2009), Informacion mbi shoqërite aksionere nga zyrat e sektorit të Vlerësimit ;
  - 6.OECD (2008), “Organization for economic cooperation and development”, White Paper, URL <http://www.jyftaytay.com>, Access: qershor 2009;
  - 7.Banka e Shqipërise (2007), “Buletini informativ i bursës së Tiranës” ;
  - 8.Manuali i qeverisjes se korporatave, Bursa e Tiranes;
- AATDA (2009), Vezhgimi mbi Corporate Governance ne Shqiperi;
- OECD (2004), Corporate Governance in South East Europe, White Paper, URL ;
- <http://www.oecd.org/dataoecd/41/63/32503108.pdf>.

**Dr. Ramis Merko**

**International University of Struga**

**Faculty of Economic Sciences**

## **LIZING-U FINANCIAR NË SHQIPËRI**

### **ABSTRAKT**

-Lizing-u Financiar efektivisht është një instrument i tregut kapital. Megjithëse disa karakteristika e bëjnë atë të jetë i ndryshëm nga format e tjera të financimit me të ardhura fikse, parimet mbi të cilat vlerësohen anët pozitive dhe ato negative të përdorimit tij janë të njëjta.

Ishte zhvillimi i tregjeve ndërkombëtare të kapitalit, si dhe globalizimi gjithnjë e më shumë i ekonomisë botërore që solli nevojën në rritje të shoqërive për të kërkuar kapital jashtë tregjeve tradicionale të vendeve të tyre. Shoqëritë filluan të drejtoheshin në tregje të huaja ku hyrja kushtëzohej nga rregullat e caktuara nga organet mbikqyrëse të këtyre tregjeve për ndërtimin e pasqyrave financiare.

**Fjalët çelës: lizing-u financiar, kapital, tregje ndërkombëtare.**

## **HYRJE**

Mjedisi për zhvillimin e lizingut në Shqipëri mori një hov të madh pozitiv më së fundi me miratimin e Ligjit për Lizingun Financiar nga Parlamenti Shqipëtar në 12 maj të 2005-ës. Ky ligj siguron përkufizime të kësaj qeraje dhe të palëve që marrin pjesë, si dhe vendos kushte dhe kritere për kompanitë e angazhuara në lizingun financiar. Qeraja operative ishte tashmë prezente në treg përpara Majit 2005, bazuar në Ligjin Tregtar. Me aplikimin e këtij ligji specialistët shpresojnë për një rritje të Produktit të Brendshëm Bruto dhe të nivelit të punësimit.

Drafti përfundimtar i miratuar, që ka ardhur pas ridiskutimeve që janë kërkuar nga Këshilli Konsultativ i Biznesit, do të vijë në ndihmë të financimeve afatgjata të cilat mungojnë në vendin tonë. Ministria e Ekonomisë në bashkëpunim shumë të ngushtë me SEED (Southeast Europe Enterprise Development), dhe ekspertizën ligjore ka punuar me intensitet në ripunimin e ligjit duke marrë në konsideratë të gjitha vërejtjet e bëra si nga Këshilli i Biznesit edhe nga ministritë dhe institucionet e tjera. Lidhur me rëndësinë e kontratave të lizingut financiar duhet theksuar se në kushtet aktuale të vendit tone, krahas zhvillimit të biznesit në tërësi dhe kontributit të sistemit bankar, vërehet një mungesë financimesh afatgjata dhe kjo në veçanti për SME-të, ku akses i tyre në bankë është i kufizuar, me interesa të larta dhe hua afatshkurtra. Ligji i miratuar nga Parlamenti Shqipëtar autorizon krijimin e kompanive të pavarura dhe vendos standarde të qarta dhe transparente për sigurimin e pajisjeve për kompanitë lokale.

Legjislacioni pritet të plotësojë boshllëkun e një financimi të rëndësishëm për SME-të, të cilat shpesh kërkojnë pajisje të reja për veprimtarinë e tyre por që nuk mund të sigurojnë hua nga bankat lokale për blerjen e tyre. Meqenëse kompanitë e lizingut do të kenë pronësinë ligjore të aktiveve që do të japin me qera, ato do të jenë në gjendje të tejkalojnë këtë pengesë duke kualifikuar SME-të bazuar në flukset e arkes së gjeneruar, më tepër sesa bazuar mbi historikun e kreditit të tyre, kolateralit apo të kapitalit të kërkuar nga bankat. Rezultati pritet të jetë një shenjë pozitive për sektorin lokal të biznesit të vogël, pika kyçe për krijimin e punës në ekonominë në zhvillim dhe në tranzicion.

### **1.1. Ligji për lizing-un Financiar dhe kushtet e kontratës**

Një nga çelsat kyç që promovon zhvillimin e lizingut në të gjitha vendet, është ekzistenca e një kuadri transparent dhe efektiv ligjor, i cili rregullon marrëdhëniet midis palëve në një marrëveshje lizingu.

Është shumë e rëndësishme që legjislacioni të përcaktojë qartë se çfarë përbën një transaksion apo marrëveshje lizingu, të ofrojë një listë të barabartë të drejtash dhe detyrimesh ndërmjet palëve dhe të vendosë një mekanizëm eficient të rizotërimit të aseteve të dhëna me qira.

Ligji përfaqëson një hap të rëndësishëm përpara në favor të zhvillimit të këtij sektori, meqenëse ai ul pasigurinë duke ofruar përkufizime standarte të qirasë financiare dhe përcakton qartë rolin e palëve të përfshira në këtë kontratë. Gjithashtu, Ligji përcakton kriteret e subjekteve që do të ofrojnë shërbime lizingu. Përveç kësaj, mund të jetë e nevojshme që të përmirësohen kapacitetet rregullatore dhe mbikëqyrëse me qëllim që rreziqet e mundshme që paraqet rritja e përdorimit të qirasë financiare, të monitorohen në mënyrë të përshtatshme dhe që instrumentet të përdoren siç duhet.

Ligji Për Lizing-un Financiar numër 9196, miratuar dt 12 maj 2005 përmban përkufizime në terma ligjorë si:

- Akti i Pranimi
- Transaksioni i Lizing-ut Financiar
- Marrëveshja e Lizing-ut
- Afati dhe kësti i Lizing-ut
- Lizingdhënësi dhe Lizingmarrësi
- Objekti i Lizing-ut
- Akti i Riposedimit
- Furnizuesi dhe Kontrata e Furnizimit

Ligji lejon ndërthurje të roleve të Furnizuesit dhe Lizingmarrësit (në transaksionet Sale-and-lease-back) dhe në këtë rast Lizingdhënësi nuk është përgjegjës për dorëzimin e Objektivit të Lizingut. Lizingmarrësi ka të drejtë të zgjedhë Objektivin e Lizingut dhe Furnizuesin nëse ka, pa u mbështetur në gjykimin e Lizingdhënësit. Në rast se marrëveshja parashikon që ky i fundit të zgjedhë Furnizuesin dhe Objektivin, ai ka përgjegjësi të plotë për Furnizuesin dhe për dorëzimin e Objektivit të Lizingut.

## **1.2. Kushtet e Marrëveshjes së Lizingut Financiar**

### **Çfarë është një marrëveshje Lizingu?**

Lizingu financiar është një marrëveshje, kryesisht ndërmjet tre palëve: qiradhënësit (shoqëria e lizingut), qiramarrësit (në rastin tonë biznesi - lizingmarrësi) dhe furnitorit, ku lizingdhënësi, person juridik fiton dhe mban të drejtën e pronësisë mbi Objektivin e Lizingut dhe i transferon Lizingmarrësit person juridik ose individ të drejtën ta përdorë atë gjatë afatit të Lizingut-periudha e kohës e përcaktuar në Marrëveshjen e Lizingut, në këmbim të Këstit të Lizingut.

Forma e Marrëveshjes së Lizingut, pavarësisht nga afati i saj, lidhet me shkrim. Do të vërtetohet nga noteri në rastet kur :

- Objekti i Lizingut është pasuri, transaksionet me të cilën kërkojnë vërtetim noterial;

- Me kërkesë të njëres palë;

- Kur palët përfshijnë Aktin e Rizotërimit si pjesë të Marrëveshjes për të siguruar riposëdim jashtëgjyqësor në rast mospërbushje detyrimi.

- Çdo marrëveshje Lizingu mund të deklarohet e pavlefshme nga gjykata kompetente në rast se nuk përfshin ndonjë nga pikat e mëposhtme në lidhje me Objektivin e Lizingut:

Përshtkrimin e Objektivit të Lizingut me të gjitha karakteristikat që lejojnë identifikimin e tij;

Kohëzgjatjen e Afatit të Lizing-ut;

Numrin dhe shumën e kësteve të Lizing-ut ose një formulë për llogaritjen e tyre si dhe kriteret për rregullimin e tyre;

Marrëveshjen në fund të afatit për të përtërirë Marrëveshjen e Lizing-ut, për të kthyer Objektin ose për të blerë Objektin nga Lizingmarrësi;

Çmimin e rënë dakort në rast se Lizingmarrësi ka zgjedhur të blejë Objektin si dhe kriteret e përcaktimit të tij;

Përcaktimin e një pale që do të marrë përsipër detyrimin të paguajë shpenzimet e përgjithshme dhe të funksionimit, përfshirë shpenzimet teknike, të mirëmbajtjes dhe shërbimeve ndihmëse që lidhen me funksionimin e Objektit të Lizing-ut;

Përgjegjësitë e tjera që lindin nga;

-përdorimi i papërshtatshëm dhe jo në kohën e duhur të Objektit;

-sigurimi ndaj rreziqeve i Objektit;

-dëmtimet e shkaktuara palëve të treta nga përdorimi i Objektit;

-përgjegjësitë që burojnë nga defektet

Kushtet dhe afatet e shitjes së Objektit, ndarja e të ardhurave nga shitja dhe metoda e llogaritjes së dëmeve të Lizingdhënësit në rast zgjidhjeje të parakohshme të Marrëveshjes dhe riposedimit të Objektit.

Neni 15 i Ligjit përcakton lidhjen e një marrëveshjeje shoqëruese detyruese për përmbushjen e detyrimeve sipas Marrëveshjes. Kjo mund të përfshijë Kontratën e Furnizimit, çdo marrëveshje kredie, marrëveshje kolaterale, marrëveshje garancie, transporti dhe marrëveshje të tjera shërbimesh shtesë.

### **1.2.1. Të drejtat dhe detyrimet e palëve në një transaksion Lizing-u Financiar**

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 9196, “Për qiranë financiare”, i cili përcakton se veprimtaria e qirasë financiare rregullohet si veprimtari e veçantë dhe që mund të kryhet si nga bankat dhe institucionet financiare ashtu dhe nga shoqëritë e tjera tregtare, trajtohen të drejtat dhe detyrimet e palëve në kontratën përkatëse dhe rregullohen marrëdhëniet që lindin nga dhënia me qira financiare e sendeve, të luajtshme e të paluajtshme si dhe kërkesa për kapitalin minimal të kërkuar prej 20 milionë lekësh. Bazuar në nenet 16-17-të këtij ligji:

#### **Të drejtat dhe detyrimet e Lizingdhënësit janë:**

-Lizingdhënësi ka të drejtë të ushtrojë kontroll për kushtet e mirëmbajtjes dhe përdorimin e duhur të Objektit të Lizing-ut nga Lizingmarrësi , në përputhje me Marrëveshjen e Lizing-ut;

-Lizingdhënësi ka të drejtë të kontrollojë dokumentet financiare të Lizingmarrësit gjatë gjithë afatit të lizing-ut, në përputhje me Marrëveshjen;

-Lizingdhënësi është i detyruar të garantojë një të drejtë të pakufizuar përdorimi dhe posedimi të objektit nga Lizingmarrësi;

-Lizingdhënësi ka detyrimin të dorëzojë Objektin, nëse marrëveshja nuk e përcakton se dorëzimi duhet të bëhet dhe nga furnizuesi;

-Me pranimin e objektit, detyrimet e lizingdhënësit, në lidhje me objektin dhe pretendimet e të tretëve pushojnë me përjashtim të pretendimeve, që rrjedhin nga veprimet ose mosveprimet e lizingdhënësit.

-Ai mund të ketë të drejta dhe detyrime të tjera që burojnë nga dispozitat e këtij Ligji, akte të tjera ligjore dhe Marrëveshja e Lizing-ut.

**Të drejtat dhe detyrimet e Lizingmarrësit janë:**

-Lizingmarrësi ka të drejtën e përzgjedhjes së objektit, si edhe të furnizuesit, kur ka të tillë.

-Lizingmarrësi duhet të vendosë nëse Objekti i dorëzuar i Lizing-ut është në përputhje me Marrëveshjen e Lizing-ut.

-Lizingmarrësi ka të drejtë të refuzojë Objektin dhe të zgjidhë Marrëveshjen e Lizing-ut në qoftë se Objekti nuk është në përputhje me marrëveshjen.

-Lizingmarrësi nënshkruan Aktin e Pranimi nëse Objekti është në përputhje me kushtet dhe afatet e Marrëveshjes së Lizing-ut.

-Lizingmarrësi ka të drejtë t'u japë me nënqira financiare të tretëve tërë objektin ose pjesë të tij vetëm me pëlqimin me shkrim të lizingdhënësit.

-Në rast se lizingmarrësi lidh marrëveshje nënqiraje pa pëlqimin e lizingdhënësit, ky i fundit ka të drejtë ta zgjidhë marrëveshjen e Lizing-ut dhe të kërkojë dhe dëmshpërblim.

-Lizingmarrësi është i detyruar të përdorë dhe të mirëmbajë në mënyrën e duhur Objektin e Lizing-ut dhe të përballojë kostot e kësaj mirëmbajtjeje në rastet kur nuk parashikohet ndryshe në marrëveshjen e Lizing-ut.

-Lizingmarrësi përgjigjet për humbjet e shkaktuara nga përdorimi i Objektit në kundërshtim me marrëveshjen ose në kundërshtim me qëllimin e qirasë, pavarësisht nëse e ka përdorur vetë, një person i autorizuar prej tij apo një person tjetër, me miratimin e mëvonshëm të tij.

-Ai mund të ketë të drejta dhe detyrime të tjera që burojnë nga dispozitat e këtij ligji, akte ligjore dhe nga Marrëveshja e Lizing-ut.

### **1.2.2. Sigurimi i marrëveshjes së lizingut financiar**

Marrëveshja e lizingut duhet të parashikojë sigurimin e objektit nga çdo lloj dëmtimi, që ka lidhje me rrezikun e shkatërrimit, humbjes, vjedhjes, prishjes ose vjetërsimit të parakohshëm. Në mungesë të parashikimeve në marrëveshje detyrimi për sigurimin e objektit rëndon mbi qiramarrësin.

### **1.3. Kushtet e falimentimit të dy palëve të kontratës**

Në rast deklarimi të Lizingmarrësit të falimentuar ose në paaftësi paguese, Objekti i Lizing-ut nuk do të përfshihet në masën dhe fondet e falimentimit, si dhe as në garancinë e përgjithshme për kreditorët. Objekti i Lizing-ut do t'i kthehet Lizingdhënësit. Megjithatë, administratori i falimentimit mund të njoftojë Lizingdhënësin, brenda tridhjetë ditëve nga nxjerrja e vendimit të gjykatës që shpall falimentimin, lidhur me dëshirën e tij për të vazhduar Marrëveshjen e Lizingut. Kjo do të mundësonte shtimin e fondit të pasurisë së vënë gjatë procedurës së falimentimit. Në këtë rast Marrëveshja do të vazhdojë të ekzistojë, pra të zbatohet, me kusht që kështu e Lizing-ut të jenë paguar në përputhje me kushtet e Marrëveshjes.

Në rast procedurash likuidimi të Lizingmarrësit, kur ai është person juridik, pavarësisht nëse likuidimi është i detyrueshëm apo vullnetar, (me përjashtim të rastit kur ai ndodh si rezultat i bashkimit, dhe pa paragjykuar të drejtat e Lizingdhënësit të parashikuara në Marrëveshje), Objekti i Lizing-ut i kthehet lizingdhënësit.

Në rast se Lizingdhënësi ndodhet në paaftësi paguese ose deklaron falimentim, Lizingmarrësi ka të drejtë të vazhdojë Marrëveshjen e Lizing-ut. Edhe në rast procedurash likuidimi, me përjashtim të rastit kur ai ndodh si rezultat i bashkimit, Lizingmarrësi ka të drejtë të vazhdojë Marrëveshjen e Lizing-ut me pronarin e ri të Objektit të Lizing-ut ose të ripaguajë shumën e pashlyer të Kësteve dhe të fitojë pronësinë mbi Objektin, në rast se marrëveshja parashikon transferimin e pronësisë.

#### **1.4. Hapi i parë i një shoqërie lizing-u në Shqipëri**

Lizingu njihet si një formë e rëndësishme financimi që është duke u zgjeruar vazhdimisht jo vetëm në vendet e zhvilluara por dhe në vendet në zhvillim. (Gao and Herbert 1996; LFG 1996; Lowe et al. 1980; Mc Adam 1988; Myeers 1964). Para viteve '50 lizingu ishte më shumë i përdorur në investimet që kishin të bënin me pasuri të paluajtëshme. Ndërkohë që sot, është shumë e lehtë që të marrësh me qira çdo lloj aktivi fiks. Në 1984 rreth 20% e kapitalit të paisjeve të reja kërkuar nga bizneset në Shtete të Bashkuara të Amerikës financoheshin nëpërmjet marrëveshjeve të Lizingut. Aktualisht, lizingu në të gjithë botën është forma më e përhapur e financimit krahasuar me kreditë bankare, bondet. Anderson (1980) vlerëson se gjatë fundit të viteve 1980, rreth 20% e blerjeve të reja të kapitalit në Amerikë, financoheshin nga Lizingu. Në fundin e viteve '90, lizingu përbënte 1/8 e kërkesave në të gjithë botën për financim sidomos në makineri. Në 2004, lizingu financiar ishte mënyra më e shpejtë dhe në rritje e financimit të të gjitha llojeve të aktiveve fikse në të gjithë botën. Kjo formë financimi u rrit në 26% duke numëruar 580 bilionë dollarë. Vetëm pjesa e Shteteve të Bashkuara numëron rreth 241 bilionë dollarë . duke shtuar se 15% e aktiveve fikse blerë nga 500 kompanitë më të mëdha në Amerikë në 2004, ishin financim i marrëveshjeve të Lizingut. (Al Rai 2007).

Opsionet e financimit për bizneset e vogla në Shqipëri janë përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme nëpërmjet miratimit të Ligjit mbi Linzing-un. Lizingu si fenomen në Shqipëri është ende në hapat e parë. Që në fillim të 2005-ës, dy kompani lizingu që ushtrojnë aktivitetin e qiradhënies financiare filluan punimet në vend, një e zotëruar nga Banka Greke e Pireut, "Tirana Leasing", dhe tjetra e zotëruar nga përfaqësues lokalë të prodhuesve të pajisjeve gjermane, "Landeslease". Lizingu në një shkallë të konsiderueshme është zhvilluar edhe në dy kompani të tjera, importuese automjesh që nënshkruajnë kontrata lizingu për automjete me klientë të tipit korporatë. Pritet që të paktën dy kompani të tjera filiale të bankave të vijnë në tregun shqipëtar në të ardhmen e afërt.

Aktualisht, në Shqipëri qiraja financiare kufizohet kryesisht të pajisjet e transportit. Në krahasim me makineritë, pajisjet e transportit janë në mënyrë të veçantë të përshtatshme për të aplikuar qiranë financiare, meqenëse vlera e

tyre e mbetur është relativisht e lehtë për t'u vlerësuar dhe ekziston një treg i konsiderueshëm dytësor. Kështu, veprimtaria e qirasë financiare në Shqipëri kufizohet kryesisht në këtë lloj aset. Me zhvillimin e tregut, pritet që subjektet e lizingut t'i shtrijnë shërbimet e lizingut te makineritë e prodhimt dhe pasuritë e paluajtshme.

Shoqëria “Tirana Leasing”, aktualisht fokuson veprimtarinë e saj, siç është përmendur dhe më lart vetëm në mjetet e transporti, por së shpejti pritet që të zgjerohet edhe në objekte të tjera si makineri dhe pajisje të nevojshme për bizneset apo edhe ndërtesa për nevojat e konsumatorëve. Tirana Leasing u krijua në nëntor të vitit 2004, si kërkesë e tregut për më shumë mundësi kreditimi. Specialistët e kësaj kompanie theksojnë se paraqiten vështirësi në plotësimin e kuadrit tatimor: si do të trajtohet çështja e TVSH-së për këtë aktivitet; a do të zbatohet TVSH mbi interesin që do të aplikojë kompania qiradhënëse (meqenëse është veprimtari financiar-“kredi pa garanci shtesë”). Në “Tirana Leasing” nuk ka një shumë limit për dhënien e qirasë financiare, por pasi bëhet analiza financiare, e cila përcakton edhe aftësinë paguese të subjekteve që aplikojnë për qira, përcaktohet shuma që do të jepet. Deri tani në këtë kompani për financim janë drejtuar biznese të mëdha, biznese të mesme dhe individë të ndryshëm.

Duke qënë se transaksioni i Lizingut financiar përmban elementë të qirasë, kredisë, shitjes, shitjes me kontratë, shitjeve të shtyra në kohë ai mund të konsiderohet disi i komplikuar. Duke qënë për më tepër dhe një fenomen shumë i ri në Shqipëri, patjetër që do të kërkojë krijimin e një strukture të duhur rregulluese. Besimi i aksionerëve në suksesin e kësaj alternative të re do të mund të shtohet vetëm nga krijimi i një baze të fuqishme legjislative për zhvillimin e transaksioneve financiare, bazë kjo që do të sigurojë edhe mbrojtjen e të drejtave të të gjitha palëve pjesëmarrëse në këto marrëveshje si dhe do të krijojë kushte më të mira për zbatimin e tyre.

### **1.5. SEED dhe projekti për ndihmë për financimin e SME-ve**

Cilësuar nga menaxherët e projektit të lizingut nga SEED, duke parë zhvillimin e përshpejtuar të lizingut financiar në vendet e tjera në tranzicion, projektet për Shqipërinë po e vënë tregun e lizingut në vlera mbi 100 milion euro deri në 2008-ën,. Në Serbi janë ngritur 6 shoqëri, të cilat qarkullojnë rreth 50 milionë euro në vit. Ndërkohë në Europë qarkullohen rreth 200 miliardë euro në vit me këtë mënyrë financimi. Në nivel botëror, industria globale e lizingut mbulon më shumë se një të katërtën e të gjithë financimit të blerjes së pajisjeve, me mbi 40 miliardë dollarë në vit.

Zhvillimi i legjislacionit ishte vetëm një nga komponentët e asistencës së përgjithshme të SEED-it në prezantimin e lizingun. SEED (Southeast Europe Enterprise Development, projekt i IFC-së (International Finance Corporation) nga Banka Botërore, jo vetëm ka ofruar konsultime financiare por ka ndihmuar bizneset në rajon të njohin burimet dhe programet që duhen zhvilluar, të zgjedhin anëtarët dhe investitorët, të bëjnë studime të qëndrueshme e të plota si dhe ka ofruar suport në implementimin. Paraprakisht adoptimit të Ligjit për Lizingun, SEED ka organizuar trajnime dhe seminare për institucionet financiare dhe për SME-të të shoqëruar me një program kombëtar informues. Ligji i ri “Për qiranë financiare“, sipas SEED, do të mund të ofrojë mundësi investimi për IFC të zgjerojë aktivitetin e kompanive të lizingut.

### **1.6. Lejimi i liçensimit të shoqërive qiradhënëse**

Të gjitha bankat dhe institucionet financiare që duan të kryejnë shërbimin e qirasë financiare, liçensohen dhe mbikqyren nga Banka e Shqipërisë, ndërsa shoqëritë tregtare, që kërkojnë të kryejnë vetëm veprimtarinë e qirasë financiare, e fitojnë këtë të drejtë në mbështetje të ligjit “Për qiranë financiare”. Kjo nënkupton se këto subjekte tregtare do të zbatojnë ligjin “Për qiranë financiare” dhe aktet nënligjore të nxjerra nga Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Financave në zbatim të këtij ligji. Banka e Shqipërisë, ka miratuar disa ndryshime në rregulloren “Për liçensimin e subjekteve jobanka”. Këto ndryshime, sipas BSH-së, lidhen me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 9196, datë 12.05.2005 “Për qiranë financiare”, i cili përcakton se veprimtaria e qirasë financiare rregullohet si veprimtari e veçantë dhe që mund

të kryhet si nga bankat dhe institucionet financiare ashtu dhe nga shoqëritë e tjera tregtare. Ky ligj trajton qiranë financiare, të drejtat dhe detyrimet e palëve në kontratën përkatëse dhe rregullon marrëdhëniet që lindin nga dhënia me qira financiare e sendeve, të luajtshme e të paluajtshme si dhe kërkesën për kapitalin minimal të kërkuar prej 20 milionë lekësh. Ndërkohë që, në rregulloren e Bankës së Shqipërisë “Për liçensimin e subjekteve jobanka”, aktiviteti i qirasë financiare përfshihet në aktivitetet që kryejnë subjektet jobanka dhe përveç të tjerave, kërkesa për kapitalin minimal për fillimin e aktivitetit është 100 milionë lekë.

### **1.7.Veçori të trajtimit fiskal**

Përveç kornizës së qartë ligjore për lizingun, trajtimi fiskal i lizingut në Shqipëri mbetet i paqartë në veçanti përsa i përket TVSH-së, e cila është një formë e re taksimi në Shqipëri që nuk është kuptuar ende shumë mirë. Ndërsa një TVSH prej 20% është normale të aplikohet kur importohen pajisje apo kur bëhen pagesat e një qiraje operative, ka një numër të madh përjashtimesh nga TVSH-ja apo shtyrjesh të mundshme për kategori të ndryshme të importeve të pajisjeve, rrethana ku, në disa mund të aplikohet kur merret me qira, dhe të tjera kur nuk aplikohet. Gjithashtu TVSH-ja në lizingun financiar është një situatë që duhet të qartësohet, pasi rregullimi tatimor që daton përpara majit të 2005-ës duket se aplikon TVSH-në mbi interesin në qiratë financiare, edhe pse Lizing-u Financiar është i përkufizueshëm si një shërbim financiar që përjashtohet nga TVSH-ja mbi interesin. Është gjithashtu e paqartë sesi procedurat mbi rimbursimin e tejkalimit të TVSH-së do të funksionojnë në praktikë.

Në parim, qiraja e pasurisë së paluajtshme është e përjashtuar nga TVSH-ja. Megjithatë shumë shtete zvogëlojnë ose edhe eliminojnë tërësisht efektin kumulativ të mundshëm të kësaj arritjeje duke u lejuar qiradhënësve të zgjedhin regjistrimin dhe pagesën e TVSH-së (duke i trajtuar në mënyrë të barabartë me taksapaguesit e tjerë: kreditim tërësor për taksën në fillim dhe pagesë takse në pagesat e qirasë), duke patur parasysh që edhe qiramarrësi është taksapagues i regjistruar (që do të thotë që ata do të mund të kreditohen për taksën në pagesat e qirasë) ose bien dakort të bëhen taksapagues të regjistruar. Kjo masë e marrë lë jashtë përjashtimit efektin goditës kaskadë. Në praktikë, kjo arritje e taksimit opsional përjashtues, i jep një mundësi

zgjedhjeje qiradhënësit; i cili patjetër do të shohë drejt pagesës më pak të kushtueshme të taksës, por njëkohësisht duhet edhe të mbajë parasysh se zgjedhja është e pakthyeshme. Në Belgjikë, Francë dhe Itali qiradhënësit e pasurive të paluajtshme tregtare janë gjithmonë të taksueshëm referuar si qirasë edhe shitjes së një pasurie të tillë (Lizing-u Financiar). Shtetet që përjashtojnë qiranë e pasurive të paluajtshme dhe të shërbimit të strehimit, gjithsesi taksojnë akomodimin hotelier, si dhe qiranë e vendeve të parkimit dhe fushave të kampingut.

### KONKLuzion

Karakteristika kryesore e lizing-ut është ndarja e pronësisë nga përdorimi i aktivitetit, në veprimtari ligjore dhe ekonomike. Një marrëveshje qiraje financiare varet më shumë nga përmbajtja ekonomike e transaksionit se sa nga forma ligjore e kontratës. Marrëveshjet e qirasë që plotësojnë kriteret e një qiraje financiare, do të njihen në pasqyrat financiare si qira financiare, pavarësisht nga fakti që nga ana ligjore ose formale ato mund të konsiderohen si marrëveshje të një qiraje.

Kushtet më të përshtatshme që ofron Lizing-u Financiar krahasuar me huamarrjen apo blerjen e aktiveve të kapitalit, si dhe tatimi më i favorshëm bëjnë që lizing-u të kthehet në mjetin financiar më tërheqës për shoqëritë e lizingut për biznesin e tyre.

Në ekonominë në zhvillim shpesh herë është mënyra e vetme e financimit për njësitë me pamundësi financiare për të paguar menjëherë koston e blerjes së aktivitetit. Qiramarrësi mund të rrisë kapacitetin prodhues të tij pa kërkesa kolaterale siç do të ndodhte me një hua bankare. Ndërkohë edhe qiradhënësi ka një risk më të ulët në financimin e bizneseve, sepse mban pronësinë mbi aktivin derisa të shlyhet tërësisht detyrimi.

Duke qënë se në Europën Lindore dhe atë Qëndrore, Lizing-u konsiderohet gjerësisht si alternativa më e favorshme për financimin e investimeve duhet të prezantohet gradualisht edhe në tregun shqiptar pranë SME-ve të cilat ndodhen në vështirësi financiare dhe pamundësi investimi në blerje të aktiveve afatgjata.

Lizing-u me anë të fluksit në rritje të financimit të sektorit prodhues të ekonomisë, rritjes së prodhimit vendas dhe përmirësimin e mundësive për financimin e biznesit, lehtëson zhvillimin ekonomik të vendit tonë dhe nis një rrugë drejt integritetit evropian.

Për t'u përballur në këtë rrugë aplikimi i IFRS-ve në vendin tonë përbën një sfidë tjetër. Reformat e parashikuara për t'u zhvilluar në Shqipëri në fushën e kontabilitetit lidhen pikërisht me përmirësimin e rregullimeve kontabël me qëllim rritjen e transparencës dhe të besueshmërisë së informacionit financiar si dhe për t'iu përgjigjur sa më mirë nevojave të tregut dhe për mbrojtjen e interesave të publikut dhe të shtetit.

Adaptimi i Standarteve ndërkombëtare do të ishte një arritje shumë e madhe për Shqipërinë, në kushtet kur në vend ka mangësi në njohuri, kompleksitet të strukturimit të standardeve si dhe për shkak të organizimit shtetëror, ndikimit fiskal, trashëgimisë kulturore në fushën e kontabilitetit, si dhe nivelit të zhvillimit ekonomik, do të ishte më i lehtë hartimi dhe aplikimi në praktikë i Standardeve Kombëtare.

Analizimi i lizing-ut si zgjedhje financimi mund të bëhet vetëm pasi flukset e arkës të projektit të investimit vetë të dëshmojë që do ti shtojë me të vërtetë vlerë kompanisë. Vetëm atëherë, lizing-u mund të konsiderohet siç duhet tërësisht si formë financimi. Zgjedhja e dhënies së aktivitetit me qira financiare ndaj asaj operative nga ana e qiradhënësit mund të ndodhë për pajisje që dëmtohen lehtësisht nga përdorimi i pakujdesshëm. Pronari e di që për përdoruesit afatshkurtër është e pamundur të tregojnë të njëjtin kujdes për pajisjen si për pajisjet në pronësi të tyre. Kur rreziku i abuzimit bëhet shumë i madh, tregu i qirasë afatshkurtër nuk mbijeton dot; ka vend vetëm lizing-u financiar si financim afatgjatë.

Një nga anët negative të Lizing-ut Financiar ishte fakti i mosnjohjes si i tillë në bilanc vetëm për arsye të mosplotësimit të kushteve të përkufizimit të Lizing-ut në kufi me vlerat e përcaktuara, për ta diferencuar atë nga Lizing-u Operativ. Shumë menaxherë të firmave mund të marrin një aktiv, ta financojnë me lizing financiar, e të mos pasqyrojë as aktivin dhe as kontratën e qirasë në bilancin e vet. Firma përfiton financim jashtë bilanci dhe masat konvencionale të levës financiare, si raporti borxh/mjete, etj, sjellin

nënvlerësimin e shkallës së vërtetë të levës. Ndërkohë që detyrimet afatgjata të Lizing-ut, duhet të njihen si detyrim, shfaqen apo nuk shfaqen në bilanc.

Përsa i përket kontabilizimit, kontabiliteti për transaksionet e lizing-ut është një nga shembujt më të mirë të zbatimit të parimit të substancës apo thelbit mbi formën, sikurse përcaktohet në kuadrin për përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare të IASB-së. Që informacioni të jetë i besueshëm, të paraqesë saktë dhe me vërtetësi ngjarjet, në rastin e qirasë financiare, ku transaksioni e “transferon” efektivisht pronësinë tek qiramarrësi, substanca e transaksionit është ajo e një shitjeje dhe duhet të kontabilizohet si e tillë edhe pse ka formën e qirasë.

Shpenzimet e amortizimit për mjetet e dhëna me lizing si dhe shpenzimet financiare llogariten për çdo periudhë ushtrimore. Normat e amortizimit të përdorura për amortizimin e mjeteve të marra me qira janë të njëjta me ato që përdoren për mjetet e tjera të njësisë ekonomike. Pasiguria e qiramarrësit për të marrë mjetin nën pronësinë e tij në fund të afatit të qirasë, sjell amortizimin e tij përgjatë afatit të qirasë.

Përfshirja e një kompanie lizing-u në këtë lloj qiraje, që do të thotë ndryshimi i qëllimit të veprimtarisë së qiradhënësit, është përcaktues i kontabilizimit vetëm të një lloj të ardhureje, të ardhurave nga interesat, dhe jo të fitim / humbjes nga diferenca e çmimit të shitjes dhe kostos së prodhimit apo blerjes së aktivit.

Në Shqipëri, lidhur me rëndësinë e kontratave të lizingut financiar duhet theksuar se në kushtet aktuale të vendit tonë, krahas zhvillimit të biznesit në tërësi dhe kontributit të sistemit bankar, vërehet një mungesë financimesh afatgjata dhe kjo në veçanti për SME-të, ku akses i tyre në bankë është i kufizuar, me interesa të larta, hua afatshkurtra dhe me kolateral të paimagjinueshëm. Legjislacioni i ri i vendosur pritet të plotësojë boshllëkun e një financimi të rëndësishëm për SME-të, të cilat shpesh kërkojnë pajisje të reja për veprimtarinë e tyre por që nuk mund të sigurojnë hua nga bankat lokale për blerjen e tyre.

-Zhvillimi i legjislacionit është vetëm një nga komponentët e asistencës së përgjithshme të SEED-it në prezantimin e lizingun. SEED

(Southeast Europe Enterprise Development, projekt i IFC-së (International Finance Corporation) nga Banka Botërore, jo vetëm ka ofruar konsultime financiare por ka ndihmuar bizneset në rajon të njohin burimet dhe programet që duhen zhvilluar, të zgjedhin anëtarët dhe investitorët, si dhe të bëjnë studime të qëndrueshme e të plota.

Trajtimi fiskal i lizingut në Shqipëri mbetet i paqartë në veçanti përsa i përket TVSH-së. TVSH-ja në lizingun financiar është një situatë që duhet të qartësohet, pasi rregullimi tatimor që daton përpara majit të 2005-ës duket se aplikon TVSH mbi interesin në qiratë financiare, edhe pse është shërbim financiar.

Përzgjedhja e pajisjes së duhur është shumë e rëndësishme për biznesin, dhe si të financohet ajo pajisje është një vendim po aq i rëndësishëm. Lizing-u ofron fleksibilitet klientëve duke u mundësuar atyre zgjedhjen më të mirë midis alternativave të financimeve.

Gjithashtu vlen për tu theksuar se mungesa e vetëdijes nga ana e kompanive dhe stimujt e kufizuar për të nxitur bankat që të përfshijnë produkte të reja, gjithashtu, kufizon mundësitë e qirasë financiare në Shqipëri. Përveç problemit të trajtimit të paqartë financiar të kontratave për qiranë financiare, duket se ka faktorë të tjerë që e kufizojnë rritjen e industrisë së lizingut në Shqipëri. Koncepti i qirasë financiare është relativisht i ri për Shqipërinë dhe do të duhet të bëhen përpjekje të konsiderueshme për të rritur sensibilizimin e tregut. Në të njëjtën kohë, bankave shqiptare u mungon ekspertiza lidhur me këto produkte dhe mungesa e përvojës ndërlikon çështjet e vënies së çmimeve dhe të sekuestros. Për më tepër, stimujt për të nxitur bankat që të krijojnë produktet dhe ekspertizën e nevojshme janë shumë të kufizuara, duke patur parasysh faktin se kërkesa e paplotësuar për kredi lejon shtrirjen e shpejtë të operacioneve në segmente më tradicionale.

Së fundi, sipas studimit që ka bërë Korporata Ndërkombëtare e Financave, tregu dytësor i aseteve, për të cilat është ofruar qira financiare, është i pazhvilluar, duke ndikuar në këtë mënyrë tek mëkëmbja e parashikuar në rast mosplotësimi.

### **Literatura**

## The Heritage

- Prof.As.Dr Dhomo.S “Kontabiliteti i avancuar” , Tiranë
- Standardi Kombëtar nr.7
- Ligji mbi Lizing-un financiar, 12 Maj 2005
- James C.Van Horne, “Financial Management and Policy”, Twelfth Edition, Ch 18 -Lease Financing,
- Brealey, Myers, “Principles of Corporate Finance”, Ch 26-Leasing,
- Revista “IEKA” nr.4 dhe nr.7
- Material për seminarin e trajnimit nga SEED dhe IFC “Qiraja Financiare si produkt financiar”, 14 Prill 2005
- Revista “ADVANTAGE”, botimi nr 9, Maj 2006, Dhoma Amerikane e Tregtisë.
- Gazeta “Biznesi” prill 2006.
- Williamson, O.E (1998), “Corporate Finance and Corporate Governance,” Journal of Finance, 43, PP.41-47.
- Stulz, R.M; and Johnson.H (1985), “An analysis of Secured Debt”, Journal of Financial Economics, PP.501-521.
- Ross. L; and Stephen.C (2001), “The Leasing Industry’s Legal Environment Improves”, Jan-Feb, PP.48-51.
- Schallheim, J.S; R.E; Johnson, R.C; Lease, and McConnell (1987), “The Determinants of Yields on Financial Leasing Contracts”, PP.46-67.
- Merhan, Hamed; R.A; Taggart, and Yermack.D (1999), “CEO Ownership, Leasing, and Debt Financing”, Financial Management, 28, PP.5-14.
- Miller, M.H; and C.W.Upton (1976), “Leasing, Buying and Cost of Capital Services”, Journal of Finance, PP.761-786.

**Iliriana Rajta, M.Sc**

[ilirianarajta@gmail.com](mailto:ilirianarajta@gmail.com)

## **KËNAQËSIA NË PUNË DHE ANAGAZHIMI ORGANIZACIONAL**

### **ABSTRAKTI**

Koncepti i kënaqësisë në punë dhe ai i angazhimit organizacional kanë qenë objekt i studimeve të ndryshme sidomos dhjetë vjeçarin e fundit. Për sa i përket zhvillimit historik të tyre si koncepte, mund të thuhet se vetëm kënaqësia në punë ka qenë studiuar, ndërsa angazhimi organizacional është studiuar mëvetësisht kryesisht pas viteve 90. Për të hetuar lidhjen që ekziston midis konceptit të kënaqësisë në punë dhe angazhimit organizacional brenda kontekstit të organizatës CCCI në Tiranë, u ndërmorr ky studim.

Hipoteza mbi të cilin është ngritur ky studim është se ekziston një korrelacion pozitiv midis kënaqësisë në punë dhe angazhimit organizacional. Kampioni përbëhet nga 60 punonjës të organizatës (N=60) në filialin e Tiranës dhe informacioni u mbledh përmes dy pyetësorëve të cilët masin secilin prej variablave.

Hipoteza e ngritur në fillim të punimit u vërtetua, pra ekziston një marrëdhënie korrelacionale pozitive ndërmjet kënaqësisë në punë dhe angazhimit organizacional. Megjithëse e rëndësishme nga pikëpamje statistikore ( $r=0.42$ ,  $p<0.01$ ), kjo marrëdhënie nuk është shumë e fortë.

Gjithashtu nga rezultatet e ANOVA dhe Krostabulimeve të variablave u pa që nuk ekzistojnë ndryshime statistikisht të rëndësishme ndërmjet gjinive në nivelin e kënaqësisë dhe angazhimit.

Fjalët kyçe: kënaqësi në punë, angazhim organizacional, diferenca gjinore,

## Hyrja

Kënaqësia në punë është studiuar gjerësisht si koncept dhe fillesat e studimeve rreth këtij koncepti kanë nisur që me studimet e Hawthorne, pasi eksperimenti i këtij të fundit sugjeroi se punëtorët performuan më mirë jo nga përmirësimi i kushteve të punës, por prej faktit se ata ishin nën vëzhgim. Ky zbulim i shtroi rrugën hetimit të fenomenit të kënaqësisë në punë, duke e parë fillimisht si të lidhur me produktivitetin, e më pas, gjatë dekadave të fundit është studiuar dhe parë se si ky koncept korrelohet pozitivisht me angazhimin organizacional. Ndërsa nga ana tjetër koncepti i angazhimit organizacional është relativisht më i ri krahasuar me kënaqësinë në punë. Sipas Bakker & Leiter (2010) organizatat kanë nevojë për punonjës energjik dhe të përkushtuar për të ecur përpara. Sipas tyre punonjësit e angazhuar janë plotësisht të përfshirë në punën e tyre dhe janë entuziastë për rolin e tyre në organizatë. Kohët e fundit koncepti i kënaqësisë në punë është studiuar edhe në lidhje me angazhimin organizacional dhe është parë që ekziston një lidhje pozitive ndërmjet tyre. (Raporti i SHRM 2010). Gjithsesi literatura mbështet edhe pikëpamjen tjetër që nuk paraqet ndonjë lidhje domethënëse midis këtyre dy variablave, ndaj kjo temë ia vlen të shqyrtohet më tej.

## Hipotezat

1. Hipoteza 1: Ekziston një lidhje pozitive korrelacionale midis kënaqësisë në punë dhe angazhimit organizacional të punonjësve të CCCI në Tiranë.
2. Hipoteza 2: Ekzistojnë diferenca gjinore ndërmjet femrave dhe meshkujve në nivelin e kënaqësisë në punë dhe angazhimit organizacional të punonjësve të CCCI në Tiranë.

## Qëllimi:

Të studiojë lidhjen që ekziston ndërmjet kënaqësisë në punë dhe angazhimit organizacional, natyrën dhe fortësinë e lidhjes midis këtyre dy variablave duke vënë theksin tek diferencat gjinore.

## Objektivat:

1. Të masë nivelin e kënaqësisë në punë te punonjësit e CCCI.
2. Të masë nivelin e angazhimit organizacional te punonjësit e CCCI.
3. Të studiohet korrelacioni midis kënaqësisë në punë dhe angazhimit organizacional.
4. Të hetohen diferencat gjinore mes femrave dhe meshkujve në nivelin e kënaqësisë në punë dhe angazhimit organizativ.

### **1. Rishikimi i literaturës**

#### **1. 1 Cilësia e shërbimit**

Pavarësisht nga përdorimi i gjerë në kërkimet shkencore, si dhe në jetën e përditshme, ende nuk ka një marrëveshje të përgjithshme në lidhje me çfarë është kënaqësia në punë. Autorë të ndryshëm, kanë qasje të ndryshme në përkufizimin e kënaqësisë në punë. Megjithatë përkufizimi përkufizimi mbi të cilin është ndërtuar ky studim është ai i dhënë nga Thompson & Phua (2011) sipas të cilëve, kënaqësia në punë është sa i lumtur është një individ me vendin e punës. Ata dallojnë kënaqësinë afektive nga ajo kognitive. E para lidhet me emocionet pozitive që ka punonjësi lidhur me vendin e punës në tërësi, ndërsa e dyta me masën me të cilën individët janë të kënaqur me aspekte të caktuara të punës si paga, shpërblimet, orët e punës dhe aspekte të tjera, Moorman (1993).

#### **1. 2 Angazhimi Organizacional**

Ekzistojnë dy qasje kryesore teorike ndaj angazhimit organizacional. Qasja e parë vjen nga Maslach & Leiter (1997). Këta dy autorë argumentojnë se angazhimi karakterizohet nga energjia, përfshirja dhe efikasiteti, që praktikisht janë antidote të Burnout. Qasja e dytë vjen nga Schaufeli, Salanova, Gonzalez-Roma dhe Bakker (2002). Këta studiues e shohin angazhimin organizacional si një gjendje mendore pozitive që karakterizohet nga gjallëria, përkushtimi dhe asimilimi. Studime të shumta e kanë validuar empirikisht këtë model 3 faktorial gjatë kohës së punimit për hartimin e Shkallës së Angazhimit në Punë

të Utrehtit (SHAPU) nga (Schaufeli dhe kolegët 2002; Schaufeli dhe Bakker, 2004; Schaufeli, Taris dhe Rhenen, 2008). Ndaj mbi këtë përkufizim bazë është ndërtuar ky studim.

### **1.3 Mbështetja teorike e hipotezave**

Studime të mëparshme kanë treguar një lidhje pozitive midis kënaqësisë në punë dhe angazhimit organizacional. Më konkretisht Saks (2006) zbuloi se angazhimi në punë kishte lidhje pozitive me kënaqësinë në punë si dhe ekzistonte një korrelacion negativ midis saj dhe synimeve për ta lënë punën. Kamalanabhan dhe kolegët (2009) kanë vërtetuar se angazhimi organizacional i punonjësve ndikon pozitivisht kënaqësinë në punë në industrinë e IT.

## **2. Metodologjia**

### **2.1 Dizajni i kërkimit**

Studimi në fjalë ka natyrë joeksperimentale dhe është studim korrelacional, pasi qëllimi kryesor i tij është të hetojë marrëdhënien që ekziston midis kënaqësisë në punë dhe angazhimit organizacional.

### **2.2 Kampioni**

Në përzgjedhjen e të anketuarve është përdorur metoda e kampionimit rastësor. Ky kampion është një ndër metodat e kampionimit me probabilitet dhe konsiderohet si një metodë e shkëlqyer e mbledhjes së të dhënave që i jep mundësi të barabarta përfaqësimi të gjithë popullatës dhe shmang njëanshmërinë. Madhësia në total e kampionit është  $N=60$ . Në këtë kampion, 51.6% ( $n=31$ ) ishin femra dhe 48.4% ( $n=29$ ) ishin meshkuj. Mosha e pjesëmarrësve varionte nga 22 deri në 42 vjeç.

### **2.3 Instrumentet**

Të dhënat primare janë mbledhur nëpërmjet aplikimit të dy pyetësorëve. Pyetësorët përmbajnë pyetje të strukturuar, që lidhen me variablat e studimit dhe që masin përkatësisht kënaqësinë në punë dhe angazhimin organizacional.

Pyetësi i kënaqësisë në punë përbëhet nga 15 pohime dhe kënaqësia në punë ndahet në 6 komponentë si mjedisi i punës, paga dhe shpërblimet, drejtuesit e organizatës, njohjen dhe reputacionin që gëzojnë në punë. Ky pyetësor përdor një shkallë Likert 5 pikëshe ku 1 tregon shkallën më të ulët të pajtimit “aspak dakord” dhe 5 tregon pajtueshmëri të lartë me pohimin “plotësisht dakord”. Instrumenti është produkt i punës kërkimore të shoqatës PMW Associates si dhe është i standartizuar për kontekstin amerikan.

Pyetësi i Angazhimit Organizacional është ndërtuar mbi bazën e Utrecht Work Engagement Scale (Schaufeli & Bakker 2003), dhe është ripunuar nga Paul Marciano (2006). Përbëhet nga 10 pohime dhe secili prej tyre mat tre aspektet kryesore të angazhimit si gjallëria, përkushtimi dhe asimilimi. Shkalla matëse e secilës pyetje është Shkalla 5 pikëshe Likert, ku 1 tregon shkallën më të ulët të pajtimit me pohimin, ndërsa 5 shkallën maksimale të dakordimit. Maksimumi i pikëve që mund të grumbullohet është 50 pikë ndërsa minimumi është 10 pikë. Sa më i lartë niveli i pikëve aq më i lartë niveli i angazhimit dhe anasjelltas.

## 2. 4 Aspektet etike

Gjatë mbledhjes së të dhënave i është kushtuar një vëmendje e veçantë respektimit rigoroz të standarteve etike të studimit. Të anketuarit janë garantuar për ruajtjen e anonimatit dhe konfidencialitetit të të dhënave të tyre dhe të pyetësorëve. Gjithashtu ata janë njoftuar se pjesëmarrja në studim është falas dhe se ata gëzojnë lirinë për t’u tërhequr nga pjesëmarrja në studim në cdo moment.

## 2. 5 Limitet e studimit

Disa nga limitet e këtij studimi lidhen me kampionimin. Rezultatet e këtij studimi nuk mund të përgjithësohen për të gjithë popullatën pavarësisht metodës së probabilitare të kampionit për shkak të madhësisë së kampionit. Një tjetër limit është mungesa e literaturës në shqip dhe e studimeve të mëparshme rreth lidhjes së këtyre dy variablave. Instrumentet e përdorur janë të pastandardizuar për kontekstin shqiptar. Si dhe limite që lidhen me metodologjinë - Ky studim ka qasje sasiore. Ndërthurja me metoda cilësore do të mundësonte një fotografim më të plotë të realitetit.

### 3. Testimi i hipotezave

Lidhja që ekziston ndërmjet dy variablave është studiuar me anë të analizës së korrelacionit Pearson. Nga tabela rezultojnë që ekziston një lidhje statistikisht e rëndësishme dhe pozitive ndërmjet KP dhe AO ku ( $r=0.42$ ,  $p<0.01$ ). Domethënë me rritjen e kënaqësisë në punë rritet dhe angazhimi organizacional dhe anasjelltas. Bazuar arsyetimin e mësipërm vërtetohet Hipoteza 1. Për të hetuar diferencat gjinore nivelin e angazhimit organizacional u përdor procedura e analizës së variancës ANOVA. U vërejt që nuk ekzistonin diferenca statistikisht të rëndësishme ndërmjet femrave dhe meshkujve në pyetësorin e cilësisë së shërbimit ku,  $F(1,58) = 0.00$ , dhe  $p=0.98$  pra  $p > 0.05$ . Ndërsa nga krostabulimi i gjinisë me nivelin e kënaqësisë rezultojnë se ( $n=13$ ) meshkujt janë përgjigjur se janë plotësisht të kënaqur, ndërsa ( $n=11$ ) femrat kanë pohuar se janë plotësisht të kënaqura. Pra pavarësisht se mesataret e grupeve janë të ndryshme gjithësesi nga pikëpamja statistikore hipoteza dy hidhet poshtë.

### 4. Diskutime

Konfirmimi i hipotezës së parë mbështet nga rezultati i studimit të Saks (2006), i cili zbuloi se angazhimi organizacional kishte lidhje pozitive me kënaqësinë në punë. Gjetjet e Kamalanabhan dhe kolegëve (2009) të cilët kanë studiuar lidhjen mes angazhimit organizacional të punonjësve dhe kënaqësisë në punë në industrinë e IT, konfirmojnë të njëjtën hipotezë. Gjithashtu edhe sipas Statt (2004) niveli i kënaqësisë në punë varet nga masa me të cilën punonjësi është i kënaqur me shpërblimet që merr nga puna dhe se kjo e bën atë të jetë më i angazhuar drejt përmbushjes së objektivave dhe qëllimeve të organizatës. Por nga ana tjetër kjo gjetje bie në kundërshti me gjetjet e Bakker & Leiter (2010), të cilët pohojnë se koncepti i kënaqësisë në punë dhe ai i angazhimit organizacional, janë tërësisht të ndryshëm në thelb dhe se nuk kanë kurrëfarë pikëprerje ndërmjet tyre.

Gjetja se nuk ka diferenca statistikisht mes femrave dhe meshkujve në nivelin e KP dhe AO është surprizuese pasi sipas Kanter (1977) femrat dhe meshkujt vlerësojnë aspekte ose karakteristika të ndryshme të punës së tyre. Rrjedhimisht secili prej tyre mund të jetë i kënaqur me aspekte specifike të punës së tyre, por jo me punën në tërësi. Një tjetër arsye është se femrat

përqëndrohen në rolet e tyre si shtëpiake më shumë se sa në rolet e tyre në punë. Gjithsesi studimet që përkrahin pikëpamjet e dallimeve gjinore janë studime të hershme dhe vlen për t'u theksuar fakti se pozita e femrës në shoqëri ka ndryshuar dhe mund të spekulohet se të dhënat tona paraqesin pikërisht këtë realitet të ri. Gjithsesi lipset punë e mëtejshme kërkimore për të zbardhur plotësisht faktorët ndikues.

### 5. Rekomandime

Në këtë seksion do të paraqiten disa rekomandime të cilat do të ndihmonin organizatën në njohjen e mëtejshme të koncepteve si kënaqësia në punë apo angazhimi organizacional. Bazuar në gjetjet e këtij ministudimi, do të paraqiten disa hapa të thjeshtë dhe praktik që mund organizata mund t'i implementojë brenda strukturave të saj dhe departamenteve përkatëse. Së pari lind si nevojë rishikimi i politikave të nxitjes dhe motivimit të punonjësve pasi koncepti i kënaqësisë dhe angazhimit është i lidhur ngushtësisht të lidhur me to. Një tjetër component për t'u marrë në konsideratë është zhvillimi i potencialit të personelit përmes trajnimeve si në aspektin teknik ashtu edhe individual. Gjithashtu edhe përfshirja e tyre në procese të ndryshme që lidhen me punën duke iu dhënë atyre mundësi të kontribojnë me ide dhe sugjerime. Së fundi vlerësimi dhe matja e vazhdueshme e nivelit të kënaqësisë dhe angazhimit organizacional krahas vlerësimit të performancës.

### Bibliografia

Armstrong, M. (2006). A Handbook of Human resource Management Practice, Tenth Edition, Kogan Page Publishing, London, , p. 264

Aziri, B. (2008). Human resource Management Practice, Job Satisfaction and Employee Motivation Tringa Design, p. 46

Bates, S. (2004) 'Getting engaged', HR Magazine, Vol 49, No 2, pp44-51

Davis, K. and Nestrom, J.W. (1985). Human Behavior at work: Organizational Behavior, 7 edition, McGraw Hill, New York, p.109

Harper. Cufaude, J. (2004) in Lanphear, S. (2004). 'Are Your Employees Highly Engaged'

Hoppock, R. (1935). Job Satisfaction, Harper and Brothers, New York, p. 47

Goffman, E. (1961) Encounters: Two Studies in the Sociology of Interaction. Indianapolis, Bobbs-Merrill Co. in Ferguson, A. (2007) 'Employee engagement: Does it exist, and if so, how does it relate to performance and organizational engagement. Engaged?' Credit Union Executive Newsletter, 19, 1-2. Credit Union National Association, US. Deci, E.L. and Ryan, R.M. (1987) 'The support of autonomy and the control of behaviour', Journal of Personality and Social Psychology, 53, pp1024-1037.

Locke, Edwin A. (1969) 'What is job satisfaction?', Organisational Behaviour and Human Performance 4: 309–336 May, D.R. Gilson, R.L. and Harter, L.M. (2004) 'The psychological conditions and the engagement of the human spirit at work', Journal of Occupational and Organisational Psychology, Vol 77, pp11-37.

McCashland, C.R. (1999) 'Core Components of the service climate: Linkages to customer satisfaction and profitability'. Dissertation Abstracts International. University Microfilms International, USA.

Merton, R.K. (1957) Social Theory and Social Structure. New York, Free Press of Glencoe in Ferguson, A. (2007) 'Employee engagement: Does it exist, and if so, how does it relate to performance, other constructs and individual differences?'

Miles, R.H. (2001) 'Beyond the age of Dilbert: Accelerating corporate transformations by rapidly engaging all employees', Organisational Dynamics, 29(4), pp313-321.

Moorman, R.H. (1993). "The influence of cognitive and affective based job satisfaction measures on the relationship between satisfaction and organizational citizenship behavior". *Human Relations* 6: 759–776.

Moore, K. (2004) 'The healthy balance among work, family, and personal relationships: Fact or fiction?' *Proceedings of the APS Psychology of Relationships Interest Group 4th Annual Conference*, pp79-84.

Mullins, J.L. (2005). *Management and organizational behavior*, Seventh Edition, Pearson Education Limited, Essex, p. 700

Rue, L.W. and Byars, L. (2003). *Management, Skills and Application*, 10 ed., McGraw-Hill/Irwin, New York, p. 259

Robinson, D., Perryman, S. and Hayday, S. (2004) *The Drivers of Employee Engagement*. Brighton, Institute for Employment Studies.

Rothbard, N. (1999) 'Enriching or depleting? The dynamics of engagement in work and family'. *Dissertation Abstracts International US: University Microfilms International*, 59.

Saks, A.M. (2006) 'Antecedents and consequences of employee engagement', *Journal of Managerial Psychology*, Vol 21, No 6, pp600-619.

Schaufeli, W.B. and Bakker, A.B. (2004) 'Job demands, job resources, and their relationship with burnout and engagement: a multi-sample study', *Journal of Organisational Behaviour*, Vol 25, pp293-315.

Spector, P.E. (1997). *Organizational Engagement: Application, assessment, causes and consequences*, Thousand Oaks, CA, Sage Publications, Inc

Thompson, E.R.; Phua F.T.T. (2011). "A Brief Index of Affective Job Satisfaction". *Group & Organization Management* 37 (3): 275–307. doi:10.1177/1059601111434201.

Vroom, V.H. (1964). *Work and motivation*, John Wiley and Sons, New York, p.99

## The Heritage

Vanderberg, R.J. and Lance, Ch.E. (1992). Examining the Causal Order of Job Satisfaction and Organizational Engagement, *Journal of Management*, Vol.18, No.1, pp

Yeung, R. (2006) 'Getting engaged', *Accountancy*, Vol 138, No 1360, pp58-59.

Wilson, F. (2004) *Organisational Behaviour and Work, A Critical Introduction*. 2nd ed. Oxford, Oxford University Press.